

ECONOMICUS

NR 5/2010

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT EKONOMIK

Kryeredaktor

PROF. ASOC. DR. ADRIAN CIVICI
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS (UET)

Këshilli botues

PROF. ASOC. DR. LULJETA MINXHOZI
PROF. ASOC. DR. FATOS IBRAHIMI
DR. KRESHNIK BELLO
DR. GJERGJI FILIPI
DR. SELAMI XHEPA
DR. NEVILA XHINDI
DR. SHKËLZEN MARKU
MSC. ILIR HOTI

Arti grafik

ALTIN ÇEÇO

përmbajtja

Kriza financiare 2007–2009:

tronditja dhe pikëpyetjet mbi efektivitetin e kapitalizmit..... 5

Prof.Ass.Dr. Adrian CIVICI

1. Analiza & kërkime

Impakti i Ekspozimit në Rrezik i Industrisë Bankare në Shqipëri 19

Doc. Ilir HOTI

Sa ndikohet PBB – ja nga krediti bankar dhe standartet e kredithënies?

Një Panel për Eurozonën..... 35

Arjan Kadareja, PhD

Roli dhe objektivat e AMF si rregullator i tregjeve financiare

jobankare në Shqipëri..... 47

Elisabeta Gjoni, Anxhela Dervishi

Politikat e bankës qendrore të Shqipërisë gjatë krizës globale 55

Besart Kadia MSc

2. DOSSIER : Tregjet Financiare

Ndërmjetësit financiarë jo banka në Shqipëri..... 63

Dr. Brunilda Duraj, Artan Santo

Bursat e kapitaleve – një sfidë ende për t'u ndërmarrë. Realiteti i Shqipërisë 77

Dr. Elvin MEKA, Gjergji Filipi, PhD

Tregu i kapitaleve në Shqipëri, nevoja për një bursë të re me kapital privat 91
Artan Gjergji MA, Enkela Idrizi MBA

Zhvillimet globale dhe tregu financiar në Shqipëri 105
Kreshnik Bello Dr, Ilia Kristo Prof. Dr, Edmond Bello Mba, Artur Temo Msc

Krijimi i tregut privat të pensioneve në Shqipëri. Sfidat, perspektivat 115
Naim Hasa, MA Ermela Kripa

Roli i mjeteve financiare që ndikojnë në fondet private të pensioneve 125
M.Sc. Albana Demi, Armando Mosho

Shoqëritë e kursim-kreditit, sfida në kreditimin e ekonomive të vogla dhe përballja me konkurrencën e bankave tregtare 133
Doktorante Arlinda Hoti, Zana Komini

Risku i kredidhënies në Shqipëri 145
MA. Majlinda Gjata, MA. Evis Gjebrea

Drejt një mbikqyrje efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri 153
MSc Rinald Guri, MA Anxhela Dervishi

3. Argument - Debat

Financimi i qeverisjes vendore – sfidat bashkitë, komunat dhe sistemin bankar . 165
Ornela Shapo (Këmbora), MA. Ardiana Sokoli, Dr. Anilda Bozdo

Kreditimi i njësiave të qeverisjes vendore dhe roli i fondeve të zhvillimit 179
Benet Beci, Enea Hoti, Blendi Bushati

Aktiviteti financiar i njësiave dhe sfidat e sistemit financiar në shqipëri 191
Dr. Fatbardha Molla (Beqiri), Prof. PhD. Flutura Kalemi

<i>Pse nuk ishin efektive uljet e kontributeve për sigurimet shoqërore për periudhën 2005–2009</i>	<i>201</i>
<i>Illir Begja, Mba Enea Zafiri</i>	
<i>Analiza e mjeteve financiare në shpenzimet e marketingut në sektorin bankar shqiptar.....</i>	<i>213</i>
<i>Jonida Këllezi MA, Valbona Zeneli PhD candidate, Oltjana Zoto MA</i>	
<i>Menaxhimi dhe mundësitë e mikrofinancës në vendet në zhvillim: rasti i Shqipërisë</i>	<i>225</i>
<i>Prof.Asoc.Dr. Magdalena Bregasi , Dr.Eda Luga</i>	
<i>Një këndvështrim etik mbi krizën financiare</i>	<i>239</i>
<i>Dr. Kreshnik Bello, MSc. Artur Temo, MBA Edmond Bello</i>	
<i>Abstracts</i>	<i>247</i>

Kriza financiare 2007–2009: tronditja dhe pikëpyetjet mbi efektivitetin e kapitalizmit

— Prof.Ass.Dr. Adrian CIVICI —

ABSTRAKT. Më shumë sesa për një krizë, flitet “për një transformim rrënjësor të natyrës dhe të sjelljes së kapitalizmit”. Ndoshta e gjithë kjo duhet konsideruar si një “revolucion shumëdimensional”; “revolucion ekonomiko-financiar”, që korrespondon me fundin e ciklit neoliberal të globalizimit, i cili filloi në fund të viteve 1970 dhe u karakterizua nga një tërheqje drastike e shtetit nga ndërhyrja në ekonomi, nga sundimi i politikave derregulluese e liberalizuese, nga primati i politikave financiare e monetare mbi ato ekonomike e sociale; “Revolucion gjeopolitik” që po përmbys hierarkinë e shteteve dhe të kontinenteve, duke shënuar tkurrjen e fuqisë së vendeve të zhvilluara perëndimore, përfshirë këtu dhe SHBA-në, dhe daljen në skenë të “superfuqive të reja të jugut”, të rreshtuara së bashku me Kinën, Indinë, Brazilin, etj; “Revolucion intelektual” dhe ideologjik që e shkurorëzoi neokonservatorizmin dhe mitin e “aftësisë magjike vetërregulluese” të tregjeve. Ja përse në gjithë këtë vorbull hamendjesh, analizash e komentesh ka filluar të gjejë vend një përfundim i përbashkët: “është vitale të mos gabohemi në lidhje me natyrën e kësaj krize”. Nuk duhet ngushtuar fokusi duke e parë vetëm si një krizë likuiditeti, por si një krizë shumë më komplekse, që preku kreditin, sistemin financiar, sektorin imobiliar, rritjen ekonomike, punësimin, konsumin, mjedisin, modelin e zhvillimit, etj. Dhe mbi të gjitha, nuk bëhet fjalë vetëm për një krizë amerikane, por për një krizë më globale, të cilën mund ta cilësojmë edhe si “krizën e parë të kapitalizmit universal”. Nuk bëhet fjalë thjesht dhe vetëm për një krizë financiare, por për një krizë të madhe ekonomike që vë në pikëpyetje mjaft vlerësime për kapitalizmin dhe mënyrën sesi ka evoluar ai këto 30–40 vitet e fundit. Pra, në fund të fundit, e gjithë kjo nuk duhet konsideruar si një “aksident në rrugë e sipër”, por si një “kthesë historike” në zhvillimin e ardhshëm të planetit, kthesë e cila pritet që të na shfaqë përpara një tablo të modifikuar gjeopolitike dhe hierarkike të superfuqive ekonomike e financiare të shekullit XXI.

Fjalët kyçe:

krizë financiare, kapitalizëm, tregje financiare, recesion, modeli ekonomik.

Çfarë ndodhi me kapitalizmin?

Në vitin 1989, një ekonomist i ri amerikan i quajtur Paul Krugman, publikoi një libër të titulluar “The age of diminished expectations” (“Koha e shpresave të kufizuara”), i cili shkaktoi shumë polemika e diskutime. Krugman-i, që 20 vite më vonë do të laureohej me çmimin Nobel në ekonomi, lajmëronte për rreziqet që i kanoseshin botës dhe sidomos shoqërive perëndimore, nëse ato vazhdonin të besonin verbërisht në mundësitë e pafundme të zhvillimit dhe të konsumit. Sipas tij, gjeneratat e ardhshme nuk do të kishin mundësi që të shpresonin për një nivel jetese shumë më të mirë sesa prindërit ose gjyshërit e tyre. Ata duhet të ishin të kujdesshëm në administrimin e ambicieve të tyre. Zhvillimi dhe progresi i jashtëzakonshëm, i nisur që në vitet 60-të të shekullit XX, nga brezi i të ashtuquajturve « baby boom », nuk mund të vazhdonte pa limit. Dhe e gjithë kjo thuhej në vitin 1989, vit në të cilin më shumë se kurrë besohej se triumfi i kapitalizmit perëndimor evropian ose anglo-sakson ishte i padiskutueshëm. Rënia e murit të Berlinit dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, që Presidenti Regan, e kishte cilësuar si “perandoria e së keqes”, si dhe përpjekjet titanike të Gjermanisë për t’u unifikuar u cilësuan si “sakrifica e fundit” në rrugën drejt progresit të pandalshëm.

Presidenti Xhorxh Bush në krye të agjendës së tij vuri krijimin e “rregullit të ri botëror” duke synuar që ta “eksportonte” sa më shpejt dhe përfundimisht demokracinë dhe ekonominë e tregut në të gjithë botën, por veçanërisht në vendet e Evropës Lindore, në ish-republikat e Bashkimit Sovjetik dhe në Kinë. Kjo u konsiderua si përpjekja më e madhe në histori për të imponuar modelin dhe filozofinë perëndimore të zhvillimit në botë. E gjithë Evropa Lindore filloi periudhën e tranzicionit “nga shteti tek tregu”, duke filluar gradualisht të bëhej pjesë dhe të integrohej në Evropën Perëndimore, duke synuar standardet e saj të zhvillimit dhe të jetesës. Dukej se asgjë nuk mund ta ndalte “marshimin drejt mirëqenies dhe konsumit”. Fundit të luftës së ftohtë duket se ia vuri vulën një tjetër libër i famshëm i titulluar “Fundi i historisë”, i filozofit Francis Fukajama, sipas të cilit “me vdekjen e ideologjisë totalitare të komunizmit në botë mbetej vetëm ideologjia liberale perëndimore”. Pra, rroftë kapitalizmi triumfues që nuk ka më as rivalë e as pengesa në rrugën e përjetshme të tij. Në këtë frymë u pranuan me shumë entuziazëm dhe idetë e John Kenneth Galbraith-it, i cili duke u përpjekur të bashkonte optimizmin idealist të Presidentit Xhon Kenedi, rolin e shpenzimeve publike dhe të shtetit të John Keynes-it, efektet e tregut të lirë dhe vullnetin e mirë të qeverive, besonte se gjithçka ishte e mundur drejt rrugës së progresit.

Ndërkohë, në kontinentin aziatik, veçanërisht në Kinë, nën frymëzimin e ideve të Ten Siao Pin-it u hap epoka e “ndryshimit të madh”. Kina zbuloi rrugën drejt zhvillimit ekonomiko-social dhe drejt mirëqenies për qindra milionë njerëz, që asnjëherë në historinë e saj nuk kishin besuar e shpresuar se mund të bëheshin si Evropa ose si perëndimi. Por, edhe vende të tjera rrotull Kinës si Hong-Kongu, Koreja e Jugut, Taivani e Singapori u zhvilluan me shpejtësi marramendëse duke u quajtur “Dragonjtë e Azisë”. Rusia së bashku me Indinë, me Kinën dhe me Brazilin, vende

që zinin rreth 35% të sipërfaqes së globit dhe ku jetonin mbi 40% e popullsisë së botës njohën ritme marramendëse rritjeje ekonomike duke i dhënë jetë një kategorie të re vendesh të quajtura “ekonomitë emergjente” ose vendet me zhvillim të shpejtë. Natyrisht që në këtë rrugë të jashtëzakonshme drejt zhvillimit pati dhe disa “viktima” të tilla si kriza japoneze, kriza argjentinase, kriza braziliane, etj., por ato u cilësuan si “kalimtare” dhe me efekte lokale. Pas 11 shtatorit 2001, armiku kryesor i perëndimit dukej se ishte vetëm Al Kaeda dhe Bin Laden-i, të cilët në një farë mënyre dukej se përfaqësonin revoltën e botës myslimane të pazhvilluar kundrejt perëndimit fitimtar.

Të gjithë këtë “boom” të pandalshëm drejt zhvillimit, Luttwak-u, një nga këshilltarët e Presidentit Regan, do t’a cilësonte si “epoka e turbokapitalizmit”. Të çliruar nga “vargonjtë e ideologjive” me qindra milionë njerëz në perëndim e në lindje, në jug e në veri u pasuruan me shpejtësi dhe filluan të konsumojnë sikur të ishin prej kohësh të pasur. Në Lindjen e Mesme ose në Amerikën Latine ishin të shumtë ata që e ndryshuan si me magji statusin e tyre social mbas dekadash të tëra vuajtjesh dhe varfërie. Turbokapitalizmit iu shtua dhe një shok i ri i quajtur si “turbofinancat”. Wall Street-i në New York dhe City në Londër u bënë qendrat e kapitalizmit financiar botëror. Teoria dhe praktikat e “creative finance” filluan të pushtojnë botën. Paraja filloi të prodhonte para pa asnjë kufizim. Produkte financiare, të panjohura deri tani, prodhohin çdo ditë milionerë e miliardë të rinj. Bota e financave u bë mbretëresha absolute e zhvillimit dhe e mirëqenies. Tregjet financiare u bënë tregjet më të zhvilluara dhe më të sofistikuara të botës. Por pikërisht, në këtë kontekst euforie ndërkombëtare, si rrufe në qiell të hapur, shpërtheu kriza financiare që tronditi nga themelet ekonominë dhe financat botërore, që vuri në pikëpyetje edhe vetë kapitalizmin si sistem.

Pikëpyetja e madhe: krizë financiare apo globale?

Sapo kishte mbaruar pranvera e vitit 2007! Në mënyrë krejt të papritur fjala e tmerrshme “krizë financiare” filloi të përhapej me shpejtësi. E lindur në SHBA, ajo dukej se shumë shpejt do të mbulonte me panik gjithë botën. Fjala “subprimes” që deri në këtë periudhë kishte shprehur vetëm njërën nga format e kredisë hipotekore me risk të lartë në SHBA, u bë menjëherë simbol i tmerrshëm i krizës. Ndërkohë që Amerika filloi të publikonte llogaritë e para të humbjeve financiare marramendëse, bankat dhe tregjet financiare të të gjithë botës filluan të dridhen. Flitej për mijëra, miliarda dollarë të humbur dhe po kaq të nevojshëm për ta përballuar këtë krizë.

U bënë shumë krahasime me krizën e depresionit të madh të viteve 1929-33 dhe pothuajse të gjithë u shokuan. A na priste i njëjti skenar katastrofik si ai i të “enjtës së zezë” të 24 tetorit 1929, i cili gjithashtu ishte pasojë e një “fluske financiare” gigante spekulative? A i kishte ardhur fundi vet kapitalizmit si sistem, ose edhe këtë radhë faji duhej kërkuar te kapitalistët e këqinj dhe te “mjeshtërit e financave botërore” të Wall Street-it? A duhej vënë me shpatulla për muri globalizimi si shkaktari kryesor i lindjes dhe i përhapjes së saj? A duhej vënë pikëpyetje mbi shumë teori e koncepte ekonomiko-financiare me të cilat ishte vepruar e analizuar sistemi financiar deri tani?

A ishte vetëm një krizë financiare apo prapa saj fshiheshin dhe pritej të shfaqeshin frikshëm kriza të llojeve e të natyrave të tjera?

Shumë ekspertë e akademikë nxituan të deklaronin “fundin e palavdishëm të liberalizmit” dhe domosdoshmërinë e rikthimit dhe të rivlerësimit të John Maynard Keynes-it dhe të teorisë së tij të prezencës dhe të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Ndërsa disa të tjerë shkuan edhe më tej: i dhanë të drejtë Karl Marksit dhe teorisë së tij mbi natyrën dhe krizat e kapitalizmit. Në shumë librari u shfaqën klientë të rinj që kërkonin “Kapitalin” e Marksit, ndërkohë që u nxitua të deklarohej se tekstet dhe lëndët universitare që trajtonin problematikën e “Creative finance” duheshin hequr nga përdorimi menjëherë. Kësaj klime i shkoi shumë për shtat edhe një deklaratë pendimi e gurusë së financave botërore, ish-drejtnesit legjendarë të Federal Reserve në SHBA, Alain Grinspeen, i cili deklaroi publikisht se ndoshta ishte gabuar në vlerësimin absolut që i kishte bërë rolit të parës, financave dhe tregjeve financiare për zhvillimin dhe stabilitetin e botës.

Në kulmin e krizës ishte më se e natyrshme që të pritej me interes dhe emri i atij që do të kandidohej për çmimin “Nobel në ekonomi”. Dhe me sa duket, mesazhi dhe vlerësimi i Akademisë Mbretërore Suedeze ishte në drejtimin që pritej. Çmimi kurorëzoi ekonomistin amerikan Paul Krugman, një nga kritikët më të mëdhenj të politikës ekonomike e financiare amerikane të Presidencës Bush, ekonomist i njohur dhe i identifikuar si “neokeynesian dhe përkrahës i teorisë së nevojës së ndërhyrjes së shtetit për të rregulluar devijimet dhe çrregullimet e tregut”. Profesori i shquar i universitetit të Princeton-it, MIT Boston dhe editorialist i spikatur i New York Times, që tashmë ishte 20 vjet më i madh sesa në vitin 1989 kur shprehu publikisht dyshimet e tij mbi “të ardhmen e garantuar të kapitalizmit si sistem i mbizotëruar nga shoqëria e konsumit” u laureua veçanërisht për faktin se bënte pjesë në një grup të vogël studiuesish që e kishin “parashikuar” rrezikun e krizës financiare aktuale duke evidentuar dhe faktorët që e shkaktojnë atë. Për të gjithë lexuesit, politikanët dhe analistët u vlerësua si profetik libri tjetër i Krugman-it, botuar në 2001, me titullin tundues “Rikthimi i ekonomisë së depresionit. A po shkojmë drejt një krize të re si ajo e 1929-ës?”. Fatkeqësisht, as në vitin 1989 kur botonte “Koha e shpresave të kufizuara” dhe as në 2001-in Krugmani nuk u dëgjua.

Dhe pyetjet e pikëpyetjet vazhdonin....A do mbetej kjo një krizë financiare apo do zgjerohej shpejt në një krizë ekonomike e sociale ndërkombëtare? Dhe vjen dilema edhe më e vështirë: a mund të përballohej “normalisht” kjo krizë? Pasojat e saj mund të provokonin një kaos ndërkombëtar? A ishte thjesht një krizë financiare apo tek ajo ndërthureshin bashkë disa kriza njëherësh? “Plani Paulson”, “Plani Bush”, “Plani Sarkozy”, “Plani Brown”, “Propozimi Merkel”, “vendimet e FED-së”, “pozicioni i Bankës Qendrore Europiane”, “rekomandimet e FMN-së”, “vlerësimi i OCDE-së”, “pozicioni i J.C. Trichet dhe B.Bernankes”, etj., u bënë levat dhe mekanizmat nga të cilat pritej shpëtimi. Vetëm për “Planin Paulson”, Presidenti Bush foli 14 herë publikisht gjatë 15 ditëve kur pritej miratimi i tij, gjë që nuk kishte ndodhur asnjëherë me presidentët amerikanë.

Por si u arrit deri këtu? Deri në këtë kohë dukej se gjithçka në botë shkonte për mbrekulli. ShBA, Europa, Kina, etj., kishin një rritje ekonomike të pëlqyeshme dhe konstante; rritja ekonomike e gjithë planetit ishte nga më të shpejtat në gjithë historinë e tij; varfëria filloi të zvogëlohej në Azi dhe në Amerikën Latine; demokracia, liritë individuale dhe ato politike dukej se po përhapeshin në çdo cep të globit; shkenca dhe teknologjia ndodheshin në një progres mjaft dinamik duke i krijuar gjithnjë e më shumë botës mundësi për t'u orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm; me qindra miliona njerëz, kryesisht në vendet në zhvillim dhe në ato me ekonomi emergjente po bëheshin gati për t'u futur në klasën e mesme duke përshtatur modele jete e konsumi të tipit përëndimor, modele që deri në këtë kohë kishin qenë një ëndërr e largët.

Dhe ja, pa asnjë paralajmërim ose shenjë të dukshme që mund të tërhiqte seriozisht vëmendjen, një mëngjes korriku të vitit 2008 ekonomitë dhe sistemet financiare më të fuqishme të planetit filluan rrugën drejt një depresioni të dhimbshëm, më i rëndi i tetëdhjetë viteve të fundit. Goditja që i dha kapitalizmit kjo krizë u krahasua me goditjen befasuese të japonezëve ndaj amerikanëve në Pearl Harbor në dhjetor të vitit 1941: një surprizë e plotë, një ndryshim i frikshëm dhe një ecje drejt një të panjohure të madhe. Dhe bashkë me të, filluan dhe reflektimet e debatet mbi shkaqet e krizës, mbi fajtorët që e shkaktuan atë. U hartuan planet urgjente të veprimit për stopimin dhe kontrollin e saj. Filozofia dominuese e kësaj kohe dhe kolona vertebrale e masave u bë shprehja e famshme e Keynes-it “kur një ekonomi është duke u zhytur thellë e më thellë në gropë, veprimi i parë, më i rëndësishëm është stopimi i zhytjes së mëtejshme dhe nxjerrja nga gropa”. Nën këtë këndvështrim filluan të hartohen politikat financiare e ekonomike të domosdoshme, u bënë plane veprimi mbi llogaritjen e kostove dhe të kohës së mundshme të daljes prej saj, u ndërmorën veprimet e menjëhershme e dinamike të mjaft qeverive e bankave qendrore për t'i ngritur asaj të gjitha “barrikadat” e mundshme të përhapjes dhe të infektimit të të gjithë sistemit financiar e ekonomik botëror, etj.

Në këtë luftë të paprecedentë u angazhuan të gjithë, institucionet ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, OCDE-ja, etj., bankat qendrore të pothuajse të gjitha vendeve të botës, si Federal Reserve në SHBA, Banka Qendrore Evropiane, Banka e Anglisë, Banka e Kanadasë, Banka e Kinës, Banka e Japonisë, etj., bankat tregtare dhe ato të investimeve më të mëdha të botës, qeveritë e pothuajse të gjitha vendeve të planetit, biznesi, universitetet, akademikët dhe media, qendrat e kërkimit, etj.

Aq shumë të panjohura, të papritura dhe shfaqje multidimensionale kishte kjo krizë, sa po t'i referohesh qëndrimeve dhe vlerësimeve për të, gjatë periudhës korrik 2007 – dhjetor 2009, aty do të gjesh luhatje optimizmi dhe pesimizmi nga më të çuditshmet, shpesh herë shumë më tepër emocionale sesa profesionale dhe akademike. Çdo informacion ose lajm i mirë tentohej menjëherë të servirej si “fillimi i daljes nga kriza” ose si “fakt që tregon se kriza nuk është aq e rëndë sa mendohet”, ashtu si çdo informacion ose lajm i keq provokonte menjëherë pesimizëm dhe parashikime të zymta për kohëzgjatjen e krizës, efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të saj,

“plagët” që ajo pritej të hapte në ekonominë botërore, etj. Ndoshta kjo është periudha më kontradiktore në qëndrimet, vlerësimet dhe në deklaratat e politikanëve, të kryeministrave e të presidentëve, të ekspertëve e të drejtuesve të institucioneve ndërkombëtare, të analistëve e të medias në përgjithësi.

Ngjashmëritë dhe diferenat ndërmjet depresionit të madh së viteve 1929-33 dhe asaj të viteve 2007-2009

Tetori i vitit 2009 përkoi edhe me një eveniment tjetër, me 80-vjetorin e “*depresionit të madh*” ose të ashtuquajturën “*e enjtja e zezë*”, që shpërtheu në 24 tetor 1929, në bursën e Wall Street-it. Tetëdhjetë vjet mbas krizës së tij më të madhe në histori, kapitalizmi iu afrua frikshëm humnerës së një krize të re me përmasa universale. Kur dukej se kriza e viteve 1929-33 i takonte thjesht historisë, shumë elemente të saj u rishfaqën në horizont. Në fakt, shumë nga evenimentet e krizës së vitit 1929 kanë vazhduar për një kohë të gjatë që të shqetësojnë ekonomitë e zhvilluara kapitaliste të botës. Deflacioni, papunësia masive, varfëria dhe shkatërrimi i sistemit të këmbimit dhe i pagesave në shkallë ndërkombëtare i hapi rrugën totalitarizmit dhe Luftës së Dytë Botërore. Në përfundim të saj, si pasojë e aplikimit të politikave rregullatore me frymëzim keynesianist dhe me zgjerimin e “*Etats-providence*”, miratimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe avancimit në rrugën e krijimit të Bashkimit Evropian, u krijua një ekonomi tregu e stabilizuar dhe e ndihmuar shumë edhe nga ndërhyrja publike në ekonomi. Por, stagflacioni i tmerrshëm i viteve 1970 i dha fund “epokës Keynesiane” dhe hapi një faqe të re në zhvillimin dhe transformimin e kapitalizmit tashmë të globalizuar, duke e rritur shumë fuqinë dhe rolin e tregjeve dhe duke zvogëluar e asfiksuar atë të shtetit, duke zgjeruar procesin e derregullimeve, të inovacioneve financiare, duke hequr barrierat tregtare dhe hapur maksimalisht tregjet dhe ekonomitë e shumicës së vendeve të botës. Por, ky “kurs i ri” i kapitalizmit, duket se shpërtheu në 15 shtator 2008 me falimentimin e njëres nga bankat më të mëdha e më të vjetra në SHBA, Bankës “Lehman Brothers”. Kjo u cilësua edhe si “Pearl Harbour i globalizimit financiar”.

A ka pika të përbashkëta ndërmjet krizës së vitit 1929 dhe asaj të viteve 2007-2009? Në shumë nga analizat krahasuese të zhvilluara, rezultojnë të paktën tri pika të forta të përbashkëta.

Së pari, “*natyra ekonomike e choc-ut*”. Shfaqja e deflacionit dhe e një borxhi financiar kolosal, origjina e të cilit rrjedh nga politika monetare jashtëzakonisht liberale, të cilat inkurajuan krijimin e fluskave financiare spekulative në tregjet amerikane të aksioneve në fund të viteve 20-të të shekullit XX; dhe fluskave financiare spekulative në tregjet e pasurive të patundshme dhe atyre të kreditit në vitet 2000.

Së dyti, disekuilibret e modelit ekonomik: (1) kufizime të mëdha të prodhimit si pasojë e saturimit të kërkesës dhe e çrregullimeve monetare e financiare, pasoja të Luftës së Parë Botërore dhe të viteve “të çmendura” pas saj; (2) divergjenca të jashtëzakonshme në fillim të shekullit XXI ndërmjet një grupi vendesh si SHBA-ja,

Anglia, Spanja, etj., që merrnin vazhdimisht borxhe për të konsumuar dhe importuar dhe një grupi tjetër vendesh si Kina, Japonia, Gjermania, etj., që kursenin për të investuar dhe për të eksportuar.

Së treti, këto kriza shënojnë jo thjesht një ndryshim të natyrës ose të evolucionit të kapitalizmit, por një “hap historik” të tij: dyshime të forta mbi aftësinë e “shtetit minimal” për të qenë totalisht e kurdoherë efikas në zgjidhjen e problemeve të zhvillimit ekonomiko-social, dyshimet mbi “lidërshtipin e përjetshëm amerikan” në botë, antagonizmi ndërmjet demokracisë dhe totalitarizmit gjatë dy Luftërave Botërore; fundi i monopolit të perëndimit si udhëheqës dhe si “pronar” i kapitalizmit botëror, rënia relative e superfuqisë amerikane në ekonominë dhe në financat botërore, zhvendosja e qendrës së gravitetit të globalizimit drejt Azisë, etj., në këtë fillim shekulli XXI. Ndërkohë, diferenca kryesore ndërmjet dy krizave qëndron te politikat ekonomike e financiare të aplikuara për përballimin dhe daljen prej tyre. Thelbi dhe synimi kryesor i politikave “antikrizë” gjatë vitit 2009 ishte krijimi “në mënyrë paqësore” i mundësive për një ringritje shkallë-shkallë të aktivitetit ekonomik e financiar. Në 1929-n, shembja e bursës së Wall Street-it u transformua në një depresion të madh të ekonomisë e të financave amerikane me pasoja negative në të gjithë botën. Si pasojë e politikës monetare, tejet shtrënguese të Rezervës Federale, politikës proteksioniste amerikane dhe strategjisë “së ekuilibrit buxhetor”, të ndjekura nga administrata e Presidentit Hoover, në SHBA, falimentuan mbi 10 000 banka, duke shkaktuar njëkohësisht një deflacion të përgjithshëm botëror, një zhvleftësim të shumë monedhave të botës dhe një krizë të madhe 10-15 -vjeçare në tregtinë botërore.

Krejt e kundërta ndodhi në vitin 2009. Të nesërmen e falimentimit të Bankës “Lehman Brothers”, si pasojë edhe e mësimave të krizës së viteve 1929-33, politikat ekonomike, financiare e monetare në pothuajse të gjithë vendet e botës u përqendruan në tri përparësi bazë : (1) shpëtimi i bankave (u mobilizuan mbi 17 000 miliardë dollarë në shkallë botërore); (2) mbështetja e biznesit dhe e punësimit nëpërmjet shpenzimeve publike (vetëm në vendet e zhvilluara dhe në ato me ekonomi emergjente u shpenzuan rreth 5000 miliardë dollarë për këtë qëllim); (3) dënimi dhe frenimi i çdo lloji forme proteksionizmi individual dhe kërkimi i zgjidhjeve në mënyrë sa më globale (takimet e shpeshta të G7-ës, G8-ës dhe G20-ës gjatë gjithë vitit 2009).

Dueli ndërmjet shkollës së Keynes-it dhe Friedman-it vazhdon : kush është fajtori i krizës?

Kriza ekonomiko-financiare 2007-2009 u bë shkak edhe për një rringjallje të luftës së vjetër ideologjike ndërmjet ekonomistëve “mbi origjinën dhe shkaqet e rëzësionit ekonomik...mbi fajtorët dhe mënyrat e daljes prej saj..mbi ekonomistët profetë që duhet të besojmë”. Vija e tyre e ndarjes është e dukshme : përballë ekonomistëve Keynesianistë, që privilegjojnë ndërhyrjen publike në ekonomi, qëndrojnë liberalët që janë partizanë të tregut të lirë dhe të globalizimit pa limit. Sipas Keynesianistëve, kjo krizë tingëllon si një revansh kundër 30 viteve të fundit të zotëruara nga doktrina liberale dhe të

ashtuquajturat “suksese universale të saj”. Nga ana e tyre, liberalët, të tronditur nga një krizë që nuk e prisnin, vazhdojnë të interpretojnë evenimentet e saj, por gjithsesi rreth një argumenti qendror : kjo krizë nuk erdhi për faj të liberalizmit dhe do të jetë po liberalizmi ai që do të na nxjerrë prej saj.

Debati për origjinën e krizës duket se vazhdon të përqendrohet rreth një pikëpyetjeje të madhe : a ishte kjo krizë një disfatë e mendimit dhe praktika liberale? Por, ndërkohë që ekonomistët vazhdojnë të grinden ende se kush ishin fajtorët e krizës së depresionit të madh të viteve 1929-33, duket shumë e vështirë që të përcaktohet që tani fajtori për krizën financiare 2007-2009. Megjithatë kampet janë ndarë në llogore të kundërta. Për Keynesianistët dhe përgjithësisht për të gjithë ata që quhen si “etatistë”, kriza erdhi si pasojë e mungesës së rregullimit dhe dobësia e shtetit i la shteg të lirë fenomenit të superspekullimit financiar. Por, përballë kësaj teze liberalët reagojnë me dy argumente të kundërta. Sipas tyre, së pari, spekulimet imobiliare në SHBA, të cilat konsiderohen edhe si pikënisja e krizës, u inkurajuan nga shteti dhe nga qeveria amerikane; së dyti, kreditë hipotekore me risk, që gjithashtu u bënë faktor i krizës, gëzonin një mbështetje publike nga bankat (Freddie Mac dhe Fanny Mae). Pra, ishte shteti ai që deformoi dhe denaturoi tregun. Liberalët tregohen shumë kritikë edhe ndaj “tolerancës së jashtëzakonshme” të bankës qendrore amerikane (Fed). Ekonomistja e shquar liberale Anna Schëartz (bashkëthemeluesja e teorisë monetariste së bashku me Friedman-in) akuzon dy drejtuesit e fundit të Fed-it, Alan Greenspan-in dhe pasuesin e tij Ben Bernanke-n se e përmytën tregun me një sasi të pakontrolluar parash. Duke qenë dhe një eksperte e shquar e historisë monetare të SHBA-së, Anna Schëartz nënvizon se të gjitha krizat amerikane kanë lindur si pasojë e sasisë së jashtëzakonshme të parave në qarkullim, duke krijuar kështu premisat për lindjen e spekulimeve dhe të flluskave financiare. Sipas saj, është teknikisht e pamundur që të përpiqesh t’i rregullosh tregjet financiare kur ato “rënojnë nën peshën e parave”. Pikërisht për këtë arsye, Milton Friedman-i rekomandonte që paratë duhet të administrohen sipas kriterëve matematike dhe jo sipas dëshirës dhe vullnetit të bankierëve qendrorë ose qeverive. Megjithëse divergjencat ndërmjet Keynesianistëve dhe liberalëve janë të shumta, thelbi i konfliktit të tyre për sa i përket krizës qëndron te roli dhe prezenca e shtetit në ekonomi : kriza vjen nga pamjaftueshmëria e shtetit, apo nga paaftësia e tij?

Në kushtet kur pasoja e drejtpërdrejtë e krizës financiare duket se është reçesioni si dhe shifrat minimale të rritjes ekonomike, pyetja kryesore që shtrohet është : a mundet që shpenzimet publike të nxisin rritjen ekonomike? Shpresa e vetme duket se mbështetet tek efekti i të ashtuquajturit “multiplikatori keynesian”, sipas të cilit, çdo njësi monetare e investuar në ekonomi e shton me disa herë vlerën e saj, dhe po kaq rrit edhe punësimin. Por kjo teori kundërshtohet me forcë dhe konsiderohet e gabuar nga liberalët të cilët insistojnë te fakti se “para e investuar nga shteti është para që hiqet si mundësi për t’u investuar nga sektori privat, ndërkohë që për të gjithë është e qartë se “investimet publike janë më pak produktive se ato private”. Liberalët insistojnë në argumentet e tyre se “shpenzimet publike janë thjesht një transferim i pushtetit nga ndërmarrjet private te burokracia shtetërore”. Si politikat më të mira “antikrizë”,

liberalët kundërshtojnë rritjen e shpenzimeve publike dhe propozojnë “zvogëlimin e taksave për të favorizuar investimet private të cilat janë shumë më efikase sesa ato publike”.

Por, thelbi i kësaj krize nuk qëndron thjesht dhe vetëm te mënyrat e nxitjes së rritjes ekonomike, qofshin këto shpenzime publike ose private. Rrënjët e krizës janë financiare dhe monetare. Problemet kryesore të saj u shfaqën në sistemin bankar dhe në tregjet financiare. Çfarë duhet bërë me bankat? A duhen kontrolluar dhe kondicionuar më shumë ato në gjithë aktivitetin e tyre? Presidenti Obama dha sinjalin e parë në janar 2010 duke propozuar një “paketë speciale masash” për të kufizuar dhe kontrolluar aktivitetin e bankave. Europeanët u shprehën të kënaqur dhe deklaruan se kjo ishte mënyra më e mirë për të mos lejuar rishfaqjen e krizave të ngjashme në të ardhmen. Ndërkohë, liberalët u shprehën tërësisht kundër këtyre masave duke argumentuar se “kontrolli shtetëror mbi bankat nuk nënkupton automatikisht se ato do të administrohen më mirë në të ardhmen”. Sipas liberalëve, “në vend që të ashtuquajturat produkte toksike të bankave të blihen nga fondet publike, do të ishte më mirë që ato të hidheshin në treg dhe vetë tregu do ta caktonte çmimin e tyre”, natyrisht duke pranuar riskun që shumë banka ose institucione financiare do të falimentonin”. Do të ishte më mirë që “bizneset joefektive të falimentonin sesa të bllokohej krediti për një kohë të gjatë”, shprehet Anna Schëartz. Duke qëndruar në pozicionin e saj ekstremisht liberal, ajo mbetet në favor të aplikimit të parimit kapitalist të “shkatërrimit krijues” në sektorin bankar dhe atë financiar.

Në debatin e ashpër se kush ka të drejtë : “liberalët ose Keynesianistët” u përfshinë dhe dy ekonomistë nobelistë shumë të njohur, Edward Prescott (ekspert i makroekonomisë, i bankave qendrore dhe i politikave monetare) dhe Vernon Smith (ekspert i ekonomisë eksperimentale dhe i kërkimeve psikologjike në shkencat ekonomike) të cilët në janar 2009 nënshkruan dhe shpërndanë një peticion që shpejt u bë objekt diskutimesh në gjithë botën. Në këtë peticion nënvizohet se “*jo të gjithë ekonomistët janë bërë Keynesianistë në kohë krizash financiare...jo të gjithë ekonomistët janë dakord që shpenzimet publike nxisin rritjen ekonomike. Rritja e shpenzimeve publike në kohën e Presidentit Franklin Roosevelt nuk e nxorën SHBA-në nga depresioni i madh i viteve 1930. Ato nuk arritën të shpëtonin as ekonominë japoneze në 1990. Të besosh se shpenzimet publike mund të shpëtojnë një ekonomi në krizë është një shpresë që nuk përputhet me eksperiencën. Garantimi i treguesve të lartë të rritjes ekonomike mund të vijë vetëm nëpërmjet eliminimit të pengesave për punësimin, për kursimin dhe investimet dhe veçanërisht nëpërmjet uljes së taksave*”. Në fakt, ky peticion nuk gjeti shumë përkrahës në radhët e ekonomistëve dhe të financierëve, qofshin këta edhe të rrymave e të shkollave të afërta me liberalët. Por, argumenti bazë i liberalëve në këtë rast është shumë interesant : në vitet 1930, dy ekonomistë të shquar liberalë, Jacques Rueff në Francë dhe Friedrich Hayek në Angli ishin në minorancë kur kritikonin teorinë Keynesianiste të punësimit të plotë si shkaktare të inflacionit. Por historia iu dha plotësisht të drejtë atyre. Po kështu edhe me dy ekonomistë të tjerë, Robert Barro dhe Milton Friedman, të cilët gjatë viteve të krizës 1974-1979 kundërshtuan përdorimin e logjikës së multiplikatorit

Keynesian dhe historia iu dha gjithashtu të drejtë. Ishte pikërisht rikthimi në idenë dhe dogmën liberale në vitet 1980 ai që rriti punësimin dhe rritjen ekonomike dhe jo rritja e inflacionit ajo që zvogëlonte papunësinë.

Një tjetër debat interesant ndërmjet ekonomistëve amerikanë u provokua edhe nga nobelisti Paul Krugman, sipas të cilit, “kriza u shkaktua nga ekonomistët e sotëm të cilët braktisën Keynesin në mbështetje të shkollës së Çikagos të drejtuar nga ekonomisti liberal e monetarist Milton Friedman. Friedman-i e quante të gabuar pretendimin e Keynes-it që “çdo krizë mund të rregullohet nëpërmjet një ekspansioni progresiv të masës monetare”, pra nëpërmjet një ndërhyrje masive publike. Keynesi, i cili besonte se “reçesionet dhe depresionet shkaktoheshin nga rënia e konsumit dhe e kërkesës”, në propozimin e tij për të shtuar masën monetare si “ilaçi” më i mirë për shërimin e krizës, inspirohej nga gabimi i bërë nga Fed-i në kohën e depresionit të madh të viteve 1929-33, i cili në vend që ta shtonte masën monetare në qarkullim, bëri pikërisht të kundërtën, e shtrëngoi shumë atë. Në këto kushte, një zvogëlim drastik i normës bazë të interesit nga ana e bankave qendrore do të ishte veprimi më i drejtë për të nxitur konsumin dhe investimet. Shteti nëpërmjet rritjes së shpenzimeve publike do të ishte faktori vendimtar për daljen e shpejtë nga kriza. Në të njëjtën logjikë qëndron dhe Krugman-i, i cili nënvizon se “kriza aktuale financiare është një krizë klasike në sensin Keynesian”. Sipas tij, shpërthimi i fluskës imobiliare zhvleftësoi ndjeshëm titujt hipotekorë të mbajtur nga bankat dhe reduktoi kredinë, duke bërë që gjithë ekonomia të bjerrë në reçesion. Pra, në fund të fundit, duke e parë nga pikëpamja makroekonomike, e gjithë kjo krizë erdhi si pasojë e tkurrjes së konsumit dhe kredisë.

Kriza – përgjegjësi apo pamundësi e ekonomistëve për ta menaxhuar?

Iniciativa Xhorxh Soros-it, e tetorit 2009, për të financuar me 50 milionë dollarë krijimin e një instituti për “kritikën e ekonomisë moderne” duket se po i hap rrugën një reflektimi të ri. Tashmë që kriza e jashtëzakonshme ekonomiko-financiare duket se po shkon drejt fundit, në mjediset politike, financiare, akademike e mediatike ka shpërthyer një debat fundamental. Për të përballuar krizën, vetëm nga vendet e G20-ës u mobilizuan me urgjencë mbi 9 mijë miliardë dollarë, ndërkohë që pasojat e krizës për vendet e ndryshme, bizneset ose individët, llogariten në rreth 45 mijë miliardë dollarë. Humbjet ekonomike e financiare llogariten të jenë më të mëdha se ato të Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore së bashku. Cilët ishin përgjegjësit që e shkaktuan atë? Dhe, akoma më shumë se kaq: ekonomistët si profesionistë ose si ekspertiza më e specializuar që duhet ta kuptonte dhe parandalonte atë duket se dështuan në rolin e tyre si “doktorët” e shëndetit ekonomik e financiar si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar. A kanë ata përgjegjësi të drejtpërdrejtë për këtë krizë?...Dhe mbi të gjitha, a ka ndonjë reflektim thelbësor mbi rolin e ardhshëm të tyre?...Apo, mbi vetë përmbajtjen e profesionit të ekonomistëve? Pikëpyetjet mbi utilitetin social e politik të tyre janë çdo ditë e më shumë në fokus të analizave të specializuara. Çfarë ekonomistësh na duhen? Çfarë njohurish janë të nevojshme për të formuar një ekonomist? Çfarë

problemesh duhet të zgjidhin ata? Si ta vlerësojmë cilësinë e tyre? Të gjitha këto pyetje e pikëpyetje reflektojnë një kohë të re sfidash përballë ekonomistëve në mënyrë që ata ta “justifikojnë” veten përballë asaj çka pritet prej tyre sot.

Profili dhe përmbajtja e re për ekonomistët po analizohet mbështetur në ato që cilësohen “*tri portretet ose figurat e ekonomistëve*”. Figura e parë është ajo e një ekonomisti teoricien që nëpërmjet matematikës, statistikës ose ekonometrisë synon që çdo gjë ta “formalizojë në një ekuacion ose në një formulë të përgjithshme me spektër të gjerë dhe të pakufizuar në kohë e hapësirë”. Por, me gjithë sukseset e ekonomistëve të cilësuar si neoklasikë, të cilët e ngritën në art një profil të tillë ekonomisti, aktualisht të gjithë po binden se kjo mënyrë veprimi për të ndërtuar hipoteza të përgjithshme përmban në vetvete mjaft subjektivitet, aq më tepër që vetë ekonomia si shkencë nuk është e ngjashme me shkencat ekzakte si kimia, fizika, etj. Profili i dytë i ekonomistëve përmbledhet në atë që quhet “*makroekonomia e aplikuar e tipit Keynesian*”, e cila bashkonte në një të vetme modelet ekonometrike me politikat ekonomike. Por, zhvillimet ekonomiko-financiare e sociale në vitet 80-90-të të shekullit të kaluar nxorën në dukje një sërë rezervash për këtë tip ekonomistësh. Kritikën u përqendruan në “*vlerën dhe besueshmërinë e parashikimeve afatmesme dhe afatgjatë*” të ecurisë së fenomeneve të tilla si papunësia, rritja ose rënia ekonomike, inflacioni, përqindjet e këmbimit, ekuilibrat dhe dizekuilibrat strukturorë, lidhjet shkak-pasojë ndërmjet konsumit dhe investimeve, etj. Politikën ekonomike nuk ndiheshin të sigurta në objektivitet dhe në instrumentet kryesore të tyre duke u mbështetur vetëm në seritë tendenciale makroekonomike. Profili i tretë i ekonomistëve i takon viteve të fundit dhe është ai që e cilëson ekonomistin si “*një inxhinier social të politikave ekonomike*”. Detyra e tij është orientimi i saktë i gjithë mjeteve dhe i instrumenteve që zotërojnë autoritetet publike drejt realizimit të disa objektivave themelore në dobi të komunitetit, të tilla si : stimulimi i rritjes ekonomike, mbajtja e nivelit të lartë të punësimit, lufta kundër inflacionit, ekuilibri i tregtisë së jashtme, rritja e fuqisë blerëse, stabiliteti i skemave të pensioneve dhe i mbrojtjes sociale, cilësia e shërbimeve publike, etj. Ky evolucion u cilësua si trilogjia e famshme “*të parashikosh...të veprosh...të garantosh*”, dhe u duk se më në fund ekonomistët “*e gjetën veten dhe u bënë aq të rëndësishëm sa pretendonin se ishin në shoqëri dhe politike*”. Por fillimi i mijëvjeçarit të ri, dhe sidomos debatet “për fajin e krizës dhe për mënyrat më efektive të daljes prej saj” dëshmuar për mjaft kufizime të kësaj trilogjie. Kur vinte fjala për politikat ekonomike ose financiare, ekonomistët rezultonin të ndarë: Keynesianë, monetaristë, klasikë, neoklasikë, institucionalistë, regulacionistë, shumpeter-ianë, etj.

Edmund Phelps, çmimi Nobel i ekonomisë në vitin 2006 e titullon në mënyrë disi provokative një artikull të tij: “*Kriza?...Shkolla të mendimit ekonomik, flisni!*”. Dhe kjo sepse zgjedhja e politikave ekonomike, po varen gjithnjë e më tepër nga koalicionet dhe ekuilibrat politikë të pushtetit dhe të vetë politikës duke i dhënë fund dhe vetë konceptit të neutralitetit të ekonomistit si “*zëdhënës i njohurive dhe i koncepteve shkencore*”. Kjo e ka bërë ekonomistin palë me politikën dhe për pasojë e relativizon shumë atë dhe politikat ekonomike të propozuara e të mbrojtura prej tij. Ekonomistët

u vendosën nën çadrën e politikës dhe në shërbim të saj, ndërkohë që sot, opinioni publik dhe ekspertët e fushës mendojnë se duhet të jetë e kundërta, “duhet të jetë politika ajo që duhet t’i marrë referencat bazë nga ekonomia dhe ekonomistët”. Për këtë arsye, sot kërkohet një profil dhe figurë e re ekonomistësh, të cilët në përmbajtjen dhe veprimin e tyre t’i përgjigjen stadi dhe problemeve të reja me të cilat po përballen shtete, kontinente ose vetë bota në tërësi. Përfundimet e para, të frymëzuara dhe nga domosdoshmëria e një “profili të ri ekonomistësh” të aftë që të mos lejojnë shfaqjen e krizave me përmasa të tilla, duket se po kristalizohen çdo ditë e më tepër.

Së pari, ekonomistët e sotëm duhet të jenë të aftë “*jo vetëm ta nxjerrin në pah fenomenin, por në radhë të parë ta kuptojnë në thelbin e tij dhe të propozojnë konkretisht mjetet dhe mënyrat për transformimin e tij*”. Në vend që të merren pafund me modele e vërtetime teorike, ata “*duhet të shqetësohen për problemet më shqetësuese aktuale si papunësia, destabiliteti financiar, varfëria dhe moszhvillimi, zgjidhja e problemeve të ushqimit dhe të energjisë, problemet e cilësisë së jetës, etj.*”

Së dyti, ekonomistët modernë duhet të “*bëhen dishepujt e shpërndarjes së koncepteve dhe të praktikave të asaj që cilësohet si shoqëri e qëndrueshme*”, që garanton lirinë individuale, drejtësinë sociale dhe respektin për natyrën dhe mjedisin në përgjithësi. Ekonomistët duhet të profilizohen në një rol të ri, në atë të “*reformatorit social*” duke kërkuar inpakt gjithnjë e më të madh në organizimin dhe qeverisjen e shoqërisë. Kërkimet e fundit në fushën e “*Ekonomisë historike*” po hapin perspektivën e riintegritimit të ekonomisë në shkencat sociale. Edhe vetë ajo që quhet “*ekonomia eksperimentale*” po kërkon gjithnjë e më tepër hapësira të reja për të shpjeguar sjelljen e individëve ose të grupeve, hapësira që duhet të jenë shumë më të gjera sesa ato të konturuara dhe të propozuara deri tani nga ekonomistët liberalë dhe nga produkti themelor i tyre “*homo economicus*”.

Së treti, ekonomistët duhet të fillojnë “*të shkrihen*” më shumë me shkencat dhe disiplinat e tjera. Ekspertët mendojnë se ekonomisti modern duhet të formohet pa tjetër me njohuri më komplekse duke synuar në përgatitjen e ekonomistëve mjedisorë, të informacionit, të shëndetësisë, të arsimit, të teknologjive të reja dhe të inovacioneve, të ekonomistëve informaticienë, të ekonomistëve të zhvillimit, të transportit”, të ekonomistëve urbanë e të shërbimeve, ekonomistëve të turizmit, të ekonomistëve të territorit, etj.

Së katërti, ekonomistët duhet “*të kenë këndvështrim e formim sa më global e ndërkombëtar*”. Ata duhet të jenë në gjendje të njohin dhe të përballen me debatet dhe sfidat që vijnë si pasojë e fenomenit të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike, të emigracionit ndërkombëtar, të gjeopolitikës së naftës dhe të energjisë, të aksesit të burimet dhe lëndët e para jetësore si uji, tokat bujqësore, pyjet, ajri, mineralet, problemet e ushqimit dhe të varfërisë, rolit dhe ndikimit të institucioneve ndërkombëtare si FMN-ja, OBT-ja, Banka Botërore, FAO-ja, etj., në ekonomitë lokale e rajonale, rolit të ideologjive, të fesë dhe të ndryshimeve të civilizimeve në zhvillim, krizat financiare dhe roli i tyre mbi vende e popuj të ndryshëm, efektet e teknikave dhe të teknologjive të reja si nanoteknologjitë, organizmat gjenetiksht të modifikueshme, ndikimin dhe oportunitetet që po prodhon zhvillimi i shpejtë i Kinës, i Indisë, i Brazilit, etj.

Zgjedhja e Xh.Sorros-it, që iniciativën e tij t'ia besonte Universitetit të Europës Qendrore në Budapest dhe Pragë, dëshmon më së miri për rolin që pritet të luajnë universitetet në këtë proces. Edhe në SHBA, në Angli, në Francë, në Itali, në Gjermani, në Kanada, në Australi, në Kinë, në Indi, në Suedi, etj., vende që shquhen për shkollat e universitete nga më cilësoret në fushën e ekonomisë, është hapur tashmë një debat i përgjithshëm mbi këtë shqetësim: “*cili është roli i ekonomisë dhe i ekonomistëve në shoqëritë moderne?*” Kriza financiare e ekonomike aktuale i “hodhi edhe më shumë benzinë” këtij zjarri diskutimesh e reflektimesh, rezultatet e të cilave priten dhe janë me mjaft interes për të gjithë.

Literatura

- Aglietta M., “*La crise : Pourquoi on en est arrivé là ? Comment en sortir ?*”, Collection : 10 + 1, Editeur : MICHALON 21 novembre 2008.
- Aglietta M., Rigot S., “*Crise et rénovation de la finance*”, Collection : Economie, Editeur : Odile Jacob mars 2009.
- Amir W., “*L’Affaire Madoff*”, Editeur : PLON; Édition : Plon mai 2009.
- Civici A., “Globalizimi ante portas”, Botim i UET Press, 2009, 278 faqe.
- Civici A., “Kriza Financiare – apo Globale”, Botim i UET Press, 2010, 320 faqe.
- Klein L., “*La crise des subprimes – origines de l’excès de risque et mécanismes de propagation*”, Revue Banque edition, 2008.
- Lacoste O., “*Comprendre les crises financières*”, Collection : Eyrolles Pratique, Editeur : Eyrolles avril 2009.
- Laurent E., “*La face cachée des banques : Scandales et révélations sur les milieux financiers*”, Editeur : Plon 2009.
- OCDE - The Road to Recovery - Update on the OECD’s Strategic Response to the Financial and Economic Crisis, 27 March 2009.
- OECD Economic Outlook No. 86, November 2009.
- Orlean A., “De l’euphorie à la panique : penser la crise financière”, Collection : CEPREMAP, Editeur : Rue d’Ulm mai 2009.
- Pauget G., “Faut-il brûler les banquiers?”, Collection : Idées fausses Vraies réponses, Editeur : Jean-Claude Latt 2009.
- Posner Richard, *A Failure of Capitalism: The Crisis of ‘08 and the Descent into Depression*, 2009. ISBN 978-0-674-03514-0
- Revista “ECONOMICUS”, nr. 2, 2009, botim i UET
- Soros G., “Mes solutions à la crise”, Collection : Pluriel, Editeur : Hachette Littératures 2009.
- Trichet Jean-Claude: “Key lessons from the crisis”, “Annual conference 2009”, organised by the Asociación de Mercados Financieros, Madrid, 23 November 2009, BIS review, 150/2009.
- Trichet Jean-Claude: “Shaping the future of global financial market regulation”, The De Nederlandsche Bank’s Amsterdam Financial Forum 2009, Amsterdam, 28

November 2009, European Business Review, November 30, 2009.
Trichet Jean-Claude: “The financial crisis and our response so far”, Global financial forum, New York, 27 April 2009. BIS review, 51/2009.
Trichet Jean-Claude: Remarks on the recent turbulences in global financial markets; The Policy Discussion “Global Economic Policy Forum 2008”, New York University, New York, 14 April 2008. BIS review, 44/2008.
UN Conference on the *World Financial and Economic Crisis and its Impact on Development*, **New York 24 - 26 June 2009.**

Impakti i Ekspozimit në Rrezik i Industrisë Bankare në Shqipëri

Doc. Ilir HOTI¹

ABSTRAKT. Rregullorja e Basel II ju kërkon bankave të zbatojnë stress test mbi kapitalin e tyre minimal të kërkuar në të ardhmen. Implementimi i standarteve ndërkombëtare të raportimeve financiare nga të gjitha bankat residente në Shqipëri është bërë e detyruar që nga 1 janari i vitit 2009. Ky studim fillon me informacionin asimetrik që shkon nëpërmjet të gjithë përbërësve sistemik në industrinë bankare në Shqipëri. Ekzaminimi diagnostik mbulon mospërputhjet midis Basel II, IFRS dhe Rregulloreve të Bankës së Shqipërisë në identifikimin e riskut të provigjionimit të portofolit të huave, në matjen dhe menaxhimin e tij. Së fundi ne kemi zhvilluar një model në për matjen e stress testing dhe ndikimin e zbatimit të IFRS 39 mbi cilësinë e portofolit të huasë së paku në baza mujore. Korniza e stress testing për kapitalin minimal të kërkuar është bazuar në një skenar dhe që merr në konsideratë të gjithë komponentët e ekspozimit ndaj riskut sipas Basel II dhe IFRS. Ajo përfshin të gjitha paradokset që vijnë nga zhvillimi i riskut të kredisë dhe si konsekuencë efektet mbi kapitalin minimal të kërkuar. Ky referim siguron pik[pa]mje të ngjashme konkurruese në sistemin banker shqiptar dhe nënvizon rëndësinë e modelimeve të tilla të përbashkëta.

Fjalët kyçe:

Basel II, IFRS, kërkesa për kapital, testi i provigjionimeve, humbjet nga huatë, stress testing, menagjimi i rikut.

^{<1>} Autori zotëron Financial Engineer Certificate nga Center of Financial Engineering Development/ American University Washington D.C. Aktualisht është anëtar i asocuar i Banking Consultants International, Këshilltar i Lartë i Uniq Group/SIGAL dhe Drejtues i Institutit të Inxhinierisë Financiare për Bankë dhe Sigurime. Studimi i paraqitur është aplikuar në Bis Banka [2009].

Sot të gjitha diagnozat dhe terapitë për dalje nga kriza po provojnë varësi të fortë me cilësinë e informacionit. Të gjitha falimentimet e firmave të mëdha kanë përmbysur aksiomën që formonte doktrinën e qetë financiare 'It's too big to fail'. Informacioni si produkt perceptohet me kosto shumë të lartë, por pasojat që kemi akumuluar argumentojnë se është e kundërta dhe që imponon investime prioritare. Nëse në këtë prozë përfshijmë falimentimin e Enron, argumenti kryesor ka qenë asimetria e informacionit, e cila shembi dhe fundosi mitin e garantuesit të informacionit, një prej Auditorëve më të mëdhenj Arthur Hendersen. Histori e ngjashme është edhe me WorldCom, Lehman Brothers, Merrill Lynch, City Bank, etj., që sot mbushin argumentet 'post mortum' për 'kiminë' dhe 'fizikën' e gjenerimit dhe të zhvillimit të krizave sistematike në shkallë globale. Greqia, Portugalia, Irlanda, Italia, etj., janë argumenti sesi informacioni asimetrik nuk është produkt i një rreziku idiosinkratik, por po institucionalizohet si politikë shtetërore që demoralizon deri në kërcënim sistemin e Euros. Aspekti tjetër është se prodhuesit e informacionit asimetrik bartin përfitime të padrejta në kurriz të palëve që lidhen me to, duke krijuar kosto të papërballueshme derivative. Financimet që Qeveritë i bëjnë institucioneve që falimentojnë, sikurse edhe financimet që BE i ofroi Greqisë janë një kosto shtesë që financon hazardin moral nëpërmjet krijimit të burimeve shtesë garantuese për krizat.

Pabarazia e informacionit në pikëvështrimin tonë analizohet së pari ndërmjet sistemeve, ndërmjet vetë institucioneve përfaqësuese të sistemeve dhe shtrihet deri në marrëdhëniet e institucioneve me bizneset dhe publikun. Duhet kuptuar se ne nuk jemi ndryshe nga bota e mësipërme. Punimi përqendrohet në informacionin asimetrik të mjedisit bankar për rrethanën kur huamarrësit kanë më shumë informacion për vetveten nëse e shlyejnë apo jo huanë sesa banka ka për ata. Në këto rrethana, bankat aplikojnë pak a shumë procedura standarde në miratimin e huasë dhe nga ana tjetër aplikojnë për të dy tipet e huamarrësve [të ndershëm e të pandershëm normë interesi të njëjtë, e cila përbëhet nga:

- (a) *norma reale e interesit* apo *norma e interesit pa rrezik*,
- (b) *norma e pritshme e inflacionit*, dhe
- (c) *primi i rrezikut* që banka e përcakton nga përvoja, analiza e ecurisë së tregut të produkteve për të cilat jepet huaja, etj.

Nëse në vijim të arsyetimit të mësipërm, vazhdon rritja e normës së interesit, bankat rrezikojnë të japin hua vetëm ndaj huamarrësve të pandershëm apo me rrezik shumë të lartë, duke dëmtuar portofolin e tyre. Kjo shpie në rrethanën që sistemi bankar të mbetet me huamarrës që e dinë mirë se do të falimentojnë e dështojnë në shlyerjen e huasë e megjithatë, për hir të informacionit asimetrik, banka vijon të japë hua.

Këtu përjetohet dukuria e *përzgjedhjes së kundërt* dhe e *bazardit moral* që bankat të mos e transmetojnë tek mbikëqyrësit dhe publiku gjendjen reale të portofolit të dëmtuar të huave, si dhe të anashkalojnë aksionarët duke i ofruar një fitim, shpesh herë duke mos zbritur pjesën reale për rezerva që mbulojnë humbjet nga huatë.

Asimetria Informativë në Sistemet Përbërëse Financiare

Së pari, analiza e asimetrisë së informacionit ndërmjet sistemeve lidhet me saktësinë, vërtetësinë dhe ritmin apo shpejtësinë e komunikimit të informacionit, në mënyrë të ndërsjellë nga Bankat e Nivelit të dytë drejt Bankës Qendrore dhe anasjelltas.

Së dyti, analiza e asimetrisë së informacionit ndërmjet Bankës së Shqipërisë, si përfaqësuesja e epërme e sistemit bankar/monetar, me Ministrinë e Financave, si autoriteti themelor i sistemit fiskal.

Së treti, analiza e asimetrisë së informacionit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Institucioneve themelore ku spikasim Parlamentin dhe Publikun.

Në vijim po ndalemi tek disa ‘paradokse’ që formojnë lëndën e këtij punimi:

“Paradoksi” 1

Konkretisht në raportin e fundit të Bankës së Shqipërisë², pohohet se ‘ndërmjetësimi i depozitave është 67%’. Kjo d.m.th., se rreth 33% e depozitave të pashndërruara në kredi janë gjendje si “Rezerva të Tepërta” (*excess reserves*).

Në fakt ka ndodhur e kundërta. Të gjitha bankat për periudhën deri në prill 2010 kanë ofruar reklama me fushata publicitare vetëm për grumbullim depozitash, që d.m.th., se bankat nuk kanë tepriçë, por mungesë likuiditetesh. Në të gjitha reklamata fillimisht intensitetin më të madh e ka pasur Raiffeisen [dhjetor 2009-janar 2010] e ndjekur nga Tirana Bank, Emporiki, Credins, etj. Madje reklamata e Tirana Bank janë aktualisht në postera të shfaqur nëpër kalimet rrugore p.sh., drejt Aeroportit, ku interesat për depozita reklamohen si shigjeta!

Për sa më sipër, kuptohet se në thelb bankat nuk kanë rezerva të tepërta, financiare por vetëm kontabël, kjo sepse ka rënë cilësia e portofolit të kredive në rrezik. Shtimi i kredive nën standard e të dyshimta ka kontribut në meqen se peshe në rritjen e rezervës për humbje nga huatë nga 8% në rreth 11%, por edhe kjo e dhënë informohet, ndonëse përmban asimetri sepse portofoli i bankave mund të ketë përmbajtje më të lartë. Kjo rrethanë së bashku me të tjerat formojnë thelbin e këtij punimi që përplas kriteret e Basel II me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS).

“Paradoksi” 2

Agregati total i kreditimit në ekonomi [kredi gjithsej minus kreditimet ndaj Qeverisë] arrin në 428,5 miliard lek (viti 2009).

Duke ditur që çdo njësi kredie e ofruar gjeneron po aq njësi blerjeje, atëherë në analizën makroekonomike pritet që agregati i kredisë të gjenerojë një agregat fiskal të Taksës ndaj Vlerës së Shtuar (TVSH) për 20% të shumës.

Kjo d.m.th., se për çdo njësi kreditimi në ekonomi, huamarrësit kanë bërë blerje

2 Raporti i Bankës së Shqipërisë për vitin 2009 [Maj 2010].

Treguesi	Dhjetor 2007	Mars 08	Qershor 2008	Shtator 2008	Dhjetor 2008	Mars 09	Qershor 2009	Shtator 2009	Nëntor 2009	Dhjetor 2009
Mjetet e brendshme	618,926	638,569	683,714	712,787	725,737	727,373	745,897	760,189	773,419	780,222
Pretendimet neto ndaj qeverisë gendrore	256,840	255,744	265,569	265,655	257,992	245,574	261,781	264,766	269,286	269,923
Pretendimet ndaj korporatave jofinanciare publike	3,923	4,450	4,557	7,205	12,899	14,228	12,634	12,815	12,012	12,056
Pretendime ndaj sektorit privat*	285,425	306,984	338,608	365,237	377,924	396,635	399,714	408,854	412,198	416,496

dhe në kushtet e një evazioni fiskal 0, duhet që rreth 85 miliard Lekë të ishin të ardhura buxhetore shtesë në Ministrinë e Financës, ndërkohë që në strukturën e të ardhurave fiskale nuk vërehet një përpjesëtim i tillë.

Argumenti i mësipërm mbijeton fort edhe sikur të supozohet një evazion fiskal për 20% ose 30%, përsëri të ardhurat që derivojnë në fiskale janë shumë më të ulëta. Në bazë të përllogaritjeve rezulton se 50%-60% e kreditimit nuk ka gjeneruar transaksione reale.

Për mendimin tim, ky hon mund të jetë një sinjal për një efekt të pritshëm fluskë (*bubble effect*), i cili e ekspozon sistemin bankar në një rrezik sistemik. Kjo sepse nëse nga agregati i kredisë në ekonomi nuk gjenerohet TVSH, d.m.th., se një pjesë e kreditimit nuk ka motivuar blerje reale, nuk ka rritur kërkesën por thjesht mund të ketë zëvendësuar kreditë e maturuara për nën standard me kredi me maturim të freskuar. Kjo priret të argumentohet nga dy dukuri shoqëruese bazë që i parashatrojmë në vijim:

I-Ndikimi në Agregatin e Kërkesës [GDP] dhe Defiçitin Buxhetor

Nëse kreditimi në ekonomi do të ishte realisht 100% për blerje atëherë do të rritej agregati i kërkesës për mallra dhe shërbime dhe pesha e kreditimit ndaj GDP. Mirëpo, duke qenë se nuk kemi këtë efekt, atëherë rrezikohet të ketë ndodhur e kundërta, që në vend që kërkesa të rritej me shtimin e sasisë së lekut në qarkullim nga kreditimi në ekonomi, në fakt kërkesa është zvogëluar dhe që me të drejtë pohohet në raportin e Bankës së Shqipërisë:

“Sidoqoftë, ndryshimet në situatën e likuiditetit, nënçmimi i kursit të këmbimit, si edhe vështirësitë e sektorit real të ekonomisë, ndikuan në ngadalësimin e kreditimit dhe në rënien e cilësisë së tij. Në fund të vitit 2009, veprimtaria e kreditimit, duke përfshirë edhe interesat e përllogaritura, zinte rreth 50.8 për qind të totalit të mjeteve të sektorit bankar, ose rreth 40 përqind të PBB-së. Ndërkohë, raporti i kredive me probleme ndaj vlerës së përgjithshme të portofolit të kredisë u ngjiti në nivelin 10.5 përqind.” [fq. 10]

Në këtë mënyrë të gjithë shitësit potencial të blerësve me para të marrë hua nga sistemi bankar duhet të rrisnin depozitat e tyre në bankë, ndërkohë që raporti vëren se ritmi i rritjes së depozitave të publikut do të ishte më i lartë nëse do të përmirësohej situata në sektorin real të ekonomisë dhe do të gjallërohej veprimtaria e kreditimit nga sektori bankar.

Nëse rikthehemi tek të ardhurat shtesë të munguara p.sh., nga 85 miliard Lekë që duhet të ishte TVSH, në fakt ka ndikim negativ për mbi 50 miliard, atëherë kjo

shifër duke ushqyer buxhetin me të ardhura do të ulte defiqitin dhe përmirësonte strukturën ndaj GDP-së, pra me rritjen e kreditimit në ekonomi duhej të kishim efektin shumëfishues në uljen e defiqitit, gjë që nuk rezultoi një përpjesëtim i tillë nëse analizojmë paraprakisht të dhënat në Ministrinë e Financës.

II-Ndikimi i Shtyrë në Portofolin e Kredive me Probleme

Informacioni i qenësishëm që sugjeron skenarin plotësues është pohimi se në terma realë, rritja e kreditimit në valutë ka qenë negative. “Efekti fluskë” provokohet nga shumë transaksione, por në kushtet e skenarit që po shtjellojmë transaksioni bazë është:

Një individ huamarrës ekzistues AB që figuron gati me problem në portofolin e kredive të Bankës XYZ, sugjeron një mik të tijin BC të hua marrë tek një bankë MNO dhe me paratë e tij shlyen kredinë tek banka XYZ dhe në bankë pasqyrohet si huamarrës i mirë, që i jep të drejtën të ri-hua marrë më pas për më shumë, duke ja rikthyer BC që e shlyen kredinë e tij me Bankën MNO dhe përfundimisht BC ka një fitim komisioni, ndërsa AB vijon si huamarrës i rregullt në portofolin e bankës XYZ. Një transaksion i tillë ka karakterizuar Turqinë në krizën e sistemit bankar të saj të vitit 1999-2000, ku nga 54 banka mbeten në treg vetëm 4 banka.

A kërcënohemi nga një sindromë e ngjashme? Mbetet sfida e departamentit të mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ta ekzaminuar, por treguesit që e mbështesin këtë ‘paradoks’, përveç sa më sipër, lidhen edhe me rritjen e numrit të kredive të përsëritura për të njëjtin klient si tipi AB që morëm në konkretizimin e transaksionit si më sipër.

“Paradoksi 3”: Varësia Kritike Defiqit Buxhetor dhe Borxh Publik: Pamje Rrethanore

Lidhja shkak pasojë defiqit-borxh është ndër drejtimet më të vëzhguara për performancën e një Qeverie, qoftë në cikle normale biznesi, po ashtu edhe në fazat ciklike që bartin kriza. Aktualisht Qeveria ka një propensitet të lartë marxhinal për të hua marrë, aq sa sot absorbon 35%-40% të agregatit të kredisë apo 270 miliard Lekë. Kostoja oportune e huamarrjes Qeveritare po prodhon asimetri informacioni dhe rënie efçience të sistemit bankar. Defiqiti buxhetor po përkthehet në agregat krediti me koston, duke ja hequr fondet disponibël që mund t’i ofroreshin biznesit privat/real në ekonomi. Kjo rrethanë krijon të ashtuquajturin paradoks të tretë që përmbledh këto kundërti:

1) Rritja e kërkesës për kredi motivohet si nga Qeveria po ashtu edhe nga bizneset, ndërkohë që oferta për kredi ‘sotet’ nga huamarrësi më i madh, që është Qeveria. Rritja e hises së Qeverisë në huamarrje pritet të jetë e lartë me 2 skenarë alternativë që po interpretohen jo drejtë nga shumëkush:

a) Nëse Qeveria do të realizojë huamarrjen duke emetuar Eurobonde, shtohet kostoja e shërbimit të borxhit që d.m.th., se në afat të ndërmjetëm [mbi 1 vit deri 2 vjet]

Qeveria do të ri-huamarrë në tregun e brendshëm. Kjo do të shtyjë në kohë rritjen e çmimit të kredisë, por nuk e shmang atë.

- b) Nëse Qeveria nuk do të realizojë huamarrjen duke emetuar Eurobonde, ajo do drejtohet në tregun e brendshëm sepse e ka të domosdoshme huamarrjen për të respektuar termat e borxheve të akumuluar, atëherë përsëri, në afatshkurtër do të përjetohet sosja pjesore e agregatit disponibël të kredisë, që përsëri ka si efekt rritjen e normës së interesit.

Kjo d.m.th., se mekanizmi i tregut objektivisht kundërshton preferencat [edhe të mija] për një normë më të ulët interesi.

2) *Një sistem bankar që 35% të fondeve disponibël ja krediton Qeverisë, d.m.th., se ka një beta negativ* sepse krijon një portofol të koncentruar pa rrezik vetëm në instrumente qeveritar, ndërkohë që i mbeten pak fonde disponibël për të ulur rrezikun nëpërmjet diversifikimit të portofolit të huarave në ekonomi, ndaj të cilave kërkohet normë shlyerje/kthimi me rrezik apo më e lartë se norma e shlyerjes që ofrojnë financimet me kredi të Qeverisë. Në këtë parashtrim rrjedhin këto kundërti:

- a) Sistemi bankar duke hua dhënë në Lek me rreth 7% ndaj Qeverisë, shton sasinë e parasë në qarkullim dhe krijon prirje inflatore. Mirëpo, norma nominale e interesit që kontraktjnë bankat në depozita dhe kredi duhet të jetë mbi normën e inflacionit për plus normën reale të interesit, me të cilën sistemi bankar përballon koston e plotë të funksionimit të tij, plus fitimin e kërkuar nga aksionarët. Shkurtimisht këto jepen nga lidhjet:

$$[1] i = r + e = [\text{total cost} + \text{risk} + \text{rprofit}] + e$$

- b) Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë ka si limit të fundit të saj [me marzh pozitiv që një normë interesi bazë baras sa është norma e inflacionit. Ndërsa bankat e nivelit të dytë, përpos kësaj norme bazë, kanë normë interesi plus edhe për pjesën e koston së depozitave dhe të koston së zhytur [infrastrukturë, zyra, administratë, etj.]. Rikujtojmë se sot numërohen rreth 200 agjenci/pika bankare, që me një kosto mesatare për 120 000 Euro në vit krijon një kosto të zhytur minimale për 24 milion euro që i rëndon interesave në kredi. Treguesit bëhen më shprehës nëse marrim në konsideratë edhe koston e depozitave, si dhe koston e rezervave për humbje nga huatë, që në vitin 2009 primi i këtyre rezervave rezultoi 10,5%.

Sot, klima makroekonomike është mosrënie të inflacionit, rritje e portofolit të kredive në rrezik, si dhe rritje e koston për çdo njësi shtesë depozitash, gjë që përfundimisht nuk mbetet pritshmëri dhe as hapësirë për ulje të normave të interesit.

3) *Sikurse në pozitë e çdo huamarrësi, edhe qeveria për çdo njësi borxhi shtesë ekspozohet në rrezikun e uljes së mbulimit të borxhit me garanci*, duke sosur kapacitetin huamarrës të saj, si dhe duke implikuar zëra shpenzimesh shtesë për shërbim borxhi dhe rritje të deficitit buxhetor.

- a) Rritja e borxhit për shkak të mbulimit të rritjes së deficitit buxhetor bëhet me argumentin se shtesa e shpenzimeve do të ndikojë në rritjen e GDP dhe ku shtesa e GDP me nivel konstant taksash do të rrisë arkëtimet e qeverisë për t'i shërbyer pa problem shlyerjes së borxhit. Problemi përpara sistemit bankar me

fondet disponibël që ka, mbetet ndërmarrja e një vendimi optimal [zgjedhja se kujt t'i huajapë dhe vendimi racional [qëllimi apo objektivi përse huajep]. *Vendimi i zgjedhjes se kujt t'i huajepet sistemit qeveritar apo ekonomisë reale, varet nga eficienta e secilit. Nëse Qeveria e përdor borxhin për investime/infrastrukturë, etj., kërkon të peshohet me elementët e koston dhe të konkurrimit në eficientë me alternativën e huadhënies në ekonomi.* Indikatorin më i rëndësishëm që rekomandohet është analiza marzhinale e borxhit sipas raportit bazë: [3] $\Delta \text{Borxh} / \Delta \text{Net Income}$

Nëse ky raport vjen në rritje atëherë d.m.th., se vendimi racional për të rritur huamarrjen qeveritare ndeshet me sfidën për pasigurinë e rritjes së të ardhurave. Në afat të shkurtër ndikimi rritës në GDP vjen për shkak të komponentit G [shpenzimeve qeveritare, por nga ana tjetër kjo si kosto ka përkeqësimin e defiçiti [G-Tx], duke krijuar një rreth vicioz për ta gjetur zgjidhjen në rimarrje borxhi, deri sa rrezikohet të soset kapaciteti huamarrës i Qeverisë. Kështu rritet pritshmëria e krijimit të një krize që del jashtë kontekstit kontrollues qeveritar, duke krijuar një stad më problemor të **rrezikut të vendit**.

- b) Problemi i mësipërm rrit *barrën e borxhit* [saktifikim që duhet të bëjnë qytetarët e një vendi për të përballuar shlyerjen e borxhit publik]. Kjo e prir qeverinë që të shesë aktive/asete të saj nëpërmjet tenderave të privatizimit dhe arkëtimet nga këto privatizime rimbushin vakumet financiare të krijuara nga borxhi. Problemi shtrihet se ndërkohë që qeveria pakëson asetet e saj sa ulet fuqia huamarrëse e vetë Qeverisë, gjë që të rikthen në argumentet e pikës së mësipërme.

Aktualisht Greqia sintetizon këto dy probleme në versionin më kritik sepse Qeveria greke nëpërmjet dikotomisë borxh-deficit nga njëra anë dhe shitjes së krejt aseteve nga ana tjetër, ka 'ezauruar' rëndë kapacitetin huamarrës të saj.

4) *Për ekonomi jashtë eurozonës*, sikurse është Shqipëria, ka një sfidë shtesë që i rëndon Bankës së Shqipërisë. Problemi shtrihet edhe për ruajtjen e fuqisë blerëse të parase kombëtare –të lekut. Rritja e defiçitit buxhetor për shkak të rritjes së shpenzimeve apo të uljes së taksave rrit fraksionin e parase në qarkullim e cila shton masën monetare, inflacionin dhe rrezikun e një suaze morale për Bankën e Shqipërisë për mos arritje të stabilitetit të çmimeve, apo të daljes jashtë kontrollit kritik të inflacionit ose të stabilitetit të Lekut. Qeveria si huamarrëse, priret të preferojë rritje të inflacionit sepse i ul koston reale të shlyerjes së borxhit nëpërmjet uljes së normës reale të interesit³. Nga pikëpamja ekonomike pagesat e interesit në kushtet e inflacionit konsiderohen si shlyerje të shumës themelore të borxhit⁴. Prandaj investitorët rrezikojnë të arkëtojnë para me fuqi blerëse më të ulët.

“Paradoksi” 4: Iluzioni Fiskal dhe Ekuivalenca e Rikardos

Në doktrinën ekonomike, impakti i financimit të defiçitit buxhetor me huamarrje [borxh apo me rritje taksash ose ulje shpenzimesh, vlerësohet se nuk sjell ndryshim

3 *Shih identitetin 1 fq 7.*

4 *Mishkin 'Economics of Money, Banking and Financial Markets' 2008 Pearson.*

në pozicionin financiar të publikut, gjë që njihet si *teori e ekuivalencës së Rikardos* (*Ricardo's equivalence*). Sipas tezës së ekuivalencës së Rikardos, mendon se ulja e sotme e taksave do të shoqërohet nesër [në të ardhmen] nga një rritje e taksave dhe që neutralizon ndikimin e ndryshimeve të taksave ndaj konsumit të tyre, duke kursyer përfitimet që rrjedhin nga ulja e sotme e taksave për ti përdorur në të ardhmen kur pritët të rriten taksat.

Teoria apo teza e ekuivalencës së Rikardos është formuluar nga D. Rikardo⁵, konsiston në pohimin se nëse Qeveria e një vendi tërheq një pjesë të kursimeve kombëtare sepse shtrëngohet nga financimi i deficitit buxhetor me borxh-marrje, atëherë e njëjta shumë do të rikompensohet me rritje taksash të mëvonshme. Rikardo vetë ishte skeptik për këtë tezë, që formon një ndër bazat historike të teorisë së vonshme të pritjeve racionale të *Robert Lucas*, që pohon se nëse njerëzit e kanë këtë pritje racionale, ata do të ishin indiferent ndërmjet dy sistemeve, por për rrethanat ose segmentet shoqërore që nuk e kanë këtë pritje racionale ata mbeten subjekt i këtij *iluzioni fiskal* që do të shtrembëronte vendimet e tyre. Për ekuivalencën e Rikardos, ekonomisti i shquar Robert Barro pohon se kur pasuria neto marxhinale nga investimi në bonde i afrohet nivelit zero, atëherë ndikimet fiskale që lidhen me ndryshimin relativ të taksave dhe të financimit me borxh, nuk kanë ndikim në agregatin e kërkesës, në normat e interesit dhe formimin e kapitalit. Ky pohim u konsiderua si kontributi themelor në Makroekonomikën e Re Klasike nën këndvështrimin e pritjeve racionale⁶ Teza e ekuivalencës së Rikardos dhe punimi i Robert Barro janë edhe sot objekt studimi, madje edhe nga vetë Banka Qendrore Evropiane, ku studimi më informues është punimi i Gabriella Briotti për "Reagimet Ekonomike ndaj Konsolidimit të Financave Publike..."⁷.

"Paradoksi" 5: Asimetria e Informacionit në Impaktin e Kreditimit Sistemi

Bankat nëpërmjet *huadhënies për Qeverinë* pritët të ndikojnë:

- a) *Në rritjen e agregatit kërkesës për strukturën e mallrave dhe të shërbimeve të konsumit dhe*
- b) *Në rritjen e agregatit kërkesës për mallra kapitale [p.sh., për pjesën e huamarrjes që qeveria e përdor për blerje të mallrave kapitale – p.sh., makineri, pajisje, ndërtim veprash publike, etj.].*

Mirëpo, në thelb kjo strukturë borxhi nuk ka ristrukturuar ekonominë nga konsumi drejt investimeve. Kjo për arsye se statistikat e investimeve prodhuese në zonat rurale, nën-urbane, etj., janë të papërfillshëm, ndërkohë që kreditë kryesisht drejtohen për transaksione tregtare. Këto drejtime shihen edhe në pasqyrën vijuese:

5 David Ricardo, "Essay on the Funding System" McCulloch 1888

6 Robert J. Barro – "Are Government Bonds Net Wealth?" *Journal of Political Economy* Vol. 82, No. 6. (Nov. – Dec., 1974, pp. 1095-1117)

7 M. Gabriella Briotti, "Economic Reactions to Public Finance Consolidation: a Survey of the Literature", ECBank Occasional Paper No. 38/ Oct 2005,

Borxhi	Yield			
	2009	2008	2009	2008
Afatshkurtër	57%	56%	8,788%	8,213 %
fatgjatë	43%	44%	n/a	n/a
Totali	100%	100%		
Ekspozimi në Rrezik	Kontribuesit ndaj Totalit:		22%	23%
↓	Raiffeisen Bank	34,5%	35,2%	
↓	Bankat e Tjera	31,3%	31,8%	
↓	Sistemi Bankar II	35,8	37%	2009/2008 ↓
↓	Sistemi Bankar I+II	57,8	60	2009/2008 ↓
↑	Biznese Jo Banka	2,5	2,3	2009/2008 ↑
↑	Individë	9,7%	7,7%	2009/2008 ↑

Kundrejt pasqyrës, treguesit strukturor të borxhit përmbajnë këto shqetësime kryesore:

Së Pari: Rreziku i likuiditetit mbetet i lartë, sepse Qeveria mban peshë të lartë të borxhit afatshkurtër madje në rritje [+1%] dhe peshë të ulët të borxhit afatgjatë. Duke qenë se peshën më të lartë e ka borxhi afatshkurtër, kjo d.m.th., se ekonomia jonë nuk po ristrukturohet drejt investimeve. Fakti se 60% e borxhit financohet tërësisht nga sistemi bankar, ku vetëm një Bankë si Raiffeisen ka mbi 34,5% të financimit të borxhit, tregon për shkallë të lartë koncentrimi dhe varësie.

Në këtë mënyrë, edhe portofoli i aktiveve të RBAL priret drejt investimit pa rrezik kreditimi, por me rrezik inflacioni. Kjo d.m.th., se nga njëra anë qeveria ka varësi shumë të lartë vetëm nga një bankë, nga ana tjetër RBAL ka ekspozim për mbi 40% të portofolit në tituj pa rrezik, me rendiment mesatar rreth 8%. Kjo d.m.th., se në terma reale, kur inflacioni priret shumë pranë 8%, t'i krijojë një fitim ekonomik thuajse zero për RBAL.

Së Dytë: Struktura e borxhit krijon një kosto të lartë oportuniteti. Qeveria është huamarrësi më i madh i sistemit bankar që financon 60% të borxhit të saj. Kjo d.m.th., se bankat gërryejnë bazën monetare të tyre duke ja huadhënë Qeverisë, sepse po kaq i pakësohen fondet disponibël për t'i huadhënë në ekonomi – *biznesit privat*. Konflikti shihet në përgjigje të pyetjes nëse ekonomia është përdoruese më efeçiente e kredive bankare apo Qeveria.

Së Tretë: Bankat rrezikojnë të krijojnë hazard moral për faktin se prirjen të huajapin nominalisht ndaj qeverisë në kosto të mos-huadhënies ndaj publikut. Duke qenë se bankës i mbetet një disponibilitet i pakët fondesh, rritet shkalla e koncentrimit të rrezikut për njësi kredie të huadhënë, gjë që rrit koston e kredisë në ekonomi. Diferenciali i normës së interesit në kredi për ekonomi është mbi 2 herë më i lartë se i kredisë ndaj qeverisë.

Së Katërtë: Një vendim optimal i bankave për të zgjedhur që të investojnë në të Mira/Bono Thesari informon për krizë likuiditeti, për faktin se bankat pranojnë fitime të munguara [kosto oportune shtesë] vetëm e vetëm për të pasur sa më shumë gjendje

instrumentesh me likuiditet të lartë, sikurse janë të mirat e thesarit.

Së Pesti: Dukuria më negative që ka filluar të shfaqet është fakti se ndërkohë bankat kanë pakësuar peshën ndaj kreditimit për qeverinë, institucionet jo bankë dhe individët e kanë rritur këtë peshë [+2%]. Kjo e zhvendos barrën e rrezikut tek pjesa më e brishtë e strukturës ekonomike.

Identifikimi i Rrezikut

Për sistemin tonë bankar është e domosdoshme ripërtëritja e qasjeve për identifikimin e ekspozimit në rrezik, të vlerësimit të tij si dhe të kontrollit të rrezikut drejt një minimizimi të kostonë së rrezikut. Sot funksioni qëllimor për çdo biznes, është maksimizimi i fitimit me minimizimin e kostonë. Pikërisht për të mbështetur qëndrueshmërinë e sistemit bankar u projektua dhe zbatohet Basel II, parimet bazë të të cilit janë de facto standarde për mbikqyrjen e bankave.

Informacioni asimetrik josh teknika të kontabilitetit krijues/kozmetikë, të cilat dëmtojnë moralin e lojës së drejtë në treg sepse fshehin aktivitetet mashtruese brenda bankave, minojnë besimin e palëve të interesuara dhe ul vlerat e bankës si një e tërë.

Krahas zbatimit të Bazel II, një dëshmi e rëndësishme e qeverisjes së mirë të një banke është edhe cilësia e lartë e raportimit financiar. Orientimi i shëndoshë i kontabilitetit është një politikë e rëndësishme për mbrojtjen e integritetit të një banke. Përtej shpalosjes dhe komunikimit me publikun, një sistem rigoroz dhe i besueshëm kontabiliteti siguron dhe ofron informacion të rëndësishëm me të cilin bazohen vendimet faktike që ndikojnë në të ardhmen të bankës.

Rregullat që udhëzojnë kontabilitetin dhe raportimet financiare duhet të konvergojnë dhe të përputhen në mënyrë të përkryer sipas një baze globale. Mirëpo ato nuk janë të mirëfillta në vetvete, e për këtë arsye Tryezat e Standardeve Ndërkombëtare kanë marrë misionin për standardizimin e tyre.

Për shkak të blerjeve të shpeshta të bankave që kanë ndodhur në sistemin tonë bankar, si dhe për faktin se pothuajse të gjithë blerësit janë të vendeve të BE, zbatimi i IFRS shndërrohet në domosdoshmëri urgjente.

2-Prospekti i IFRS dhe i Basel II brenda Sistemit Bankar në Shqipëri

Më shumë se kurrë, bashkësia e pjesëmarrësve të tregut rajonal dhe global po përmirësojnë kodet e tyre informuese duke mbrojtur me forcë që pasqyrat financiare të jenë të sakta, të drejta dhe të ndershme. Një rationale plotësuese se përse Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit duhet të bëhen të detyrueshme, lidhet edhe me kushtet e konvergjencës dhe të pajtueshmërisë që Shqipëria punon për të ndjekur BE⁸.

Vlen të përmendet se megjithëse që nga 1 janari 2009, raportimi sipas IFRS është

8 Regulation No. 1606/2002 of the European Parliament and of the Council of 19 July 2002 on the application of International Accounting Standards

detyrim për të gjitha bankat rezidente në Shqipëri, megjithatë bankat ende e masin ekspozimin në rrezik dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duke u bazuar në Rregulloren Nr 52 të Bankës së Shqipërisë mbi “Menaxhimi i rrezikut të kredisë”, e cila më shumë përputhet me Basel I se sa me Bazel II. Për këtë arsye, Rregullorja nr 52 e Bankës së Shqipërisë mbetet jashtë kohës dhe që nuk i përgjigjet zgjidhjeve që kërkojnë shqetësimet e reja që shfaq sistemi ynë bankar.

Ekspozimi në Rrezik dhe Vlerësimi i Kredive të Dëmtuara sipas IFRS **—Konteksti i Shqipërisë**

Urdhëri i MF për të përkthyer kontabilitetin bankar sipas IFRS, imponon aplikimin e këtij algoritmi:

Identifikimi dhe Vlerësimi i Cilësisë së Kredive sipas IFRS	
Step 1	<i>Metodat Identifikuese</i>
Step 2	<i>Teknikat e Matjes së Humbjeve të Pësuar nga Huatë</i>
Step 3	<i>Përcaktimi i Rezervave për Humbje nga Huatë dhe i Fondeve për Financimin e Humbjeve nga Huatë</i>
Step 4	<i>Vendosja/Artikullimi i Rregullt në Kontabilitet</i>
Step 5	<i>Kontrolli i Ndikimeve në Portofolin e Kredive</i>
Step 6	<i>Rivlerësimi i pozicionit të Kapitalit të Bankës</i>
Step 7	<i>Sigurimi i Shpalosjes së Informacionit në Përputhje të Plotë me IFRS</i>
Standardi Kontabël Udhëzues Bazë: IAS 39: Instrumentet Financiare	

Algoritmi i IAS 39

Më sipër jepen pikat kryesore të IAS 39, për evidentimin në kontabilitet të dëmtimit të kredive në portofolin e një banke duke ju referuar rrezikut themelor që njihet si “Të pësuar por jo të raportuara” [IBNR], ndërkohë që praktikisht, duke u bazuar në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë kriteri i përcaktimit të rezervave për humbje nga huatë bazohet në humbje të pritshme për t’u ndodhur sipas normativave që ka caktuar banka e Shqipërisë.

Në historikun e shkurtër, raporti i kredive të këqija ndaj portofolit gjithsej të sistemit bankar nga 3,5% më 2008, arriti në 10,5% në 2009 dhe brenda 6-mujorit të parë 2010 prirjet të jetë mbi 12% apo rreth 4 herë më shumë se sa niveli bazë krahasimor. Vërejtja e dukurisë është e drejtë, pavarësisht se sa luhatje saktësie mund të pretendohet.

Duke u bazuar në sistemet e paralajmërimit sa më të hershëm (*Early Warning Systems*) vërehen probleme kritike që e bëjnë imperative përkthimin me cilësinë e duhur të kontabilitetit bankar sipas IFRS.

1-Shqetësimet domethënëse⁹ së pari lidhen me përkufizimin e një kredie apo grupi

9 IAS 39.64

kredish të dëmtuara. *Kriteri bazë për ta quajtur një kredi të dëmtuar është kur gjendja e kredisë në llogarinë kontabël apo vlera kontabël e kredisë është më e madhe se shuma që mund të arkëtohet prej saj, duke marrë në konsideratë edhe shitjen e kolateralit.*

2-Segmentimi i Portofolit për Karakteristika të Ngjashme Rreziku¹⁰ lidhet me grupimin e kredive në bazë të karakteristikave të ngjashme për rrezikun e kredisë.

3-Njohja e Interesit për zbërthimin e kredisë si aktiv [IAS 39, AG93] konsiston në përcaktimin e vlerës së tanishme të një kredie, duke skontuar arkëtimet e ardhshme të saj me normën zanafillë/originale efektive të interesit për kreditë e analizuara individualisht për prani dëmtimi dhe me normën efektive të interesit sipas tregut për kreditë e analizuara si grup. Qasja e IFRS bazohet në dëmtimin e ndodhur për arkëtimet e tanishme/ushtimore në të holla të një kredie. Problemi që përball një bankë, implikon shpalosjen e dukurisë “Se si mund të ndjekin klientët, normën aktuale ndaj normës efektive të interesit?”

4-Ristrukturimi priret drejt Ri-negocimit, kërkon të dallojë nëse një kredi do të mbahet si e tillë deri në maturim apo është kredi që do të shitet për tek një banke apo pale tjetër. Ristrukturimi përfshin alternativa të ndryshme të shlyerjes së kredisë, ndërsa ri-negocimi përfshin zgjedhjen/pranimin e njëres prej tyre. Këto bëhen vetëm për kreditë që mbahen deri në maturim (*Held To Maturity*) (IFRS) 7,36 (d).

5-Llogaritja e Përdorimit të Rezervave të Bazuara në Portofolin e Huarave [IAS 39.AG89] bazohet në përvojën e viteve të kaluara të korrigjuar në mënyrë kumulative me çdo vit ose periudhë shtesë të përjetuar. *Pengesat më spikatëse që pritët të kenë bankat rezidente në Shqipëri, lidhen me disponibilitetin e ulët të të dhënave historike, pra edhe të përvojës, sepse bankat në Shqipëri janë relativisht të reja.*

6-Llogaritja e Periudhës së Identifikimit të Humbjes [IAS 39.AG90] bazohet në mirë-përcaktimin se kur duhet konsideruar si humbje e pësuar dhe që ka “mbetur” e paraportuar. Kjo njihet si rreziku humbjes së “Pësuar por të Pa Raportuar”. Banka e Shqipërisë duhet të ofrojë një bazë të dhënash dhe një studim të dedikuar për përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes lidhur me *Periudhën e Identifikimit të Humbjes* (*Loss Identification Period -LIP*).

7-Prapa testimi (backtesting) [IAS 39.AG89] d.m.th., se çdo vlerësim për arkëtimet e supozuara në të holla nga një llogari kredie duhet të ri-testohet/provohet për objektivitetin, saktësinë, duke krahasuar diferencat ndërmjet humbjes së vlerësuar me humbjen faktike të rezultuar.

8-Llogaritja e kolateralit [IAS 39.AG84] bëhet për vlerën e tanishme të arkëtimeve të ardhshme të pritshme në kushtet e sekuestrimit dhe të shitjes së kolateralit për të kompensuar pjesën e paarkëtuar të kredisë. Arkëtimet e pritshme llogariten për neto si diferencë e arkëtimeve nga shitja me koston për zotërimin dhe shitjen e kolateralit. Vlera e tregut të kolateralit analizohet si vlerë e sforcuar tregu, vlerë normale apo e drejtë tregu, gjë që për të patundshmet përmbahen në

10 T IAS 39.AG87

standardet TeGOVA¹¹.

9-Njohja e përkundërt e Humbjeve nga Dëmtimi i Kredive [IAS 39.65] d.m.th., se nëse përmirësohen kushtet e arkëtimit të kredisë nga huamarrës që më parë janë vlerësuar si problemor, këto duhet të pasqyrohen nëpërmjet njohjes përkundër humbjes, duke ndërmarrë edhe veprimin kontabël të rikthimit të rezervës nga humbjet të përdorur më parë. Kjo quhet *ngjarje e përkundërt* (*reversal event*) dhe kërkon të kuptohet mirë se kjo ka sens rivlerësimi, por jo ri-korrigjim të veprimeve të mëparshme kontabël. Në këtë mënyrë kontabiliteti shpreh realisht ecurinë historike të kësaj metamorfoze.

3-Skema Bazë e Dallimeve IFRS dhe Basel II

Tabela e mëposhtme jep dallimet kryesore ndërmjet IFRS¹² dhe Basel II¹³:

Basel II [EBNR ¹] ekspozimi në humbje: <i>Humbje e Pritshme nga Huatë</i>	Treguesit/Teknika: PD*EAD*LGD	Nivele administrative provigjionimi
IFRS [IBNR ²]: <i>Humbje e Pësuar nga Huatë</i>	Kriteri i Rrezikut Kontabël IBNR: DCF= <i>Discount Cash Flow</i>	Ekspozime të Ardhshme nisur nga Ekspozimi Faktik i Sotëm IAS 37

Nga sa më sipër për Basel II duhet të kuptojmë se:

Objektivi i Basel II është siguria e një banke dhe e sistemit bankar për nivel të mjaftueshëm rezervash dhe kapitali për të mbuluar humbjet për 12 muajt e ardhshëm.

Ndërsa për IFRS duhet kuptuar dallimi bazë që konsiston në pohimin vijues:

Objektivi i IFRS është të sigurojë se pasqyrat financiare pasqyrojnë realisht, objektivisht dhe saktësisht gjendjen e bankës [aktive minus detyrime baras kapitali] dhe veçanërisht humbjet e pësuar nga dëmtimi i huarave aktive në portofol. Problemet kryesore që duhen riparë sot për sistemin tonë bankar janë

- 1- Përpilimi i një metodike për kalimin nga modeli i rezervave sipas humbjeve të pritshme në rezerva sipas humbjes së pësuar. Në aplikimin e këtij studimi në BIS Banca, diferenca rezultoi 2,5% për rritje të rezervë.
- 2- Standardizimi i raportimit të të ardhurave nga interesat për kreditë e dëmtuara; dhe
- 3- Metoda e skontimit që duhet të përdoret për provigjionimin e kredive [DCF¹⁴] The discounting of provisions for loans.

11 *The European Group of Valuers' Associations, TEGOVA: European Valuation Standards, Sixth Edition-2009*

12 Expected but not reported-të pritshme por të paraportuara

13 Incurred but not reported-të pësuar por të paraportuara.

14 DCF-discount cash flow

- 4- Mirë përcaktimi se bankat duhet të konsiderojnë huara të dëmtuara kundrejt provave objektive, sepse rritja artificiale e tyre mund të motivohet nga krijimi i rezervave të tepërta/të fshehura për shmangie të taksës ndaj fitimit.
- 5- Verifikimi nëpërmjet ri testimit apo testimit prapakthyes, kjo për të sheshuar diferencat ndërmjet humbjes së vlerësuar dhe të rezultuar në fakt.

Një element i rëndësishëm që shpesh neglizhohet lidhet me përkufizimin e Probabilitetit të Dështimit [probability of default –PD] që sipas Basel II llogaritet për periudhë 12 mujore. Ndërsa sipas IFRS merret në konsideratë çdo muaj.

Testimi i Stresit

Sa më sipër, kërkohet që bankat të kenë një rezervë mbështetëse kapitale (*capital buffers*) dhe Basel II i kërkon bankave që ta vlerësojnë stresin e mjaftueshmërisë kapitale, duke u bazuar në **përqasjen sipas normimit të brendshëm të bankës** në kushtet e një recesioni të butë [me të paktën 2 tremujorë të njëpasnjëshëm me rritje zero].

Një sugjerim është që korniza e testimit të stresit modelohet me variabla makro sikurse është rritja e GDP¹⁵. Një alternativë tjetër është testimi i stresit i lidhur me ecurinë e humbjeve nga kreditë. Kjo alternativë i përgjigjet më mirë horizonteve afatgjatë të **testit të stresit**.

Rezultatet e studimit argumentojnë që në fazën e parë testimi i stresit të bëhet me dy alternativat dhe krahasimi i tyre përcakton nëse kemi rezervë të mjaftueshme kapitale për përballim rrethanash të pafavorshme dhe të mundshme në të ardhmen (*capital buffer*).

Ndryshimi i kërkesës për kapital minimal sugjeron një nivel kapitali rezervë për 2,5%-4,5% në përgjigje të një niveli mirëbesimi (confidence level) 99%.

Brenda intervalit të mësipërm, banka të ndryshme do të rezultojnë me nivele të ndryshme. P.sh., tek BIS Banka niveli i kapitalit rezervë shtesë është 3.83% ndaj aktiveve gjithsej.

Detyra e Bankës për zbatimin e testit të stresit bazohet në Normimin sipas Përqasjes së Brendshme. Objektivi është vlerësimi se sa kapital shtesë i duhet bankës ndaj kërkesës ekzistuese për kapital minimal të domosdoshëm, për të përballuar skenarë të pafavorshme në skenare të rënies së butë

Modeli i Finlandës [Sorge dhe Virolainen] argumenton një kovariancë të ngushtë dhe korrelacion pozitiv të fortë ndërmjet humbjeve nga huatë dhe propensitetit të huamarrësve për të dështuar. Verifikimi i kësaj lidhje në një kontekst shqiptar mbetet për t'u verifikuar kur në një të ardhme të afërt mund të kemi të dhëna disponibël.

15 Sorge and Virolainen (2006) and Virolainen (2004)

4-Konkluzione

Synimi ynë nuk është argumenti krizë-jo krizë se sa efçencë dhe jo efçencë. Nëse nga lexues të ndryshëm të kësaj proze, paradokset dhe argumenti vijues nuk pranohen për krizë, atëherë duhet pranuar si diferencial shqetësues efçence që Bankave u imponon tregu të zgjedhin ndërmjet kreditimit të Qeverisë [Qendrore ose Lokale] dhe përmirësimit të vetë sistemit bankar.

Nga ana tjetër, asimetria negative që bankat përjetojnë me huamarrësit transmeton asimetri negative të bankës me aksionarët, me Bankën e Shqipërisë dhe më e rëndësishmja, bankat rrezikojnë hazardin moral të asimetrizojnë informacionin në lidhje me publikun, e sidomos me depozituesit.

Shqipëria nuk ka mbrojtje të konsumatorit të produkteve bankare, qoftë të depozituesit po ashtu edhe të huamarrësit. Kjo bën që depozituesit të rrezikojnë që të humbin fuqi blerëse, duke depozituar në banka sepse interesi që ofrojnë bankat priret të gërryhet nga inflacioni. Një depozitues merr më pak euro me paratë [Lekë pas një viti se sa kur përftonte përpara një viti kur vendoste depozitën].

Teknikisht orientimet e politikave dhe të studimeve të ardhshme rekomandojmë të priren:

- 1- Në përsosjen e Arkitekturës së Amvisimit/Drejtimimit të Rrezikut;
- 2- Standardizimi bashkëkohor i Identifikimit, Vlerësimit dhe Kontrollit të Rrezikut të Kontrollit të Brendshëm në secilën bankë dhe krejt sistemin, duke aplikuar futjen/përpunimin dhe raportimin e treguesve përkatës.
- 3- Konfigurimi dhe zbatimi i Sistemit të Informacionit Menaxherial;
- 4- Rritja e nivelit të identifikimit dhe kontrollit të rrezikut të IT dhe të transaksioneve elektronike [e-banking].
- 5- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të dedikuara dhe krijimi i Njësive të Përputhshmërisë si alternativa bazë e shmangies së rrezikut reputacional të bankës.

Të gjitha këto përkthehen në ulje të kostos së mbikqyrjes dhe të vetë kostos së rrezikut, inventarizim në kohë i problemeve operationale dhe vendimmarrëse dhe pasurim i bazës së të dhënave për saktësi dhe efikasitet të ardhshëm/vijues.

Sa ndikohet PBB – ja nga krediti bankar dhe standartet e kredidhënies?¹⁶

Një Panel për Eurozonën

— Arjan Kadareja, PhD —

ABSTRAKT. Duke zbatuar metodën e mirënjohur të identifikimit të Driscoll (2004)¹⁷ në këtë studim jepet evidencë empirike për praninë e kreditit bankar si kanal transmetimi i politikës monetare në eurozonë. Ne gjejmë se luhatjet e sasisë dhe standarteve të kreditit bankar kanë ndikim të rëndësishëm në prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Kjo gjetje nënvizon rëndësinë që ka ndjekja e zhvillimeve të kreditit bankar për politikëbërësit, si edhe mbështet rolin e rëndësishëm që duhet të luajë analiza monetare dhe e kreditit në strategjinë e politikës monetare të Bankës Qëndrore Europiane. Ky studim gjithashtu tregon se problemet e ndërmjetësuesve financiarë me bilancin në situatën e pas-krizës 2007, do të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike. Arsyeja është se kriza financiare i ka detyruar bankat të marrin masa për uljen e raportit të aktiveve me kapitalin¹⁸ që do të thotë më pak kredit për bizneset dhe individët.

Përmbledhje

Ky studim jep evidencë empirike për praninë e kreditit bankar si kanal transmetimi i politikës monetare në zonën euro. Metoda e identifikimit që përdorim e ka origjinën nga Driscoll (2004) dhe është zbatuar për herë të parë në studimin e tij për ekonominë e Shteteve të Bashkuara. Por, ndryshe nga studimi i mësipërm, ne gjejmë se në Eurozonë luhatjet e sasisë dhe standarteve të kreditit bankar kanë ndikim në prodhimin e brendshëm bruto.

Kjo gjetje nënvizon rëndësinë që ka ndjekja e zhvillimeve të kreditit bankar për

16 Ky është një version i shkurtuar i ECBWP 1150 i Janarit 2010

17 Driscoll, J.C. (2004), "Does bank lending affect output? Evidence from the US states", *Journal of Monetary Economics* 51, pp. 451-71.

18 angl. delever balance sheets

politikëbërësit, si edhe mbështet rolin e rëndësishëm që duhet të luajë analiza monetare dhe e kreditit në strategjinë e politikës monetare të Bankës Qëndrore Europiane.

Ky studim gjithashtu tregon se problemet e ndërmjetësuesve financiarë me bilancin në situatën aktuale do të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike. Kjo ndodh sepse kriza financiare i ka detyruar bankat të marrin masa për uljen e raportit të aktiveve me kapitalin që do të thotë më pak kredit për bizneset dhe individët.

Endogjeneiteti ose lidhja e kundërt shkak – pasojë është çështja më e rëndësishme që duhet patur parasysh kur vlerësohet ndikimi i kreditit bankar tek prodhimi¹⁹. Në merremi me këtë çështje duke përdorur metodën e identifikimit à la Driscoll (2004). Kështu zona euro konsiderohet si një grup shtetesh me kurs të përhershëm fiks këmbimi por me tregje bankare të pakicës të fragmentarizuara sipas kufijve gjeografikë. Si rrjedhojë, goditjet shock psh. pozitive të kërkesës për para në shtete të veçantë do të sillnin rritje të ofertës së kreditit bankar. Përderisa goditjet shock të kërkesës për para janë të lidhura me ofertën e kreditit dhe jo me prodhimin e brendshëm bruto, atëherë ato mund të përdoren si instrumenta identifikimi të lidhjes *rritje prodhimit të brendshëm bruto – rritje e kreditit bankar*.

Kjo metodë realizohet teknikisht në tre shkallë. Së pari, vlerësohet korrelacioni midis rritjes së prodhimit të brendshëm bruto dhe kreditit bankar. Së dyti, vlerësohen goditjet shock të kërkesës për para si edhe gjykohet nëse ato janë instrumenta të përshtatshëm për kreditin bankar. Së fundmi, vlerësohet lidhja *rritje prodhimit të brendshëm bruto – rritje e kreditit bankar*, duke përdorur goditjet shock të kërkesës për para si instrumenta identifikimi.

1. Hyrje

Kriza financiare e Gushtit të vitit 2007 zbuloi brishtësinë e ndërmjetësuesve financiarë dhe sidomos të bankave, sipas të paktën dy drejtimeve. Nga njëra anë, për shkak të humbjeve të mëdha, bankat kërkuan ethshëm të rrisnin kapitalin përmes investitorëve privatë ose programeve të ndihmës qeveritare. Nga ana tjetër, rritja e nivelit të kapitalit por edhe e fondeve afatshkurtra u bë mjaft e vështirë. Kjo faktohet si me rritjen e theksuar të normave të interesit për bondet bankare kundrejt atyre qeveritare, ashtu edhe me diferencën e rritur Libor – OIS²⁰ në tregjet ndërbankare pas falimentimit të Lehman Brothers në USA.

Problemët i detyruan bankat të reduktonin bilancin pra edhe kreditin bankar. Kështu në fund të 2008-ës, u dokumentua një rënie e theksuar e kreditit bankar për bizneset dhe individët në Eurozonë. Rezultatet e një ankete të Bankës Qëndrore Europiane²¹ treguan se faktorët ishin të lidhur jo vetëm me uljen e kërkesës për kredit

19 Problemi i endogjeneitetit në lidhjen *rritje prodhimi – rritje krediti* ka të bëjë me vështirësinë për të dalluar nëse krediti vetëm ndikon prodhimin apo edhe oferta e kreditit ndikohet nga prodhimi i pritshëm.

20 Rritjet në diferencën Libor – OIS (*angl. Overnight Index Swap*) tregojnë se bankat e kanë gjithnjë e më të kushtueshme marrjen e kredive afatshkurtra nga njëra – tjetra në tregun ndërbankar.

21 Hempell dhe Kok Sørensen (2009)

nga bizneset si rezultat i pritshmërive për tkurrje të aktivitetit ekonomik por edhe me uljen e ofertës së kreditit nga bankat si rezultat i vështirësive të tyre për të siguruar financim.

Ky studim merret me matjen e ndikimit të kreditit bankar në PBB për Eurozonën. Ne parashikojmë se ky ndikim duhet të jetë i konsiderueshëm, duke ditur se në sistemin financiar në Eurozonë, ndryshe nga USA, bankat tregtare zënë një peshë dominuese. Studimi hedh dritë edhe mbi çështjen, që preokupon bankierët qëndrorë në rast krize si kjo e sotnja, e që ka të bëjë me efektivitetin e transmetimit të politikës monetare përmes një sektori bankar në vështirësi.

Studimi vijon me literaturën rreth kreditit bankar si kanal transmetimi i politikës monetare në seksionin 2, si edhe në seksionin 3, me analizën e peshës së ndryshme që zënë bankat në sektorin financiar në USA kundrejt Eurozonës. Konsideratat teorike rreth problemit të endogjeneitetit të kreditit bankar në lidhjen me PBB jepen shkurtimisht në seksionin 4. Seksioni 5 shpjegon modelin, ndërsa seksioni 6 jep metodologjinë e vlerësimit dhe të dhënat e përdorura. Rezultatet dhe konkluzionet jepen në dy seksionet e fundit.

2. Transmetimi i politikës monetare përmes kreditit bankar – Literatura

Teorikisht dihet se politika monetare ndikon aktivitetin ekonomik dhe inflacionin përmes një sërë kanalesh transmetimi të lidhura me sektorin bankar. Kontributet në literaturë në këtë drejtim janë të shumta dhe ne do t'i përmendim shkurtimisht.

Studimet e hershme që mbështesin rëndësinë e bankave në transmetimin e politikës monetare janë nga Brunner dhe Meltzer (1963) dhe Bernanke (1983).

Kanali klasik i transmetimit të politikës monetare është ai i *normave të interesit*. Ky kanal përmes bankave funksionon me inerci të madhe sepse varet nga disa faktorë të tjerë përveç normës bazë të interesit të kontrolluar nga politika monetare²².

Një tjetër kanal është ai i *kreditit bankar*. Kështu politika monetare ndikon kredidhënien bankare përmes efekteve në depozitat. Ky ndikim është i rëndësishëm përsa kohë bankat luajnë rol primar në kredidhënie²³.

Kanali i kreditit bankar është “përditësuar” me pikëpamjet për rëndësinë e *bilancit* të firmave në transmetimin e politikës monetare. Kështu një politikë monetare e uljes së normës së interesit do të rriste kreditin bankar për firmat përmes forcimit të kredibilitetit të tyre. Forcimi do të vinte sepse do të rriteshin të ardhurat e firmave dhe do të uleshin kostot e financimit. E kundërta do të ndodhte në rast se politika

22 Shih psh. Gropp et al. (2007), Van Leuvensteijn et al. (2008)

23 Shih psh. Bernanke dhe Blinder (1988), Bernanke dhe Gertler (1995), Peek dhe Rosengren (1995),

Kashyap dhe Stein (2000), Van den Heuvel (2002), Kishan dhe Opiela (2006), Ehrmann et al. (2001), Angeloni, Kashyap dhe Mojon (2003), Gambacorta dhe Mistrulli (2004), Altunbas et al. (2004), Altunbas et al. (2008)

monetare do të rriste normën bazë të interesit²⁴.

Një tjetër kanal transmetimi realizohet përmes ndikimit mbi *rrezikun* e marrë përsipër nga bankat²⁵. Kështu politika monetare ndikon kreditin bankar përmes efekteve në çmim, manaxhim dhe perceptim të rrezikut nga bankat²⁶.

Duhet theksuar se studimet e shumta japin evidencë solide për ndikimin e politikës monetare në ofertën e kreditit bankar. Nga ana tjetër, evidenca për ndikimin e ofertës së kreditit bankar në PBB është jo e rëndësishme statistikisht. Kështu, as Driscoll (2004) dhe as Ashcraft (2006) nuk gjejnë një ndikim të rëndësishëm të kreditit bankar mbi PBB për ekonominë e USA.

3. Fakte për peshën e sektorit bankar në sistemin financiar – USA kundrejt Eurozonës

Ne mendojmë se rezultatet e përmendura në seksionin më lart janë ndikuar nga fakti që objekti i studimit ka qënë ekonomia Amerikane ku financimi direkt përmes obligacioneve dhe aksioneve luan rol mjaft të rëndësishëm krahas financimit bankar dhe ndërmjetësuesve të tjerë. Në rastin e Eurozonës faktet tregojnë se financimi përmes bankave tregtare luan rolin dominues ndërsa financimi direkt nuk është i rëndësishëm.

Kështu deri në fund të 2007-ës sasia totale e obligacioneve dhe aksioneve të emetuara në USA ishte sa 312% e PBB, ndërsa në eurozonë sa 166% e PBB, nga ana tjetër financimi bankar i sektorit privat ishte sa 145% e PBB në Eurozonë, ndërsa në USA vetëm sa 63% e PBB²⁷.

Sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Eurozonë është mjaft më i rëndësishëm se sa në USA. Kështu 67% e numrit total të të punësuarve i përkisnin këtij sektori në eurozonë dhe vetëm 43% në USA. Këto të dhëna përforcojnë rëndësinë e financimit bankar në Eurozonë kundrejt USA, po të kihet parasysh se sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka mundësi të pakta të emetojë direkt borxh dhe financohet kryesisht përmes kreditit bankar.

Më tej, sikurse tregohet qartë në fig.1, për periudhën 1970 – 2000, financimi përmes bankave zinte 75% të financimeve për ndërmarrjet jo financiare në Gjermani krahasuar me vetëm 18% në USA. Nga ana tjetër, financimi direkt përmes obligacioneve dhe aksioneve zinte 42% të financimit për ndërmarrjet jo financiare në USA krahasuar me vetëm 15% në Gjermani.

24 Shih psh. Bernanke et al. (1999)


25 *Angl.* risk – taking

26 Shih psh. Rajan (2005), Borio dhe Zhu (2008), Jiménez et al. (2007), Maddaloni et al. (2009), Altunbas et al. (2009), Ioannidou et al. (2009).

27 Shih ECB (2009)

Figura 1

USA dhe Gjermania: Financimi i Jashtëm Për Ndërmarrjet Jo Financiare
(Mesatarja e Viteve 1970 – 2000)²⁸



Pra faktet e mësipërme tregojnë qartë se krediti bankar ka peshë mjaft më të rëndësishme në Eurozonë se sa në USA.

4. Krediti bankar dhe PBB, ose problemi i “pulës me vezën”

Kur përpiqesh të vlerësosh ndikimin e kreditit bankar në prodhim, duhet të merresh me problemin e *endogjeneitetit* ose të lidhjes së kundërt shkak – pasojë. Ky problem ka të bëjë me pamundësinë për të dalluar nëse oferta e kreditit bankar ndikon prodhimin apo në të kundërtën, pritshmëria e prodhimit të ardhshëm ndikon ofertën dhe/apo kërkesën për kredi, sot.

Literatura na mëson se shpërfillja e këtij problemi sjell pasojat e një vlerësimi kryekëput të gabuar statistikor. Atëhere për të matur ndikimin e kreditit në prodhim, ne do të përdorim të ashtuquajturit *instrumenta*. Instrumentat e mirë janë ata që ndikojnë variablin që zëvendësojnë në një regresion²⁹ si edhe që ndikojnë variablin e varur vetëm përmes efektit që kanë në variablin e zëvendësuar.

Ne merremi me këtë çështje duke adoptuar për Eurozonën, modelin e Driscoll (2004) për ekonominë e USA. Sipas këtij modeli, vendet e Eurozonës i konsiderojmë si një grup ekonomish të vogla dhe të hapura nën një regjim me kurs fiks këmbimi të monedhës si edhe me tregje të fragmentarizuara të bankngut me pakicë. Prej këtej rrjedh se goditjet shock të kërkesës për para në një vend të caktuar të Eurozonës

28 Burimi i të dhënave : Andreas Hackethal dhe Reinhard H. Schmidt, “Financing Patterns: Measurement Concepts and Empirical Results,” Johann Wolfgang Goethe “Universitat Working Paper No. 125, January 2004.

29 Në këtë rast është regresioni i PBB – së ndaj kreditit bankar. Pra instrumenti zëvendëson në regresion variablin e kreditit bankar, për të cilin kemi dyshime se ndikohet nga PBB-ja.

ndikojnë ofertën e kreditit në atë vend.

Le të marrim një shembull. Supozojmë se për një nivel të caktuar prodhimi dhe normash interesi në një vend të Eurozonës, ndodh një goditje pozitive shock e kërkesës për para. Pra papritur e pakujtuar, konsumatorët e atij vendi dëshirojnë të kenë më shumë para se më parë. Kjo me fjalë të tjera do të thotë se kërkesa për depozita bankare do të rritet. Meqënëse jemi nën një regjim me kurs fiks këmbimi, rritja e kërkesës për depozita në një vend nuk do të mund të zvogëlonte normën afatshkurtër të interesit³⁰ por do të sillte vetëm rritjen e ofertës për para në atë vend dhe zvogëlimin lehtësisht të saj në pjesën tjetër të Eurozonës. Përfundimisht, rritja e ofertës për para në vendin e goditjes shock, do të sillte rritjen e ofertës së kreditit bankar sepse burimet e financimit të bankave (depozitat) do të rriteshin³¹. Duke supozuar se bizneset dhe konsumatorët i varin shpresat për financim kryesisht tek bankat, atëherë rritja e ofertës së kreditit do të çonte në rritjen e konsumit dhe të investimeve pra në rritjen e prodhimit.

5. Modeli

Ne e vlerësojmë ndikimin e kreditit bankar në PBB duke adaptuar për Eurozonën, modelin e Driscoll (2004) për ekonominë e USA. Modeli është një formë e ISLM – së dhe përmban tre ekuacione të kërkesës për mallra, para dhe kredit si edhe ekuacionin e ofertës së kreditit bankar.

Variablat në model janë *devijime* nga mesatarja e Eurozonës³² dhe kjo bëhet që të përjashtohen nga modeli normat e interesit të bondeve (*angl.* yields). Qëllimi është të përjashtohet ndikimi i politikës monetare në prodhim përmes kanalit të normave të interesit (*angl.* liquidity channel). Mospërjashtimi do të sillte problem shtesë identifikimi.

Zgjidhja e modelit në ekuilibër, në kohën ‘t’ për vendin ‘i’ të Eurozonës, përfaqësohet nga dy ekuacionet e mëposhtme: ekuacioni i prodhimit (1) dhe ai i kreditit bankar (2),

$$\tilde{y}_{it} = \frac{\alpha}{\chi + \omega\alpha} \tilde{l}_{it} - \frac{\alpha}{\chi + \omega\alpha} v_{it} + \frac{\chi}{\chi + \omega\alpha} z_{it}, \quad (1)$$

$$\tilde{l}_{it} = \frac{\beta\delta\chi}{\chi + \mu} \tilde{r}_{it}^d + \frac{\beta\gamma\chi + \omega\mu}{\chi + \mu} \tilde{y}_{it} + \frac{\chi\beta}{\chi + \mu} \varepsilon_{it} - \frac{\mu}{\chi + \mu} v_{it} + \frac{\chi}{\chi + \mu} w_{it}, \quad (2)$$

Në ekuacionet e zgjidhjes (1) dhe (2) përveç prodhimit dhe kreditit bankar që

30 Normat afatshkurtra të interesit janë unike në Eurozonë dhe lëkundjet e një vendi të vetëm nuk i ndikojnë dot.

31 Kjo ndodh me siguri përsa kohë depozitat përfaqësojnë për bankat burime të preferuara financimi (pra jo lehtësisht të zëvendësueshme me burime të tjera)

32 Pra, PBB-ja tremujore (në logaritëm natyral) e një vendi në model është e barabartë me diferencën e PBB-së tremujore të tij (në logaritëm natyral) me mesataren e PBB-së së Eurozonës (në logaritëm natyral) në atë tremujor.

ndodhen respektivisht në të majtë, figurojnë (në të djathtë) një sërë parametrash si edhe goditjet shock të kërkesës për mallra e shërbime (z_{it}), goditjet shock të kërkesës për para (ε_{it}), goditjet shock të kërkesës për kredit bankar (v_{it}), goditjet shock të ofertës së kreditit bankar (w_{it}) dhe norma e interesit të depozitave (r_{it}^d).

Ekuacionet e zgjidhjes tregojnë ndër – varësinë midis prodhimit dhe kreditit bankar³³. Nga zgjidhja shihet se goditjet shock të kërkesës për para nuk figurojnë në të djathtë të ekuacionit (1)³⁴ pra ato e ndikojnë prodhimin vetëm nëpërmjet kreditit bankar, sipas ekuacionit (2). Goditjet shock të kërkesës për para do të ishin *totalisht egzogjene* në lidhje me prodhimin nëse do të bëhej supozimi se, **Corr** ($\varepsilon_{it}; v_{it}$) = **Corr** ($\varepsilon_{it}; z_{it}$) = 0

Ky supozim duhet të jetë realist sepse goditjet shock të kërkesës për para (ε_{it}) vijnë nga ndryshimi i papritur i shijeve të publikut apo institucioneve, faktorë këta që nuk kanë të bëjnë me goditjet shock të kërkesës për mallra e shërbime (z_{it}) dhe goditjet shock të kërkesës për kredit bankar (v_{it}). Pra goditjet shock të kërkesës për para (ε_{it}) duke qënë të lidhura me kreditin bankar (nga ekuacioni (2)) por jo direkt me prodhimin, plotësojnë kushtet për të qënë instrumenta të mirë në vlerësimin e ndikimit të kreditit bankar në prodhim.

6. Metoda ekonometrike dhe të dhënat e përdorura

Në këtë studim vendet e përfshira të Eurozonës janë : Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Holanda, Portugalia dhe Spanja. Kriteri i përfshirjes ose jo bazohet vetëm tek disponibiliteti i të dhënave. Të dhënat janë tremujore dhe mbulojnë periudhën 1999 T1 deri 2008 T1, dmth fillojmë që nga momenti i lindjes së Eurozonës. Kjo zgjedhje duhet të përjashtojë ndikimin në vlerësimin empirik të ndryshimeve strukturore të lidhura me përgatitjen për futjen e Euro – s.

Të dhënat për PBB – në nominale dhe reale si edhe seria e indeksit të çmimit të PBB – së, janë marrë nga Eurostat. Të dhënat për M_3 ³⁵, M_2 ³⁶ dhe kreditin bankar³⁷ janë marrë nga ECB. Normat e interesit për depozitat janë marrë gjithashtu nga ECB. Tabela 1 (në Shtesë) përmban karakteristikat bazë të të dhënave.

Ne përdorim panel të instrumentalizuar për vlerësimin e ndikimit të kreditit bankar në prodhim. Qëllimi është të përdorim në vlerësim të gjithë informacionin që vjen nga diferencat ciklike mes ekonomive të Eurozonës. Sikurse shihet nga Figurat 1 dhe 2 (në Shtesë) diferencat ciklike janë të konsiderueshme dhe rrjedhimisht përdorimi i panelit duhet të sjellë vlerësim më të saktë.

Paneli është i instrumentalizuar sepse ne përdorim goditjet shock të kërkesës për para për të zëvendësuar kreditin bankar në lidhjen e tij me PBB – në. Ky zëvendësim

33 Sepse krediti dhe prodhimi ndodhen edhe në të majtë edhe në të djathtë të sistemit (1), (2).

34 Nëse do të figuronin do të kishim problem shtesë identifikimi

35 Ne përdorim M_3 minus *currency* (*cash* që mban publiku)

36 Ne përdorim M_2 minus *currency* (*cash* që mban publiku)

37 Teprica e kredisë për bizneset jo – financiare

është i detyruar për shkak se krediti bankar është endogjen dhe si i tillë *ofendon* kushtet statistikore për një *vlerësim të pagabueshëm* të ndikimit të tij në prodhim.

Vlerësimi është bërë me tre faza,

Së pari, vlerësohen goditjet shock të parasë;

Së dyti, është vlerësuar lidhja goditje shock të parasë – kredit bankar;

Së treti, vlerësohet ndikimi i kreditit bankar në prodhim (PBB) duke përdorur si instrumenta goditjet shock të parasë.

7. Rezultatet

Rezultatet e vlerësimit jepen në **Tabelën 2**. Sikurse shihet rritja reale e prodhimit³⁸ (variabli endogjen) është një proces autoregresiv sepse vlerat e tij një dhe dy periudha më parë vlerësohet se kanë një ndikim të rëndësishëm statistikiisht. Këta koeficientë janë **0.456** për rritjen reale një periudhë më parë dhe **0.322** për rritjen reale dy periudha më parë. Çështje më e rëndësishme ndikimi i rritjes së kreditit bankar³⁹ të periudhës së tanishme në rritjen e prodhimit, është **0.077**, pra me shenjë e duhur dhe i rëndësishëm statistikiisht. Për të shpjeguar më qartë rezultatet e vlerësimit do të ndërmarrim një stimulim të thjeshtë. Supozojmë se ka një goditje shock negative në një vend të zonës euro dhe si pasojë rritja e kreditit bankar ulet me 5%⁴⁰ në krahasim me mesataren e rritjes në Eurozonë.

Sipas rezultateve tona kjo përkthehet në ulje afatshkurtër të PBB – së prej

*-5% * 0.077 = - 0.4%*

dhe ulje afatmesme prej

-5%(0.077)/(1-0.456-0.322) = -1.7%.*

Këto janë ndikime të rëndësishme dhe duhet të vijnë nga fakti që ndryshe nga USA, në Eurozonë krediti bankar i dominon shumë qartë format e tjera të financimit.

8. Konkluzione

Ky studim jep evidencë empirike për praninë e kreditit bankar si kanal transmetimi i politikës monetare në Eurozonë.

Ndryshe nga evidenca e USA, ne gjejmë se ndryshimet në ofertën e kreditit bankar për bizneset jo – financiare kanë ndikim të konsiderueshëm në aktivitetin real ekonomik. Kjo vë theksin në rëndësinë e monitorimit nga bankat qendrore të zhvillimeve të kreditit bankar si edhe në përdorimin e tyre në politikëbërje. Ne japim një vlerësim sasior për ndikimet negative në rritjen ekonomike të problemeve të bilancit të bankave të Eurozonës që erdhën si pasojë e krizës që u përhap në Shtator 2007.

38 Si devijim nga rritja mesatare e PBB – së në Eurozonë

39 Si devijim nga rritja mesatare e kreditit në Eurozonë

40 Kjo është një goditje që është verifikuar gjatë periudhës që ne studiojmë.

Tabela 2 – Rezultatet e Vlerësimit

Madhësia e Varur: $\Delta \check{Y}_{it}$ Metoda e vlerësimit është panel i instrumentalizuar. Goditjet shock të kërkesës për para janë përdorur si instrumenta.		
	Koeficienti	Gabimi standard
$\Delta \check{Y}_{it-1}$	0.456	0.080
$\Delta \check{Y}_{it-2}$	0.322	0.061
$\Delta \check{I}_{it}$	0.077	0.036
$\Delta \check{I}_{it-1}$	-0.004	0.012
$\Delta \check{I}_{it-2}$	-0.035	0.020
R^2	0.66	
# Obs.	366	
Koeficientët në “bold” janë të rëndësishëm statistikisht të paktën në 5% $\Delta \check{Y}_{it}$ - rritja e pbb si devijim nga mesatarja e zonës euro $\Delta \check{I}_{it}$ - rritja e kreditit bankar si devijim nga mesatarja e zonës euro		

9. Bibliografi


- [1] Altunbas, Y., de Bondt, G. and Marqués-Ibañez, D. (2004), "Bank capital, bank lending and monetary policy in the euro area", Kredit und Kapital, 4/2004.
- [2] Altunbas, Y., Gambacorta, L. and Marqués-Ibañez, D. (2008), "Securitisation and the bank lending channel", European Economic Review (forthcoming).
- [3] Altunbas, Y., Gambacorta, L. and Marqués-Ibañez (2009), "Bank risk and monetary policy", Journal of Financial Stability (forthcoming).
- [4] Angeloni, I., Kashyap, A.N. and Mojon, B. (eds.), (2003), Monetary Policy Transmission in the Euro Area, Cambridge University Press.
- [5] Ashcraft, A. (2006), "New evidence on the lending channel", Journal of Money, Credit and Banking 38(3), pp. 751-76.
- [6] Bernanke, B.S. (1983), "Nonmonetary effects of the financial crisis in the propagation of the Great Depression", American Economic Review 73(2), pp. 257-76.
- [7] Bernanke, B.S. and Blinder, A. (1988), "Credit, money and aggregate demand", American Economic Review, Papers and Proceedings 75(1), pp. 435-39.
- [8] Bernanke, B.S. and Gertler, M. (1995), "Inside the black box: The credit channel of monetary policy transmission", Journal of Economic Perspectives Vol. 9(4), pp. 27-48.
- [9] Bernanke, B.S., Gertler, M. and Gilchrist, S. (1999), "The financial accelerator in


- a quantitative business cycle framework”, in Taylor, J. and Woodford, M.(eds.), *Handbook of Macroeconomics*, Amsterdam, North-Holland.
- [10] Berger, A.N. and Hannan, T.H. (1989), “The price-concentration relationship in banking”, *Review of Economics and Statistics* Vol. 71 (2), pp. 291-299.
 - [11] Berger, A.N., Kashyap, A.K. and Scalise, J.M. (1995), “The transformation of the US banking industry: What a long strange trip it's been”, *Brookings Papers on Economic Activity* Vol. 2, pp. 55-218.
 - [12] Borio, C. and Diyat, P. (2009), “Unconventional monetary policies: An appraisal”, *BIS Working Papers* No. 292.
 - [13] Borio, C. and Zhu, H. (2008), “Capital regulation, risk-taking and monetary policy: A missing link in the monetary policy transmission mechanism?”, *BIS Working Paper* No. 268.
 - [14] Brunner, K. and Meltzer, A.H. (1963), “The place of financial intermediaries in the transmission of monetary policy”, *American Economic Review* 53(2), pp.372-82.
 - [15] Campbell, J.Y., A.W. Lo and A.C. MacKinlay (1997), *The Econometrics of Financial Markets*, Princeton University Press, Princeton, N.J.
 - [15.1] L. Capiello, A. Kadareja, C. K. Sorensen and M. Protopapa(2010), “Do Bank Loans and Credit Standards Affect Output? - A Panel Data Approach”, *European Central Bank Working Paper* No. 1150, January 2010.
 - [16] Correa, R. and Suarez, G.A. (2009), “Firm volatility and banks: Evidence from U.S. banking deregulation”, *Federal Reserve Board Finance and Economics Discussion Paper* No. 2009-46.
 - [17] Diyat, P. (2008), “Monetary policy implementation: Misconceptions and their consequences”, *BIS Working Papers* No. 269.
 - [18] Driscoll, J.C. (2004), “Does bank lending affect output? Evidence from the US states”, *Journal of Monetary Economics* 51, pp. 451-71.
 - [19] European Central Bank (2008a), *Financial Integration in Europe*, April.
 - [20] European Central Bank (2008b), “The role of banks in the monetary policy transmission mechanism”, *Monthly Bulletin*, August.
 - [21] European Central Bank (2009), “The external financing of households and non-financial corporations”, *Monthly Bulletin*, April.
 - [22] Gambacorta, L. and Mistrulli, P. (2004), “Does bank capital affect lending behaviour?”, *Journal of Financial Intermediation* Vol. 13, pp. 436-57.
 - [23] Gerali, A., Neri, S., Sessa, L. and Signoretti, F.M. (2009), “Credit and Banking in a DSGE model of the euro area”, paper presented at the Conference on Financial Markets and Monetary Policy organised by the Federal Reserve Board of Governors, June 4-5 2009, Washington D.C.
 - [24] Hempell, H.S. and Kok Sørensen, C. (2009): “The Impact of Supply Constraints on Bank Lending in the Euro Area .Crisis Induced Crunching?., paper presented at the ECB Workshop on “Challenges to monetary policy implementation beyond the financial market turbulence” (30 Nov.-1 Dec. 2009, Frankfurt).
 - [25] Gropp, R., Kok Sørensen, C. and Lichtenberger, J. (2007), “The dynamics of bank

- spreads and financial structure”, ECB Working Paper No. 714.
- [26] IMF (2008), Global Financial Stability Report, October.
- [27] Ioannidou, V., Ongena, S. and Peydró, J.L. (2009), “Monetary policy and subprime lending: A tall tale of low Federal Funds Rates, hazardous loan, and reduced loan spreads”, European Banking Center Discussion Paper, No. 2009-04S.
- [28] Jiménez, G., Ongena, S., Peydró, J.L. and Saurina, J. (2007), “Hazardous times for monetary policy: What do twenty-three million bank loans say about the effects of monetary policy on credit risk?”, CEPR Discussion Paper No. 6514.
- [29] Kashyap, A.N. and Stein, J. (2000), “What do a million observations say about the transmission of monetary policy?”, American Economic Review 90(3), pp.407-28.
- [30] Kishan, R.P. and Opiela, T.P. (2006), “Bank capital and loan asymmetry in the transmission of monetary policy”, Journal of Banking and Finance Vol. 30, pp. 259-85.
- [31] Maddaloni, A., Peydró, J.L. and Scopel, S. (2009), “Does monetary policy affect bank credit standards? Evidence from the euro area bank lending survey”, ECB Working Paper, forthcoming.
- [32] Peek, J. and Rosengren, E. (1995), “Is bank lending important for the transmission of monetary policy: An overview”, Federal Reserve Bank of Boston Conference Series: Proceedings, pp. 1-14.
- [33] Rajan, R. (2005), “Has financial development made the world riskier?”, NBER Working Paper No. 11728.
- [34] Van den Heuvel, S. (2002), “Does bank capital matter for monetary transmission?”, Economic Policy Review, Federal Reserve Bank of New York, May 2002, pp. 259-65.
- [35] Van Leuvensteijn, M., Kok Sørensen, C., Bikker, J.A. and Van Rixtel, A. (2008), “Impact of bank competition on the interest rate pass-through in the euro area”, ECB Working Paper No. 885.

Shtesë

Figura 2





	Mean	Median	Maksimum	Minimum	Dev.Standard	Variacioni
PBB nominal(€mld.)	678.3	278.4	2452.1	81.7	709.4	1
PBB real (€mld.)	595.1	258.9	2331.0	69.1	672.7	1.1
Deflator (%)	1.2	1.2	1.6	1.0	0.1	0.1
M3 (€mld.)	509.8	287.4	1891.8	63.7	481.7	0.9
M3 (€mld.)	434.6	276.3	1751.3	55.5	407.7	0.9
Norma e depozitave(%)	2.7	2.9	9.2	0.1	0.8	0.3
Kredit Bankar	272.5	117.8	903.9	20.5	260.8	1.0
Standartet e kreditit	12.7	12.5	100.0	-50.0	6.8	0.5
- Konkureshmëria (bk)	-17.8	-18.3	50.0	-75.0	6.9	-0.4
- Konkureshmëria (job)	-17.8	-18.3	33.3	-40.0	6.9	-0.4
- Konkureshmëria (mk)	-17.8	-18.3	40.0	-40.0	6.9	-0.4

Burimet e të dhënave janë Eurostat dhe ECB

Roli dhe objektivat e AMF si rregullator i tregjeve financiare jobankare në Shqipëri

Elisabeta Gjoni

Kryetare AMF

Anxhela Dervishi

Departamenti i Mbikëqyrjes, AMF

ABSTRAKT. Ky punim fillimisht pasqyron mësimet e nxjerra nga kriza financiare botërore në lidhje me përmirësimin e rregullimit ligjor të sistemit financiar në tërësi, si dhe aspektet kryesore mbi të cilat janë mandatuar reformat për përmirësimin e rregullimit ligjor të këtij sistemi në kuadrin ndërkombëtar, duke marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të sektorëve.

Ky punim fokusohet në sfidat dhe rregullimin ligjor të sektorit të sigurimeve në botë e në vijim edhe në rolin e AMF si rregullator i tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri. Në mënyrë të përmbledhur, në këtë punim trajtohen projektet e ndërmarra prej AMF në drejtim të përmirësimit të rregullimit ligjor, e në mënyrë të veçantë puna e AMF në drejtim të përmirësimit të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve në Shqipëri për adaptimin e një metodologjie mbikëqyrje me bazë riskun.

Tendencat e Rregullimit Ligjor të Sistemit Financiar

Regullimi ligjor i sistemit financiar për çdo sektor brenda tij bëhet mbi bazën e parimeve ose standardeve themelore, të nxjerra nga organizatat ndërkombëtare respektive. Nisur nga fakti se çdo sektor i veçantë brenda sistemit financiar ka karakteristikat e veta, edhe parimet themelore të sektorëve respektivë reflektojnë karakteristikat e tyre, natyrën e institucioneve financiare të mbikëqyrura dhe tiparet e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të këtyre sektorëve. Këto parime themelore të nxjerra në mënyrë të pavarur nga organizatat ndërkombëtare si BCBS, IAIS dhe

IOSCO përfaqësojnë kërkesat minimale për një mbikëqyrje të shëndoshë të sektorëve respektivë.

Kriza e fundit financiare botërore evidentoi probleme nga secili sektor: bankar, i sigurimeve apo i letrave me vlerë. Këto probleme kanë tendencën të kenë impaktin e tyre në sistemin financiar në tërësi. Për një sistem financiar të qëndrueshëm afatgjatë është i rëndësishëm përmirësimi i rregullimit ligjor në kuadrin ndërkombëtar, duke marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të sektorëve.

Në deklaratën e Kryetarëve të shteteve dhe qeverive të G20, në vijim të takimit në Londër në Prill 2009⁴¹, u vu theksi në nevojën për përmirësimin e rregullimit ligjor të sistemit financiar, duke mandatuar reforma mbi mënyrën e rregullimit. G20 vendosi një peshë të madhe në zgjerimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve, instrumenteve dhe tregjeve financiare. Zbatimi i këtyre reformave përfshin dy aspekte kryesore: të sigurohet që sistemet financiare t'i përgjigjen risqeve të ndërmarra gjatë aktiviteteve në sektorët e ndryshëm të sistemit financiar, dhe standardizimi dhe uniformiteti i rregullimit ligjor. Kështu, rekomandimet e përgjithshme të mbledhjes së G20 konsistojnë në:

- ❖ Kërkesa që aktivitete, produkte dhe tregje të njëjta duhet të jenë subjekt i një mbikëqyrje dhe rregullimi minimal të njëjtë
- ❖ Uniformitet në rregullimin ligjor përmes sektorëve të ndryshëm të sistemit financiar, pavarësisht se mund të ekzistojnë diferenca legjitime ndërmjet sektorëve
- ❖ Rregullimi ligjor dhe mbikëqyrja duhet të mbajnë në konsideratë risqet dhe në mënyrë të veçantë riskun sistemik
- ❖ Uniformitet në zbatimin e standardeve ndërkombëtare

Globalizimi dhe lidhjet e botës financiare kërkojnë një bashkëpunim të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar. Pavarësisht se aktivitetet për të parandaluar dhe zgjidhur krizat duhet të jenë globale, janë autoritetet rregullatore kombëtare ato, që përbëjnë vijën e parë të mbrojtjes kundër destabilizimit të tregut. Në arenën ndërkombëtare një koordinim më i mirë ndërmjet rregullatorëve është një faktor pozitiv për vendosjen e standardeve të duhura për të pasur një stabilitet financiar. Edhe kriza e fundit ekonomike tregoi që në fazat e para të saj, se bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të bëhej një faktor kryesor në menaxhimin e kësaj krize.

Rregullimi ligjor në sektorin e sigurimeve

Standardet ndërkombëtare të sektorit të sigurimeve vendosen nga IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Siguruesve), themeluar në 1994. Kjo organizatë

41 *Banque de France • Financial Stability Review • No. 13 – The future of financial regulation • September 2009*

ka mbledhur rregullatorët dhe autoritetet mbikëqyrëse nga rreth 190 vende, të cilat përbëjnë rreth 97% të primeve të sigurimit në rang botëror.

IAIS kontribuon në zhvillimin e tregjeve të rregulluara të sigurimeve, duke vendosur standarde ndërkombëtare dhe duke nxitur zbatimin efektiv të këtyre standardeve, me objektiv mbrojtjen e policë-mbajtësve. Standardet e vendosura nga IAIS në sektorin e sigurimeve mbulojnë fusha rregullatore, si: liçensimi, mbikëqyrja dhe qeverisja e shoqërive të sigurimit. Këto standarde janë pjesë e paketës së standardeve të përdorura nga IMF dhe WB në kuadrin e FSAP (Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar).

Aktualisht, IAIS është angazhuar në diskutime të nivelit ndërkombëtar lidhur me çështje të stabilitetit financiar dhe të rëndësisë së institucioneve financiare. Me qëllim arritjen e rezultateve të dëshiruara nga mbikëqyrja, IAIS ka ndërmarrë një sërë iniciativash të tjera.

Kështu, fillimisht në Janar të këtij viti, 2010, IAIS duke e gjykuar mjaft të nevojshme mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit në bazë grupi u angazhua në ndërtimin e një kuadri ligjor të përbashkët për mbikëqyrjen e grupeve (ComFrame) të cilët zhvillojnë aktivitetin e sigurimeve në nivel ndërkombëtar. Ky qëndrim shoqërohet me zhvillim qasjesh më të efektshme për të mundësuar mbikëqyrjen e strukturës së grupit, aktivitetet e grupit dhe transaksionet brenda për brenda grupit me qëllim identifikimin e risqeve të mundshme dhe krijimin e masave të nevojshme mbrojtëse. ComFrame do të ndërtohet brenda një periudhe tre vjeçare zhvillimi, duke filluar jo më vonë se 30 qershor 2010. Miratimi i dokumentit përfundimtar planifikuar në 2013 do të ndiqet nga vlerësimet e impakteve të krijuara nga ky dokument i ri.

IAIS gjithashtu shikon mbikëqyrjen me fokus makro si mjet të domosdoshëm për përmirësimin e mbikëqyrjes. Mbikëqyrja me fokus makro është një përforsim që i bëhet mbikëqyrjes mikro nga kuadri rregullator në nivel kombëtar, duke nxitur rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare për të gjithë sistemin në tërësi, gjë që ndihmon në zbutjen e riskut në nivel sistemi.

Së dyti, standardet dhe udhëzimet ekzistuese po azhurnohen për tu siguruar që në to do të reflektohen mësimet nxjerrë nga kriza financiare, siç është rasti i trajtimit të entiteteve të pa mbikëqyrur dhe trajtimi i çështjeve të veçanta si për shembull përmirësimi i menaxhimit të riskut të ndërmarrjeve, stress-testing, menaxhimi i aktive-detyrimeve dhe qeverisja e shoqërisë.

Së treti, po vijon puna për Memorandumin Multilateral të Mirëkuptimit lidhur me bashkëpunimin në mbikëqyrje dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe bashkëpunimin ndër kufitar në menaxhimin e krizave.

Sfidat e sektorit të sigurimeve në botë

Megjithëse situata e tregut të sigurimeve në botë në fillim të vitit 2010 është më e mirë se ajo e fillimit të vitit 2009, përsëri ka ende shumë sfida afatgjata dhe afatshkurtra me të cilat përballet sektori i sigurimeve. Pasiguria për formën dhe shpejtësinë e rikuperimit nga kriza, vështirëson rikthimin në nivelin e të ardhurave

dhe rentabilitetit të periudhës para krizës për siguruesit botërorë. Kriza financiare ka rezultuar në disa ndryshime strukturore afatgjatë në mbarë ekonominë botërore, dhe kjo ka ndryshuar në mënyrë thelbësore karakteristikat e disa risqeve në sektorin e sigurimeve. Ndryshimet që kanë ndodhur, mund t'i detyrojnë shoqëritë e sigurimit të ndryshojnë aktivitetin e biznesit të tyre, p.sh të lëvizin drejt shitjes së produkteve të reja ose në drejtim të tregjeve të reja. Kjo gjë do të sjellë ndryshime në profilin e riskut të shoqërive të sigurimit, gjë që nëse nuk menaxhohet si duhet, mund të kërcënojë aftësinë paguese të këtyre shoqërive dhe si rrjedhojë mund të shkaktojë shqetësime për trajtimin e konsumatorëve.

Rekomandimet në shkallë botërore për siguruesit dhe ndërmjetësit në sigurime, fokusohen së pari tek menaxhimi i kapitalit si mjet kryesor për të përballuar kriza të ardhshme. Së dyti, shoqëritë e sigurimeve duhet të përdorin teknikën e stress-testing në mënyrë të rregullt për t'iu përshtatur ndryshimeve të kushteve ekonomike dhe të tregtimit. Së treti, shoqëritë e sigurimit duhet të sigurojnë që produktet e tyre ofrojnë benefite reale për konsumatorët, që risqet dhe kufizimet e produkteve i janë bërë të qarta konsumatorëve dhe se vetë shoqëritë e sigurimit i kuptojnë implikimet për menaxhim të riskut për biznesin e tyre.

Një nga zhvillimet e rëndësishme që do të ndikojë sektorin e sigurimeve në botë, për një periudhë afatgjatë, do të jetë zbatimi i regjimit të ri të Solvency II, i cili do të ndryshojë rrënjësisht regjimin e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin e sigurimeve në Evropë. Siguruesit duhet të jenë të vëmendshëm për ndikimin që do të ketë në aftësinë paguese të tyre futja e kërkesave të Solvency II. Ky regjim i ri synon të vendosë një sërë kërkesash për mjaftueshmërinë e kapitalit, të cilat duhet të jenë më sensitive ndaj riskut, kërkojnë standarde të qëndrueshme të menaxhimit të riskut dhe sigurojnë vlerësim konsistent për asetet dhe detyrimet. Gjithashtu, do të ketë kërkesa të reja rregullatore për transparencën e shoqërive të sigurimit. Për finalizimin e këtij projekti është parashikuar fillimi i vitit 2013 dhe shoqëritë e sigurimit evropiane janë në fazën e marrjes së masave për zbatimin e tij. Zbatimi efektiv i këtij regjimi të ri do t'i sjellë benefite të konsiderueshme afatgjatë këtij sektori dhe do të përmirësojë cilësinë e menaxhimit të riskut në këto shoqëri sigurimi.

Roli i AMF si rregullator i tregjeve financiare jo bankare

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) është një institucion rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

Në kuadrin e zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare me ritme të shpejta, dhe unifikimit të standardeve rregulluese dhe mbikëqyrëse, edhe AMF si rregullatorët e vendeve të tjera është angazhuar për zbatimin e “parimeve të përgjithshme”. Në këtë frymë, AMF ka intensifikuar kontaktet dhe shkëmbimin e eksperiencës me homologët

dhe vazhdon të ketë një pjesëmarrje gjithnjë e më shumë aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë. AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve: të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensione (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. AMF është pjesëmarrëse, me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të dhënave të Ligjeve të IAIS-it. Synimi i funksionimit të kësaj strukture lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t'u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare.

Pas një pune intensive për t'u bërë pjesë e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit me IOSCO-n, në Qershor 2009, gjatë Konferencës së 34 Vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Letrave me Vlerë (IOSCO) që u mbajt në Tel Aviv, AMF nënshkroi këtë Marrëveshje me IOSCO-n, duke u bërë anëtare e organizatës me të drejta të plota. Ky anëtarësim është i një rëndësie të veçantë dhe ka ardhur pas një procesi të gjatë verifikimi, i cili solli nevojën e hartimit të një sërë aktesh rregullative. Nënshkrimi i Marrëveshjes hap rrugën e madhe të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet homologe në mbarë botën, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje ishte një detyrim për të gjithë anëtarët e IOSCO-s dhe procesi i nënshkrimit të tij duhet të përfundonte brenda vitit 2010.

Një nga prioritetet e punës së AMF që nga krijimi i saj është rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor, që rregullon sektorët e mbikëqyrur. Përjasja me direktivat Evropiane, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian, si dhe përshtatja e rregullave me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shëndoshë të tregjeve, mbeten faktorët kryesorë në ndërmarrjen e nismave ligjore nga ana e AMF.

Që nga krijimi i AMF, kuadri ligjor dhe rregullativ i tregut financiar jo-bankar ka pësuar ndryshime progresive, në përgjigje të kërkesave dhe zhvillimeve të tregut dhe si refleks i nevojës për një rregullim më të mirë dhe mbikëqyrje nga ana e Autoritetit. Kështu, vlen për t'u përmendur realizimi i projekteve të ndërmarrja për hartimin e ligjeve, si: për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, për sipërmarrjet e fondeve të investimeve, për fondet private të pensioneve dhe për obligacionet, ligje të cilat do të ndihmojnë për t'i dhënë një impuls tjetër dhe frymëmarrje tregut financiar jo-bankar. Këto projekte ligjore janë realizuar dhe miratuar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë. Në vijim të kësaj pune, AMF ka si objektiv hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve nënligjore në zbatim të këtyre projekteve të miratuara.

Një tjetër objektiv i AMF është ligji bazë i sigurimit dhe risigurimit, për të cilin janë evidentuar problemet dhe ndryshimet ligjore që kërkohen. Këto ndryshime janë duke u përgatitur në bashkëpunim me Bankën Botërore, në kuadër të projektit për një mbikëqyrje efektive, financuar nga FIRST Initiative. Me realizimin e këtij objektiivi përmbillet matrica e akteve ligjore apo ndryshimeve ligjore të planifikuara.

Objektivat e AMF në drejtim të mbikëqyrjes efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri

Gjatë këtyre viteve të fundit, tregu i sigurimeve është karakterizuar kryesisht nga zhvillime pozitive dhe qëndrueshmëri. Zhvillime pozitive ka pasur edhe në drejtim të përmbushjes së objektivave dhe prioriteteve të AMF për forcimin e mbikëqyrjes së këtij tregu. AMF, në kuadër të krizës financiare globale, ka ndjekur një strategji të kujdesshme për të monitoruar, parandaluar dhe reaguar ndaj efekteve negative të krizës financiare në tregun financiar shqiptar të mbikëqyrur prej tij. Në përputhje me këtë strategji, janë evidentuar risqet me ekspozim më të lartë ndaj efekteve të krizës ndërkombëtare, duke konsideruar skenarët e mundshëm si dhe reagimin përkatës, janë orientuar shoqëritë e sigurimit drejt masave për mbrojtjen ndaj risqeve me ekspozim më të madh, janë kërkuar raportime më të shpeshta dhe të detajuara nga tregu dhe institucione të tjera shtetërore, në lidhje me të dhënat financiare, portofolin e investimeve dhe risqet madhore, janë kryer takime në kuadër të Grupit të Stabilitetit Financiar, pjesëmarrës të të cilit janë AMF, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, për të marrë në konsideratë situatën dhe koordinimin e aktiviteteve, etj.

Në zbatim të përgjegjësisë ligjore si Autoritet mbikëqyrës e në funksion të misionit të tij themelor, atë të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, AMF realizon funksionin e vet mbikëqyrës nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, bashkërendimit të analizave financiare dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit të mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me bazë risku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrje efektive, etj

Kështu, AMF ka monitoruar me sukses procesin e rritjes së kapitalit minimal në formën e fondit të garancisë në nivelet e vendeve të BE-së. Fondi i Garancisë, si për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe ato të jo-jetës tashmë është minimalisht në masën 370 mln lekë. I gjithë procesi i rritjes së kapitalit, në të gjitha format e përzgjedhura nga shoqëritë e sigurimit, është ndjekur me përparësi nga AMF dhe është mbyllur me sukses, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në ndihmë të funksionit të vet mbikëqyrës, një nga projektet e rëndësishme që AMF ndërmori që në vitin 2007 ishte projekti i ngritjes së Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik. Ky projekt kalon nëpër disa faza e deri tani janë realizuar me sukses faza e parë dhe e dytë e këtij projekti, në lidhje me ngritjen e Regjistrat Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik dhe ngritjen e Regjistrat të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike. Për të mundësuar fazën e tretë të projektit, krijimin e sistemit Bonus Malus, Regjistri i Dëmeve do të plotësohet me të dhënat historike të dëmeve për tre vitet e fundit. Sistemi i ndërtuar, në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimeve, përpunon tërësinë e informacionit të nevojshëm, si pjesë e aktivitetit të institucionit, ndërkohë që garanton stabilitet, siguri dhe vazhdueshmëri të proceseve të punës të pjesëmarrësve të tregut.

Në kuadrin e këtij projekti është ndërtuar dhe është në mirëmbajtje “Motori i

kërkimit të policave për institucionet”, i cili mundëson kërkimin e policave nëpërmjet aksesit të sigurt nga faqja e internetit e Autoritetit dhe me rezultat dhënien e konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil ose TPL për automjetet shqiptare apo të mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e transparencës së veprimtarisë të sigurimeve të detyrueshme, AMF gjatë vitit 2008 ka bërë të mundur kërkimin nga qytetarët të vlefshmërisë të policave në përkatësi. Autoriteti projektoi, ndërtoi dhe ka në mirëmbajtje “Motorin e kërkimit të policave për qytetarët”, i cili mundëson kërkimin e policave nëpërmjet faqes së internetit të Autoritetit (<http://www.amf.gov.al/mtpl.asp>) dhe me dhënien e konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil ose TPL për automjetet shqiptare apo mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

Në kuadër të përmirësimit të raportimit të subjekteve në mbikëqyrje, AMF, me ndihmën financiare të BERZH, po zhvillon projektin “Management Information System” (MIS). Projekti nga ana teknike përbëhet nga një platformë raportimi web, nëpërmjet së cilës operatorët e mbikëqyrur raportojnë në mënyrë elektronike të dhënat financiare e statistikore të kërkuara periodikisht nga Autoriteti në mbështetje të bazës ligjore në fuqi.

Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, me asistencën e Bankës Botërore dhe financim të FIRST Initiative, në vitin 2008 filloi projekti “Për Mbikëqyrjen Efektive”, i cili ka për qëllim përforcimin e metodologjisë së mbikëqyrjes, duke kaluar në një përjasje me bazë riskun. Projekti përbëhet nga dy pjesë: Mbikëqyrja efektive nëpërmjet zhvillimit të një metodologjie mbikëqyrje me bazë riskun dhe Rishikimi i legjislacionit në fushën e sigurimeve.

Objektivat kryesore të këtij projekti janë:

- ❖ Promovimi i një tregu eficient sigurimesh, të sigurt dhe të qëndrueshëm, me qëllim mbrojtjen e policë-mbajtësve.
- ❖ Dizajnimi i një metodologjie efektive të mbikëqyrjes me bazë riskun dhe të një platforme mbikëqyrjeje efikase.
- ❖ Rritja e kapaciteteve të AMF, për të vlerësuar risqet e pjesëmarrësve të tregut, përdorimi eficient i burimeve dhe vendosja e prioritetëve të ndërhyrjes.
- ❖ Forcimi i kuadrit rregullativ dhe i mbikëqyrjes së sigurimeve.
- ❖ Rritja e kapaciteteve rregullative dhe institucionale të AMF, si dhe
- ❖ Rishikimi i bazës ligjore për tregun e sigurimeve.

Pjesë e këtij procesi është edhe hartimi i manualit të mbikëqyrjes me bazë riskun, i cili do të shërbejë si një bazë procedurale për stafin mbikëqyrës të AMF në marrjen e vendimeve gjatë procesit të vlerësimit të riskut dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit.

Politikat e bankës qendrore të Shqipërisë gjatë krizës globale

Besart Kadia MSc

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT. Ky studim analizon masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në fillesat dhe pas krizës globale financiare. Analiza është e ndarë në dy pjesë, pasi bëhet një qasje e veçantë për dy fenomenet e ndodhura në ekonominë shqiptare gjatë vitit 2008–2009. Ky studim argumenton se Banka e Shqipërisë, përmes shfaqjeve të kujdesshme në publik si dhe inkurajimit të rritjes së sigurimit të depozitave, ka qenë tejet e sukseshme në parandalimin e një paniku bankar. Por të dhënat e fundit për uljen e nivelit të kredidhënies si dhe rritjes së kredive të këqija në rreth 10% ekspozon problemet që do të hasë ekonomia shqiptare në periudhën afatgjatë dhe rëndësinë e politikave mbikqyrëse të reja të Bankës së Shqipërisë.

Fjalë kyç:

krizat financiare, kreditë e reja, sigurimi i depozitave

Hyrje

Nuk ka ndonjë përcaktim të saktë të termit "krizë financiare," por një këndvështrim i pranuar nga shumë ekonomistë është kur kemi një ndërprerje të rrjedhjes së kredisë nga sistemi bankar drejt familjeve dhe bizneseve dhe për pasojë vërehet rënie e ekonomisë reale dhe prodhimi i mallrave dhe shërbimeve ndikohet negativisht.⁴²

Për këtë arsye gjatë analizës së ngjarjeve ekonomike në Shqipëri unë do të interpretoj masat e marra nga Banka Qendrore në dy faza: periudha e panikut dhe periudha pas-panikut. Sipas këtij këndvështrimi Banka e Shqipërisë ka qenë tepër efikase në menaxhimin e krizës dhe evitimin e një paniku të gjerë në publik. Njoftimet

42 Jickling, (2008), Averting Financial Crisis.

për shtyp, kontakti i vazhdueshëm me publikun dhe mbështetja e dhënë për rritjen e sigurisë së depozitave në 2.5 milion lekë mund të konsiderohen si hapa tejte efikase ku të dhëna për 2009 tregojnë një rritje të kënaqëshme të depozitave.

Por roli kryesor i sistemit bankar mbetet çiftëzimi i kursimeve me kredit-kërkuesit. Për këtë arsye hapat e marra nga Banka e Shqipërisë për të ruajtur apo rritur nivelin e kreditimit në ekonominë shqiptare nuk kanë patur reagimin e dëshiruar. Për këtë arsye unë mendoj se Banka e Shqipërisë ka qënë efikase në parandalimin apo përshkallëzimin e panikut të agjentëve ekonomikë në sistemin tonë bankar por nuk ka qënë njësoj e suksesshme në promovimin e kredithënies.

Nuk ka asnjë teori apo model ekonomie që të japë me saktësi rolin apo ndërhyrjet që duhet të ndërmarë qeveria për të ndryshuar në mënyrë pozitive dinamikat e ekonomisë në periudha krize. Për këtë arsye interpretimi dhe gjykimi mbeten të rëndësishëm. Duke ditur ekspozimin minimal të ekonomisë shqiptare ndaj aseteve toksike teoria do të rekomandonte hapa të matur dhe minimal prej Bankës Qendrore dhe të Qeverisë për të ndërhyrë në treg. Por efektet në ekonominë reale u shpërndanë shumë shpejt dhe viti 2009 nxorri në pah se asnjë ekonomi nuk ishte immune ndaj krizës globale. Në fund të 2009 vende si Lituania, Estonia, Serbia dhe Ukraina kishin probleme të theksuara makroekonomike me rritje negative ekonomike prej -18.4%, -13.2%, -4% dhe -14% të PBB respektivisht. Shumë ekonomistë kanë interpretuar zhvillimet makroekonomike në vendet e Europës Lindore si më të rënda se recesioni i viteve të postkomunizmit. Vendet e rajonit të Ballkanit gjithashtu patën vështirësi ekonomike ku mesatarja e këtyre vendeve ishte -6.2%⁴³ për vitin 2009. Shqipëria nga ana tjetër duket se ka qënë ndër vendet e vetme me rritje ekonomike pozitive. Duke iu referuar statistikave zyrtare, por edhe institucioneve ndërkombetare, ekonomia shqiptare u rrit në vitin 2009 me 3%. Për këtë arsye FMN-ja deklaroi se “gjatë furtunës së madhe ekonomike Shqipëria ka dalë paq” ku “politika të mira ekonomike si dhe integrimi i limituar në tregjet ndërkombëtare kanë qënë arsyet kryesore të zbutjes së krizës globale”.

Në Shqipëri kjo krizë erdhi disi me vonë për vetë specifikat që ka ekonomia shqiptare. Ndaj është e vështirë të bëjmë një analizë të saktë rreth impaktit të krizës në ekonominë shqiptare. Interpretimi është i kushtëzuar dhe nga vështirësitë e mbledhjes dhe interpretimi i statistikave zyrtare. Por vlen të përmendet se disa të dhëna makroekonomike si rritja e PBB, kursi i këmbimit, tregëtia me jashtë, depozitat dhe niveli i kreditimit të ekonomisë apo dhe niveli i remitancave tregojnë se jo gjithçka ishte pozitive gjatë vitit 2009. Këto të dhëna tregojnë se kriza ekonomike globale ndikoi në shumë indikatorë makroekonomikë dhe është e rëndësishme të interpretohen masat e marra nga Banka Qendrore në veçanti. Për këtë arsye kjo analizë fokusohet se si ekonomia shqiptare reagoi gjatë krizës dhe sa efikase ka qënë Banka Qendrore në parandalimin e krizës së panikut dhe në ringritjen e kreditimit të ekonomisë.

43 Vendet e përmendura përfshijnë: Shqipërinë, Bosnje Herzegovinën, Bullgarinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Rumaninë, dhe Serbinë. Të dhënat janë marre nga Raporti i Tranzicionit 2009, BERZH.

1. Tërheqja e depozitave dhe shenjat e panikut

Kryetari i Rezerves Federale Allan Greenspan njihej si një ekonomist që shqiptonte mjaft mirë zhvillimet dhe ndjenjat e tregut të sofistikuar Amerikan. Nje nder shprehjet e tij mjaft te spikatura ishte dhe “irrational exuberance” ose entuziasem jo racional. Kjo i perkonte zhvillimeve te tregut financiar gjate investimeve ne periudhen e fundviteve 90. E njehta gje mund te thuhet dhe per sjelljen e tregut financiar gjate vitit 2008, ku mjafton nje ngjarje jo pozitive per te vene ne panik shume prej aktoreve financiar. E njehta sjellje paniku duket sikur ndodhi dhe me “agjentet” ekonomike shqiptar ku gjate vitit 2008 pesha e depozitave të publikut në totalin e aktiveve të sektorit bankar, shënoi rënie për herë të parë pas disa viteve, si rezultat i tërheqjes së depozitave nga publiku në tremujorin e fundit të vitit. Në këtë periudhë vlerësohet se janë tërhequr rreth 49.1 miliardë lekë ose rreth 7 përqind e vlerës së tyre në tremujorin e tretë⁴⁴. Vlersohet se arsyeja kryesore e tërheqjes se depozitave ne bankat Shqiptare ka qene efektit psikologjik që shkaktoi ashpërsimi i krizës. Pasojat e këtij reagimi ishin rritja e nevojave për likuiditet si edhe rënia e ritmeve të kreditimit në sektorin bankar. Rendesia e depozitave ne sistemin financiar Shqiptar reflektohet nga Raporti i Stabilitetit Financiar 2008 te Bankes se Shqiperise ku depozitat e klienteve zene 77% ose 645.1 miliardë lekë te totalit te aktiveve te bankave ne Shqiperi. Pjesën më të madhe të aktiveve të sektorit bankar, në fund të vitit 2008, e zë portofoli i kredive që përbën 47.6 përqind të totalit të aktiveve. Konkretisht, për të përballuar rënien e depozitave në tremujorin e fundit të vitit 2008, bankat tregtare pakësuan portofolin e mjeteve të tyre likuide, rritën huamarrjet nga grupet bankare zotëruese dhe atë nga Banka e Shqipërisë.

1.1 Modeli Diamond-Dybvig

Diferenca ne likuiditetin e detyrimeve ndaj aseteve ka cuar ne kirza bankare dhe me pare ku per shkak te panikut njerezit terheqin ne mase dhe ne te njejten kohe depozitat e tyre. Diamond dhe Dybvig (1983) kane zhvilluar një model qe mundohet te shpjegojë pse bankat zgjedhin qe depozitat te jene me likuide se asetet e tyre për të kuptuar pse bankat ekspozohet nga paniku. Ky model është përdorur gjerësisht për të kuptuar krizen bankare dhe llojet e tjera të krizave financiare. Investitorët përballen me rreziqe qe i verjane privatisht të cilat çojnë në një kërkesë për likuiditet. Sipas Diamond (1983) kontratat tradicionale te depozitave të cilat ofrojnë likuiditet cojne ne ekuilibrim te ndryshem, nder te cilat eshte dhe terheqe ne mase e depozitave. Kjo padyshim shkakton dëme të vërtetë ekonomike. Kontratat që mund të parandalojnë terheqjen e depozitave ne mase janë studiuar dhe analiza tregon se ekzistojnë rrethana kur qeveria me sigurimin e depozitave mund të prodhojnë kontrata superiore qe parandalon panikun.

1.2 Moral Hazards

Duke iu referuar modelit të lartëpërmendur një studim i krizave bankare që nga fillimi i viteve 1980 në mes të viteve 1990 ka gjetur se prania e një skeme e sigurimit

44 Raporti i Vjetor i Mbikqyrjes 2008, Banka e Shqiperise

të depozitave ka tendencë për të rritur probabilitetin e sjelljeve me risk të lartë nga ana e bankave⁴⁵. Sigurimi i depozitave mund të rrisë rrezikun e sjelljeve të pakujdesshme nga bankat individuale. Nëse bankat e dinë se depozitat janë të siguruara, ato janë më të predispozuar për të marrë rrezikun e tepruar duke ekspozuar dhe rrezikun e Moral Hazards, ku qeveria garanton depozitat pavarësisht veprimeve të bankave. Për këtë arsye agjentët nuk do të kenë asnjë nxitje për të kërkuar një bankë të kujdesshme dhe do të kërkonin banka me normë më të lartë të kthimit. Prandaj, sigurimi i depozitave ka për të shkuar së bashku me rregullimin dhe mbikqyrjen për të parandaluar rrezikun e tepruar.

Gjithsesi bankat shqiptare nuk mund të karakterizohen si banka të cilat janë duke ndjekur politika me risk të lartë. Aktivët bankarë gjatë vitit 2008 përbëheshin nga portofoli i kredive -që përbën 47.6 për qind të totalit të aktivëve- dhe veprimet me thesarin, ky zë arriti në 251.4 miliardë lekë ose në 30.1 për qind të totalit të aktiveve.

Për këtë arsye sigurimi i depozitave nuk mund të ketë efektin Moral Hazards në ekonominë shqiptare, përkundrazi ajo mund të rrisë besimin e publikut në banka duke e bërë sistemin financiar më të qëndrueshëm. Një rrjet sigurie mund të kufizojë efektin që problemet në një bankë mund të kenë në bankat e tjera të shëndetshme duke zvogëluar kështu mundësinë e infektimit apo një reaksion zinxhir brenda sistemit bankar si një e tërë.

1.3 Masat e marra për ruajtjen e depozitave.

Eksperienca e fundit e krizës ekonomike globale, ku shumë vende ndërmorën masa unilaterale për të garantuar sigurinë e pjesshme ose të plotë të depozitave tregon rëndësinë e veçantë të sigurimit të depozitave gjatë krizave financiare. Në mënyrë të veçantë, vende si Austria, Belgjika apo Holanda patën rritje të depozitave të garantuara deri në 100,000 €, ndërsa vende të tjera si Franca, Danimarka, Gjermania dhe Irlanda garantuan siguri të plotë për depozitat bankare.

Duke parë masat e marra nga shumë ekonomi të zhvilluara për të rritur nivelin e sigurimit të depozitave besoj se rreziku i panikut publik ndaj institucioneve financiare ishte tepër i përhapur. Në këtë këndvështrim paniku i agjentëve ekonomikë në Shqipëri duhej përballur dhe trajtuar me masa të ngjashme si në vendet e tjera.

Për këtë arsye mendoj se vendimi i Agjensisë së Sigurimit të Depozitave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për të rritur sigurimin e depozitave deri në 2.5 milion lekë ishte hapi më i rëndësishëm për të qetësuar dhe bindur depozituesit në Shqipëri se sistemi bankar Shqiptar është i sigurt. Rëndësia e rritjes së garantimit të depozitave merr një rëndësi të veçantë sidomos në Shqipëri ku kriza e skemave piramidale nuk është shumë e largët dhe mund të çonte në një precipitim të rëndë të panikut dhe tërheqjes së depozitave.

Ndërhyrja dha kontributin e saj ku duke iu referuar periudhës së vitit 2009 në totalin e depozitave në sistemin bankar shqiptar vërehet një rritje e depozitave të individëve me rreth 12.5 për qind. Për sa i përket depozitave që janë pjesë e skemës së sigurimit, sanksionuar edhe prej shumës ato vlerësohen në masën e 83 për qind të totalit të parave që janë investuar në sistemin e bankave të nivelit të dytë në vend. Ky është një tregues në

45 Sebastian Schich (2008) Financial Turbulence: Some Lessons Regarding Deposit Insurance, OECD


rritje nga viti në vit duke pasqyruar besim ndaj sistemit bankar vendas. Ky trend pozitiv vazhdon dhe gjatë muajve të parë të 2010 ku është vënë re një rritje e konsiderueshme e depozitave. Depozitat e familjeve dhe bizneseve shqiptare në sistemin bankar u rritën me 135 milionë euro gjatë muajit janar, duke shënuar rritjen më të lartë mujore që nga gushti i vitit të kaluar, gjë që e rriti totalin e depozitave përtej maksimumit historik të shënuar para krizës së vitit 2008. Sipas statistikave të publikuara nga Shoqata e Bankave, totali i depozitave në sistem arriti në 713 miliardë lekë (5.16 miliardë euro). Fakti që dy të tretat e depozitave të reja u furnizuan nga klientët individë, ndërsa një e treta nga kompanitë e biznesit tregon për rikthim të besimit të plotë të individëve ndaj sistemit bankar shqiptar.

2. Aktiviteti Kreditues

Gjatë vitit 2009 vërehet ekspansion më i ulët të aktivitetit kreditues. Arsyeja kryesore e këtij frenimi janë kreditë me probleme të cilat kanë pësuar rritje gjatë vitit 2009, si pasojë e ngadalësimit të ekonomisë dhe e nënçmimit të kursit të këmbimit. Treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë, i shprehur si “kredi me probleme ndaj teprcës totale të kredive” u rrit në 10.48 përqind në fund të vitit, nga 6.64 përqind në fundin e vitit 2008.

Por shumë mund të argumentojnë që rritja e kësaj shifre vjen më tepër prej faktit se në 2009 filluan të maturoheshin shumë prej kredive të dhëna nga sistemi bankar dhe për këtë arsye koha ekspozoi kredite me probleme dhe jo kriza financiare. Por në rast se ky interpretim do të merret për bazë atëherë ditë akoma më të errëta e presin ekonominë shqiptare ku maturimi i kredive të dhëna do të jetë akoma më i madh. Prandaj rritja e kredive me probleme nuk duhet interpretuar bardh e zi vetëm si maturim apo si pasojë e krizës. Në vend të saj duhet të shihet kombinimi i të dyjave.

Ecuria e Portofolit të Kredisë sipas Monedhave⁴⁶



46 Raport i Politikave Monetare (2009) Banka e Shqipërisë.

Duke qënë se detyra kryesore e Bankës Qendrore mbetet inflacion i kontrolluar si dhe stabilitet makroekonomik është me rëndësi ti kushtojmë pak vëmendje pikës së dytë të detyrës së Bankës Qendrore. Në këtë këndvështrim përfundimi i Bankës Botërore në raportin e saj “Ndërtimi i konkurrencës në Shqipëri⁴⁷,” se interesat e kredive në Shqipëri mbeten më të lartat në rajon është tejet shqetësuese për të ardhmen e ekonomisë sonë.

Të dhënat e publikuara në raport tregojnë se bizneset dhe individët janë ngarkuar me kosto shtesë, pikërisht për shkak se bankat në Shqipëri kanë mbajtur fitimet më të larta në rajon. Diferenca mes normës së interesit që bankat aplikojnë për kreditë dhe asaj që ato paguajnë për depozitat është në Shqipëri plot 3 pikë përqindje më i lartë se vendet e tjera të rajonit. Normat e interesit mbeten shumë të larta në monedhën vendase lek dhe pikërisht për shkak të këtyre kostove të larta, kredia në Shqipëri është orientuar në pjesën dërrmuese drejt valutës, që mbetet një risk konstant, për shkak të goditjeve të kursit të këmbimit. Disa ekspertë thonë se normat e larta të interesit që bankat i ngarkojnë biznesit dhe individëve mund t’i atribuohen edhe kërkesës së lartë që ka pasur ekonomia për financime. Të dhënat tregojnë se që nga viti 2004, kredia për ekonominë ka shënuar bum, duke regjistruar norma rritje historike rritjeje, të cilat ranë vetëm vitin e kaluar për shkak të krizës.

3. Përfundim

Për këtë arsye kostot e larta të kredidhënies kombinuar me uljen e sasisë së kredidhënies e fshijnë me dorë entuziazmin paraprak se rritja e depozitave është në vetvete pozitive për ekonominë shqiptare. Kështu që kërkesat nga ana e Bankave për të ulur normën bazë të interesit për të rikthyer rritjen e kreditimit janë të pabaza dhe të pavlefshme kur inflacioni vertitet mbi 3% gjatë tre mujorit të parë të vitit. Bankat në Shqipëri kanë dështuar në përcjelljen e politikave lehtësuese monetare të Bankës Qendrore në normat e interesit të produkteve të tyre bankare dhe ky autoritet duhet të marrë masa për të rifilluar procesin e kreditimit të ekonomisë. Në rast se pranojmë që termi “krizë financiare” sjell ndërprerje të rrjedhjes së kredisë nga sistemi bankar drejt familjeve dhe bizneseve dhe për pasojë vërehet rënie e ekonomisë reale dhe prodhimi i mallrave dhe shërbimeve ndikohet negativisht atëherë Shqipëria pa dyshim që është prekur nga kriza financiare dhe shtyn Bankën Qendrore të ketë më tepër rol për Bankën Qendrore.

Literatura:

- Diamond, D.W. (1984). “Financial Intermediation and Delegated Monitoring.” *Review of Economic Studies* 51 (July): 393–414.
- Neil Wallace, (2007). Narrow Banking Meets the Diamond-Dybvig Model, Federal

47 Gazeta Sot, (9 Prill 2010). Banka Botërore: Kreditë në Shqipëri, më të shtrenjtat në rajon,

Reserve Bank of Minneapolis.
 Raporti i Stabilitetit Financiar, (2008). Banka e Shqipërisë.
 Raporti i Vjetor i Mbikqyrjes, (2008). Banka e Shqipërisë.
 Raporti i Politikave Monetare, (2009). Banka e Shqipërisë.
 Kuvendi i Shqipërisë Ligji nr. 10 106, date 30.03.2009 „Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 „Për sigurimin e depozitave“.
 Sebastian Schich (2008) Financial Turbulence: Some Lessons Regarding Deposit Insurance, OECD
 CGFS Papers, (July 2008). Central Bank Operations in Response to the Financial Turmoil, Bank for International Settlements, No 31.
 Mark Jickling, (2008), Averting Financial Crisis CRS Report for Congress.

Ndërmjetësit financiarë jo banka në Shqipëri

Dr. Brunilda Duraj

Lektore, Departamenti i Financës, Universiteti i Tiranës

Artan Santo

Drejtor i Përgjithshëm, Banka Credins

ABSTRAKT. *Institucionet financiare jo bankare janë institucione që ofrojnë shërbime financiare, të licensuara nga banka e Shqipërisë, sipas rregullores “Për dhënien e licensës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jo banka në Republikën e Shqipërisë”. Këto institucione jo banka, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet dhe të ofrojnë të gjitha produktet në shërbim të klientit, përveçse nuk u lejohet mbledhja e depozitave të kursimit.*

Këto institucione luajnë një rol parësor në tërësinë e ndërmjetësve financiar dhe roli i tyre ka ardhur gjithmonë në rritje, duke u ofruar shërbime një numri të madh klientësh. Në Shqipëri këto institucione janë të reja krahasuar me bankat, të cilat datojnë pas vitit 2000. Ndër institucionet financiare jo bankare në vendin tonë peshën më të madhe e zënë institucionet e mikrokredisë, leasingut, si dhe për gamën e gjerë të veprimtarisë së tyre posta Shqiptare dhe Instituti Credins. Qëllimi kryesor i këtij artikulli është të japim llojet kryesore të institucioneve financiare jobankare, rolin që ato kanë luajtur në ekonomine e vendit, si dhe produktet bazë që ofrojnë këto institucione.

Analiza e zhvillimit të këtyre institucioneve do të bazohet tek analiza e kuadrit rregullativ dhe zbatimit të tij para dhe pas viteve 2000. Studimin e kemi të ndarë në dy periudha para viteve 2000 që mungonin institucionet financiare jo banka dhe pas viteve 2000 me krijimin e tyre duke u ndalur tek roli dhe ndihmesa e tyre në ekonominë e vendit tonë. Në pamje të parë duket sikur tregu bankar dhe ai financiar është mbingopur në lidhje me numrin dhe shtrirjen që këto kanë. Realisht kur funksionet bazë të qytetarëve kryehen me para kesh, një mori e madhe shërbimesh nëpër zyrat e institucioneve të vecanta, prezumohet fakti që jemi ende larg përmbushjes së interesave ekonomike financiare të grupeve të interesuara të popullsisë.

Vendi ka nevojë për produkte të reja që duhet të ofrohen si nga institucionet financiare bankare dhe jo bankare, për shtrirjen kudo ku ka grupime njerëzish, si dhe në përmbushjen e nevojave për mjete monetare dhe financiare të individëve apo grupeve të interesit.

Ende në vendin tonë huamarrja dhe fajdja individuale është në përmasa jo të vogla, kryesisht në sektorë të tillë të ekonomisë si ndërtimi dhe infrastruktura, që do të thotë se njohja dhe futja e këtyre institucioneve është larg përmbushjes së interesave të tregut.

Fjalët kyçe:

Institucionet financiare jo bankare, banka, sistemi financiar në Shqipëri

1. Hyrje

Proçesi i kursimit/investimit në ekonominë kapitaliste është i organizuar rreth ndërmjetësimit financiar, gjë e cila i bën këto institucione qendër të rritjes ekonomike të një vendi. Ndërmjetësit financiarë klasifikohen në bankare dhe jo bankare. Institucionet bankare janë **Institucionet Depozituese dhe Bankat**, që kanë karakteristikë kryesore pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive (Bankat Tregtare, Bankat e Kursimit, Shoqëritë e Kreditit etj). Institucione financiare jo bankare janë **Kompanitë e financimit**, tipari kryesor i tyre është se marrin hua në shuma të mëdha me një normë relativisht të ulët interesi dhe japin hua në shuma të vogla me risk të lartë dhe me norma të larta interesi; **Ndërmjetësit kontraktual** përfaqësojnë institucione financiare që në anën e pasivit krijojnë instrumente financiare duke lidhur kontrata me huadhënësit. Përmendim kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensione; si dhe **Kompanitë e investimit** (fondet e përbashkëta, trustet). Këto ndërmjetës krijojnë instrumente financiare në anën e pasivit nëpërmjet grumbullimit të fondeve duke emetuar aksione, ndërsa në anën e aktivitetit blejnë instrumente financiare ekzistues, kryesisht në tregun monetar, në atë të obligacioneve dhe atë derivativ. Format kryesore të kompanive investuese janë: Trustet (numër i kufizuar i aktiveve dhe pasiveve), fonde të përbashkëta me pasive fikse, dhe fonde të përbashkëta me aktive dhe pasive fleksibël.

Ky punim ka si objekt studimi **institucionet financiare jo bankare**, të cilat liçensohen, rregullohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Sipas rregullores “Për dhënien e liçensës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jo banka në Republikën e Shqipërisë” kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet dhe të ofrojnë të gjitha produktet në shërbim të klientit, përveçse nuk u lejohet mbledhja e depozitave të kursimit, zhvillimin e tyre në Shqipëri dhe analizën e kuadrit rregullativ përkatës. Gjithashtu një vëmendje të veçantë i kushtojmë dhe ndikimit të krizës financiare globale në këto institucione në vendin tonë.

2. Kuadri Rregullativ i Institucioneve jo bankare

Institucionet financiare jo banka filluan aktivitetin në vendin tonë në vitet 1993, me iniciativën e Bankës Botërore, nëpërmjet financimit në formën e granteve ose

kredivë të buta të saj. Fillimisht ato ishin të organizuara në formën e OJF-ve dhe regjistroheshin në gjykatë si persona juridik që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë. Deri në vitin 2000, ku për herë të parë u miratua Rregullorja mbi *Normat e Mbikqyrjes së Subjekteve Jobanka që Ushtrojnë Veprimtari Financiare*, këto institucione nuk monitoroheshin apo mbikëqyreshin nga ndonjë institucion financiar. Ngjarjet e krizës financiare të viteve 1997, vunë në lëvizje autoritete kontrolluese, me qëllim shmangien e ngjarjeve të përsëritura të një krize të tillë. Gjatë një periudhe 13-14 vjeçare, këto institucione janë konsoliduar dhe sot veprojnë në përputhje me ligjet e komercializmit, si pjesë e tregut financiar bankar. Aktualisht në vendin tonë funksionojnë 10 institucione financiare jobankare, rreth 134 shoqëri kursim-krediti dhe 5 fondacione krediti me një tepriçë mbi 100 milionë dollarë amerikanë⁴⁸. Kundrejt totalit të kredisë, duke përfshirë edhe sistemin bankar shqiptar, kredia nga institucionet mikrofinanciare zë rreth 5.2 % të saj. Ndërsa nisur nga sasia e klientëve që ajo mbulon në vitin 2008 zinte rreth 50 mijë klientë, të cilët përbëjnë shtresën më të varfër të popullsisë. Institucionet mikrofinanciare, sipas qëllimit të tyre të krijimit, financojnë kredi në biznese të vogla dhe shumë të vogla, për të ndikuar në zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin e mikrobiznesit në tërësi. Në këtë sistem bëjnë pjesë edhe Unionet e Shoqatave të Kursim Kredisë, të cilat kanë ligjin e tyre të veçantë dhe nuk janë objekt i këtij studimi, pasi ato pranojnë depozita në shuma të vogla dhe japin kredi anëtarë të unionit.

Zhvillimi i veprimtarisë së institucioneve jobanka në vendin tonë, neni 126 i ligjit për bankat pika 2 e tij i jep të drejtën BSH të merret me liçensimin dhe mbikqyrjen e tyre. Një sërë rregulloresh janë hartuar për rregullimin e kësaj veprimtarie që prej vitit 1999, ku për herë të parë u miratua rregullorja *"Për dhënien e liçensës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë"* e cila u ripa dhe u ndryshua në vitin 2003 duke hyrë në fuqi rregullorja e re *"Për Liçensimin e Subjekteve Jobanka"* dhe përsëri kjo rregullore është ndryshuar në datë 25.02.2009 duke u hartuar rregullorja numër 11 *"Për Liçensimin dhe Ushtrimin E Veprimtarisë Nga Subjektet Financiare Jobanka"*. Ndryshimet kryesore vërehen në përcaktimin e kushteve, kërkesave për shumën minimale të kapitalit fillestar të kërkuar, e cila në rregulloren e vitit 2009 krahasuar me atë të vitit 1999 është më e vogël, (përkatësisht për shërbimin e pagesave dhe arkëtimeve nga 30 milion lekë është bërë 20 milion, për qeranë financiare nga 100 milion lekë është bërë 20 milion lekë, për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve nga 100 milion është bërë 20 milion, madje është përcaktuar dhe shuma e kapitalit minimal për institucionin financiar të mikrokredisë 15 milion lekë), afateve, dokumentacionit dhe procedurave për liçensimin e subjekteve financiare jobanka dhe institucioneve financiare të mikrokredisë për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë; dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka dhe të institucioneve të mikrokredisë; detyrimet për njoftime në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të

48 <http://lajme.shqipëria.com/media/artikull/iden/303251/titulli/Institucionet-mikrofinanciare-barkë-shpëtimi-për-kreditimin-rural-dhe-përditësuar-me-të-dhënat-e-reja-nga-Banka-e-Shqipërisë>.

veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka dhe institucioneve të mikrokredisë; miratimin e agjentit të subjekteve financiare jobanka.

Në lidhje me Zyrat e këmbimit valutor neni 90-të i Ligjit për bankat në Republikën e Shqipërisë (nr.9662 dt.18.12.2006) pika 1 e tij përcakton “Ushtrimi i veprimtarisë bankare ose i çdo veprimtarie tjetër financiare të parashikuar në nenin 4 dhe nenin 54 të këtij ligji, pa licensë të lëshuar nga BSH **përbën krim dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet**”. Ky nen i dha të drejtë strukturave shtetërore që në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë të ndalonin zhvillimin e çdo aktiviteti informal financiar duke nxitur licencimin e tyre nga BSH konkretisht duke e dyfishuar nr. e ZKV të licencuar nga 60 në vitin 2006 në 112 në vitin 2007 dhe 245 në 2010⁴⁹. Në 2007 miratohet rregullorja për “ Licencimin, Organizimin, Veprimtarinë dhe mbikqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”.

Siç shikohet, BSH me anë të këtyre rregulloreve ka mbuluar shumë aspekte që kanë të bëjnë me licencimin e institucioneve jobanka, dhe me detyrimet që i lindin këtyre institucioneve si rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vendin tonë. Pra, asnjë institucion i tillë, nuk mund të nisë aktivitetin pa plotësuar kriteret e përcaktuara nga BSH.

Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e subjekteve që duan të ushtrojnë aktivitetet e mëposhtme financiare:⁵⁰

- të gjitha format e kredidhënies,
- faktoringun,
- qiranë financiare,
- shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave,
- ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve,
- këmbimin valutor; dhe
- shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër.

Siç mund të shihet, shkalla e mbulimit të kuadrit rregullator të BSH për këto institucione është e lartë pasi janë përfshirë një shumëllojshmëri aktivitetesh financiare. Përveç kësaj vlen për t’u përmendur fakti që disa institucione financiare jo banka të cilat nuk janë subjekt i kësaj rregulloreje, si shoqëritë e sigurimit, fondet e pensione, fondet e përbashkëta, tregu i letrave me vlerë, janë subjekt i rregullimit nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Pra, po të krahasojmë kërkesat për kapitalin minimal në këtë rregullore me atë të vitit 1999, vërehet që përveç formave të kredidhënies që ka ngelur e njëjta shumë, për aktivitetet e tjera kërkesa për kapital minimal ka pësuar rënie. Nga këndvështrimi ynë, ky fakt tregon se këto institucione tashmë konsiderohen më pak riskoze, duke stimuluar kështu rritjen dhe zhvillimin e tyre.

49 BOA – Raportet e mbikqyrjes 2006, 2007, 2010 (deri në muajin prill)

50 Neni 5

Tabela 2: Numri i Institucioneve jo banka të licensuara nga Banka e Shqipërisë 2003-2005

Vitet Institucionet jo Banka	2003 (Numër)	2010 (Numër)
Subjekte jo banka	7	10
Mikrokredi	4	5
Leasing	-	5
Factoring	-	-
Pagesa dhe transfertat	3	3
Zyra këmbimi valutore	56	205

Burimi: Banka e Shqipërisë

Përveç rregullores në lidhje me licensimin, BSH ka hartuar një rregullore e cila pasqyron “*Normat e Mbikqyrjes të Subjekteve Jobanka që Ushtrojnë Veprimtari Financiare*” e cila daton në 05.07.2000. Kjo rregullore kërkon që secili institucion të ketë një manual të veçantë për kreditë, të miratuar nga organet drejtuese. Gjithashtu, klasifikimi i kredive dhe i të gjitha aktiveve, në përgjithësi, bëhet duke respektuar rregullat e parashikuara në rregulloren “*Për klasifikimin e kredive dhe krijimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë*” të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë nr. 50, datë 18.03.1999 dhe të gjitha ndryshimeve të saj. *Treguesit e mbikqyrjes së institucioneve jo banka janë plotësimi i rregullave lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit, me shpërndarjen e riskut, me treguesit e likuiditetit, me transparencën, me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.*

Treguesi i raportit të kapitalit me totalin e aktivëve nuk duhet të jetë më i vogël se 10 përqind, e krahasuar kjo me jo më të vogël se 8 përqind, sipas Basel II për bankat, po kështu nëse analizojmë treguesit e likuiditetit ku raporti i aktivëve më afatshkurtër me detyrimet nuk duhet të jetë më i vogël se 100 përqind, e cila dëshmon që çdo detyrim duhet të jetë i mbuluar nga aktivët. Lidhur me investimet në letra me vlerë Rregullorja përcakton kufizime në investime në bono thesari të Qeverisë Shqiptare apo të vendeve të huaja të vlerësuara me A nga kompanitë e ratingut deri në 5 përqind të kapitalit dhe totali i investimeve në letra me vlerë nuk duhet të jetë më shumë se 40 përqind e kapitalit të subjektit jo bankë.

Institucionet financiare jobanka që ofrojnë kredi, janë subjekt i rregullores së: “*Për Kredinë Konsumatore Dhe Kredinë Hipotekare Për Individët*”, e datës 11.02.2009. Kjo rregullore i drejtohet të gjithë atyre institucioneve të cilat japin kredi, bankat si dhe institucionet jo banka. Përveç kësaj në rregulloren “*Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë*” institucionet jo banka trajtohen njësoj si bankat, dhe të gjitha rregullat për administrimin e riskut të kredisë janë të njëjta. Gjithashtu edhe mënyra e klasifikimit të kredive është pothuajse e njëjtë.

Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë dhe informacionit çoi në lindjen e nevojës

së zhvillimit të një kuadri të gjerë rregullator të miratuar në datë 23.12.1997 në bazë të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, “Për Bankën e Shqipërisë”, “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licësuara nga Banka e Shqipërisë”. Qëllimi kryesor është ulja e rrezikut operacional që mund të vijë nga keqpërdorimi i sistemeve TIK.

Gjithashtu, për të mbrojtur publikun nga mungesa e informacionit mbi produktet bankare dhe financiare Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi *me vendimin nr. 59. datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet bankare dhe financiare”*. Subjekte (sipas nenit 2) të kësaj rregullore janë bankat, degët e bankave të huaja dhe **subjektet financiare jobanka**. Banka dhe institucionet financiare jo banka (institucionet e mikrokreditit) duhet të publikojë **normën efektive të interesit** në mënyrë të saktë dhe të thjeshtë në ambientet e saj. Një tjetër fokus i kësaj rregulloreje janë dhe materialet promocionale⁵¹ të produkteve apo shërbimeve bankare ose të institucioneve financiare jobanka gjatë fushatave të marketingut, të cilat duhet të jenë në përputhje me parimin e mirëbesimit dhe të praktikave më të mira, me qëllim që t’i komunikojë publikut një informacion objektiv, të mjaftueshëm e të paanshëm. Por institucionet financiare bankare dhe jobanka duhet të ruajnë konfidencialitetin⁵² dhe/ose sekretin për të gjithë informacionin personal të klientit duke i garantuar atij, ruajtjen dhe administrimin e informacionit personal në sisteme të sigurta dhe të besueshme informacioni apo pagesash (transaksione, shërbime etj.).

Një rregullore tjetër e cila rregullon veprimtarinë e një prej llojeve të institucioneve financiare, është edhe ajo në lidhje me veprimtarinë valutore. Përditësimi i rregullave në lidhje me veprimtarinë valutore i referohet rregullores së miratuar me vendimin nr.70, datë 30.09.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për veprimtarinë valutore”. Përveç sa parashikohet në këtë rregullore, për transaksionet e pagesave me jashtë në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu, vlen të përmendet se në mbështetje të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Mbikqyrjes dhe të Departamentit të Sigurimit dhe të Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë, Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë, **miratoi rregulloren “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë së mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”** vendimi nr. 91, datë 24.12.2008. Banka e Shqipërisë rregullon jo vetëm kushtet e sigurisë së bankave të nivelit të dytë, por edhe të subjekteve financiare jo banka, zyrat e këmbimit valutë, subjektet financiare jobankare që kryejnë veprimtari me sportel, si edhe agjentët e tyre.

Të gjitha këto rregulla dhe kufizime të mirë specifikuar për institucionet jobankare në mënyrë të njëpasnjëshme që prej vitit 2000 ku u miratua për herë të parë Rregullorja mbi licëncimin e këtyre institucioneve, të cilat gjithmonë e më tepër nga ky këndvështrim i trajtojnë në të njëjtin status si bankat, dhe pse në dallim nga ato nuk

51 Neni 10 me vendimin nr. 59. datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet bankare dhe financiare”

52 Neni 11 me vendimin nr. 59. datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet bankare dhe financiare”

pranojnë depozita, nga njëra anë tregon për një mirë rregullim të këtij sektori, por nga ana tjetër kufizojnë hapësirat e këtyre institucioneve jo me pak rëndësi në vendin tonë për nga mbulimi gjeografik i tregut për tu rritur në numër, për të ofruar produkte të reja dhe për tu bërë më konkurrenciale në treg.

2. Zhvillimi i Institucioneve Jo banka në Shqipëri

Bazuar edhe në Rregulloren 11 të BSH *“Për Liçencimin Dhe Ushtrimin E Veprimtarisë Nga Subjektet Financiare Jobanka”*, institucionet kryesore të mbikqyrura nga BSH të cilat janë edhe objekt i këtij punimi janë si më poshtë:

- a) të gjitha format e kredidhënies,
- b) faktoringun,
- c) qeranë financiare,
- d) shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave,
- e) ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve,
- f) këmbimin valutor; dhe
- g) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara me sipër.

Do të trajtojmë zhvillimin e secilit lloj të institucioneve më lart.

a. Të gjitha format e kredidhënies Në këtë grup përfshihen kryesisht institucionet financiare jo bankare ose institucionet e mikrofinancës të cilat ofrojnë shërbime të kredidhënies dhe që zënë peshën më të madhe ndër institucionet financiare jo banka në vendin tonë. *Mikrofinanca ofron mundësi kreditimi për një kategori njerëzish, të cilët nuk kreditohen nga institucionet bankare. Eksperiencia tregon se mikrofinanca mund t'i ndihmojë të varfëritë të rrisin të ardhurat e tyre, të ngrenë biznese frytdhënëse, të reduktojnë prekshmerinë e tyre nga efekte të jashtme, si dhe kontribuon në rritjen ekonomike dhe forcimin e një shoqërie demokratike.*

Mikrofinanca, ka qenë pjesë thelbësore e zhvillimit dhe mjedisit ekonomik në Shqipëri. Institucionet mikrofinanciare kanë hyrë në Shqipëri në fillimet e 1990, disa si organizata jo qeveritare dhe disa si agjenci qeveritare. Deri në kohën kur këto institucione filluan të mbikëqyreshin dhe të liçencoheshin nga Banka e Shqipërisë, një numër i madh i këtyre institucioneve operonin në Shqipëri.

Këto institucione kanë mbajtur një nivel të lartë ripagimi të kredive gjatë periudhës, pavarësisht disa krizave sociale dhe ekonomike në vend si ajo e skemave piramidale në 1997, ku rreth 50% e popullsisë humbën kursimet e tyre. Vitet 2007 dhe 2008 ishin vite konsolidimi për të gjithë institucionet mikrofinanciare, përmirësim i treguesve financiarë dhe zgjerimi i aktivitetit në të gjitha zonat. Sektori mikrofinanciar në Shqipëri është pjesë integrale dhe e rëndësishme e gjithë sistemit financiar dhe institucionet mikrofinanciare po ndihmojnë vendin me rritje ekonomike dhe reduktim të varfërisë duke nxitur sipërmarrjen e vogël dhe të mesme në Shqipëri. Kriza e vitit 1997 na kujton se mos perceptimi i saktë i riskut dhe politikat jo të përshtatshme për përgjigjen e tyre mund të jenë me kosto të larta. Tregu në Shqipëri karakterizohet gjithashtu nga një mungesë informacioni dhe agjenci të raportimit të kredive. Në këto kushte vlerësimi i riskut bëhet më i vështirë dhe kjo gjë rrit rëndësinë e monitorimit të

kredisë nga huadhënësit, duke përfshirë përpjekje efektive të mbledhjes së kredive pas daljes me vonesa. Ky ambient ku veprojnë institucionet mikrofinanciare përfaqëson mundësi dhe kërcënime për to. Në këto kushte manaxhimi efektiv i pagesës së kredisë bëhet një strategji kritike për t'u ndjekur. Gjithashtu duhet përmendur edhe fakti se vendi ynë karakterizohet nga një nivel i lartë informaliteti dhe probleme me regjistrin e pasurisë. Gjithashtu niveli i korrupsionit është i lartë, të gjitha këto i vështirësojnë institucioneve mikrofinanciare vlerësimin e riskut të kolateralit dhe mbledhjen e borxhit të keq. Mikrofinanca në Shqipëri sigurohet nëpërmjet bankave tregtare (si ProCredit Bank), Shoqatat/Unionet e Kursim Kreditit (si Fondi i Financimit Rural dhe Shoqata e Kursim Kreditit Jehona, aktualisht Unioni Shqiptar i Kursim-Kreditit), institucione financiare jo-bankare/OJF (si Opportunity Albania, Fondi BESA, Fondi i Financimit të Zonave Malore (FAF-DC), Fondacioni drejt të Ardhmes, VISION-FUND ALBANIA, **Fondacioni Drejt Të Ardhmes FDA**), dhe huadhënës joformal.

a1. Kuadri Rregullator për Mikrofinancën

Çështjet e rregullimit kanë qenë gjerësisht të diskutueshme për sa i përket sektorit bankar tradicional, por janë relativisht të reja në debatin lidhur me mikrofinancën. Shumë vende në zhvillim dhe vende në tranzicion po marrin në konsideratë faktin nëse duhet dhe si duhet rregulluar mikrofinanca. Institucionet financiare janë përgjithësisht objekt i dy rregullimeve: rregullimit që kërkon të forcojë qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe një rregullimi që synon mbrojtjen e konsumatorit dhe që është i ngjashëm me rregullimet e aplikuara për institucione të tjera tregtare. Elementët që duhen konsideruar në një plan rregullues janë mbrojtja e të varfërve, mbrojtja e sistemit financiar, promovimi i sektorit mikrofinanciar si dhe mbrojtja e fondeve publike.

Në vendin tonë Banka e Shqipërisë⁵³ është autoriteti që liçencon institucionet mikrofinanciare. Rregullorja “Për liçencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” përcakton të gjitha kushtet që duhet të plotësojë një institucion i mikrokredisë për t'u liçencuar. Në bazë të kësaj rregulloreje kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionin financiar të mikrokredisë është 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë. Edhe pse mikrofinanca ka qenë një objekt debati në shumë vende për gati një dekadë, çështja e vendosjes së ligjeve mbi rregullimin mbetet e pazgjidhur. Nuk ekziston një model standard, elementët e disponuar për raste preçedente që kanë treguar sukses tregojnë që struktura rregulluese e mikrofinancës duhet përshtatur me kushtet specifike të shteteve ku këto institucione funksionojnë.

b. Faktoringu Nga verifikimet e kryera në BSH në lidhje me institucionet që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti, nuk rezultoi ndonjë kompani që të ushtrojë një aktivitet të tillë.

c. Qeraja Financiare është konsideruar si alternativa më e favorshme për financimin e investimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, së pari për një kolateralizim të mirë dhe termat afatgjatë. Gjithashtu avantazhet në taksa dhe kontabilitet e shtojnë këtë

53 http://www.bankofalbania.org/web/Baza_rregullatore

atraktivitet.⁵⁴ Tregu i qerasë financiare është relativisht i ri në vendin tonë dhe operatorët janë të pakët në numër, vetëm 5, megjithatë kjo nuk do të thotë që hyrja, mbijetesa dhe suksesi në këtë sektor do të jetë e lehtë. Pavarësisht trajtave që merr, qeramarrja është zhvilluar me ritme të shpejta, duke u bërë një nga metodat më të preferuara për financimin e investimeve në biznes por edhe të konsumit privat e familjar. Një studim i kryer në mars të 2010 nga Korporata Ndërkombëtare e Financave, tregu i mundshëm i qerasë financiare në Shqipëri rezultoi në një masë rreth 98.4 milion euro në kontrata të reja, në vit. Sipas këtyre vlerësimeve, potenciali për zhvillim është i konsiderueshëm si në qiranë financiare të automobilave, ashtu edhe në atë të pajisjeve (përkatesisht, 37.6 milion euro dhe 30.8 milion euro në kontrata të reja, në vit). Duke përdorur shifra nga vende të tjera të rajonit, studimi vlerëson se, në një periudhë afatmesme, qeraja financiare mund të zërë nga 13% deri në 19% të investimit të përgjithshëm në vend.⁵⁵

Ky institucion financiar u krijua për herë të parë në vendin tonë në vitin 2005, ku u miratua Ligji nr.9366, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” i ndryshuar, i cili trajton dhe rregullon aktivitetin e qirasë financiare në Shqipëri. Aktualisht në Shqipëri këtë aktivitet e ofrojnë më së shumti bankat si dhe pesë shoqëri leasingu, Tirana Leasing, Raiffesisen Leasing, Credins Leasing, Landeslease, dhe FIN – Al, e licënsuar në datën 20.02.2009 dhe Sogelease Albania sh.a - Liçensa nr.18 dt.25.01.2010. Të gjitha janë shoqëri aksionere, kurse vetëm FIN Al është SH.p.k. Në zhvillimin e këtyre shoqërive në vendin tonë ka ndikuar si kapitali i kërkuar 20 milion lekë, që mendojmë se është relativisht i lartë, por edhe legjislacioni aktual tatimor, ku në dallim nga politikat tatimore të ndjekura në vendet e rajonit e më gjerë, nuk përmban asnjë element favorizues për leasing-un.

Ligji nr.7928 datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.3 datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, përmbajnë dispozita jo nxitëse madje në ndonjë rast kontradiktor lidhur me leasing-un financiar. Në paragrafin 7 të nenit 13 të ligjit thuhet: “Kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate, e cila parashikon marrjen me qira ose shitjen me këste, pavarësisht nga momenti i kalimit të pronësisë, detyrimi për TVSH-në lind mbi vlerën e plotë të mallit dhe llogaritet mbi pagesat e vlerës së plotë të kësteve për mallin e vënë në dispozicion për përdoruesin”. Në paragrafin 5.1 thuhet se: “TVSH-ja aplikohet mbi vlerën e plotë të kështit përfshirë interesat”. Pra siç e shohim TVSH aplikohet dhe mbi interesat. Mirëpo në nenin 21 të ligjit thuhet se shërbimet financiare janë të përjashtuara nga TVSH, ku tek pika 2. a theksohet se dhënia dhe marrja e huave përjashtohet nga TVSH, ç’ka sjell dhe përjashtimin e interesave të këtyre huave nga TVSH, ku interesat konsiderohen shërbime financiare. Nga sa pamë më sipër del se neni 13 në parim jo vetëm që konfliktin dispozitat e nenit 21 të ligjit, por është diskriminues për financimin nëpërmjet leasing-ut në raport me financimin nëpërmjet

54 Mundësitë e shqipërisë për financimin e sektorit të ndërmarrjeve”, http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/Shqipëria_Akresi_për_kredi_08.pdf, dt.25.03.10

55 “Mundësitë e Shqipërisë për financimin e sektorit të ndërmarrjeve”, http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/Shqipëria_Akresi_për_kredi_08.pdf, dt.25.03.10

kredisë. Duke ditur se shërbimin e qiradhënies e kryejnë dhe bankat, madje aplikojnë norma interesi të ngjashme sjell që i njëjti transaksion, i financuar me kredi do të ishte më i leverdishëm se financimi me leasing, pikërisht për faktin se në rastin e leasingut aplikohet TVSH edhe mbi interesat, dhe në rastin e kredisë jo.

Pra është e rëndësishme që neni 13 pika 7 të rishikohet në mënyrë të atillë që të mos jetë diskriminues midis këtyre dy formave të financimit dhe TVSH-ja të aplikohet vetëm ndaj principalit, pa interesat. Në Ligjin dhe Udhëzimin për TVSH hasen dhe probleme të tjera të cilat e bëjnë jo të preferueshme qiramarrjen si mënyrë financimi.⁵⁶

Në kuadrin e zgjerimit të aktivitetit të kompanive leasing, jo vetëm tek financimet ekzistuese apo të reja në automjete, mjete pune (furgonë, autobuzë, kamione etj), por dhe në formën e linjave të reja të prodhimit, pajisje e makineri ndërtimi etj, theksojmë se propozimet ose kërkesat e parashtruara këtu, janë jo vetëm në funksion të stimulimit të aktivitetit të leasing por edhe të futjes dhe rinovimit të flotave të mjeteve të transportit si edhe të teknologjisë së re dhe bashkëkohore në tregun shqiptar duke ndikuar në: Zhvillimin e ekonomisë shqiptare në tërësi dhe duke i dhënë mundësi biznesit shqiptar që të kryejë investime të reja në teknologji, pajisje dhe plotësimin e nevojave të saj në rritje për kapital punues; Ndhmon në formalizmin e biznesit duke marrë parasysh faktin që transaksionet e Qirasë Financiare janë të shoqëruara me fatura tatimore dhe stimulon në hapat e tij të para aktivitetin e Qirasë Financiare (Leasing), në mënyrë që ky aktivitet të jetë në kushte të barabarta me institucionet e tjera të kreditimit, si p.sh Bankat të cilat janë të përjashtuara nga TVSH dhe me legjislacionin aktual nuk lënë hapësirë për kushte të barabarta konkurrence në treg

Në këtë kontekst do të ishte shumë efektive nëse do të bëheshin amendime të legjislacionit tatimor ekzistues, si më poshtë:

2. Rimbursimi i TVSH –së i menjëhershëm për llogari të kompanisë së leasing

Sipas Ligjit të TVSH – se, kur një kompani mbart në librat e saj për më shumë se 6 muaj një tepricë kreditore mbi vlerën 400 000 Lek, Administrata Tatimore duhet t'i rimbursojë subjektit vlerën e kësaj TVSH - je. Në rastin e transaksioneve të Qirasë Financiare, kompanitë e Leasing-ut gjithmonë do kenë një tepricë të tillë, sepse blerjet janë në vlerë më të madhe (100 % e Çmimit të Objektit të Qirasë) krahasuar me shitjet (vlera e mallit e shpërndarë në këste sipas afatit të kontratave të Qirasë Financiare). Meqenëse kjo TVSH që administrata tatimore do të duhet t'ia rimbursojë kompanive të leasing sipas ligjit, në fakt do të arkëtohet sipas kësteve të qirasë financiare gjatë afatit të kontratave të qirave financiare, atëhere mendojmë se do të ishte më e favorshme Rimbursimi i Menjëhershëm i TVSH –së (që në pagesën e Objektit të Qirasë) nga ana e Shoqërisë Leasing për llogari të klientit. Në këtë rast, TVSH-ja e rimbursuar do të aplikohet mbi këstin e qirasë (duke përjashtuar interesin)

⁵⁶ Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.3 datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”

dhe do të paguhej tërësisht gjatë gjithë kohës së Qirasë Financiare, deri në shlyerjen e plotë të financimit.

Avantazhet e këtij përmirësimi janë:

- a) E vendos Shoqërinë Leasing në një situatë të barabartë me Kredithënien apo edhe me blerjen cash nga klienti. Investitorët privatë e kanë aktualisht TVSH-në pasi TVSH-në e kanë të rimbursueshme menjëherë dhe nuk presin amortizimin e saj gjatë kohëzgjatjes së afatit të kontratës së Qirasë.
- b) Kjo ndihmon në rritjen e aktivitetit Leasing dhe si rrjedhim në **formalizimin e investimeve** sepse siç dihet Leasing është një aktivitet i bazuar vetëm mbi faturat tatimore.
- c) Në të njëjtën kohë edhe shteti nuk do të kishte ndonjë efekt negativ të lartë në lidhje me mbledhjen e TVSH-së (pasi në fakt ai e ka mbledhur TVSH që në hapin e parë – shitjen e asetit nga prodhuesit) dhe gjatë transaksionit të Qirasë Financiare nuk ka rritje të vlerës së Asetit por thjesht kalim pronësie (Shitës - Kompani Leasing - Blerës përfundimtar).
- d) Ky përmirësim do të çonte në rritjen e importit të mjeteve të reja përkundrejt atyre të përdorura. Kjo do të rezultonte pozitivisht edhe në drejtim të ruajtjes së ambjentit sepse duket se mjetet e reja kanë një konsum më të ulët dhe me efikas të karburanteve.

3. Kreditimi i TVSH-së për autoveturat e përdorura për nevoja biznesi.

Mos lejimi i kreditimit të TVSH-së për autoveturat e përdorura për nevoja biznesi, gjithashtu ka qenë pengesë për zgjerimin e aktivitetit të qirasë financiare. Në kushtet kur shoqëritë e leasing-ut, operojnë nën një formalitet të plotë dhe disponojnë të dhëna të detajuara mbi vlefat e transaksioneve, kemi propozuar që për tatimpaguesit e TVSH-së që operojnë autovetura për nevoja biznesore të financuara me qira financiare të lejohet kreditimi i tvsh-së në blerje të aplikuar me pagimin e çdo kësti të qirasë financiare. Për të kufizuar zbritjen e TVSH-së për mjete luksoze, mund të vendoset një limit i sipërm për çdo makinë (p.sh. kësti leasing për një makinë të mos jetë më i madh se 500 Euro në muaj)

Trajtimi fiskal - Në praktikë metodat dhe normat e amortizimit të përcaktuara në Ligji për tatimin mbi të ardhurat⁵⁷ dhe në standardet kombëtare të kontabilitetit (SKK7) nuk i shërbejnë kushteve dhe afateve normale të kontratave të qiramarrjes. Këstet e pagesave të principalit sipas kontratës së qirasë rezultojnë shumë më të larta se amortizimi i lejuar sipas normave fiskale bazuar në nenin 22 të këtij ligji, duke krijuar vështirësi financiare për zëvendësimin e mjeteve. Pra, metodat aktuale fiskale të amortizimit nuk stimulojnë investimet e reja dhe bëhen pengesë për rinovimin e teknologjive. **Një gjë e tillë rregullohet nëpërmjet lejitimit të aplikimit të metodave të amortizimit të përsheptuar.**

57 Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"

Praktika e deritanishme e vendeve që aplikojnë amortizimin e përshpejtuar tregon se ai është kthyer në një nga mjetet më efektive për të mundësuar rritjen e investimeve kapitale dhe në veçanti financimin e tyre nëpërmjet qirasë financiare.

Konkluzione

Bazuar në faktet e përmendura më sipër, u vu re se sistemi i institucioneve jo bankare në Shqipëri është subjekt i një sërë rregulloresh përsa i përket të gjithë aktiviteteve të tyre. Ne gjykojmë se ky sistem është i mirë rregulluar nga BSH, e cila ka hartuar rregullore për të mbuluar të gjithë aktivitetet e këtyre institucioneve, ***por nga ana tjetër kufizojnë hapësirat e këtyre institucioneve jo me pak rëndësi në vendin tonë për nga mbulimi gjeografik i tregut për t'u rritur në numër, për të ofruar produkte të reja dhe për t'u bërë më konkurrionale në treg.***

- Tregu i institucioneve financiare jo bankare në Shqipëri, është në fillimet e tij. Pra kemi të bëjmë me një treg jo shumë të zhvilluar, i cili ecën ndryshe dhe si i tillë priret të jetë inelastik. Megjithatë ndikimi i tyre në vendin tonë ka qenë pozitiv, duke ndihmuar zhvillimin e shumë bizneseve të vogla dhe të mesme, duke krijuar në këtë mënyrë vende të reja pune.
- Qeraja financiare ofron një sërë avantazhesh si fleksibilitet financiar, premisa për futjen e teknologjisë së re dhe për rritje ekonomike, formalizmi i ekonomisë, sigurimi i menjëhershëm i cash-it, ulja e rrezikut, transferimi i pronësisë, opsionet e anulimit, ofrohet mirëmbajtja, mund të arrihet kosto e ulët, mbrojtja nga taksat, leasing-u shmang kontrollet e shpenzimit kapital, leasing-u mbron kapitalin etj.
- Tregu i qirasë financiare në Shqipëri është relativisht i ri dhe operatorët janë të paktë në numër, megjithatë kjo nuk do të thotë që hyrja, mbijetesa dhe suksesi në këtë sektor do të jetë e lehtë. Për të stimuluar në hapat e tij të para aktivitetin e Qirasë Financiare (Leasing), në mënyrë që ky aktivitet të jetë në kushte të barabarta me institucionet e tjera të kreditimit, si p.sh Bankat, duhen bërë mendimet në legjislacionin aktual tatimor si rimbursimi i TVSH menjëherë në llogari të kompanisë leasing dhe kreditimi i TVSH-së për autoveturat e përdorura për nevojat e biznesit.
- Rritja dhe zhvillimi i planeve marketing për përmirësimin e imazhit të kompanive jo banka, duke sjellë një njohje më të madhe të shërbimeve të ofruara prej tyre. Ofrimin e një game më të gjerë shërbimesh si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë, si dhe një shërbim më të mirë ndaj klientelë.

Literatura:

1. Money, Banking and financiar Institutions, Mishklin 2009
2. "The Roles of Microfinance, Entrepreneurship and Sustainability in Reducing Poverty in Developing Countries" Guy Vincent 2005;

3. "Analysis of the Effects of Microfinance on Poverty Reduction" Jonathan Morduch 2002
4. Raporti vjetor Opportunity Albania
5. Analiza vjetore Fondacioni Besa
6. Albic Qendër Informacioni e Biznesit Shqiptar
7. Tregu i sigurimeve në Shqipëri dhe pasojat e krizës globale
8. DEKLARAT E BANKËS SË SHQIPËRISË
9. Markets sustainability and the end of politics.
10. AMF Tregu i sigurimeve nuk u prek nga kriza financiare në vitin 2009.
11. Raporti për Sigurimet Janar 2010.
12. Raporti për Pensionet Private Dhjetor 2009.
13. Rregullore Nr. 32 datë 03.05.2006 "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licensuara nga Banka e Shqipërisë".
14. Rregullore Nr 59 Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare
15. Rregullore Nr 70 Për Veprimtarinë Valutore.
16. Rregullore Nr 91 Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare.
17. Rregullore Për licensimin organizimin veprimtarinë dhe mbikqyrjen e zyrave të këmbimit valutor.

“Bursat e kapitaleve – një sfidë ende për t’u ndërmarrë. Realiteti i Shqipërisë”

Dr. Elvin MEKA

Emporiki Bank

Gjergji Filipi, PhD

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT. *Kriza financiare që shpërtheu në SHBA në vjeshtën e vitit 2008 e që u shndërrua me shpejtësi në një krizë globale financiare dhe ekonomike, ka ndikuar thellësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme në mënyrën e funksionimit të sistemeve dhe tregjeve financiare, jo vetëm në rang global, por dhe në rang rajonal e kombëtar. Përmasat e jashtëzakonshme të humbjeve financiare të përjetuara si pasojë e rënies dramatike të çmimeve të titujve financiarë në bursa, pashmangshmërisht ngrenë pyetjet:*

- *A ishin bursat, tregjet e kapitaleve dhe instrumentet e tregtuara në to shkaktarët kryesorë të kësaj krize apo ato ishin thjesht mekanizmi që transmetoi krizën tek investuesit?*
- *Cili do të jetë këtej e tutje roli i bursave dhe tregjeve të organizuara të titujve financiarë?*

Realiteti financiar shqiptar, përballë dhe në kuadër të kësaj krize globale, nuk mund të japë një përgjigje të matshme në terma standardë të luhatjeve të çmimeve të titujve financiarë, për sa kohë atij i mungon ende një bursë aktive kapitalesh (pavarësisht nga hapja formale e saj në 1996) dhe vazhdon ende të mos jetë pjesë e globalizimit financiar.

Gërshtimi i krizës financiare me atë ekonomike, e shtrirë tashmë njëkohësisht në shkallë planetare, dhe identifikimi i faktorëve që shkaktuan ato i japin përgjigje retorikës shumëvjeçare mbi aktivizimin ose jo të bursës së kapitaleve në Shqipëri: Bursa e kapitaleve duhet të jetë e pranishme në sistemin financiar shqiptar jo vetëm për kontributin që mund të japë në drejtim të rritjes ekonomike, rritjes së konkurrencës, por dhe për evitimin e faktorëve dhe premisave që shërbyen si iniciues dhe katalizatorë të kësaj krize.

1. Në vend të hyrjes...bota ishte paralajmëruar!!!

Në vitin 2002 Dean LeBaron dhe Romesh Vaithilingam në librin: “Thesari i Mençurisë së Investimit – 30 Mendjet më të Ndritura të Investimit” në kapitullin përmbyllës: **“future focus II: ten key global issues”**, ndër të tjera shkruanin:

“Ndërlidhja”⁵⁸

Një nga karakteristikat thelbësore të kësaj epoke është shkalla e lartë e ndërlidhjes që po përjetojmë – ndërlidhje kjo në nivele personale, biznesi dhe qeveritare. Tashmë jemi në gjendje, si asnjëherë tjetër më parë, të lidhim apo bëjmë bashkë thujtje gjithçka; kemi përfituar aq shumë nga avantazhi konkurrues sa jemi bërë specialistë në prodhimin e diçkaje dhe këtë mund ta prodhojmë më mirë sesa ç’mund ta prodhojnë të tjerët për vete. Por kjo ka bërë që mos arrijmë të prodhojmë më gjithçka vetë; tashmë nuk mund të mbijetojmë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Praktikisht po i shijojmë përfitimet nga kjo, por jemi dhe të ekspozuar ndaj rreziqeve...Ndërlidhja financiare në rang global nuk ka qenë asnjëherë në një nivel si ky i sotmi. Tani kemi një sistem të përbashkët bankar, ku paraja ka mundësi të qarkullojë, në çast, në rrugë elektronike dhe në sasi të pakufizuara, në të katër anët e globit, pa asnjë lloj transparence. Ne përdorim të njëjtin sistem arsimor për edukimin e njerëzve të biznesit, bazuar gjerësisht në modelin amerikan. Ne besojmë tek shprehja e Adam Smithit se, kapitalizmi i pakufizuar prodhon më të mirën për individin. Ne përdorim të njëjtën platformë pune, gjuhën angleze.

Por kur një nga lojtarët globalë ka probleme, qoftë kjo Korea, Indonezia, Rusia apo Brazili, pjesa tjetër e mendon me të drejtë se, duhet zbatuar një paketë shpëtimi me çdo çmim. Kjo është sikur të kemi një pacient që mund të vuajë nga një sëmundje ngjitëse. Pavarësisht nga kjo, duket se e vetmja mënyrë për ta ndaluar atë është që ta lemë të lirë pacientin mes njerëzve. Normalisht, një pacient i tillë trajtohet duke e mbajtur në karantinë”.

2. Kriza globale financiare... jo si rrufe në qiell të hapur

E hëna e datës 15 shtator 2008 ka hyrë tashmë në historinë e financave globale si “Dita e Gjykimit”, apo momenti i shpërthimit piroklastik të krizës më të madhe financiare brenda sistemit financiar të SHBA-ve dhe më gjerë, në të gjithë rrjetin global të tregjeve financiare. Natyrisht tre ngjarjet madhore që formësuan “cunamin” financiar botëror ishin:

- Depozitimi i kërkesës për mbrojtje nga falimentimi nga “Lehman Brothers”, një prej bankave më të mëdha të investimeve në botë (tashmë e likuiduar);
- Shitja e rufeshme e të gjithë aksioneve të “Merril Lynch” (nga bankat më të mëdha


58 LeBaron, D. & Vaithilingam, R: “*Treasury of Investment Wisdom - 30 Great Investing Minds*”, f.2002.

të investimeve në botë) tek “Bank of America” (për një vlerë 50 miliard US\$);

- Njoftimi i rrezikut të falimentimit të grupit më të madh sigurues në botë AIG (American International Group), nëse nuk tejkalonte mungesën e theksuar të likuiditetit brenda disa ditësh.

Praktikisht, mbi një vit më parë nga shtatori 2008, fluska e pasurive të paluajtshme brenda sistemit financiar në SHBA kishte plasur që në 6 gusht 2007 me shpalljen e falimentimit të “American Home Mortgage” (AHM), një institucion i specializuar në dhënien e huave për shtëpi. Më tej, lajmet negative vijuan me falimentimin dhe shtetëzimin në vijim të “Northern Rock”, banka hipotekare më e madhe në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe përthithjen e Bear Stearns (bankë investimesh) nga banka tregtare JP Morgan Chase në 16 mars 2008. Shihet se kriza nuk shpërtheu brenda një dite, për faktin e thjeshtë se premiset që shërbyen si katalizatorë të krijimit të potencialit të jashtëzakonshëm me të cilën shpërtheu kriza globale financiare ishin në funksionim të plotë dhe e ushqenin atë që prej vitit 2002. Megjithatë, falimentimi i AHM do të shënonte fillimin e pashmangshëm të krizës komplekse financiare në SHBA, një krizë kjo e ndezur fillimisht nga kreditë hipotekare të pakthyera, për të vijuar me falimentimet dhe largimet nga *Wall Street* -i të bankave më të spikatura të investimeve, që bënë dhe historinë e hershme dhe të re të vetë tregut dhe industrisë amerikane të letrave me vlerë dhe bursave. Patjetër që, kjo nuk ishte një krizë e shkaktuar thjesht nga moskthimi i kredive hipotekare, por ashtu siç dhe koha e tregoi, në përbërje të saj ajo ngërthente një mori faktorësh, ngjarjesh dhe një model biznesi, brenda industrisë së letrave me vlerë, të cilat të vendosura në mozaikun e ekonomisë komplekse dhe të sofistikuar të SHBA-ve, e kthyen atë në një krizë të vetë sistemit financiar amerikan.

**Figure II.1. Credit default swaps outstanding (LHS)
and positive replacement value (RHS)**



Source: BIS, ISDA, OECD.

Tani është e lehtë të nxirrej në dritë “fajtori i madh”, apo dashi i kurbanit, që shkaktoi këtë krizë globale financiare: *Credit Default Swaps*, CDS, ose policat e sigurimit që mbulojnë rrezikun nga kreditë e humbura. Vërtet që, paniku i vërtetë i tregjeve financiare u shkaktua nga 900,000 kontrata financiare dhe CDS-je të mbetura pezull pas falimentimit të Lehman Brothers dhe zbulimit të një portofoli prej 2 trilion US\$ kontratash CDS tek AIG, por kjo ishte vetëm maja e ajsbergut të stërmadh të grupit të fajtorëve, shkaktarë të krizës. Nëse volumi i CDS-ve të emetuara teknikisht dhe paradoksisht tejkaloi dhe prodhimin botëror në 2008 (rreth 60 trilion US\$), vijoi të mbetet në kufijtë e papërgjegjshmërisë profesionale dhe publike, mosreagimi nga autoritetet mbikëqyrëse monetare dhe financiare të ekonomive më të zhvilluara të botës, ndaj shkëlqes me ndërgegje, për vite me radhë, të standardeve dhe kriterëve të prudenës nga ana e bankave dhe institucioneve të tjera jobanka.

Gjithashtu, anashkalimi dhe shfrytëzimi maksimal i të çarave në kërkesat për kapital (të përcaktuara nga Bazeli I dhe II) si dhe ekzistenca e parajsave fiskale, ndihmuan fuqishëm në përdorimin në nivele të paprecendta të levës financiare dhe modelimin e një morie produktesh të strukturuar me bazë hipotekat e shtëpive dhe kontratat derivate. Së fundi, vlerësimet e besueshmërisë (credit rating) që jepnin agjencitë e specializuara, ishin vula përfundimtare e tërheqjes në investime me risk të lartë, por me vlerësim AAA, të mijëra e miliona investuesve institucionalë e privatë

3. Më shumë se një vit më pas....

Kur ka kaluar më shumë se një vit nga shpërthimi i krizës globale financiare dhe ekonomike, ekonomia botërore vijoi të ecë në rrugën e padëshirueshme të rënies, rikompozimit e ri-dimensionimit të të gjithë aktivitetit ekonomik dhe financiar brenda saj.

Fakti është që, ekonomia globale gjatë 2009-ës hyri në fazën më të vështirë, në atë të zhytjes në territorin negativ dhe të ristrukturimit të dhimbshëm të kërkesës dhe ofertës për mallra e shërbime në rrafsh global. Por nëse viti 2009 u pranua botërisht me ndërgegje si një vit i vështirë, viti 2010 është thjesht viti i pasigurisë. Natyrisht mund të konsiderohen tashmë të kaluara dy fazat e para post-krizë, siç ishin Kriza Institucionale dhe Kriza e Likuiditetit. Kriza e rënies (apo depresioni) së ekonomisë reale për fat të keq nuk mund të kalojë aq shpejt sa dy të parat apo të vihen re përmirësime të dukshme shumë shpejt.

Bota, asnjëherë, nuk ka përjetuar një krizë të përmasave të tilla dhe pas ndërhyrjeve energjike qeveritare me të gjithë levat dhe mekanizmat e mundshme, madje deri tek ato më të paimagjinueshmet (shtetëzimet në SHBA), duket se rimëkëmbja ekonomike në periudhë afatgjatë do të mbetet në dorë të vetrregullimit natyral që ekonomia e tregut ka në gjenomën e saj, të bazuar në të vetmin ligj ekonomik të pasfiduar deri më sot: LIGJI I KËRKESËS DHE OFERTËS!

4. A janë bursat e kapitaleve fajtores të krizës?

Siç u përmend dhe pak më lart, procesi i identifikimit të “fajtorëve” shkaktarë të stuhisë financiare dhe ekonomike globale ishte i shkurtër dhe nxori në pah produktet financiare të sofistikuara dhe bursat. E nëse produktet financiare të sofistikuara (si letrat me vlerë të kolateralizuara dhe CDS-të) ishin ekzekutorët e humbjeve disa trilionëshe dollarë në mbarë globin, bursat thjesht transmetuan dhe ekspozuan aktin e fundit të dramës globale financiare, pikërisht atë të realizimit faktik të humbjeve!

Shkalla e lartë e sofistikimit financiar dhe globalizimi i tregjeve, i nisur dhe zbatuar si proces për më shumë se një dhjetëvjeçar, pas vitit '95) thjesht përcollën dhe përhapën me shpejtësinë e dritës epideminë e krizës financiare, që u shndërrua në një pandemi financiare globale. Gjithsesi, bursat dhe tregjet e kapitaleve nuk mund të ishin as shkaktari e as fajtori i krizës financiare. Pretendimi i të kundërtës është tërësisht i gabuar dhe i pabazë.

Realiteti dhe praktika tregoi më së miri se, të gjithë tregjet e letrave me vlerë dhe kryesisht bursat e aksioneve ishin viktime e pashmangshme fundore e një “krimi” jo të kryer apo të instrumentalizuar prej tyre. Pavarësisht nga rënia e pashmangshme që pësuan treguesit dhe indekset e të gjithë bursave, ato thjesht transmetuan perceptimin dhe qëndrimin natyral ndaj rrezikut që kërkojnë dhe marrin përsipër investuesit në letrat me vlerë që tregtohen në to. Investuesit, në mbarë globin, vijnë ende të preokupuar për fondet dhe investimet e tyre e në kuadër të krizës globale. Ata ende po tregohen të rezervuar për të nxjerrë likuiditetin nga xhepat e tyre. Ky realitet u pasqyrua egërsisht në bursa, ku në momentet fillestare të krizës thjesht investuesit konvertuan investimet e bëra më parë në tituj qeveritarë. Meqenëse ligji i kërkesë – ofertës, siç u citua dhe më lart, tashmë ka mbetur i vetmi postulat që nuk do të ndryshojë kurrë në ekonomi dhe përderisa investuesit u turrën për të dalë nga investimet e tyre me çdo çmim, patjetër që çmimet e letrave me vlerë ku ata investuan do binin ndjeshëm. Duke i shtuar këtu dhe problemet komplekse me të cilat u ndeshën disa prej shoqërive të kuotuar në bursa, është e logjikshme që presioni rënës mbi çmimet e letrave me vlerë të tyre do të rritej në progresion gjeometrik.

Duke u kthyer dhe një herë tek rrënja e argumentit, pranohet se, “mëkati fillestar” i krizës financiare ishin kreditë e dhëna për strehim (hipotekare) tek ata klientë që nuk mund të kualifikoheshin për t'i marrë ato (apo “*subprime*”) dhe që si pasojë e praktikave të papërshtatshme e të papranueshme të kreditimit që u ndoqën nga bankat amerikane, u kthyen në kredi të këqija. Natyrisht që, në SHBA, bankat, një pjesë të kredive për strehim i shesin në tregun sekondar, duke i transformuar në letra me vlerë (obligacione hipotekare dhe produkte të tjera derivate e sintetike), të cilat shiten dhe blihen midis investuesve të ndryshëm.

Pikërisht këtu fillon keqkuptimi mbi “fajësinë” e bursave në krizën globale. **Paradoksi i krizës financiare qëndron në faktin se këto letra me vlerë dhe me CDS-të (të shtjelluara më lart) nuk tregtohen në bursat zyrtare të aksioneve apo në tregje të organizuara letrash me vlerë, por ato tregtohen mes tregtarëve të instrumenteve**

financiare në mbarë botën, nëpërmjet platformave globale të tregtimit elektronik, pra tërësisht jashtë mbikqyrjes së enteve rregullatorë dhe vetë bursave!

Nga ana tjetër, shoqëritë e klasifikimit të rrezikut (*credit rating agencies*) gjithnjë i kanë graduar këto instrumente si AAA (grada më e lartë), kështu që investuesit as që e morën mundimin të interesoheshin se çfarë sigurie faktike jepej, kush qëndronte pas këtyre instrumenteve dhe cili ishte rreziku i vërtetë që i shoqëronte ato. Gjithashtu, zjarrit të ndezur më parë në vatrën e madhe amerikane (përçimi i problemeve të kredive të pakthyera tek tregu i obligacioneve hipotekare dhe instrumenteve të tjera financiare) iu hodh benzinë me përhapjen virulente të emetimit të CDS-ve. Deri në vitet 2005-2006, CDS-të emetoheshin kryesisht nga shoqëritë e sigurimeve, por më vonë filluan të emetonin polica të tilla të gjithë institucionet financiare, madje dhe institucione që nuk kishin të bënin fare me tregun financiar. Fitimi prej tyre ishte i majmë dhe gjithkush lëshonte të tilla polica, pa i kushtuar vëmendje administrimit të kujdesshëm të rrezikut nga një veprim i tillë.

Gjithashtu, operatorët dhe investuesit në ekonomitë aziatike dhe ato të Lindjes së Mesme (ekonomitë e petrodollarëve) ishin tepër të etur për t'i investuar paratë e lira që kishin me shumicë (si pasojë e rritjes së fortë të çmimit të naftës) dhe instrumente të tilla, që nuk ishin transparente e me mungesë thuajse totale kontrolli, ishin vetë parajsja. **Me gjithë vlerën galaktike të emetimit të tyre (mbi 60,000 miliardë US\$), asnjë institucion apo ent rregullator nuk mbikëqyrte, monitoronte apo kontrollonte një proces të tillë apo tregtimin e tyre, që ashtu si obligacionet hipotekare tregtoheshin krejtësisht jashtë bursave!**

Me plasjen e fluskës globale financiare, e përqendruar kryesisht rreth letrave me vlerë dhe instrumenteve financiare të emetuara dhe tregtuara në SHBA (si ekonomia më me madhe dhe me tregjet më të mëdha financiare), efektet ishin të përmasave kataklizmike. Fondet shumëmiliardëshe (në para të gatshme “cash”), të investuara në instrumente financiare që mbulonin rreziqet vetëm në letër, humbën vlerë apo thjesht humbën (në para të gatshme “cash” dhe jo në letër) në përmasa të konsiderueshme. Me veprime paradoksalisht të logjikshme, investuesit e dëmtuar nga këto lloj investimesh, nxituan të dalin dhe nga investimet e tjera të qëndrueshme, pavarësisht se ato nuk kishin të bënin me krizën, si: aksione dhe obligacione të shoqërive private me pozita të shëndosha në ekonomi.

Veprime të tilla, të kanalizuar nëpërmjet tregjeve të kapitaleve dhe bursave të letrave me vlerë, shkarkuan brutalisht tek këto të fundit të gjithë efektet e lëmshit katastrofik financiar të krijuar prej instrumenteve të tregtuara jashtë tyre. Situata komplekse e krizës financiare, shoqëruar me atë ekonomike bëri që shoqëritë e kuotuar në bursa, përveç vështirësive që hasën në financimin normal të aktivitetit të tyre tregtar nga bankat, si pasojë e likuiditetit të munguar, filluan të përballen dhe me tkurrjen e kërkesës për mallrat apo shërbimet e tyre dhe vështirësi për sigurimin e kapitaleve të nevojshme shtesë, nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë (aksione, obligacione, letra tregtare, etj).

5. A kanë të ardhme bursat e kapitaleve dhe tregjet zyrtare të letrave me vlerë?

Kriza e fundit financiare dhe ekonomike nuk ka qenë as e para, e sigurisht që nuk do të jetë e fundit në historinë ekonomike të botës. Historia e largët dhe e re ka dëshmuar se tregjet e letrave me vlerë dhe bursat kanë vijuar të funksionojnë edhe pas krizave të thella ekonomike, natyrisht duke përjetuar dhe ato ulje - ngritjet e ekonomisë.

Në këtë kuadër, do të ishte thjesht e paimagjinueshme që, nga ekonomia e tregut të zhduket simboli dhe ikona e kapitalizmit, që është bursa e aksioneve dhe tregu i letrave me vlerë. Kjo pasi bursa nuk përbën thjesht një treg në vetvete, si çdo lloj tjetër tregu, por ajo tregon shkallën e zhvillimit dhe sofistikimit të një ekonomie tregu (kapitaliste).

Zhvillimi i ardhshëm dhe i pritshëm i një ekonomie moderne kapitaliste pa bursë apo treg letrash me vlerë është thjesht alogjik dhe nënkupton të fillosh të përdorësh metodat mesjetare të financimit të biznesit dhe ekonomisë apo të rikthehesh në kohën e lingotave apo monedhave në metale të çmuara! Gjithkush është i ndërgjegjshëm se periudha aktuale vijon të mbetet një kohë disi e vështirë dhe me shumë korrektime në çmimet e përgjithshme të letrave me vlerë në të gjithë dhe bursat e qendrave kryesore financiare të botës.

Vëmendja e qeverive të ekonomive të mëdha, por në një shkallë më modeste dhe e qeverive të tjera, në fazën e parë të zhvillimit të krizës globale u fokusua në kalimin e situatës që lidhej me qëndrueshmërinë institucionale të bankave dhe institucioneve të mëdha financiare, pasi pa siguruar një gjë të tillë, e tërë ekonomia globale rrezikonte praktikisht kolapsin. Hapat e tjerë që pasuan dhe që po ndërmerren aktualisht janë marrja e masave rigoroze dhe të kujdesshme për sigurimin e një rregullimi, mbikqyrjeje dhe monitorimi nga afër të aktivitetit të tregtimit të letrave me vlerë dhe gjithë instrumenteve të tjera financiare, qoftë kjo dhe në rrafsh global.

Pikërisht këtu do të nisë dhe faza e re e rritjes së rolit të veçantë të bursave të kapitaleve dhe tregjeve të tjera zyrtare të letrave me vlerë. Pashmangshmërisht, një pjesë e mirë e produkteve derivative të sipërpërmendura do të detyrohet të tregtohet nëpërmjet bursave, tregtim ky që do të rrisë transparencën e palëve të angazhuara në transaksion (duke evituar rrezikun e palëve të treta), si dhe futjen e kërkesave strikte për emetuesit e këtyre instrumenteve financiare, për të shmangur rrezikun e emetuesit. Masa të tilla patjetër që do të rikonfigurojnë profilin e të gjithë bursave të mëdha në botë apo do të çojë në krijimin e bursave të reja. Bota nuk mund të vijoje të jetojë me mentalitet krize apo me skenarë tërësisht kursimi dhe zero konsumi e investimesh. Patjetër që universi i nesërm institucional financiar global nuk do të jetë ai që ishim mësuar të shihnim deri dy vjet më parë, por shumë më i rregulluar dhe më i mbikëqyrur siç duhet.

Përmbledhtazi, mund të pohohet se, bursat e aksioneve dhe tregjet e letrave me vlerë nuk mund të ishin gjenerueset e krizës financiare globale; përkundrazi transparenca që karakterizon këto tregje dhe rregullimi rigoroz i tyre ishin elementët e munguar në tregtimin e instrumenteve që shkaktuan krizën globale financiare.

6. Po në Shqipëri?

Në vjeshtë të vitit 2008, shumëkush në Shqipëri e çmoi si pozitiv faktin që sistemi financiar shqiptar nuk kishte një bursë funksionale, pasi u gjykua se do të mund të përjetohej humbje të mëdha financiare, sikundër u evidentuan në të gjithë bursat ndërkombëtare të kapitalit. Gjithsesi, në rastin e Shqipërisë një argumentim i tillë mbetet në kufijtë e hipotezës së pavërtetuar (pasi ende nuk kemi një bursë funksionale) dhe diskutimeve mbi baza folklorike, pa mbështetje në analiza themelore apo teknike.

Teknikisht duhet të jetë e qartë është se, sikur Shqipëria të kishte bursë funksionale, qytetarët shqiptarë nuk do kishin humbur më shumë sesa ç' humbën nga mospërfitimi i interesave, nga depozitat që tërhoqën para kohe nga bankat në vend dhe mbajtja e tyre për disa muaj jashtë sistemit bankar. Nga ana tjetër, duhet të bëhet e qartë se, nëse do të kishim shoqëri të listuara në Bursën e Tiranës, ato pashmangshmërisht do të ishin kryesisht nga shërbimet publike, industria ushqimore ose shërbimet financiare bazë. Këto shoqëri, për vetë stadin e zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe nivelit të integritetit të ekonomisë e sistemit tonë financiar në ekonominë evropiane, kanë përjetuar vetëm rritje të aktivitetit e të fitimeve dhe aspak ulje.

Për më tepër, investimi në aksione dhe obligacione merr në konsideratë kryesisht parametrat ekonomiko-financiarë të shoqërisë që i emeton ato, pra ato faktorë që lidhen me rrjedhën e aktivitetit të biznesit. Efektet e krizës globale patjetër që do të ndiheshin dhe në Bursën e Tiranës, nëse ajo do të ishte aktive, por dhe aktualisht, kur nuk kemi një bursë aktive, ekonomia shqiptare e ka ndjerë goditjen nga kriza globale, si në drejtim të dërgesave të emigrantëve (56 Milion EURO më pak gjatë 2009, në krahasim me 2008), ashtu dhe të investimeve të huaja dhe në nivelin e volumit të tregtisë së jashtme.

Nga ana tjetër, gjatë gjithë vitit 2009 u vu re një rritje e konsiderueshme e kredive me probleme brenda sistemit bankar shqiptar.

Ecuria mujore e kredive me probleme në Shqipëri 2009

n ë %

Jan.	Shku.	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shta.	Tet.	Nën.	Dhjet.	Jan.10
6.8	7.8	7.6	8.0	8.9	8.7	9.0	9.5	9.7	10.1	10.7	10.5	11.6

Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) - (sipas SNK-ve)

Ritmi i rritjes vjetore: 70%

Pavarësisht se në rritjen e kredive me probleme gjatë 2009 ka kontribuar dhe rritja me ritme të shpejta e kreditimit gjatë 5-6 viteve të fundit është e pashmangshme se, një kontribues i rëndësishëm është dhe kriza globale ekonomike e financiare. Kjo pasi Shqipëria është e lidhur me ekonominë dhe rrjetin e tregtisë ndërkombëtare, jo përmes rrjetit të institucioneve financiare dhe bursave të kapitalit apo letrave me vlerë, por nëpërmjet operatorëve të ekonomisë reale. Ky fakt vërtet e shpëtoi Shqipërinë nga vala e parë goditëse e krizës, por nuk mund të shpëtonte nga goditjet dhe presionet

e krizës ekonomike, nisur dhe nga fakti i problemeve ekonomike që ndeshin dhe përjetojnë Greqia e Italia si partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë.

Ulja e aftësisë paguese të kredimarrësve në banka lidhet në mënyrë komplekse me shumë faktorë makro e mikroekonomikë, mbi të cilët ka pasur një ndikim të madh pikërisht kriza globale. Fenomeni i rritjes së kredive me probleme ka rritur nivelin e perceptuar të rrezikut brenda sistemit financiar shqiptar, fakt ky që është reflektuar më së miri në uljen e ndjeshme të ritmit të kreditimit të ekonomisë gjatë vitit 2009 dhe riorientimi i likuiditetit të tregut (qoftë ky institucional apo individual) drejt huamarrjes së qeverisë qendrore, që paraqet një rrezik më të ulët.

Ecuria e kreditimit të bizneseve dhe individëve 2009

në miliard lekë

	Jan.	Shku.	Mars	Pri.	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Jan. '10
Teprica e kredisë													
Kredia per bizneset	258.4 3	265.5 7	268.9 9	269.9 1	274.0 7	270.1 2	272.3 4	275.5 2	279.4 5	282.8 4	285.0 1	291.2 1	295.2 6
Kredia për individët	135.4 9	137.4 9	138.6 2	138.9 2	139.6 7	139.1 1	137.7 8	138.2 4	138.7 4	140.5 4	140.7 0	139.7 8	139.5 2

Teprica e kredisë	Ndryshimi vjetor në %
Kredia per bizneset	14.3
Kredia për individët	3.0

Burimi: Banka e Shqipërisë

Natyrisht, ekzistenca e instrumenteve të tjera të borxhit (si obligacionet e shoqërive aksionere) dhe të tregtuara në bursën e letrave me vlerë, do të kushtëzonte një rritje më të moderuar të paaftësisë paguese të bizneseve të mëdha (kredia me probleme e të cilëve rrit në amplitudë më të madhe e më me shpejtësi fondin e provigjioneve dhe humbjet e bankave sesa kreditë me probleme të individëve), pasi në momentet me vështirësi likuiditeti ato mjaftohen kryesisht vetëm me pagesat e kuponëve dhe jo me shlyerje principali (si në rastin e kësteve të kredisë).

Nga ana tjetër, alternativa e emetimit të obligacioneve nga ana e shoqërive aksionere të kuotuar në bursë do t'u jepte mundësi këtyre të fundit të tërhiqnin likuiditete që mund të origjinonin nga burime të ndryshme nga kanalet bankare (individë dhe investues të tjerë institucionalë), duke zbutur në këtë mënyrë shtrëngimin e kushteve të kredisë bankare të vërejtur së fundi, duke amortizuar disi efektet goditëse të krizës globale financiare, si brenda sistemit financiar ashtu dhe brenda ekonomisë reale.

Nën një vështrim makro të prekjes së ekonomisë vendase nga kriza globale, vërehet përkeqësim i treguesve apo i ritmeve të mëparshme në disa drejtime. Ritmi i rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) pësoi goditje domethënëse gjatë vitit 2009. Ky vit e gjeti ekonominë shqiptare me një ritëm mesatar rritje prej më se 7 % gjatë dekadës së fundit (1998-2008) dhe sipas shifrave të Bankës së Shqipërisë, ritmi i rritjes gjatë vitit 2009 ka rënë nën më pak se gjysmën e këtij niveli, në rreth 3%. Shifrat e INSTAT tregojnë ritme rënëse progresive të rritjes vjetore përgjatë gjithë tremujorëve të 2009, ku në tremujorin e katërt konfirmohet tkurrje e aktivitetit ekonomik në vend me rreth 1 % krahasuar me tremujorin korrespondues të një viti më parë. Nga pikëpamja sektoriale, kontraktimi duket se preku sektorë *lokomotivë* të ekonomisë vendase si: industria e veçanërisht ndërtimi, i cili u zvogëlua me 14,4% krahasuar me një vit më parë.

Lidhur me komponentët makroekonomikë të të ardhurave kombëtare, Banka e Shqipërisë vlerëson se, në vitin 2009 pati ngadalësim të kërkesës agregate, me ritme rënese në konsumin privat dhe investime si dhe me eksportet neto që vijuan të japin kontribut negativ. Theksojmë se, konsumi privat është përbërësi kryesor i kërkesës agregate, me një peshë rreth 80% të PBB-së. Ritmet e ngadalësuara të rritjes së pagave, rënia e dërgesave të emigrantëve dhe tkurrja e kredisë, ndikuan në ngadalësimin e konsumit. Investimet private, të ndikuara nga ngadalësimi i kërkesës, nga pasiguritë lidhur me situatën ekonomike, si dhe prej kushteve të shtrënguara të kreditimit, u kontraktuan gjatë vitit 2009, duke arritur në nivel të ngjashëm ndaj PBB-së së pesë viteve më parë (Banka e Shqipërisë raporton se investimet private në vitin 2009 përbëjnë 21,6 përqind të PBB-së; në vitin 2004 përbënin 21,2 përqind të PBB-së dhe në periudhën e ndërmjetme kanë arritur nivele përtej 24 përqind.

Prekja e ekonomisë vendase nga kriza globale përkoj dhe me vitin elektorale, që nisi me një politikë fiskale ekspansioniste dhe u mbyll me mosrealizim të planit të të ardhurave, duke zgjeruar deficitin buxhetor në 7,1 përqind të PBB-së. Sipas analizës së buxhetit të vitit 2009, publikuar nga Ministria e Financave, të ardhurat buxhetore shënuan një rritje vjetore prej vetëm 2.4 përqind, ku të ardhurat tatimore u rritën me vetëm 2.3 përqind. Nëse sjellim në vëmendje normën vjetore të inflacionit prej 2.2 përqind gjatë vitit 2009, shifrat flasin për ritme të rritjes së aktivitetit ekonomik akoma më të ulëta sesa 3% i rritjes së PBB-së, sipas vlerësimit të Bankës së Shqipërisë.

Në fakt, qoftë të ardhurat nga tatimi mbi fitimin apo ato nga taksa vendore mbi biznesin e vogël kishin qenë më të ulëta me rreth 5 përqind, krahasuar me një vit më parë, duke konfirmuar kështu prekjën e qartë të sektorit real nga kriza ekonomike. Gjithashtu, sipas Bilancit të Forcave të Punës, publikuar së fundmi nga INSTAT, shifrat e punësimit pësuan tronditje të rëndësishme, veçanërisht gjatë tremujorit të katërt të 2009. Norma e papunësisë rezultoi më se 1 përqind më e lartë sesa në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, numri i të punësuarve në vend ra me 7,7 përqind dhe forca e punës u tkurr me 6,5 përqind.

Thellimi i deficitit buxhetor rezultoi në rritjen e ndjeshme të borxhit publik, që rezultoi më i lartë se parashikimi dhe standardet e deritashme të mbajtura fort, mesa duket për meritë të prezencës dhe detyrimeve në kuadrin e marrëveshjeve me FMN-në. Ministria e Financave deklaroi se, borxhi publik në fund të vitit 2009 përbënte 59.63 përqind të PBB-së, pra pothuajse sa kufiri tavan prej 60% të PBB-së. Këto nivele deficioni buxhetor e borxhi duket se nuk lejojnë hapësirë për manovra të politikës fiskale, me synim stabilizimin e parametrave të ekonomisë vendase, Gjithashtu, borxhi publik është një variabël makroekonomik, që mban nën kontroll elementë të tjerë, si pozicionimin e jashtëm, kursin e këmbimit, inflacionin, qëndrueshmërinë financiare dhe fiskale. Niveli i borxhit publik është një *etiketë* e rëndësishme për përcaktimin e besueshmërisë së investuesve ndërkombëtarë, si dhe lidhet ngushtë me pozicionimin e favorshëm të vendit në renditjen për klasifikim besueshmërie (*sovereign rating*) në tregjet financiare globale.

Deficioni i llogarisë korrente, një prej dobësive të njohura të ekonomisë shqiptare,

vazhdon të mbetet në nivele të larta përtej 15 përqind të PBB-së. Viti i shkuar rezultoi me një rënie vjetore prej 18 përqind të eksporteve dhe me rënie të dërgesave të emigrantëve me 6.5 përqind. Për Shqipërinë dërgesat e emigrantëve përfaqësojnë një fluks hyrës tepër të rëndësishëm, sepse së bashku me të ardhurat nga eksporti dhe investimet e huaja të drejtpërdrejta përbëjnë elementët kryesorë në financimin e importeve dhe mbështetjen e nevojave të ekonomisë për konsum e investime.

Ritmi më i ulët i investimeve të huaja direkte ndikoi në uljen gjithashtu të suficitit të llogarisë kapitale dhe financiare, i cili ishte me 35.6 përqind më i ulët në 2009, në krahasim me një vit më parë, e për rrjedhojë këto llogari arritën të mbulonin vetëm 77 përqind të deficitit korrent.

Kjo krizë e gjeti ekonominë Shqiptare me probleme të paadresuara prej kohësh, lidhur me gjendjen e llogarisë korrente. Siç pritej, tendencat rënës në ofertën e valutave u manifestuan me nënçmimin e monedhës kombëtare. Që prej janarit 2009, Leku u nënçmua (deri në mars 2010) me 13,5 përqind ndaj Euros dhe me rreth 23 përqind ndaj Dollarit Amerikan, dhe vetëm gjatë vitit 2009 nënçmimi mesatar vjetor i lekut ishte përkatësisht 7.6 përqind dhe 13.2 përqind, duke u shfaqur më i moderuar si pasojë e korrektimit të bilancit tregtar që riekulibroi kërkesën dhe ofertën për valutë.

7. A ka të ardhme bursa e kapitaleve dhe letrave me vlerë në Shqipëri?

Të gjithë përvojat ndërkombëtare, si të vendeve të zhvilluara, ashtu dhe ato të vendeve në zhvillim, tregojnë për një zhvillim apo synimin për një zhvillim relativisht të balancuar të sistemit financiar, pavarësisht se në këto të fundit sektori bankar, si në gjithë botën, përbën një bazament më të madh mbështetës për zhvillimin ekonomik, krahasuar me tregun e letrave me vlerë dhe sektorin jobankar.

Aktualisht, sistemi financiar shqiptar mbështetet dhe identifikohet thuajse plotësisht vetëm me një shtyllë solide, atë të sektorit bankar, i cili brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohe ka arritur të sigurojë një zhvillim të shpejtë, por dhe të kujdesshëm. Ai ka arritur të ndërtojë profilin e tij profesional, të shëndoshë financiarisht dhe të mirë-kapitalizuar, duke i ofruar klientelës shërbime dhe produkte të ndryshme bankare e financiare, që nga ato tradicionale, si: kredia për biznes, strehim e konsumatore, e deri tek kartat elektronike dhe *e-banking*. Shtylla tjetër, ajo e sektorit financiar jobankar, mbetet ende në periudhën paramoderne të zhvillimit dhe me mungesa të theksuara të institucionalizimit të veprimtarisë së saj, ku më e spikatura është mungesa një burse aktive letrash me vlerë.

Modeli i zhvillimit ekonomik të ndjekur nga Shqipëria përngjason me atë të shumë vendeve në zhvillim, dhe është thelbësisht një model i propozuar nga organizma ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore (BB), e cili e ka vënë dukshëm dhe gjithnjë theksin vetëm në rolin e institucioneve financiare të zhvillimit dhe sistemin bankar.

Bazuar në këtë model, deri në vitet e fundit zhvillimi dhe promovimi i institucioneve financiare jobankare kishte mbetur në hije dhe jashtë vëmendjes, duke u fokusuar veçanërisht në parimin e ndërmjetësimit bankar, pa i kushtuar vëmendje rrezikut të

ndërmjetësimit të tepërt dhe kryesisht nivelit të lartë të raportit huamarrje (borxh) ndaj kapitalit aksioner. Nga ana tjetër, historia ekonomike dhe praktika ndërkombëtare ka vënë në dukje se, problemet ekonomike në një vend të caktuar dhe huamarrja e tepruar nga ana e firmave, e kanë vendosur ekonominë e atij vendi përballë rrezikut të kombinimit të nivelit të lartë të borxhit afashkurtër me nivelin tepër të ulët të kapitalit aksioner afatgjatë. Në këto kushte, përvojat e kaluara dhe ato aktuale kanë treguar se pjesa dërrmuese e vendeve në zhvillim kanë nevojë për një gamë dhe larmi më të madhe institucionesh e instrumentesh, sesa ato që mund të ofrohen përmes sistemit të bazuar vetëm në banka.

Nxitja dhe promovimi i pak njësive financiare të mëdha është joproduktiv dhe rezultati është krijimi i disa institucioneve shumë të pushtetshme dhe i një sistemi financiar me pak konkurrencë. Ashtu siç u përmend dhe më lart në kuadër të rritjes së shpejtë të kredive me probleme gjatë 2009, modelimi i sistemit financiar shqiptar thajse plotësisht vetëm me profil bankar, i ka përqendruar thajse të gjithë rreziqet e mundshme brenda sistemit bankar, duke kontribuar në instalimin e një rreziku të përhershëm sistematik, pa asnjë lloj mundësie diversifikimi mbi baza individuale apo tregjesh.

Promovimi i konkurrencës brenda sistemit financiar mund të jetë diçka e vështirë, por që mund të kapërcehet nëpërmjet shtimit dhe futjes së instrumenteve dhe produkteve të rinj financiarë, ku publiku të mund të investojë. Nga ana tjetër, një rol shumë të madh këtu mund të luajnë dhe tregjet e parasë dhe ato të kapitalit, pasi ato sigurojnë dhe lejojnë një numër më të madh pjesëmarrësish dhe një lehtësi më të madhe hyrjeje në treg.

Në këtë optikë, është shumë i rëndësishëm fakti se duhet t'u kushtohet e njëjta rëndësi të dy shtyllave të sistemit (tregut) financiar, pavarësisht nga kontributi sasior në angazhimin e mjeteve dhe burimeve kombëtare: sektorit bankar dhe atij jobankar me epiqendër bursën (tregun) e organizuar të letrave me vlerë. Është më se e faktuar që zhvillimi në veçanti i segmenteve të ndryshme brenda sistemit financiar nxit segmentet e tjera brenda këtij sistemi për futjen e produkteve të reja, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe efencën operacionale, si dhe për uljen e kostove dhe të çmimeve të produkteve. Kjo, nga ana e saj, nënkupton rritje dhe përmirësim të ecurisë së segmentit (sektorit) tjetër, duke siguruar kështu një nivel të kënaqshëm konkurrence sektoriale midis operatorëve që veprojnë në sektorët përkatës. Të dy sektorët duhet të zhvillohen në mënyrë simbiotike dhe duhet të kuptohet se tregu i letrave me vlerë dhe zhvillimi i tij nuk duhet konceptuar vetëm si konkurrent i tregut (sektorit) bankar, por edhe si plotësues të njëri-tjetrit⁵⁹. Praktikisht ato ofrojnë shërbime të ndryshme financiare për publikun, por harmonikisht plotësuese. Zhvillimi i sektorit bankar (i matur si raport i huave bankare për sektorin privat ndaj PBB) dhe prania e një burse likuide kapitalesh janë parashikuese të mira të rritjes ekonomike, të akumulimit të kapitalit dhe të rritjes

59 *World Bank Policy Research Working Paper: "Finance for Growth: Policy Choices in a Volatile World", May 2001.*

së produktivitetit⁶⁰.

Në këtë mënyrë, mbetet imperativ i kohës që të zhvendoset fokusi nga konkurrenca brenda sektorit bankar në atë brenda sistemit financiar, d.m.th midis institucioneve që grumbullojnë depozita nga njëra anë, dhe institucioneve financiare jobankare, nga ana tjetër, si e vetmja lloj konkurrence që siguron zhvillimin e një sistemi financiar të baraspeshuar dhe mirë-funksionues.

Ekzistenca institucionale e bursës së kapitaleve në një ekonomi nuk mund të kushtëzohet nga krizat ekonomike e financiare që shpërthejnë pashmangshmërisht në momente të caktuara, por nga nevoja dhe faktorë shumë madhorë e strategjikë që lidhen me:

- sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike;
- shpërndarjen burimeve të financimit dhe sigurimin e financimeve afatgjata për investime në ekonominë reale;
- mobilizimin e kursimeve;
- uljen e kostos së kapitalit për biznesin;
- promovimin e fleksibilitetit dhe novatorizmit në drejtim të përdorimit të teknologjisë dhe instrumentet financiare;
- diversifikimin e rreziqeve brenda sistemit financiar dhe ekonomisë;
- lehtësimin e tregtimit të instrumenteve financiare;
- lehtësimin e shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve, etj.

Kriza financiare dhe ekonomike globale dhe shkaqet që e iniciuan atë sigurisht që ka ndërgjegjësuar autoritetet rregullatore të tregjeve kryesore të kapitalit në botë të iniciojnë reforma të thella rregullatore me synim evitimin e katastrofave financiare të përmasave të tilla. Këto masa synojnë pikërisht sjelljen brenda kornizave të tregtimit standard në bursa të thuajse të gjithë instrumenteve derivate dhe forcimit të rolit mbikëqyrës e rregullator të vetë tregjeve të kapitaleve, si platformat e vetme ku mund të sigurohet transparencë për publikun dhe investuesit.

Kjo nismë mbarëbotërore përforcon dhe më shumë idenë dhe mendimin shumëvjeçar profesional se, nëse kërkojmë një ekonomi që të sigurojë ritme të qëndrueshme rritje dhe të zhvillohet larg rreziqeve të sistemit (financiar), ajo duhet të zhvillohet mbi shina institucionale të mirë-rregulluara dhe të mbikëqyrura më së miri. Padyshim që një nga shinat do të ishte dhe aktivizimi i bursës, ndonëse roli i saj do të jetë më modest se ai i sistemit bankar.

Personalisht mendojmë se e ardhmja e Bursës në Shqipëri, përveçse premtuese, nuk mund të jetë kurrësi fatale. Natyrisht çdo gjë kërkon kohën e saj, por çdo gjë e ka një kohë dhe moment fillestar në të cilën ajo fillon!

60 Levine, Ross and Zervos, Sara: *"Stock Markets, Banks, and Economic Growth"*, f.4.

Tregu i kapitaleve në Shqipëri, nevoja për një bursë të re me kapital privat

_____**Artan Gjergji MA**_____

Universiteti European i Tiranës

_____**Enkela Idrizi, MBA**_____

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT. *Pavarësisht zhvillimit të sistemit financiar në një shkallë të konsiderueshme, sektori bankar mbetet ende pjesa më e zhvilluar e sistemit financiar në Shqipëri. Në anën tjetër, vendi ka një sektor jobankar, ende në hapat e para të zhvillimit me nën-sektorë, të cilët nuk kanë të njëjtin ritëm zhvillimi. Një ndër ta, tregu i kapitaleve, mbetet tregu më pak i zhvilluar, edhe pse gjatë dekadës së fundit janë hedhur disa hapa kryesisht në drejtim të krijimit të infrastrukturës ligjore dhe institucioneve themelore të nevojshme për zhvillim. Megjithatë, këto përpjekje nuk kanë mundur të konkretizohen me zhvillimin e tregut dhe gjetjen e rrugëve që biznesi ta përdorë Bursën e Tiranës si një alternativë të mundshme financimi. Ky studim është një përpjekje për të parë mundësitë e zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri, duke marrë parasysh edhe shkaqet e mosfunksionimit deri më sot të këtij tregu. Në fund, arrihet në përfundimin se tashmë ka ardhur koha e përshtatshme për zhvillimin e këtij tregu në Shqipëri dhe krijimin e një burse me kapital privat, duke sjellë argumente për të gjithë faktorët që çojnë në këtë përfundim, por edhe duke parashtruar risqet dhe sfidat, që duhen marrë në konsideratë për ta bërë këtë iniciativë sa më të suksesshme.*

Hyrje

Shqipëria është i vetmi vend në rajon, që ka një treg kapitalesh të pazhvilluar dhe një *bursë virtuale*, krijimi i të cilës daton që prej 14 vjetësh. Edhe pas më shumë se një dekade, që nga hapja zyrtare e saj, Bursa e Tiranës (BT) ende është në pritje të listimit të kompanisë së parë. Për këtë arsye natyrisht lind pyetja: a

i nevojitet ekonomisë shqiptare një bursë letrash me vlerë dhe a do të ketë ekonomia shqiptare një treg kapitalesh të zhvilluar e një bursë funksionale? Natyrisht për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet identifikuar qartë se cila është rruga dhe strategjia që duhet përshtatur për këtë qëllim dhe cili është roli i Qeverisë apo i aktorëve të tjerë në këtë rrugë të vështirë, por jo të pamundur?!

Pavarësisht zhvillimit të kënaqshëm të sistemit financiar në Shqipëri, sektori bankar ende mbetet pjesa më e zhvilluar e tij. Në anën tjetër, vendi ka një sektor jo-bankar, ende në hapat e para të zhvillimit me nën-sektorë, të cilët nuk kanë të njëjtin ritëm zhvillimi. Një ndër ta, tregu i kapitaleve, mbetet tregu më pak i zhvilluar edhe pse gjatë dekadës së fundit janë hedhur disa hapa në drejtim të krijimit të infrastrukturës ligjore dhe institucioneve themelore, të nevojshme për zhvillim. Megjithatë, këto përpjekje nuk kanë mundur të konkretizohen me zhvillimin e tregut dhe gjetjen e rrugës, që biznesi të përdorë Bursën e Tiranës, si një alternativë të mundshme financimi.

Ky punim synon të japë, në mënyrë të përmbledhur, një pikturë të plotë, aktuale, të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe Bursës së Tiranës, në veçanti; është një përpjekje për të parë mundësitë e zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri, duke marrë parasysh edhe shkaqet e mosfunksionimit. Në fund arrihet në konkluzionin se tashmë ka ardhur koha e përshtatshme për zhvillimin e tregut të kapitalit dhe krijimin e një burse me kapital privat.

1. Përmbledhje e Përgjithshme e Zhvillimit të Ekonomisë Shqiptare dhe Sistemit Financiar të saj.

Progresi i Shqipërisë në fillim të viteve të tranzicionit ishte në një nivel të admirueshëm. Ashtu si të gjithë vendet, që kishin hyrë në procesin e gjatë e të mundimshëm të tranzicionit, Shqipëria u përball ndër të tjera edhe me një krizë ekonomiko financiare. Megjithatë, viti 1993 dhe e gjithë periudha pasardhëse shënojnë periudhën e implementimit të politikave të stabilitetit dhe rritjes ekonomike, liberalizimit të çmimeve, procesi i ngritjes së institucioneve, privatizimit të ekonomisë etj.⁶¹ Si rezultat, që nga viti 1998 ekonomia shqiptare është rritur vazhdimisht me një ritëm mesatar vjetor prej 7%. Përjashtim nga ky ritëm ka vetëm viti 2009, kryesisht për shkak të ndikimit që pati kriza botërore financiare mbi ekonominë shqiptare në tërësi.

Shqipëria trashëgoi nga ekonomia e centralizuar e sistemit komunist një sistem bankar të pazhvilluar. Pas viteve 90, përpjekje të mëdha u bënë në drejtim të zhvillimit kryesisht të sektorit bankar nëpërmjet krijimit të një banke të pavarur qendrore dhe disa bankave tregtare. Gjithashtu, një sërë reformash u ndërmorën edhe në drejtim të krijimit të sektorit financiar jo-bankar. Gjatë viteve 1995-1996 u hodhën hapa të rëndësishëm në drejtim të krijimit të tregut të kapitaleve në vend dhe institucioneve të tij, ndërsa sektori i sigurimeve filloi të zhvillohej vetëm pas viteve 1998.

Me mbështetjen e donatorëve, është bërë një punë e madhe në drejtim të krijimit

61 shih MeF, "Raporti Vjetor 2004"

të infrastrukturës juridike të nevojshme për të mundësuar funksionimin në mënyrë normale dhe eficiente të sistemit financiar. Kuadri rregullator është përmirësuar dhe vazhdon të jetë pjesë e ndryshimeve, si për sistemin bankar, ashtu edhe për atë jobankar. Megjithatë, duhet theksuar se fondet e donatorëve deri në ditët e sotme janë përqendruar më tepër në sektorin bankar se sa në sektorët e tjerë të sistemit financiar.

Meqenëse ky punim shfaq mundësitë e zhvillimit të një burse me kapital privat, në vijim do të fokusohemi vetëm tek sektori financiar jobankar dhe më specifikisht, në zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri.

2. Sektori Jobankar dhe Tregu i Kapitaleve

Pavarësisht shkallës së kufizuar të ndërmjetësimit dhe kapacitetit të shërbimeve financiare të ofruara nga bankat, sektori financiar jobankar në Shqipëri është më pak i zhvilluar se ai bankar. Ekzistojnë shumë sfida me të cilat duhet të përballet ky sektor, me qëllim që të zhvillohet në një të ardhme të afërt.

Momentalisht, pothuajse nuk ekziston një treg i mirëfilltë kapitalesh, ndërsa tregjet e parash dhe letrave me vlerë përbëhen vetëm nga emetimet primare e nga një treg shumë i ngushtë e aspak likuid sekondar (pothuajse inekzistent) për bonot e thesarit. Obligacionet e kompanive mungojnë totalisht në treg edhe pse që nga viti 2009 ka një ligj për to. Në ndryshim nga eksperiencat e vendeve të Evropës Lindore, procesi i privatizimit në Shqipëri nuk kaloi nëpërmjet tregut të kapitaleve, duke pakësuar shanset për krijimin e një oferte fillestare për letrat me vlerë në treg.⁶² E vetmja bursë e liçensuar nga rregullatorët nuk gjeti mbështetje nga institucionet financiare në vend, duke funksionuar vetëm juridikisht e jo operacionalisht. Ndërkohë, biznesi vendas nuk është i interesuar të përdorë bursën si një alternativë financimi për shkak të nivelit relativisht të lartë të informalitetit në ekonomi.

Industria e sigurimeve filloi të zhvillohej kryesisht pas liberalizimit të tregut në vitin 1999. Aktualisht në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin e tyre 10 kompani sigurimesh, 3 prej të cilave ofrojnë sigurimin e jetës. Vitet e fundit ky sektor është karakterizuar nga fluksi i kapitalit të huaj, i cili ka sjellë një zhvillim me hope relativisht më të larta. Sidoqoftë, ky sektor mbetet ende në faza jo shumë të kënaqshme të zhvillimit (*bazuar vetëm në disa produkte e shërbime të përgjithshme, ku dominon sigurimi i detyrueshëm i automjeteve*) dhe karakterizohet nga shumë probleme.

Viti 2006 shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të reformimit të mbikqyrjes dhe rregullimit të sistemit financiar jobankar, duke u finalizuar me krijimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF), si i vetmi institucion përgjegjës për liçensimin, mbikqyrjen dhe rregullimin e të gjithë aktivitetit që i përket sektorit financiar jobankar në Shqipëri.⁶³

62 Gjergji A. (2007), "Roli i Shtetit në Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Vendet e CEE", material diskutimi në "Studime mbi Tregjet e Kapitalit dhe Letrave me Vlerë", publikim i AATADA, Tiranë

63 shih AMF, "Raporti Vjetor 2006"

2.1. Tregu i Letrave me Vlerë

Shqipëria nuk ka pasur kurrë në historinë e saj një treg kapitalesh deri në vitin 1996. Fillimi i procesit të privatizimit solli edhe nevojën për krijimin e tregut të kapitaleve dhe hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor, çka u realizua me mbështetjen dhe asistencën teknike të konsulentëve të huaj si USAID dhe Fondi Britanik “Know-How”.

Gjatë kësaj kohe, në vitin 1995 u miratua ligji “Mbi Fondet e Investimeve në Bono Privatizimi”, u krijua Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA) dhe një vit më vonë, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin nr. 8080, dt. 01.03.1996 “Për Letrat me Vlerë” duke i hapur rrugën krijimit të Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) në Prill 1996 dhe Bursës së Tiranës (BT) në Maj 1996.

2.1.1. Tregjet dhe specifikat e zhvillimit të tyre

Tregu i letrave me vlerë dominohet nga tregtimi në tregun primar dhe atë sekondar të instrumenteve të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), ndërsa tregu i letrave me vlerë të aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar dhe i kufizuar kryesisht në tregun informal të aksioneve të kompanive, të cilat kryesisht ishin pjesë e procesit të privatizimit dhe që janë të regjistruara pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

Tregu i Kapitaleve

Tregu i kapitaleve mbetet ende pjesa më e pazhvilluar e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Ky treg përbëhet nga tregu zyrtar (Bursa e Tiranës) dhe tregu informal i transaksioneve mbi aksionet e shoqërive aksionere. Aktualisht, në Bursën e Tiranës nuk ka asnjë shoqëri të listuar dhe tregtimi i letrave me vlerë të Qeverisë në këtë treg është inekzistent.

Tregu informal i aksioneve është një treg i paorganizuar, i cili konsiston kryesisht në transaksionet e ekzekutuara mes aksionerëve të shoqërive të privatizuara. Ky treg vazhdon të jetë aktiv ndonëse nga viti në vit ka ardhur në rënie, për shkak të konsolidimit të pronësisë në shoqëritë e privatizuara.

Është vështirë të bëhet një vlerësim real i ecuresë së tregut informal të aksioneve në Shqipëri, kryesisht për shkak të mungesës së informacionit mbi çmimin e tregtimit të aksioneve, çka pengon në llogaritjen e treguesve realë të vlerësimit të këtij tregu. Gjithashtu, mungesa e informacionit mbi aktivitetin dhe pasqyrat financiare të këtyre kompanive lë shteg për një “*deformim*” të çmimeve në treg, duke lënë të pambrojtur investitorët e vegjël, zotërues të aksioneve të këtyre shoqërive.

Shkaqet e mosfunksionimit të Bursës së Tiranës

Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, Bursa e Tiranës (BT) nuk ka arritur të bëhet tërheqëse për biznesin vendas. Kjo ka ardhur për disa arsye, si: *a)* papjekuria dhe “frika” e biznesit për t’u listuar në BT; *b)* roli jo-mbështetës i politikave të ndjekura nga

Donatorët; c) mungesa e vullnetit politik për zhvillimin e BT.⁶⁴

Qeveria shqiptare mund të kishte bërë më tepër në drejtim të zhvillimit të tregut të kapitaleve nëpërmjet: **1) Listimit të ndërmarrjeve shtetërore në bursë**, duke përfshirë BT në privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, ashtu siç ka ndodhur në të gjitha vendet e Evropës Lindore që kanë ngjashmëri me Shqipërinë; **2) Caktimit të BT si “agjent” të Qeverisë për emetimin e letrave me vlerë të borxhit publik në tregun primar; dhe 3) Krijimit të incentivave nxitëse për kompanitë, që listohen në BT.**⁶⁵

Megjithëse ekzistojnë faktorë, që përbëjnë realisht një pengesë indirekte për afrimin e komunitetit të biznesit drejt tregut të kapitaleve dhe listimit në bursë, gjykojmë se këta indikatorë nuk përbëjnë problem për një numër relativisht të kënaqshëm (15-20) të kompanive të mëdha, që operojnë në vendin tonë.

2.2. Skemat Kolektive të Kursimit dhe Investimit

Është pak të thuash se Shqipëria nuk ka skema kolektive kursimi dhe investimi (SKKI). Në të vërtetë, me disa përjashtime të vogla, ky sektor i rëndësishëm i sistemit financiar pothuajse nuk ka ekzistuar fare deri në vitin 2005.

Fondet e Pensioneve - Sektori i pensioneve është kryesisht i bazuar në shtyllën e financuar nga shteti, ose siç quhet ndryshe Skema e Sigurimeve Shoqërore. Sistemi i pensioneve ka qenë pjesë e reformave dhe përmirësimeve të kuadrit ligjor e rregullator. Aktualisht, në Shqipëri operojnë tre fonde private pensioni, të cilët kanë një numër kontribuesish në nivele modeste. Mungon një strategji e qartë për zhvillimin dhe reformimin e sistemit të pensioneve në Shqipëri. Qeveria duhet të ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të nxitur zhvillimin e kolonës së dytë të pensioneve, si dhe mbështetur skemat vullnetare të pensioneve, duke ofruar incentiva legislative dhe fiskale për pjesëmarrësit e tregut.

Shoqëritë e Sigurimit të Jetës - Sigurimi i jetës është një produkt relativisht i ri në tregun financiar shqiptar. Kompanitë e para u krijuan vetëm pas vitit 2004, e për rrjedhojë produktet e para në lidhje me sigurimin e jetës filluan të hidheshin në treg vetëm vitet e fundit. Aktualisht në Shqipëri ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhjetë shoqëri sigurimesh, nga të cilat tre në sigurimet e jetës.

Fondet e Investimit - Zhvillimi i skemave të investimeve në Shqipëri është i lidhur ngushtë me procesin e privatizimit nëpërmjet bonove të privatizimit, i cili filloi në vitin 1995. Edhe pse në vitin 2009 është miratuar një ligj për fondet kolektive të investimeve, deri në ditët e sotme asnjë institucion i tillë nuk operon në vendin tonë. Ndër shkaqet kryesore të moszhvillimit të fondeve të investimeve në Shqipëri mund të përmenden: ekzistenca e një tregu të pazhvilluar kapitalesh dhe mungesa e instrumenteve financiare, ku mund të investonin këto fonde.

64 Shih Gjergji A. (2006), “Does Albania have a Developed Financial Market”, discussion paper, USAB publications, Bologna, Italy, http://www.usab-al.it/usab/images/punime-shkencore/artan_gjergji.pdf

65 Po aty.

2.3. Proçesi i Qeverisjes së Shoqërive Aksionere (corporate governance)

Shqipëria karakterizohet nga një kulturë relativisht e ulët e zbatimit të parimeve të qeverisjes së shoqërive aksionere.⁶⁶ Megjithatë, vihet re që vitet e fundit kanë filluar të gjejnë zbatim në kompanitë vendase disa prej parimeve kryesore, si: ndarja e pronësisë nga menaxhimi, publikimi në formë elektronike i rezultateve financiare etj.

Vitet e fundit ndihet një ndryshim në aspektin e tendencës për futjen dhe aplikimin në praktikë të parimeve të mirë-menaxhimit të shoqërive aksionere. Kështu, donatorë të rëndësishëm si IFC dhe CIPE kanë financuar projekte të ndryshme për prezantimin e këtyre parimeve para grupeve të ndryshme të interesit. Ndërkohë, në vitin 2010, është krijuar për herë të parë Instituti i Qeverisjes së Shoqërive Aksionere.

2.4. Infrastruktura Ligjore

Aktualisht në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator relativisht i mjaftueshëm për fillimin e funksionimit të tregut të kapitaleve dhe tregut të letrave me vlerë. Vlen të theksohet fakti se ky kuadër ligjor është i shoqëruar me një kuadër të mjaftueshëm rregullativ, i cili përbëhet nga Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore të AMF-së, rregullore të BSH-së, rregullore të BT-së dhe rregullore të QRA-së.

Përveç kuadrit ligjor dhe rregullativ që rregullon aktivitetin e letrave me vlerë në Shqipëri, ekzistojnë edhe një sërë ligjesh që rregullojnë momente dhe veprime, të cilat në mënyrë indirekte ndikojnë ose mund të ndikojnë në zhvillimin e tregut të kapitaleve apo atij të letrave me vlerë në vend, si baza ligjore mbi standardet e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, baza ligjore për privatizime strategjike dhe baza ligjore për regjistrimin e aksioneve të kompanive.

3. Nevoja për Zhvillimin e Tregut të Kapitaleve Vendas

3.1. Pse një Bursë e Re dhe pse me Kapital Privat?

Studiues dhe ekspertë të ndryshëm të fushës vlerësojnë se për krijimin dhe funksionimin e një tregu efektiv kapitalesh duhen plotësuar disa kriterë shumë të rëndësishëm, si stabiliteti politik dhe ai ekonomik, krijimi i institucioneve të tregut, niveli i zhvillimit të biznesit, ekzistenca e një kërkesë dhe oferte evidente për kapitale dhe letra me vlerë, etj.

Aktualisht, Shqipëria edhe pse nuk ka ende një treg të zhvilluar kapitalesh, plotëson një pjesë të konsiderueshme të këtyre kushteve dhe kriterëve. Pavarësisht këtij fakti të pamohueshëm, duhet thënë se shkalla relativisht e lartë e informalitetit,

66 Shih rezultatet e "Vëzhgim mbi qeverisjen e shoqërive aksionere në Shqipëri", Shoqata Shqiptare-Amerikane e Tregtisë dhe Zhvillimit (AATDA), 2007

që karakterizon biznesin vendas, por edhe mungesa e një vullneti të qartë politik për nxitjen dhe zhvillimin e këtij sektori kaq të rëndësishëm të ekonomisë së vendit, mbeten ende faktorët kryesorë që duhen marrë parasysh për një zhvillim të vullshëm të tregut të letrave me vlerë në vend.

Në vijim do të bëhet një përmbledhje e përgjithshme e kushteve që ofron tregu shqiptar për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe fillimin e aktivitetit të një burse letrash me vlerë.

3.1.1. Ambianti i përshtatshëm politiko-ekonomik

Shqipëria karakterizohet nga një stabilitet i qëndrueshëm politik.⁶⁷ Janë ndërmarrë reforma të rëndësishme në lidhje me përmirësimin e sistemit juridik, garantimin e një procesi të lirë dhe të drejtë elektoral, respektimin e të drejtave të njeriut, përsheptimin e procesit të decentralizimit të pushtetit lokal, si dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Klima e re pozitive që solli nënshkrimi i MSA-së dhe efektet e saj mbi ekonominë e vendit, të shoqëruara me reformat e ndërmarrë nga Qeveria, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

Oferta e letrave me vlerë

Ekziston një ofertë reale për kapitale në tregun vendas edhe pse jo e shprehur në mënyrë evidente. Është fakt që biznesi kërkon fonde për rritjen e tij, që të jetë më konkurrues karshi një ekonomie gjithnjë e më globale, më të hapur e më liberale. Tashmë sistemi bankar nuk është e vetmja zgjidhje, pasi shumë klientë (biznese) të mëdhenj të bankave i kanë ezauruar thuajse plotësisht kapacitetet kredimarrëse (sipas kufijve aktualë ligjorë të kreditimit nga ana e bankave) dhe pashmangshmërisht do të konsiderojnë shumë shpejt opsionin e përdorimit të alternativës së tregut të kapitaleve për financim.

Një tjetër aktor mjaft i rëndësishëm në tregun e letrave me vlerë është padyshim Qeveria Shqiptare. Kështu, ndër objektivat kryesorë të Ministrisë së Financave për periudhën kohore 2007 – 2009 evidentohet zhvillimi i tregut të letrave me vlerë të Qeverisë, nëpërmjet shtimit të instrumenteve, zgjatjes së afatit të maturimit dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.⁶⁸ Gjithashtu, Qeveria shqiptare mund të ndikojë në rritjen e ofertës së letrave me vlerë në treg, nëpërmjet kanalizimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të mbetura në pronësi shtetërore, nëpërmjet tregut të kapitaleve dhe të letrave me vlerë.

Një tjetër ofertues potencial i letrave me vlerë në tregun vendas në një të ardhme të afërt pritet të jetë pushteti lokal dhe biznesi privat. Miratimi i ligjit “Për huamarrjen e pushtetit vendor” dhe ligjit “Për emetimin e obligacioneve të shoqërive dhe pushtetit vendor” krijojnë të gjitha premisat për rritjen e ofertës së letrave me vlerë në treg me

67 Vlen të theksohet fakti se nuk ka patur zgjedhje të parakohshme që nga viti 1997 dhe për herë të parë që nga ndryshimi i regjimit komunist, në vitin 2005 ndodhi një rotacion i paqtë i pushtetit.

68 shih MeF, “Strategjia e Borxhit për vitet 2007 – 2009” dhe IMF, *Country Report*, July 2007

emetimin e instrumenteve të rinj financiarë, si ai i obligacioneve bashkiake apo atyre korporative.

Kërkesa e letrave me vlerë

Bazuar në të dhënat statistikore nga Banka e Shqipërisë, niveli i kursimeve në sistemin bankar ka një trend rritës nga viti në vit. Akumulimi i madh i likuiditeteve të tilla në bankat tregtare, shoqëruar me një kredidhënie jo elastike, ka detyruar këto të fundit (bankat) që të zgjedhin alternativën e rritjes së investimit të tyre në institucionet financiare jashtë vendit. Nga ana tjetër, sasia e parasë që ndodhet jashtë bankave, si dhe hyrja në treg e skemave kolektive të kursimit, si institutet private të pensioneve dhe shoqëritë e sigurimit të jetës, janë prova të pakontestueshme për një kërkesë ekzistente për letra me vlerë në Shqipëri.

3.1.2. Ekzistojnë institucionet e nevojshme për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë

Në tregun vendas të kapitaleve ekzistojnë ndërmjetësit financiarë të nevojshëm për të krijuar mundësinë e emetimit të letrave me vlerë, listimit të kompanisë emetuese në bursë dhe tregtimin e mëtejshëm të letrave me vlerë në tregun sekondar.⁶⁹ Përveç Bursës së Tiranës, si i vetmi treg i licencuar po i pa-testuar letrash me vlerë, operojnë edhe Qendra e Regjistrimit të Aksioneve, e cila ndër të tjera mundëson rregullimin e transaksioneve në aksione (rregullimi për letrat e borxhit të Qeverisë kryhet nga bankat e nivelit të dytë), si dhe disa firma të brokerimit të licencuara nga AMF.

Megjithatë, nuk duhet lënë pa përmendur fakti se interesi i bankave të nivelit të dytë ndaj zhvillimeve të tregut të letrave me vlerë nuk është i vogël. Kjo tregohet me pjesëmarrjen e tyre aktive në tregun e letrave të Qeverisë.

3.1.3. Mungon një treg efektiv për ballafaqimin e kërkesës dhe ofertës për kapitale

Pavarësisht kushteve relativisht pozitive në të cilën ndodhet zhvillimi ekonomik i vendit, është e rëndësishme të theksohet se ka ardhur koha për hedhjen e hapave të parë drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në vend. Mungesa e një tregu efektiv, i cili mundëson përputhjen e kërkesës dhe ofertës aktuale në treg për kapitale, ka penguar jo pak zhvillimin e ekonomisë së vendit me ritmet e merituar. Kështu, është rritur kostoja e financimit për subjektet që kërkojnë kapitale (biznesi, Qeveria), ndërsa investitorët potencialë (oferta) nuk kanë pasur alternativa të ndryshme investimi për diversifikimin e portofoleve apo vlerësimin më real të kursimeve të tyre.

Një vend në zhvillim si Shqipëria, me një ekonomi që rritet shpejt, shoqëruar me rritjen e kursimeve dhe kërkesës për financime, si nga sektori privat ashtu dhe nga ai shtetëror, kërkon fillimin sa më shpejt dhe jo shtyrjen, e procesit të zhvillimit të tregut të kapitaleve. Çdo shtyrje e këtij procesi nuk sjell asnjë lloj avantazhi, përkundrazi do të përbënte kosto të madhe oportune.

69 shih Gjergji A. (2004), "Biznesi Shqiptar dhe Financimi nëpërmjet Bursës", Revista MONITOR, 2004

Në këtë kontekst, është evident fakti që Bursa e Tiranës (BT), si i vetmi treg i organizuar letrash me vlerë i liçensuar nga AMF, nuk mund ta realizojë një mision të tillë, kryesisht për shkak të mungesës së një vullneti të qartë politik ndër vite për ta mbështetur në aspektin institucional dhe financiar zhvillimin e këtij institucioni.

Për këto arsye, ditë-ditës po përfordhet bindja se, tregu i kapitaleve në vend do të fillojë të zhvillohet vetëm me iniciativën private, duke aluduar në krijimin e një burse me kapital tërësisht privat nga biznese të interesuara për rritjen e kapitaleve të tyre nëpërmjet tregjeve financiare. Një rekomandim i tillë u dha edhe para disa viteve nga një mision i FMN-së, i cili deklaroi se BT duhet privatizuar ose duhet mbyllur.⁷⁰

3.1.4. Mundësia për një Bursë Pan-Shqiptare

Një tjetër argument shtesë për zhvillimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri është edhe faktori gjeopolitik aktual. Në një botë dhe ekonomi globale, ku koncepti i kufijve po humbet dita ditës, Shqipëria duhet parë nga investorët e huaj si një treg konsumi dy herë më i madh, sepse përveç shqiptarëve të Shqipërisë, në Kosovë jetojnë rreth 2 milionë shqiptarë, në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë jetojnë rreth 500 mijë banorë dhe disa mijëra të tjerë jetojnë në viset etnike shqiptare në Mal të Zi, duke e kthyer këtë zonë të Ballkanit Perëndimor në një treg potencial me mbi 7.5 milionë banorë.

Parë në këtë këndvështrim, kushdo që mendon të investojë në drejtim të zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri, duhet të marrë parasysh këtë faktor, i cili do jetë shumë pozitiv në drejtim të rritjes së kërkesës dhe ofertës për letra me vlerë në këtë treg.

4. Strategjia e rekomanduar

Në të gjitha rastet dhe opsionet e mundshme të zhvillimit të tregut të kapitaleve dhe bursës në Shqipëri, investorët që do marrin përsipër realizimin e një projekti të tillë duhet të kenë një strategji të qartë ku të merren parasysh një sërë faktorësh.

4.1. Elementët fundamentalë për suksesin e një burse në Shqipëri

Duke marrë parasysh eksperiencën jo të suksesshme të BT-së është shumë i rëndësishëm faktori i krijimit të besimit në tregun shqiptar të letrave me vlerë mbi suksesin e një projekti për krijimin e një burse letrash me vlerë. Me qëllim garantimin e një procesi të suksesshëm, konsiderohet shumë e rëndësishme ekzistenca e kushteve të tilla si vijon:

- Besueshmëria e Investitorit Strategjik dhe e partnerit lokal,
- Të qënurit “*të parët*” në treg (e para bursë funksionale),

70 shih “Albania: Financial System Stability Assessment – FSSA”, IMF Country Report, August 2005

- Pajisja me një Sistem Elektronik Tregtimi për transaksionet,
- Sjellja e një “shembulli të mirë” si kompani e parë e listuar, si dhe
- Ndërmarrja e një fushatë të fuqishme marketingu.

4.2. Opsionet dhe Modeli i Rekomanduar

Konkretisht, dy janë opsione:

4.2.1. Krijimi i një burse të re dhe përthithja e Bursës së Tiranës

Sipas opsionit të parë, investitori strategjik dhe partnerët e tij lokalë ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për krijimin e një burse të re me kapital krejtësisht privat. Gjatë këtij procesi, investitorët strategjikë duhet të jenë në kontakte të vazhdueshme me entin rregullator në Shqipëri, AMF, si dhe nevojiten negociata në nivel politik me institucionet respektive qeveritare. Zgjidhja do të ishte negociimi me qeverinë Shqiptare për përthithjen e BT-së nga bursa e re me kapital privat, kundrejt një çmimi të negociueshëm për palët.

4.2.2. Privatizimi që në fillim i Bursës së Tiranës

Investitorët strategjikë mund të kërkojnë që të privatizojnë fillimisht bursën BT, e cila ka marrë një licensë të përhershme në vitin 2007. Privatizimi i BT, do ishte politikisht më i pëlqyer nga qeveria shqiptare se sa një mbyllje e këtij institucioni. Megjithatë, BT mbetet një treg krejtësisht jashtë standardeve dhe kërkesave të tregjeve financiare bashkëkohore. Për më tepër, në këtë treg nuk asnjë kompani apo letër me vlerë të listuar dhe aftësia e saj funksionale nuk është testuar asnjëherë.⁷¹

I vetmi avantazh pozitiv në privatizimin e BT-së do të ishte fitimi automatikisht i licensës së zotëruar nga ky institucion, duke shkurtuar një kohë relativisht 1 vjeçare të procesit të aplikimit për marrjen e një licensë përfundimtare. Gjithashtu, një faktor tjetër negativ në ndjekjen e këtij opsioni është edhe imazhi relativisht “negativ”, që ka përcjellë mos-suksesi i BT-së, çka bën që investitorët strategjikë të punojnë shumë në drejtim të ndryshimit të perceptimit që ka emri i këtij institucioni, në tregun aktual.

4.2.3. Opsioni i Rekomanduar

Duke marrë parasysh dy opsionet e mësipërme, gjykohet se më i përshtatshëm është opsioni i parë i krijimit të një burse të re, pasi do të sillte një imazh krejt të ri dhe krejt bashkëkohor në tregun vendas, do të sillte standardet dhe teknologjinë më të fundit të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare, duke ndihmuar në krijimin e një perceptimi të lartë besueshmërie tek publiku investitor dhe komuniteti i biznesit vendas. Gjithashtu, hyrja në treg si një bursë e re do t’u jepte mundësinë investitorëve

⁷¹ Me përjashtim të disa letrave me vlerë të borxhit mes viteve 1996–1998, kur BT ishte departament i Bankës së Shqipërisë.

strategjikë të shfrytëzonin avantazhin e “të qënurit të parët”.

Proçesit i përthithjes së BT-së, gjykohet se mund të ishte një hap i dyte, i cili duhet të shoqërojë shumë shpejt krijimin e një burse me kapital privat. Më tepër se një investim me përfitim, kjo përthithje duhet konsideruar si një mundësi për të përfshirë shtetin shqiptar në këtë projekt.

4.2.4. Ofrimi i shërbimit të Pastrimit dhe Rregullimit të Llogarive

Investitorët që duan të hapin një bursë me kapital privat, duhet të shikojnë mundësitë e ofrimit të të gjithë paketës së shërbimeve financiare. Parë në këtë këndvështrim dhe nisur nga trendet më të fundit në industrinë financiare, gjykohet me vend konsolidimi i shërbimeve financiare, që duhet të ofrohen dhe që kanë lidhje me të gjithë proçesin e tregtimit të letrave me vlerë (*para-tregtimit, tregtimi, pastrimi dhe rregullimi i llogarive*). Ky model, do të reduktojë kostot dhe rreziqet operacionale, si dhe do t'i sjellë të ardhura të mira sipërmarrjes së bursës së re të letrave me vlerë.

4.3. Identifikimi i Kërkesës dhe Ofertës për Letra me Vlerë

Menjëherë pas marrjes së liçensës paraprake nga AMF, bursa e letrave me vlerë mund të fillojë fushatën e saj të marketingut ndaj grupeve të interesit. Takime shumë intensive duhen realizuar me grupe të ndryshme shoqërore, por kryesisht duke u fokusuar më tepër me subjektet potenciale për t'u listuar në bursë, si dhe me ndërmjetësit financiarë, të cilët mund të jenë edhe anëtarët e parë të saj.

Si pjesë e identifikimit dhe sigurimit të ofertës së letrave me vlerë, bursa e re do të ketë katër mundësi të ndryshme:

1. Listimi i kompanive shqiptare, të cilat i plotësojnë kushtet cilësore dhe sasiore;
2. Negocimi me Qeverinë për privatizimin me anë ofertës publike dhe listimit në bursë të një pakete aksionesh të një kompanie në pronësi shtetërore;
3. Listimi i një kompanie të huaj, e cila operon në Shqipëri, por që është e listuar (*jo domosdoshmërisht*) në bursën e vendit të origjinës;
4. Listimi i instrumenteve të borxhit publik (*bono thesari dhe obligacione*) dhe sensibilizimi i publikut, nëpërmjet një fushate të fuqishme marketingu, për të nxitur tregun sekondar të këtyre instrumenteve.

4.4. Negocimi në nivel politik dhe teknik për mbështetje reale

Pavarësisht kushteve mjaft pozitive për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe krijimin e një burse letrash me vlerë, gjykohet se është i një rëndësie të veçantë bashkëpunimi i ngushtë dhe negocimi në nivel politik dhe teknik me autoritetet vendase. Kjo duhet bërë në vazhdimësi dhe pavarësisht faktit që bursa do të jetë me kapital privat, gjithmonë duhet përpjekur të sigurohet mbështetja e tyre për shkak se tregu i kapitaleve është një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomive emergjente, siç është Shqipëria.

Negocimi në Lidhje me Përthithjen e Bursës së Tiranës

Është shumë e rëndësishme që investitori strategjik të negociojë intensivisht në lidhje me mënyrën dhe formulën e përthithjes së BT-së. Siç u tha edhe më lart, një lëvizje e tillë nuk i sjell asnjë vlerë të shtuar procesit të zhvillimit të tregut të kapitaleve. Madje, bursa e re do të detyrohet që të eliminojë imazhin jo të mirë që ka krijuar BT-ja në treg. Në anën tjetër, në rast të një konkurrence të ndershme në treg dhe në rast të vazhdimit të “*status-quo*”-së ku nuk do ketë ndonjë mbështetje reale nga Qeveria, BT nuk do i rezistojë konkurrencës së bursës private dhe automatikisht do jetë e destinuar të mbyllet.

Megjithatë, i vetmi shkak pse investorët strategjikë mund të ndërmarrin një lëvizje të tillë është përfshirja e Shtetit Shqiptar në këtë projekt ambicioz, duke i dhënë këtij të fundit të drejtën e përfaqësimit në organet drejtuese të këtij institucioni të rëndësishëm në zhvillimin e tregut financiar në vend. Ky opsion duhet të shfrytëzohet nga aksionerët e bursës së re, për të kërkuar nga Qeveria mbështetje për nxitjen e zhvillimit të tregut të kapitaleve.

Negocimi në Lidhje me Marrjen e një Pakete Aksionesh nga Proçesi i Privatizimit

Duhet negociuar me Qeverinë për shikimin e mundësisë së kanalizimit të procesit të privatizimit të paketave të kompanive shtetërore nëpërmjet ofertës publike dhe listimit në bursë. Duhet thënë se AMF ka qenë gjithmonë pro idesë së kanalizimit të procesit të privatizimit nëpërmjet tregut të kapitaleve.⁷²

Negocimi në Lidhje me Incentivat për Zhvillimin e Tregut të Kapitaleve

Një tjetër fushë shumë e rëndësishme ku bursa mund të kërkojë mbështetjen e Qeverisë është nxitja e industrisë së letrave me vlerë, nëpërmjet ofrimit të incentivave ligjore e fiskale. Bazuar në eksperiencat e vendeve të rajonit, Qeveria Shqiptare mund të ndërmarrë një sërë masash të caktuara, me qëllim nxitjen e këtij sektori, kryesisht në drejtim të:

- a) ***nxitjes së ofertës së letrave me vlerë*** – nëpërmjet detyrimit ligjor të subjekteve, që arrijnë kriteret të caktuara cilësore dhe sasiore të listohen në bursë, ose ofrimit të incentivave fiskale si përjashtimi nga taksat për një kohë të caktuar (*tax holidays*), apo reduktimi i nivelit të taksave (*tax reduction*) për kompanitë që listohen në bursë.
- b) ***nxitjes së kërkesës së letrave me vlerë*** – nëpërmjet detyrimit ligjor të ndërmjetësve financiarë, të tillë si skemat kolektive të kursimit, të anëtarësohen si tregtarë në bursë menjëherë sapo të marrin liçensën nga AMF, ose nëpërmjet ofrimit të incentivave fiskale për investorët e portofolit për përjashtimin nga taksat, apo reduktimin e nivelit të taksave mbi fitimet nga investimi në letra me vlerë për një kohë të caktuar.

Negocimi në Lidhje me Marrjen e Ekskluzivitetit të Proçesit të Pastrimit dhe Rregullimit të Llogarive për Transaksionet në Letrat me Vlerë

Negociatat për marrjen e “*ekskluzivitetit*” të procesit të pastrimit dhe rregullimit të llogarive për të gjitha transaksionet në letra me vlerë të ekzekutuara në tregje të ndryshme brenda vendit dhe kthimi në një “*depozitar qendror*” duhet bërë në një fazë të dytë.

72 shih KLV, “Raporti Vjetor 2005” dhe AMF, “Raporti Vjetor 2006”

5. Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

- Shqipëria ka një treg financiar asimetrik me një sektor bankar relativisht të zhvilluar dhe një treg jobankar në hapat e para të zhvillimit;
- Pavarësisht mosfunksionimit për më tepër se një dekadë të tregut të kapitaleve, tashmë janë pjekur kushtet për një zhvillim të këtij sektori në Shqipëri;
- Ekziston një kërkesë dhe një ofertë reale për letra me vlerë në tregun vendas;
- Ekziston kuadri i nevojshëm ligjor dhe rregullativ për nisjen e tregut të kapitaleve;
- Ekzistojnë institucionet e nevojshme për funksionimin e të tregut të kapitaleve në vend;
- BT nuk ka mundur të kthehet nga një koncept juridik në një institucion real për përballimin e kërkesës dhe ofertës për kapitale në vend;
- Ekonomia e Shqipërisë ka nevojë imediate për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe çdo vonesë e mëtejshme sjell një kosto reale...

Rekomandime

- Krijimi i një burse letrash me vlerë është një domosdoshmëri e pashmangshme për të mundësuar përputhjen e kërkesës dhe ofertës për kapitale në Shqipëri;
- Ndër opsionet e mundshme, rekomandohet krijimi i një burse të re me kapital dominues privat dhe nëse konsiderohet e nevojshme, të shikohet mundësia për përthithjen e BT-së;
- Për të qenë e suksesshme, bursa e re duhet të plotësojë disa elementë thelbësorë, si besueshmëria e investitorit strategjik, hyrja të parët në treg, sistem elektronik, nisja e punës me listimin e një kompanie serioze, e cila të jetë një “shembull i mirë”;
- Investitorët strategjikë duhet të shikojnë mundësinë për ofrimin e një procesi të integruar të tregtimit dhe pastrimit e rregullimit të llogarive për transaksionet e ekzekutuara në bursë (por jo vetëm). Kjo do të reduktonte rreziqet dhe kostot operacionale, si dhe do të rriste më tepër efencën e tregut;
- Sigurimi i instrumenteve të tregtimit përbën një sfidë për bursën e re, prandaj duhet bërë identifikimi i kërkesës dhe ofertës për letra me vlerë, duke kontaktuar me grupe të ndryshme, në mënyrë që tregtimi në bursë të fillojë menjëherë pasi kjo e fundit të ketë marrë licensën nga AMF;
- Negocimi në nivele politike dhe teknike është i nevojshëm dhe shumë i domosdoshëm për suksesin e kësaj iniciative. Nëpërmjet negociatave, investitorët strategjikë mund të gjejnë mbështetjen e autoriteteve vendore për një mbështetje reale të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në vend,
- Në një fazë të mëvonshme, duhet parë mundësia për zgjerimin e aktivitetit në rrafshin gjeopolitik në rajon, aty ku jeton popullsia me kombësi shqiptare si në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Krijimi i kësaj Burse Pan-Shqiptare do të ishte një faktor shumë pozitiv për zhvillimin e rajonit, si dhe do ta kthente tregun shqiptar të kapitaleve në një qendër të rëndësishme financiare në Ballkanin Perëndimor.

Literatura:

1. AATDA, (2007), “Vëzhgim mbi qeverisjen e shoqërive aksionere në Shqipëri”, Shoqata Shqiptare-Amerikane e Tregtisë dhe Zhvillimit, Tiranë
2. Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), “Raporti Vjetor 2006”, Tiranë
3. Gjergji Artan, (2007), “Roli i Shtetit në Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Vendet e CEE”, material diskutimi në “*Studime mbi Tregjet e Kapitalit dhe Letrave me Vlerë*”, publikim i AATADA, Tiranë
4. Gjergji Artan, (2006), “Does Albania have a Developed Financial Market”, discussion paper, USAB publications, Bologna, Italy, http://www.usab-al.it/usab/images/punime-shkencore/artan_gjergji.pdf
5. Gjergji Artan, (2004), “Biznesit Shqiptar dhe financimi nëpërmjet Bursës”, Revista Ekonomike MONITOR, Nr. 21 (124), Tiranë, dt. 02.06.2004, fq. 17 – 22
6. IMF, (2007), “Albania: Third Review Under the Three-Year Arrangement Under the Poverty Reduction and Growth Facility - Staff Report”, IMF Country Report No. 07/244, July 2007, International Monetary Fund, Washington, D.C. (2005),
7. “Albania: Financial System Stability Assessment - FSSA”, IMF Country Report No. 05/274, August 2005, International Monetary Fund, Washington, D.C.
8. Komisioni i Letrave me Vlerë (KLV), “Raporti Vjetor 2005”, Tiranë
9. Ministria e Financave (MeF), “Strategjia e Borxhit për vitet 2007 - 2009”, Tetor 2006, Tiranë
10. “Raporti Vjetor 2004”, Tiranë

Zhvillimet globale dhe tregu financiar në Shqipëri

____ Kreshnik BELLO, Dr _____

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti European i Tiranës

____ Ilia KRISTO, Prof. Dr _____

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

____ Edmond BELLO, MBA, Artur TEMO, MSc _____

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKTI. *Kriza e fundit financiare, e cila kulmoi në Shtator të vitit 2008, ishte vetëm fillimi i një krize ekonomike, e cila nga shumë ekonomistë konsiderohet si një nga krizat më të ashpra, me të cilën po përballen shumë vende sot. Globalizimi ka bërë të mundur rritjen e nivelit të jetesës në shumë vende në zhvillim, por nuk mundi të shmangë efektin domino të përcjelljes së krizës ekonomike, nga vendet më të zhvilluara deri te vendet në zhvillim apo të varfëra, të cilat shpresonin në mbrekullitë e sistemit kapitalist. Shqipëria është një nga vendet Europiane, i cili ende po e përballon krizen pa pasojë të theksuara ekonomike, për më tepër duke patur edhe një rritje ekonomike (vitin e kaluar). Sektori financiar (i cili ishte katalizatori i kësaj krize), nuk është i zhvilluar në të njëjtat nivele në Shqipëri, ashtu sikurse është i zhvilluar në vendet e botës perëndimore dhe kryesisht kjo dhe disa arsye të tjera, mund të kenë qenë shkaqet, se përse sistemi financiar në Shqipëri, nuk u godit me të njëjtin intensitet, me të cilin u goditën ekonomitë e tjera Europiane. Pikërisht këto çështje janë objekt i diskutimit të këtij artikulli.*

1. Kriza financiare dhe shkaqet e saj

Kriza ekonomike që bota përjetoi dhe vazhdon t'a përjetojë në disa pjesë të globit, filloi si një krizë financiare nga fundi i vitit 2007-të, dhe që kulmoi në Shtator të vitit 2008, me rënien e vlerave të produkteve financiare të shkëmbyeshme

në tregjet botërore. Procesi i globalizimit, i cili ka patur një shpejtësi dhe nivel të lartë zhvillimi në 20 vitet e fundit, përveç të gjitha avantazheve që i ka dhënë ekonomive në zhvillim, në këtë rast kontribuoi që kriza financiare të mund të transformohej në një krizë të plotë ekonomike, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe në çdo cep të botës. Ekonomia botërore, tashmë e ndërthurur si asnjëherë, po përjetonte recesionin e parë i cili kishte aftësinë t'i godiste pothuajse të gjitha ekonomitë e botës, në të njëjtën kohë.

Kriza filloi kur tregu i huave të shtëpive, për njerëz të cilët nuk duhej të kualifikoheshin për këto hua, pësoi një kolaps i cili shënoi edhe fundin e bumit në sektorin e ndërtimit dhe tregëtimit të shtëpive në SHBA. Pasi çmimi i shtëpive në SHBA kulmoi, natyrisht që do të vinte edhe rënia e tyre. Nga fillimi i vitit 2007-të, kur normat e interesit ishin planifikuar të ndryshonin, shumë familje në SHBA nuk ishin në gjendje për të paguar interesin e huasë së shtëpisë, dhe për rrjedhojë filluan të mos paguanin detyrimet e tyre ndaj bankave. Mospagesat e huasë nuk ishin raste të izoluar. Ato goditën në sektorin bankar si një efekt domino, i cili u përhap nga njëra bankë tek tjetra jo vetëm në SHBA, por në të gjitha ekonomitë e përparuara në botë. Rrjeti i produkteve derivative dhe produkteve të tjera të inxhinierisë financiare, të cilat ishin shumë komplekse për t'u kuptuar nga pikëpamja e funksionalitetit, qenë një nga shkaktarët kryesorë të krizës financiare, e cila kulmoi në shtator të vitit 2008 dhe që ishte e pamundur në atë kohë të ndalohej. Efektet e krizës financiare u ndien shumë shpejt në të gjitha ekonomitë botërore, duke i zhytur ato në recesion.

Transaksionet e huave midis bankave janë motori i një ekonomie. Ekonomia amerikane u zhyt në një situatë me zero likuiditet në treg, sepse bankat nuk po blinin produkte të bazuara në huatë e dhëna, dhe në të njëjtën kohë nuk po jepnin dhe merrnin hua prej njëra tjetrës. Kjo situatë e solli ciklin e kreditimit në ekonominë amerikane në një stop të pa precedent. Mungesa e besimit goditi sektorin bankar, për shkak se shumë institucione nuk po tregonin informacionin e vërtetë rreth përmbajtjes së produkteve të tyre financiare. Kreditimi i aktiviteteve ekonomike të shumëw bizneseve u bë problematik, dhe kur likuiditeti i duhur po mungonte, ekonomitë e botës filluan të jepnin shenjat e para të një recesioni ekonomik. Ndërthurja ekonomike botërore e cila kishte qenë një bekim për ekonomitë e përparuara dhe ato në rritje të shpejtë në botë, tashmë ishte kthyer në një rrjet të sigurt për përhapjen e krizës ekonomike në çdo cep të globit.

2. Zhvillimet ekonomike globale

Ekziston një debat tashmë nëse recesioni global ka përfunduar. Shumë analistë mendojnë se recesioni aktual do të zgjasë më shumë se recesionet e mëparshme. Mendimi se recesioni do të kishte përfunduar nga fundi i vitit 2009, tashmë është shumë i debatueshëm. Megjithatë ka një përmirësim në ekonominë botërore, ky përmirësim është konsideruar statistikor, sepse vetëm disa indikatorë po përmirësohen në krahasim me të njëjtët indikatorë të vitit 2008 dhe 2009. Ekonomia globale nuk

është kthyer ende në atë nivel të aktivitetit ekonomik të njëjtë me pikun e ciklit të fundit të biznesit, rreth 2 vite më parë. Ky reëesion është i pazakontë dhe po zgjat më shumë se reëesionet e mëparshme, me përjashtim të depresionit të madh të viteve 30. Ka disa të dhëna, të cilat sugjerojnë që reëisioni tashme ka përfunduar në verën e vitit të kaluar, por gjithsesi këto të dhëna nuk janë dhe aq bindëse dhe konkluduese.

Ka të dhëna të tjera, të cilat japin një pamje të kundërt me atë optimiste dhe për rrjedhojë analistët e kanë të vështirë të japin një opinion të saktë rreth debatit nëse reëisioni global ka përfunduar apo jo. Mospërputhshmëria e indikatorëve të cilët përcaktojnë nëse ekonomia është në ekspansion apo reëision është një nga argumentat kryesorë, në favor të këndvështrimit pesimist në lidhje me ekonominë. Mirëpo indikatorët kryesorë globalë po përforcojnë idenë se cikli i biznesit tashmë ka arritur në nivelin e tij më të ulët dhe se rritja ekonomike po avancon, edhe pse me ritme shumë të ulta. Pas gjashtë 3 mujorëve kontraktimi ekonomik të vazhdueshëm, një dysheme duket se është formuar verën e vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe, nga vera e vitit të kaluar deri në ditët e sotme, pjesa më e madhe e ekonomive botërore kanë kaluar në ekspansion.

Ky ekspansion ka krijuar disa ndarje të reja në ekonominë botërore dhe lëvizje të ekuilibrave ekonomikë në favor të vendeve aziatike. Ekonomitë e përparuara perëndimore po dalin nga thellësitë e reëisionit me një ritëm më të ngadaltë, krahasuar me ekonomitë e reja aziatike të Indisë dhe Kinës. Nëse ky trend vazhdon gjatë këtij viti dhe vitit 2010, atëherë ka të ngjarë që të ketë një riformatim të tregëtisë botërore midis lindjes dhe perëndimit. SHBA mbetet përsëri ekonomia më e madhe në botë, dhe përfaqëson rreth 23% të totalit të ekonomisë botërore. Ekspansioni i GDP-së për tre-mujorin e fundit të vitit 2009, ishte vetëm 0.1%. Edhe pse kjo shifër nuk ishte shumë premtuese, ishte e mjaftueshme për t'a nxjerrë ekonominë amerikane në zonën e rritjes, për herë të parë për më shumë se një vit reëisioni. Rritja ekonomike prej 1% në tre mujorin e parë të vitit 2010, e rregulluar me një shifër të inflacionit prej 2.6%, duket premtuese për ekonominë amerikane. Një gjë është e sigurtë. Ekonomia amerikane është në rrugën e saj të ekspansionit.

E njëjta pamje paraqitet edhe me partnerin kryesor të tregëtisë për SHBA-në, Kanadanë. Pas shtatë tre-mujorësh reëisioni të vazhdueshëm, Kanadaja arriti pikën e ulët të ciklit në verën e vitit të kaluar. Me dy tre-mujore ekspansioni Kanadaja është në rrugën e rritjes ekonomike për vitin 2010. Ekonomia kanadeze përfaqëson vetëm 2.26% të ekonomisë totale botërore. Eurozona mbetet problematike krahasuar me SHBA-në dhe Kanadanë. Të dhënat ekonomike për Eurozonën tregojnë dobësi të theksuar ekonomike, edhe pse pika më e ulët e reëisionit u arrit në verën e vitit 2009. Rruga e ekspansionit mbetet shumë e ngadaltë dhe me një shifër negative për tre-mujorin e fundit të vitit 2009, prej 3.1%. Shqetësimet për borxhet e disa prej shteteve anëtare janë një faktor me impakt negativ për ritmet e rritjes së ardhshme ekonomike.

Në krahasim me kthimin e vakët në ekspansion të ekonomive të përparuara perëndimore, ekonomitë aziatike kanë treguar një performancë mbresëlënëse. Ekonomia kineze e cila tashmë mban vendin e dytë në botë e matur nga vlera e

GDP-se, kaloi tetë tre-mujore kontraktimi të vazhdueshëm, por arriti pikën më të ulët më shpejt se mesatarja globale dhe po tregon rritje ekonomike me ritme të larta. Rritja ekonomike e tre-mujorit të fundit të vitit 2009 dhe tre-mujorit të parë të 2010, tregojnë për një rritje ekonomike në zonën dyshifrore. India e cila konsiderohet sot si demokracia më e madhe (si numër popullsie) botërore, ka patur një rritje ekonomike po aq impresionuese sa ajo e Kinës. Pas vetëm katër tre-mujorësh kontraktimi të vazhdueshëm, ekonomia indiane u kthye në rrugën e një ekspansioni të fortë në tre-mujorin e tretë, me 7.9% dhe 5.7% në tre-mujorin e fundit të vitit 2009. Parashikimet për vitin 2010 janë premtuese për ekonominë indiane, e cila që prej vitit 1997 ka njohur një rritje mesatare impresionuese prej 7%.

Ekonomitë e avancuara perëndimore të cilat më parë zotëronin rritjen ekonomike, po zhvendosen në vendin e dytë pas ekonomive të vendeve me GDP të lartë si Kina dhe India. Kjo pamje e re e krijuar në ekonominë botërore nuk pritet të jetë afatshkurtër. Ajo pritet të vazhdojë në ciklin e ri të biznesit. Për të patur një rritje të vazhdueshme, ekonomia botërore do të ketë nevojë për një motor të ri, i cili sipas parashikimeve të shumë analistëve mund të jetë Kina. Ekonomitë perëndimore, edhe pse po stabilizohen dhe janë në rrugën e përmirësimit, janë të ndjeshme ndaj shumë faktorëve me impakte negative, dhe për rrjedhojë kërkojnë mbështetje të vazhdueshme stimuluese. Edhe pse gjendja financiare është përmirësuar në këto ekonomi, ajo ende nuk është kthyer në normalitet. Sektori bankar mbetet akoma i pakapitalizuar mirë. Pozicioni i dobët financiar i familjeve dhe papunësia do të rezultojnë në nivele të ulëta të konsumit, edhe gjatë vitit 2010.

Dalja e shpejtë nga politikat stimuluese ekonomike mund të ketë të njëjtat pasoja negative, ashtu sikurse edhe dalja e vonëshme prej tyre. Një dalje e herëshme nga këto politika do t'a rënonte përmirësimin ekonomik të muajve të fundit, ndërsa një dalje e vonëshme do të shtronte rrugën për një krizë tjetër ekonomike globale të hershme. Edhe pse ekonomia botërore tashmë është në rrugën e përmirësimit, ajo ndodhet nën rrezikun e një krize të re ekonomike, "fara" e së cilës tashmë është hedhur me paketat fiskale stimuluese. Një krizë e cila do t'i kishte rrënjët e saj në borxhet sovranë, për shkak të paketave stimuluese, do të kishte një ndikim shumë negativ në ekonomitë e Eurozonës. Një situatë e ngjashme me atë çfarë mund të jetë një krizë e shkatuar nga borxhi sovran, paraqitet sot në Greqi. Edhe pse situata e krijuar në Greqi nuk vjen si rezultat i paketave stimuluese, por për shkak të shpenzimeve të pakontrolluara gjatë periudhës së ekspansionit, pasojat në Eurozonë gjatë një krize të borxhit sovran, do të jenë shumë herë më të larta, se ato me të cilat po përballlet Greqia sot.

3. Impakti i krizës globale në Shqipëri

Shqipëria ishte një nga vendet e vetme të Europës, e cila pati një rritje ekonomike në vitin 2009. Ekonomia shqiptare është vlerësuar të ketë patur një rritje ekonomike prej 4.0% në vitin 2009, e krahasuar kjo me një rritje më të lartë prej 7.9% në vitin 2008. Ajo i rezistoi valës botërore të recesionit, dhe pati një performancë të lartë krahasuar

më vendet e tjera të rajonit. Edhe pse sektori bankar ishte i kapitalizuar mirë gjatë vitit 2009, ekonomia shqiptare nuk u përball direkt më krizën ekonomike botërore. Mos ekspozimi në tregjet financiare ndërkombëtare, bëri që efektet e krizës ekonomike të përcilleshin me një intensitet të ulët dhe me vonesë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Europës dhe më gjerë. Githashtu politikat monetare të ndjekura në Shqipëri luajtën rolin e tyre në zbutjen e impaktit të krizës globale mbi ekonominë shqiptare.

Edhe pse në fund të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009, u ndie një lëkundje e lehtë në sistemin bankar për shkak të tërheqjes së depozitave nga klientët, sistemi bankar në Shqipëri ishte i qëndrueshëm dhe i konsoliduar mirë gjatë periudhës 2008-2009. Sektori financiar, i dominuar nga sistemi bankar, për rrjedhojë nuk pati lëkundje të forta dhe ekspozim direkt dhe të plotë ndaj katalizatorëve të krizës ekonomike globale. Përballja e krizës në sektorin financiar pa pasoja të rënda, dhe sistemi bankar i konsoliduar mirë, ishin baza për rritjen ekonomike në vend, gjatë këtij viti si edhe në vitin në vijim. Intensifikimi i huadhënies dhe rrjedha e kapitalit në rajon, pritet të mbështesë një rritje ekonomike prej 4% në Shqipëri, në vitin 2010. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i ekonomive botërore gjatë 2010 është një faktor tjetër, që do të ndikojë në performancën pozitive të ekonomisë shqiptare në periudhën kohore 2010-2011.

Gjatë 20 viteve të fundit ekonomia shqiptare është transformuar nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë, duke marrë si pikë reference ekonomitë e perparuara të BE-së. Do të duhet kohë për ekonominë shqiptare të transformohet plotësisht në një ekonomi të shëndoshë dhe solide tregu, ku bazat e sistemit prodhojnë mbështetje për mirëqënien e shoqërisë në tërësi. Sektori financiar i vendit, mund të konsiderohet si guri themelor i ekonomisë shqiptare. Edhe pse ka mungesë të theksuar në eksperiencë dhe zhvillim në nivele të larta, sektori financiar në Shqipëri ë përballoi mirë krizën ndërkombëtare ekonomike.

Ka shumë faktorë të cilët ndikuan në imunitetin e sektorit financiar në vend dhe për rrjedhojë në imunitetin e ekonomisë shqiptare nga kriza globale. Integrimi në nivele të ulta i sektorit financiar shqiptar me botën ndërkombëtare të financave, ndihmoi në imunitetin afatshkurtër të ekonomisë së vendit, por kjo mund të kthehet në disfavor të ekonomisë së vendit në periudhën afatgjatë, nëse vendi duhet të tërheqë investitorë të huaj dhe të rrisë mirëqënien e shoqërisë shqiptare në tërësi. Likuiditeti në vend është pjesërisht i ardhur nga reminitancat e emigrantëve, që jetojnë në ekonomitë e perparuara të botës, një faktor ky, i cili nuk mund të jetë mbështetës për ekonominë në periudhë afatgjatë.

Impakti i lehtë i krizës ekonomike globale, u shkaktua kryesisht nga mungesa e valutës në vend, e cila më parë vinte nga emigrantët shqiptarë, si edhe nga integrimi në një nivel jo të lartë i sektorit financiar të vendit në sektorin ndërkombëtar financiar. Bankat e nivelit të dytë të cilat tashmë janë në pronësi të investitorëve të huaj, përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të operacioneve të bankave mëmë, të cilat operojnë në ekonomitë e perparuara. Për shkak të masave të marra në ekonomitë e perparuara dhe likuiditetit të injektuar në sistemin financiar botëror, bankat mëmë nuk patën probleme për të mbuluar operacionet e tyre të vogla në tregun shqiptar. Ekspozimi

jo i plotë i ekonomisë shqiptare ndaj krizës globale, vjen edhe si rezultat i ekonomisë jo formale, e cila luan një rol në ekonominë shqiptare në tërësi. Sidoqoftë ekonomia jo formale po e humbet rëndësinë e saj dhe influencën e saj në ekonominë shqiptare, ndërsa Shqipëria po kërkon integrimin e saj në BE.

4. Reformimi i ekonomisë shqiptare

Edhe pse qeveritë shqiptare kanë ndërmarrë reforma të thella ekonomike në të shkuarën, për të transformuar ekonominë e vendit nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë, reforma të mëtejshme janë të nevojshme për ekonominë shqiptare, në mënyrë që të jetë në gjendje të shkojë në nivelet e ekonomive të BE. Shpejtësia, thellësia dhe shtrirja e reformave të nevojshme ekonomike, do të jetë një nga gurët themelorë të integritit të vendit në strukturat e BE. Integrimi i vendit mund të bëhet në dy platforma kryesore. E para është platforma politike dhe platforma e dytë është ajo ekonomike. Duke marrë në konsideratë platformën ekonomike, Shqipëria duhet të sjellë në nivelet e BE-së, të gjitha aspektet ekonomike të cilat janë relevante për zhvillimin e saj strategjik.

Një aspekt i rëndësishëm është krijimi i legjislacionit të duhur, për thithjen e investimeve të huaja (FDI) në Shqipëri. Edhe pse në 10 vitet e fundit investitorët e huaj kanë vendosur operacionet e tyre në Shqipëri, lehtësia për t'a bërë këtë sot, nuk është në të njëjtat nivele si ato të vendeve të BE-së. Kjo është shumë ngushtë e lidhur me funksionalitetin e tregjeve financiare në vend, për të dhënë kapitalin e duhur për mbështetjen dhe rritjen e FDI-ve në Shqipëri. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është përcaktimi i saktë i sektorëve strategjikë të ekonomisë shqiptare. Shqipëria do të jetë një pjesë integrale e BE-së në të ardhmen dhe për këtë arsye, i duhet të përcaktojë qartë sektorët strategjikë të ekonomisë, në përputhje me nevojat e BE-së në rajon.

Sektori energjitik ka prioritet në këtë periudhë, si më i rëndësishmi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë shqiptare, por ashtu sikurse edhe në ekonominë e avancuar të botës, pa një mbështetje solide nga një sistem i konsoliduar financiar, sektori energjitik, mund të zhvillohet por jo me kapacitete të plota. Gjithashtu, ekonomia e tregut të lirë që Shqipëria është duke u përpjekur për të ndërtuar sipas standarteve të BE-së, duhet të ketë në bërthamën e saj të drejtën e pronësisë. E drejta e pronësisë, dhe pikërisht ajo e pronësisë së tokës mbetet ende e pazgjidhur në Shqipëri. Investitorë potencialë të huaj dhe vendas, hezitojnë të investojnë në ato zona ku pronësia e tokës mbetet ende e pazgjidhur. Përsëri, krijimi i legjislacionit të nevojshëm dhe zbatimi i tij, është çelësi për zgjidhjen e të drejtës së pronësisë, në të gjithë aspektin e saj në Shqipëri.

5. Perspektiva e sektorit financiar

Sektori financiar në Shqipëri mund të konsiderohet si i pazhvilluar kur krahasohet me sektorët financiarë të ekonomive të zhvilluara të botës. Duke marrë në konsideratë faktin që në krye të sektorit financiar në Shqipëri janë bankat, sektori financiar është shumë i limituar në kapacitetet e veta dhe mbështetjen që ai mund të japë në

zhvillimin e ekonomisë së vendit për të arritur nivelet e ekonomive të vendeve të BE. Sektori financiar shqiptar mund të zhvillohet në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë është zhvillimi i institucioneve financiare, duke mos përfshirë këtu bankat, ndërsa drejtimi i dytë është zhvillimi i tregjeve financiare, të aftë për të mbështetur të gjitha transaksionet financiare që ndodhin në ekonomitë e përparuara të botës. Institucionet financiare janë kryesisht të përfaqësuara nga bankat në Shqipëri. Bankat e investimeve janë joekzistente përderisa nuk ka treg fizik dhe funksional të aksioneve dhe produkteve të tjera karakteristike të bankave të investimeve.

Kompanitë publike nuk ekzistojnë dhe procesi i lëshimit të letrave me vlerë është shumë i limituar. Zhvillimi i institucioneve financiare do të jetë më shumë përfitim për ekonominë shqiptare. Krijimi i fondacioneve të investimeve, do të rrisë mundësitë e investimeve për individët dhe investitorët institucionale, dhe në të njëjtën kohë do të rrisë mundësinë për fitime financiare, duke ndryshuar për mirë standartin e jetesës në vend. Gjithashtu, krijimi i fondacioneve funksionale të pensioneve, është një aspekt tjetër i zhvillimit të institucioneve financiare në Shqipëri. Pasiguritë e sistemit kapitalist ndihen më shumë në ekonomitë në zhvillim, sesa në ato të përparuara, që tashmë kanë arritur një nivel konsolidimi. Në këtë kontekst, forca e punës në Shqipëri nuk mundet më gjatë, të përballet me pasiguri në periudhën e pensionit, për shkak të mungesës së tanishme të institucioneve financiare si fondacionet e pensioneve.

Zhvillimi i tregjeve financiare është drejtimi i dytë kryesor i perspektivës së sektorit financiar në Shqipëri. Tregjet financiare në Shqipëri së bashku me institucionet financiare nuk janë të zhvilluar në nivelë të larta. Tregu i aksioneve të kompanive ekziston vetëm në letër dhe nuk ka treg fizik ku kompanitë ose produktet e tjera, të cilat prodhojnë likuiditet, të mund të shkëmbehen. Zhvillimi i një tregu financiar dominues në të gjithë rajonin, mund t'a shndërrojë vendin në një qendër financiare, duke tërhequr në të njëjtën kohë më shumë FDI. Gjithashtu likuiditeti i nevojshëm për aktivitetet ekonomike të bizneseve vendase për t'u zgjeruar, mund të sigurohet lehtësisht në tregjet financiare. Kjo do t'u krijojë investitorëve mundësinë për përfitime financiare, të cilat mund të krijohen vetëm nëpërmjet tregjeve financiare.

Përderisa ekonomitë e avancuara të botës tashmë kanë zhvilluar tregje dhe institucione financiare të avancuara, sektori financiar në Shqipëri mund të përfitojë shumë nga eksperiencat e tyre të shkuara dhe të sjellë praktikatat e tyre më të mira në vend, pa patur nevojë për të eksploruar, dhe në të njëjtën kohë duke shmangur eksperimentet në këtë sektor. Zgjidhje të gatshme mund të aplikohen në çuarjen përpara të institucioneve financiare në vend dhe në zhvillimin e tregjeve financiare, në nivelet e ekonomive të avancuara. Zhvillimi i sektorit financiar në vend, së bashku me sektorët e tjerë strategjikë të ekonomisë, është i rëndësishëm për integrimin ekonomik të vendit në strukturat e BE-së. Kjo mund të arrihet nëpërmjet kooperimit rajonal, apo nëpërmjet një konteksti më të gjerë, i cili merr në konsideratë nevojat e BE-së në rajon. Shqipëria ka vetëm përfitime nga zhvillimi i lartë dhe me standarte i sektorit financiar, i cili nëse menaxhohet në mënyrën e duhur do të rrisë mirëqënien e shoqërisë shqiptare.

Konkluzione

Kriza financiare e cila kulmoi në vitin 2008 dhe që shumë shpejt u transformua në një krizë të plotë ndërkombëtare ekonomike, i kishte rrënjët e saj në ngjarje dhe politika ekonomike të ndjekura vite më parë. Edhe pse ato dhanë rezultate pozitive në periudhë afatshkurtër, në periudhë afatgjatë rezultuan në një nga krizat më të forta ekonomike, me një aftësi unike goditëse duke i prekur pothuajse të gjitha ekonomitë botërore, në të njëjtën kohë. Pas një ekspansioni ekonomik prej më shumë se 15 vitesh, ekonomitë e përparuara të botës hynë në një recesion unik dhe më të gjatë krahasuar me recesionet e mëparshme, me përjashtim të depresionit të madh të viteve '30. Ndoshta kjo krizë po krijon një precedent të ri në zhvillimin e cikleve ekonomike dhe kohëzgjatjen e tyre. Në njërën anë mund të kemi periudha të gjata ekspansioni, në anën tjetër mund të kemi kriza të ashpra, të cilat kanë efekte ekstreme në ekonominë botërore.

Një precedent tjetër i shkaktuar nga kriza ekonomike globale, është edhe zhvendosja e ekuilibrave të tregtisë midis lindjes dhe perëndimit. Ekonomitë aziatike si ajo e Kinës dhe Indisë po zhvendosin fokusin ekonomik nga eksporti në ekonomitë e përparuara perëndimore, në konsumin domestik, për shkak të bazës së gjerë konsumatore. Ekonomia botërore ka nevojë për një motor të ri dhe ashtu sikurse është parashikuar nga shumë analistë, ky mund të jetë Kina. Do të duhet disa kohë derisa Kina të mund të jetë një lider i plotë i ekonomisë botërore, por ky fakt nuk mund të jetë lehtësisht i pranueshëm nga ekonomitë perëndimore dhe sidomos nga ekonomia amerikane.

Shqipëria ishte i vetmi vend në Europë dhe një nga vendet e pakta në botë, ekonomia e të cilit nuk u prek nga kriza financiare dhe për rrjedhojë globale. Faktorët e ndryshëm të cilët nuk lejuan ekspozimin e plotë të ekonomisë shqiptare ndaj goditjeve të mundshme të krizës ekonomike globale, duhen konsideruar si favorizues vetëm në aspektin afatshkurtër dhe jo atë afatgjatë. Këta faktorë mund të bëhen një pengesë e vërtetë për zhvillimin ekonomik të vendit në të ardhmen, dhe për rrjedhojë, në integrimin politik dhe ekonomik të vendit në strukturat e BE-së. Ekonomia shqiptare duhet të ndërtojë një bazë solide të sektorit financiar, duke marrë si pikë referimi tregjet financiare në ekonomitë e përparuara, dhe duke aplikuar eksperiencat më të mira të tyre. Zhvillimi i sektorit financiar në Shqipëri është një nga pikat kyçe mbi të cilën duhet të bazohet ekonomia e post-tranzicionit në Shqipëri.

Bibliografia

- Bank of Albania. 'Bank of Albania's Monetary Policy Instruments and Procedures for their Execution', Bank of Albania, <http://www.bankofalbania.org>
- Bernanke, B. (2007): 'Global Imbalances: Recent Developments and Prospects', Bundesbank Lecture, Berlin, September 2007
- Brochert, A. (2009): **'The Deflationary Trap, Desperate Times and Desperate Measures'** Investor Insight, <http://www.investorsinsight.com>

- European Bank for Reconstruction and Development. (2004): 'Spotlight on south-eastern Europe. An overview of private sector activity and investment', European Bank for Reconstruction and Development, June 2004
- Milne, A. and Wood, G.E. (2008): 'Banking Crises: Solutions Old and New', *Federal Reserve Bank of St. Louis Review* (Sept/Oct 2008): 526
- Shedlock, M. (2009): 'Krugman Says Inflation Is The Answer' The Market Oracle, <http://www.marketoracle.co.uk/Article17301.html>
- Taylor, J.B. (2007): 'Housing and Monetary Policy', Federal Reserve Bank of Kansas City, Jackson Hole Symposium, September 2007
- World Bank. (2009): 'Albania at a glance', World Bank, http://www.worldbank.org/data/countrydata/ag/alb_aag.pdf

Krijimi i tregut privat të pensioneve në Shqipëri. Sfidat, perspektivat

Naim Hasa

Drejtor i Përgjithshëm, CAPITAL, Instituti Privat i Pensioneve

MA. Ermela Kripa

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT. Sigurimi i shtetasve në kohën e pleqërisë është problem i çdo shoqërie. Në përcaktimin e nivelit të tyre ndikojnë dukshëm disa arritje, si niveli i ekonomisë, struktura demografike e popullsisë, interesi i individit për zgjidhjen e tyre, etj. Mbi këtë bazë, çdo vend ka ndërtuar sistemin e vet të Sigurimeve Shoqërore. Në kushtet kur ritmet e lindjes po bien dhe jetëgjatësia mesatare e njerëzve po zgjatet, numri i “popullsisë së tretë” (pensionistët), po rritet me ritme shumë më të shpejta se ritmet e rritjes së fuqisë punëtore. Në këtë kontekst, sistemi i vjetër i sigurimeve shoqërore – “Pay As You Go” (PAYG) i pensioneve, në themel të të cilit, qëndron parimi i solidaritetit dhe i vazhdimësisë së brezave (ideuar mbi 100 vjet më parë), po shkon gjithmonë e më shumë drejt pamundësisë për të plotësuar nevojat e “popullsisë së tretë”. Këto situata të reja, shtojnë sot para sistemit të sigurimeve shoqërore disa alternativa. Së pari, “A duhen reformuar sistemet ekzistuese “Pay As You Go” të pensioneve”? Nëse po, çfarë sistemi duhet vendosur – PAYG i modifikuar – Sistem pensionesh tërësisht private, apo një sistem i alternuar shumë kolonësh. Në kërkim të zgjidhjes së kësaj problematike, organizma ndërkombëtare, të tillë si F.M.N., Banka Botërore, .I.L.O.etj, orientuan për ndërmarrjen e një reforme të përgjithshme të pensioneve, tashmë në kushte të reja. Në themel të kësaj reforme qëndronte ndërtimi i një sistemi të Alternuar (shumë kolonësh), i cili do të kombinonte më mirë pjesëmarrjen financiare në fondin e pensioneve të sistemit të vjetër shtetëror të parimit të solidaritetit PAYG, me sistemin privat të përgjegjshmërisë së individit për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve sociale. Qëllimi i këtij artikulli është që të mund të tregojë se e ardhmja e zhvillimit të sistemit të pensioneve dhe e rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tij, edhe në Shqipëri, është e lidhur me fuksionimin e skemave private të pensioneve.

Fjalët kyçe:

sistemi i pensioneve, tregu privat i pensioneve, sigurimet shoqërore.

1. Hyrje

Sigurimi i shtetasve në kohën e pleqërisë është problem i çdo shoqërie. Në përcaktimin e nivelit të tyre ndikojnë dukshëm disa arritje, si niveli ekonomisë, struktura demografike e popullsisë, interesi i individit për zgjidhjen e tyre, etj. Mbi këtë bazë, çdo vend ka ndërtuar sistemin e vet të Sigurimeve Shoqërore.

Sot ne botë, veprojnë disa sisteme të sigurimeve shoqërore, por gjatë shekullit XX mbizotëruese ka qenë sistemi “Pay As You Go”, i cili mbështetet në parimin e solidaritetit dhe të vazhdimësisë së brezave dhe në kushtet e një popullsie të re e kryen mirë misionin e tij.

Por, shekulli i XXI ka shtruar para njerëzimit një sërë sfidash të reja me të cilat ai duhet të përballë. Në kushtet kur ritmet e lindjes po bien dhe jetëgjatësia mesatare e njerëzve po zgjatet, numri i “popullsisë së tretë” (pensionistët), po rritet me ritme shumë më të shpejta se ritmet e rritjes së fuqisë punëtore. Në këtë kontekst, sistemi i vjetër i sigurimeve shoqërore – “Pay As You Go” (PAYG) i pensioneve, po shkon gjithmonë e më shumë drejt pamundësisë për të plotësuar nevojat e “popullsisë së tretë”.

Këto situata të reja, shtrojnë sot para sistemit të sigurimeve shoqërore, disa alternativa. Së pari, “A duhen reformuar sistemet ekzistuese “Pay As You Go” të pensioneve”? Nëse po, çfarë sistemi duhet vendosur - PAYG i modifikuar - sistem pensionesh tërësisht private, apo një sistem i alternuar me shumë skema (kolona)?

Shumë vende Evropiane, gjatë fillimit të viteve ‘90-‘95 kaluan një periudhë, e cila u shoqërua me mjaft probleme për sistemin shtetëror të Sigurimeve Shoqërore. Fillimisht këto vende filluan të modifikojnë sistemin ekzistues, duke ruajtur ekuilibrat financiarë, nëpërmjet rishikimit të kontributeve dhe ngritjes së moshave të pensionit. Por në fakt, gjatë zbatimit, këto reforma hasën në mjaft devijime. Ato jo vetëm nuk sollën një përmirësim të situatës, por në mjaft raste thelluan më shumë kontradiktat midis brezave, duke mbingarkuar brezin e ri.

Në kërkim të zgjidhjes së kësaj problematike, organizma ndërkombëtare, të tillë si F.M.N., Banka Botërore, I.L.O. etj, orientuan për ndërmarrjen e një reforme të përgjithshme të pensioneve, tashmë në kushte të reja. Në themel të kësaj reforme qëndronte ndërtimi i një sistemi të Alternuar (shumë kolonësh), i cili do të kombinonte më mirë pjesëmarrjen financiare në fondin e pensioneve të sistemit të vjetër shtetëror të parimit të solidaritetit PAYG, me sistemin privat të përgjegjshmërisë së individit për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve sociale.

“...Ne vitin 1994, Banka Botërore organizoi në Madrid një takim me temë “Politika për përballimin e rritjes së moshës së popullsisë”. Në këtë periudhë ishte rasti të hapej një debat i gjerë për riorganizimin e sistemeve të pensioneve. Pikërisht në këtë takim, u hodh edhe idea e sistemeve shumë-kolonëshe. Kështu, Banka Botërore, orientoi

ndërtimin e sistemeve shumë-kolonëshe sisteme, të cilat me kalimin e kohës do t'i linin vendin njëri – tjetrit, por në shumicën e rasteve, do të kishte edhe alternime mes atij paraardhës, me atë pasardhës. Kështu, ky sistem, krahas **kolonës së parë**, që do të mbetej si kolona kryesore e politikës sociale, e cila ka të bëjë me sistemin publik të pensioneve, e ndërtuar sipas parimit **pay-as-you-go**, e cila vepron aktualisht pothuajse në të gjithë vendet e botës, më i zhvilluar në Evropë, u dhanë idetë e ndërtimit të kolonave të tjera, si;

- Kolona e dytë, që është një sistem i detyrueshëm me menaxhim privat, ku çdo i siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm (kolona e parë), është i detyruar ligjërisht të paguajë një pjesë të kontributeve individuale në një fond privat pensionesh. Në këtë mënyrë, me plotësimin e kushteve për përfitim pensioni, të ardhurat e personave të siguruar përbëhen nga dy burime: një e ardhur (pension) nga skema e sigurimit të detyrueshëm dhe një tjetër e ardhur (pension) nga skema private e sigurimit dhe
- Kolona e Tretë, që është një sistem krejtësisht vullnetar me menaxhim privat, ku çdo person që dëshiron të ketë burime të ardhurash më të larta në periudhën e pensionit hyn në marrëdhënie sigurimi me këto institucione private, të cilat, nëpërmjet një menaxhimi efikas, sigurojnë të ardhura më të mëdha dhe përfitime shtesë kundrejt pagimit të kontributeve

Ekzistojnë shumë shembuj, ku vende të ndryshme kanë përshtatur sistemin e tyre të pensioneve konform ndryshimeve të rëndësishme demografike që po përjetojnë. Por jo çdo gjë e mirë për një vend mund të jetë e mirë për një tjetër. Sistemi i pensioneve, krahas të tjerave duhet të jetë në përshtatje edhe me karakteristikat ekonomike, politike dhe sociale të një vendi.

2. Situata Aktuale e Sistemit të Pensioneve në Shqipëri

Është fakt i pranuar tashmë që në sistemin e sigurimeve shoqërore, pensionet janë faktor i konsiderueshëm në një sistem ekonomik të caktuar dhe një element i rëndësishëm e i pazëvendësueshëm i mbrojtjes sociale. Prej tyre përfitojnë aktualisht rreth 17.2 % e popullsisë, ose 560 mijë pensioniste, tregues ky, me prirje të qarta drejt rritjes. Vetëm për pensione sot shpenzohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore mbi 60 miliard lekë e barabartë me 86% të gjithë buxhetit të sigurimeve shoqërore

Sistemi i pensioneve në përgjithësi dhe problematika e madhe që paraqet financimin në zhvillim i këtij sistemi në veçanti, kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen e institucioneve të interesuara për të gjetur forma e metoda më efikase në administrimin e kësaj skeme.

Duke e analizuar këtë proces, konstatohet se treguesit kryesorë të funksionimit të këtij sistemi janë mjaft shqetësuese. Niveli mjaft i ulët i të ardhurave në raport me G.D.P. (5.03% kundrejt 8 – 10 % të vendeve për rreth nesh), raporti i ulët kontribues/përfitues 1.1 me 1, shkalla shumë e ulët e zëvendësimit (raporti pension mesatar/pagë mesatare) 30-35%, si dhe përqindja e ulët e popullsisë në moshë pune të inkluduar

në sistem (vetëm 30-32%) etj.,. Në këto kushte, duhet pranuar se sistemi ofron përgjithësisht përfitime të ulëta me ngarkesa kontributive të larta.

Si rrjedhojë e të gjitha këtyre dukurive negative, reformimi i sistemit të pensioneve dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare të tij është një domosdoshmëri që lidhet me tre çështje kryesore që kërkojnë zgjidhje.

Së pari - Defiçiti aktual i sistemit të pensioneve është i lartë, ai arrin në 1% te PPB dhe në këto kushte, parashikimet aktuale supozojnë përkeqësim të kësaj gjendjeje.

Së dyti Mos funksionimi i skemave private të pensioneve për një periudhë 8-10 vjeçare në Shqipëri ka ulur në mënyrë të ndjeshme shkallën e zëvendësimit (pension mesatar/pagë mesatare) ose me saktë, të ardhurat mesatare të një pensionisti.

Se treti. Problemet e papunësisë, të informalitetit dhe të emigracionit, kanë ulur ndjeshëm përqindjen e popullsisë së siguruar në këto 15 vitet e fundit, gjë, që krijon një shqetësim të madh social për të ardhmen.

3. Zhvillimi i Fondeve Private në Shqipëri

Në vazhden e orientimeve të Bankës Botërore në vitin 1995, siç u trajtua më sipër, u miratua i pari ligj për pensionet private suplementare në Shqipëri, ligj, i cili mundësonte fillimin e funksionimit të Kolonës së Tretë në Shqipëri. Por vetëm kaq. Nga kjo periudhë, deri në Korrik të vitit 2004, është miratuar vetëm një vendim qeverie (më 1998), i cili përcaktonte se krijohet organi që duhet të liçensonte dhe të mbikëqyrte veprimtarinë e fondeve private të pensioneve në Shqipëri. Kjo pauzë ka qenë pamotivuar për krijimin e fondeve private të pensioneve në Shqipëri shpjegohet vetëm me faktin se ky aktivitet nuk është parë në asnjë rast si zgjidhje e krizës së Sistemit të Pensioneve. Megjithatë, duhet pranuar se pas vitit 2005, u morën disa masa konkrete për krijimin e këtij tregu. Kështu, u ngrit Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve dhe më pas u organizua tregu financiar jo bankar në një autoritet të vetëm, A.M.F, metribute edhe për ngritjen e funksionimit të skemave private të pensioneve. U krijua infrastruktura e nevojshme rregullative dhe u ngritën tre kompanitë e para të pensioneve private suplementare, GARANSIG, IAPPS, CAPITAL.

Po t'i hedhësh një vështrim të përgjithshëm zhvillimit të kompanive të ngritura, shihet një orientim shumë i pakët i këtij tregu në raport me elementët e tjerë të tij. Aktualisht, në tregun financiar shqiptar funksionojnë 16 banka private të shtrira në të gjithë vendin, si dhe mjaft institucione të tjera financiare, si shoqëritë e sigurimeve, të kursim-kreditit, shoqëri leasing etj. Mungesa e besueshmërisë tek pensionet private nuk rezulton të jetë e përfillshme. Por, mungesa (së paku), që nga viti 1998, e një strategjie afatmesme të zhvillimit të tregut të pensioneve, ka sjellë pamundësinë e fillimit të një reforme të plotë të sistemit, gjë, e cila reflektohet aktualisht me pasoja të rënda dhe pak shpresëdhënëse në një treg pune me një nivel mjaft të lartë të shkallës së papunësisë. Shqipëria ende nuk ka përcaktuar ndonjë strategji të plotë e komplekse për reformën në sistemin e pensioneve. Siç u përmend edhe më lart, e vetmja strategji zhvillimi në këtë fushë ka mbetur ajo e sistemit publik, e cila nga ana e saj, jo vetëm nuk parashikon rezultate të ndjeshme në rritjen

e pensioneve, por nga ana tjetër, nuk merr përsipër reforma të ri-kalkulimit parametrik të sistemit bazë, të tilla që të rezultojnë të suksesshme për një periudhë më pak ose deri në dhjetë vjet. Ulja e masës së kontributit në këtë skemë përcaktohet si një faktor aksesor në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, ndërkohë që nga praktika e vendeve të tjera, ka rezultuar që menaxhimi i suksesshëm i sistemit të pensioneve nëpërmjet fondeve të investimit, nuk ka si element përcaktues vetëm zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, por krijimin e hapësirave të mjaftueshme për menaxhimin privat dhe investimet. Janë pikërisht këta tregues, të cilët ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike, por jo vetëm kaq. Menaxhimi privat i fondeve të sigurimeve shoqërore, ka rezultuar tejet efikas dhe i suksesshëm në luftën kundër uljes dhe zhdukjes së informalitetit. I aplikuar për herë të parë në vitin 1981 në Kili dhe i pasuar në një sërë vendesh të ndryshme, kjo formë e administrimit të sistemit është adaptuar tashmë nga shumica e vendeve të botës, madje edhe në Maqedoni e Kosovë.

5. Masa që mendohen të merren në fushën e pensioneve private

Ndër masat që mendohen të merren për përmirësimin e tregut të pensioneve, mund të themi me bindje të plotë, është **zhvillimi i skemave private të pensioneve**.

Legjislacioni shqiptar aktualisht lejon funksionimin e dy sistemeve (kolonave). Sistemi shtetëror dhe ai privat vullnetar suplementar. Për të rritur shkallën e zëvendësimit (raportin midis pagës mesatare me pensionin mesatar), i cili aktualisht është 30-35%, kundrejt 70 - 75% që duhet të jetë, kërkohet të merret një reformë komplekse, e cila duhet të fokusohet në tre çështje kryesore.

Së pari, konsolidimi i sistemit aktual publik të pensioneve. Nëpërmjet reformave parametrike kërkohet që ky sistem të kryejë dy funksione

- a) të mbrojë dhe të ruajë nga inflacioni pensionet aktuale që kanë dalë, të cilët historikun e kanë vetëm me skemën publike dhe nuk përfitojnë nga sistemi privat i pensioneve;
- b) të rrisë shkallën e zëvendësimit të skemës publike, deri në ato nivele që së bashku me skemat private të arrihet kushti ligjor që ka sistemi i përgjithshëm.

Se dyti, të inkurajohet skema vullnetare suplementare e sapo krijuar e pensioneve. Sipas ligjit, kjo skemë kryen dy funksione, jep pensione shtesë mbi ato që jep sistemi i detyruar shtetëror dhe jep pensione në kushte më të favorshme nga ato që ofron skema bazë. Kjo skemë ka nevojë për një përkujdesje më të madhe. Megjithatë, duhet pranuar se përmirësimet që iu bënë këtij ligji në fund të vitit të kaluar kanë rritur interesimin për të marrë pjesë në këto skema.

Parë në këndvështrimin e zhvillimit të tregut të pensioneve, miratimi i këtij ligji, sjell një sërë avantazhesh në raport me ligjin e mëparshëm. Ky ligj, me dëshirën e mirë për të zhvilluar fondet private të pensioneve edhe në Shqipëri, bën një ndryshim rrënjësor në fushën e organizimit, administrimit dhe funksionimit të fondeve private të pensioneve, duke rritur sigurinë, garancinë e këtyre fondeve dhe si rrjedhim, interesin ndaj tyre.

Në këtë aspekt, ky ligj sjell disa ndryshime pozitive në tregun e pensioneve private:

A. Është një ligj më bashkëkohor që reflekton eksperiencën, tashmë disa vjeçare, të zbatimit në praktikë të ligjit të pensioneve në disa vende të Evropës Lindore, më

konkretisht, të Polonisë, Çekisë, Sllovenisë, të Maqedonisë, si dhe eksperiencën e pakët, të zhvillimeve në vendin tonë.

Ky ligj rregullon veprimtarinë e Fondit të Pensionit Vullnetar me kontribute të përcaktuara, me plan individual dhe profesional, ku një plan pensioni mund të ketë më shumë se një produkt (pension).

Fondi i Pensionit, përbëhet nga një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit. Në asetet e fondit përfshihen kontributet e derdhura dhe fitimi neto i realizuar nga investimi i tyre. Çdo anëtar ka një kuotë që përfaqëson pjesën e pronësisë së tij në asetet e Fondit të Pensionit. Sipas Ligjit, kemi dy lloje fondesh pensioni:

1. **Fondi i Pensionit Vullnetar**, që përfaqëson bashkësinë e individëve fizike, të cilët mund të marrin pjese në një apo disa plane pensioni, pavarësisht nga vendbanimi, mosha, madhësia e kontributit.
2. **Fond Pensioni Profesional**, që përfaqëson dëshirën e punëdhënësit privat ose shtetëror për të siguruar tek një Fond Pensioni punonjësit e tij, me një plan pensioni profesional. Në këtë rast, pjesëmarrja në planin e pensionit, mund të jetë tre llojëshe, kolektive, individuale dhe e kombinuar.

Plan Pensioni Kolektiv: ku punëdhënësi obligohet të paguajë tërësisht kontributet për pension vullnetar në emër të punonjësve të tij.

Plan Pensioni Individuale: ku punëmarrësit marrin përsipër të paguajë gjithë kuotën e kontributit për pension vullnetar nga të ardhurat e tyre personale.

Plan Pensioni i Kombinuar: ku kontributet për pension vullnetar paguhen pjesërisht nga punëdhënësi, pjesërisht nga punëmarrësi, në përqindje sipas dëshirës. Edhe në këtë rast, midis punëdhënësit dhe punëmarrësve për pjesën e punëdhënësit lidhen aneks kontrata.

Sipas Ligjit, Fondi i Pensionit Vullnetar do të administrohet nga **Shoqëria Administruese**, e cila themelohet si shoqëri aksionere, ku jo më pak se 51% e aksioneve, të zotërohen nga një bankë ose institucion financiar. Funkzioni kryesor i shoqërisë administruese do të jetë mbledhja e kontributeve dhe investimi i tyre.

Asetet e fondit do të mbahen nga **Depozitari**, që është një bankë e licencuar nga banka e Shqipërisë për të ofruar shërbime kujdestarie, e miratuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare me propozim të Shoqërisë Administruese. Depozitari është përgjegjës për ruajtjen e aseteve të fondit, kontrollin e administrimit të tyre, duke siguruar që të ardhurat e fondit të shpërndahen sipas legjislacionit në fuqi dhe bën transparencën e fondit.

B. Ligji i ri, bën më të interesuara palët pjesëmarrëse në plane pensioni vullnetar, si aderuesit, ashtu dhe përfituesit favorizohen nëpërmjet një sistemi fiskal mjaft favorizues.

Lehtësirat tatimore për anëtarët e fondit të pensionit

- Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi.
- Fitimi që realizohet nga investimi nuk i nënshtrohet tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruese.

- Kontributet e bëra nga punëdhënësi në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk konsiderohen si të ardhura personale.
- Blerja e kuotave të një fondi pensioni konsiderohet shërbim financiar dhe si rrjedhojë, është e përjashtuar nga TVSH-ja.
- Shërbimet e ofruara nga Depozitari për shoqërinë administruese dhe anëtarët e saj, konsiderohen si shërbim financiar dhe si rrjedhojë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Trajtimi fiskal për punëdhënësin

- Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni, konsiderohen si shpenzim i zbritshëm në llogaritje të tatimit mbi fitimin.

Së treti, të vendoset sistemi privat i detyruar, kolona e dytë. Kjo do të kërkojë një ndarje të kontributit në dy pjesë, një kontribut shoqëror që do duhet të përballojë sistemin aktual të pensioneve dhe një pjesë kontributi individual, që do të derdhet në llogaritë e veta të fondit të pensioneve. Kjo bëhet më imperative, duke marrë në konsideratë shkallën e zëvendësimit shumë të ulët 30-35 % të sistemit bazë, e cila për të shkuar tek 70-75% sa është normativa ligjore, e ka shumë të vështirë, ndonëse të pamundur të realizohet vetëm me kolonën e tretë, si dhe popullsinë e re që ka Shqipëria, ku mosha mesatare është aktualisht 31 vjeç, kundrejt 45-48 që e ka Evropa.

Duke iu referuar eksperiencës së zhvillimit të sistemeve të pensioneve, veçanërisht në Evropën Lindore të pas viteve '95, vërehen lehtësisht dy tendenca ose dy modele, të ndërtuara në mbështetje të kushteve konkrete të çdo vendi.

Modeli i parë dhe më i përgjithshmi, sistemi i pensioneve përbehet nga tre skema.

Skema e parë - një sistem shtetëror i detyrueshëm PAYG, i cili mbulon deri në 35-40% të shkallës së zëvendësimit, nëpërmjet kontributeve që çdo person që ka aktivitet ekonomik duhet të paguajë në këtë skemë.

Skema e dytë - sistem privat i detyruar, ku një pjesë e kontributit të përgjithshëm i kalon kësaj skeme dhe menaxhohet nga Fondet Private të Pensioneve. Kjo skemë mbulon 20-25% të pensionit.

Skema e tretë - sistemi vullnetar privat, i cili mbulon 10-15% të pensionit. Këtë model e gjejmë në Poloni, Bullgari, Hungari, Kroaci, Estoni, Rumani, Sllovaki, Maqedoni, etj. .

Modeli i dytë është ai ku, sistemi i përgjithshëm përbëhet nga dy skema pensioni - nga një skemë bazë shtetërore e konsoliduar mirë, e cila të përballojë 55-60% të pensionit dhe një skemë e sigurimit privat vullnetar të zhvilluar, e cila mbulon 15-20% të pensionit, duke i krijuar mundësinë, nëpërmjet lehtësirave fiskale, të gjithë popullsisë aktive të përfshihet në të. Këtë sistem të mirë-administruar e gjejmë në Çeki, Slloveni, etj.

Mendoj se me drejtimin që ka marrë ekonomia shqiptare, futja graduale e sistemit tre kolonësh do të ishte efikase. Kjo gjë do të mundësojë rritjen e shkallës së zëvendësimit nga 30-35%, gradualisht drejt 70-75%, për rrjedhojë edhe të ardhurat mesatare të një pensionisti. Kështu, shkalla e zëvendësimit do të përballohet 40-45% nga kolona e parë bazë, 20-25% nga kolona e dytë (private e detyrueshme) dhe 10-15%

nga kolona e tretë (vullnetare suplementare), por kjo do të kërkonte disa modifikime e përmirësime edhe të ligjit bazë të pensioneve. Sigurisht arsyeja që sistemi privat i pensioneve po bëhet gjithmonë e më shumë dominues janë edhe avantazhet që ai ka në raport me sistemin e vjetër shtetëror të pensioneve.

- 1. Skemat private u japin zgjidhje problemeve demografike.** Dihet që plakja e popullsisë redukton fuqinë punëtore dhe si rezultat, prodhimin e një vendi. Efekti në skemat PAYG është shumë i ndjeshëm, mbasi baza e kontributeve zvogëlohet, ndërsa në skemat private është më pak i përfillshëm. Kur një brez shumë i madh punëtorësh del në pension, ne skemën PAYG efektet financiare do të përballohen nga brezi aktual i zvogëluar i te punësuarve, ndërsa në skemat private ai likuidon aktivet e tij financiare, në mënyrë që të paguajë pensionin e tij.
- 2. Skemat private ofrojnë stimuj më të fuqishëm në tregun e punës.** Shtrembërimet në tregun e punës minimizohen kur kontribuesit arrijnë të dallojnë një lidhje të qartë ndërmjet kontributeve aktuale dhe përfitimeve të ardhshme. Në skemat e solidaritetit mungon ky interesim, mbasi shihet një shkallë rishpërndarje mjaft e lartë, ndërsa skemat private mund t'i kenë këto karakteristika, .
- 3. Fondet e pensioneve diversifikojnë riskun.** Argumenti i diversifikimit të riskut nuk duhet të ekzagjerohet. Por, sidoqoftë nëse një fond nuk është i menaxhuar në mënyrë kompetente, ekziston mundësia që performanca e investimeve të mos i plotësojë pritshmëritë, ose që luhatjet e bursës mund të bëjnë që përfitimet të ndryshojnë në mënyrë të dukshme... “dy individë me të njëjtin profil kontributesh gjatë gjithë jetës së tyre mund të përfitojnë dy pensione të ndryshme”. Në këtë mënyrë, nevojitet një rregullim i fortë ligjor për mbrojtjen e konsumatorëve...
- 4. Pensionet private përjashtojnë qeverinë nga administrimi i tyre.** Është më se e njohur se skemat publike janë të ndjeshme ndaj dështimeve të qeverisë, por po kështu janë dhe pensionet private. Pakujdesia fiskale mund të çojë në inflacion, duke minuar stabilitetin e fondeve private. Qeverisja efektive është thelbësore për çdo lloj skeme pensionesh.

Mendojmë se disa nga resurset, që bëjnë të jenë të suksesshme skemat private suplementare të pensioneve, mund të jenë: **1.** Kontingjente mjaft të rëndësishme të kësaj skeme janë punonjësit e profesioneve të vështira, të cilët sipas sistemit bazë nuk mund të punojnë në këto profesione deri në moshën 65 vjeç. Nëpërmjet skemave private, u krijohet mundësia deri sa të arrijnë këtë moshë të marrin pension të parakohshëm, kundrejt kontributeve që punëdhënësit dhe punëmarrësit paguajnë. Këtu mund të përmendim punonjësit e minierave, të metalurgjisë, çimentos, ndërtimit, etj. **2.** Aktualisht, mjaft të interesuar për të aderuar në një fond privat pensionesh janë edhe kompanitë e mëdha, si Vodafone, AMC, Kurum, Cimento, Kompanitë e Ndërtimit dhe të sektorëve të vështirë të ekonomisë, profesionet e lira, avokat, noter, të vetëpunësuarit, individë, etj. Interesim tregojnë edhe institucionet shtetërore jo buxhetore, bankat, shoqëritë e sigurimit, korporatat KESH, Telekom, postat, etj. **3.** Përfshirja e emigrantëve në fondet private. Një rezervë e madhe është përfshirja e emigrantëve në skemën e pensioneve private. Sot llogariten mbi 550 mijë emigrantë forca aktive, që punojnë në Greqi, Itali, etj. Një

pjesë e mirë e tyre janë të punësuar në sektorë të ndryshëm dhe kontributi që ato derdhnin në sigurimet shoqërore të vendeve ku punojnë llogaritet afro 500-600 milionë euro. Fatkeqësisht, pjesa më e madhe e tyre nuk përfitojnë nga këto kontribute, sidomos në fushën e pensioneve. Zgjidhja e këtij problemi kërkon krijimin e lehtësirave për të komunikuar e afruar ndërmjetësit financiar, nëpërmjet lidhjeve të marrëveshjeve bilaterale me vendet ku është ky emigracion. Një punë e tillë, si me Greqinë edhe me Italinë, ka nisur kohë më parë, por kërkohet që të riaktivizohen. Shumë vende që kanë një emigracion të madh përfitojnë shumë nga këto marrëveshje. Mjafton të përmend marrëveshjen bilaterale Turqi-Gjermani, ku përfitojnë nga kjo marrëveshje mbi 3 milionë emigrant të punësuar. **4.** Rishikimi i skemës së pensioneve në fshat. Ekzistenca e dy pronave në të kaluarën kushtëzon vendosjen e dy sistemeve të pensioneve: pensionet për punonjësit shtetëror dhe pensionet për punonjësit e ish kooperativave bujqësore. Dallimet në pronësi favorizuan edhe dallimet në masën e pensionit. Përgjithësisht, masa e pensionit në fshat është afro 2-3 herë më e ulët se në qytet. Financimet e Pensioneve në fshat kanë denatyruar natyrën e sistemit të sigurimeve shoqërore. Me kontributin që derdhet përballohen vetëm 32 % e shpenzimeve, pjesa tjetër përballohet nga buxheti i shtetit. Synimi i politikave të pensioneve në fshat mbetet rruga e rritjes së pjesëmarrjes së fermerëve në skemë dhe e balancimit financiar të saj. Ekzistojnë dy variante që mundësojnë zgjidhjen e këtij problemi: **Varianti i parë**, skema e sigurimeve të pensioneve në fshat të kthehet në sistem vullnetar dhe të funksionojë si kolonë e tretë. Në fakt, mjaft vende të botës, me përjashtim të Kinës e Izraelit, sistemin e pensioneve në fshat e kanë vullnetar, por duhet të pranojmë se ato kanë vetëm 5 % të popullsisë në fshat. **Varianti i dytë**, të mbetet i detyruar, por të hartohet një strategji për rritjen graduale të masës së kontributit dhe të pensionit, deri në kufijtë minimal. Natyrisht, problematika e sigurimeve shoqërore dhe veçanërisht ajo e pensioneve, është mjaft e gjerë dhe komplekse. Ky kompleksitet vjen e merr një rëndësi thelbësore edhe për faktin se me këtë problematikë janë të lidhura në mënyrë direkte dhe indirekte interesat ekonomike të një pjese të konsiderueshme të popullsisë e në këtë kontekst, zgjidhjet e drejta dhe të matura të tyre nëpërmjet reformimit të sistemit të pensioneve dhe zhvillimit të skemave private, i shërbejnë më së miri qëllimit final - rritjes së mundësisë për një jetë më të qetë financiare të popullsisë së tretë.

Literatura:

1. Ligji, "Për Pensionet Civile", nr. 129, datë 28.10.1927.
2. Ligji, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Nr. 7703 dt. 11.05.1993.
3. Ligji, "Për Sigurimin Shtetëror Suplementar të Personave që Kryejnë Funksione Kushtetuese dhe Punonjësve të Shtetit", nr. 8097, datë 21.03.1996.
4. Ligji, "Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve", nr. 8087, datë 13.03.1996 (të ndryshuar).
5. Ligji, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", nr. 7943, datë 01.06.1995

Roli i mjeteve financiare që ndikojnë në fondet private të pensioneve

M.Sc. Albana Demi

Këshilltare, Departamenti i taksave qendrore të Shqipërisë

Armando Mosho

Drejtor i thesarit, UNION BANK

ABSTRAKT. *Fondet private të Pensioneve janë institucione të cilat përfaqësojnë një strukturë të kursimeve afatgjata dhe ngrihen mbi bazën e skemave kolektive të akumulimit të kapitaleve të lira. Si të tilla, konkurrojnë në krijimin e kapitaleve nëpërmjet normës së interesit që u ofrojnë investitorëve dhe nxisin investimet në instrumenta financiarë, si obligacione apo letra me vlerë duke përbërë një burim kryesor për të siguruar investime në projekte sa më fitimprurëse, me synim ruajtjen dhe krijimin e një portofoli eficient.*

Aktualisht ekziston një treg bankar, i cili funksionon si treg primar dhe sekondar për titujt e borxhit të brendshëm (bono thesari). Në këtë treg, Fondet Private të Pensioneve, për kapitalet që mbledhin, ofrojnë normë sa më të lartë fitimi. Nga ana tjetër, për të përballuar këtë normë fitimi, kapitalet e mbledhura i ri-investojnë në aktivitete me portofol investimi të efektshëm. Fondet e Pensioneve dhe ato të Investimit fillimisht e investojnë kapitalin e mbledhur në instrumentat financiar që i ofron sot tregu shqiptar: Depozita me afat; Bono thesari; Prona të patundshme; Investim në valutë të huaj; Kredi; Kuota në Shoqëri Kursim Krediti; Aksione të bizneseve private; Kreditim të bizneseve apo individëve.

Politikat e zhvillimit të Fondeve Private të Pensioneve mundësojnë që çdo individ të zgjedhë të investojë në Fond dhe të bëjë rregullisht pagesa. Veç kësaj, punëdhënësit munden gjithashtu të derdhin kontributet për llogari të punonjësve të tyre. Alternativa e ofruar nga Fondi i Pensioneve bën të mundur që çdo individ të investojë në mënyrë të sigurtë për të ardhmen e tij. Gjendja e llogarisë personale në momentin e përfitimit të pensionit, përcaktohet mbi bazën e shumës së kontributeve të derdhura, kohëzgjatjes së periudhës së investimit si dhe performancës së investimit të fondeve. Përfshirja e individëve në skemën e sigurimeve

private të pensioneve kushtëzohet nga kryerja e reformave në fushën ekonomike. Në vendin tonë aktualisht janë liçensuar nga AMF (Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare) dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre 3 (tre), Fonde private vullnetare të pensioneve të cilat funksionojnë me kapital tërësisht shqiptar: “RAIFFEISEN PENSIONS SH.A” “CAPITAL”, “SIGMA IPP” dhe përfshihen në kolonën e tretë të sistemit të pensioneve dhe është vullnetare.

Fjalët kyçe:

Instrumenta Financiar, Fondet Private të Pensioneve, politikat e zhvillimit, tregu bankar, punonjës, punëdhënës, kontribues, moment përfitimi, portofol investimi

Hyrje

Politikat në sistemin financiar, shërbejnë për të parandaluar rënie të ekonomisë. Secila teori është produkt i periudhës kohore gjatë të cilës përpunohet. Teoritë ekonomike gjithmonë e më shumë, po vënë theksin e tyre mbi politikat vepruese qeverisëse për të çuar përpara punësimin e lartë. Vendet që kanë mësuar shpejt kanë ecur përpara, pasi janë kapur fort tek burimi thelbësor pra, ekonomia globale. Hartimi dhe zbatimi i reformave në të gjitha fushat e jetës ekonomike, financiare, politike dhe sociale në vendin tonë, është kusht i domosdoshëm për plotësimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Associimit me BE dhe si i tillë edhe reforma në fushën e pensioneve është pjesë e rëndësishme për integrimin ekonomik. Zgjerimi i Bashkimit Evropian shoqërohet gjithashtu edhe me krijimin e një tregu shumë të madh të mallrave, kapitaleve dhe ideve. Këto, si edhe politika të tjera, mund të zbatohen nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm duke patur parasysh edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Nëse rritja ekonomike mund të matet në këndvështrime makroekonomike, veprimet në fakt bëhen në nivelin e rritjes mikroekonomike dhe kjo është vërtetuar në mjaft vende duke treguar se pjesa më e madhe e reformave dhe e politikave synojnë zhvillimin e mikroekonomisë. Rritja ekonomike përmbledh transformimin e ekonomisë, i cili vjen si rezultat i presionit konkurrues. Reforma e sistemeve publike të sigurimeve shoqërore tashmë ka pushtuar vëmendjen e politikëbërësve në të gjithë botën. Lehtësimi i pengesave ligjore, rregullatore, konkurrenciale dhe të politikës fiskale, me të cilat ndeshen institucionet financiare në vendin tonë si dhe në aktivitetin e tyre ndër rajonal janë kusht thelbësor dhe tepër i rëndësishëm për Integrimin Evropian. Duke analizuar mjetet financiare theksojmë se stabilitetin monetar veçanërisht në kushtet e regjimit të inflacionit të shënjestruar sigurohet nëpërmjet reformave strukturore, nxitjes së politikave fiskale dhe rritjes së mirëqenies. Në përshpejtimin e reformave strukturore, transformimi i sistemit bankar është një element i rëndësishëm i cili ka ndikun në përforsimin e stabilitetit makroekonomik, duke sjellë ndikime në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve.

Çfarë kuptojmë me mjete financiare?

Mjet financiar është një lloj mjeti ekonomik i krijuar nëpërmjet një kontrate apo marrëveshjeje formale apo joformale ndërmjet dy njëjësive institucionale dhe që

përmban një marrëdhënie kreditor/debitor ose marrëdhënie pronësie ndërmjet njërive, duke detyruar palët të paguajnë të ardhurat e pronësisë, të ripaguajnë principalin ose të transferojnë mjetet e tjera financiare.

Një mjet ekonomik zotërohet nga njësia institucionale që siguron përfitime duke:

- prodhuar mallra;
- gjeneruar të ardhurat nga pronat e patundshme në formën e rentës ose të fitimit neto;
- kryer shërbime;
- shërbyer si mbajtëse e vlerës.

Si ndryshojnë mjetet financiare nga mjetet ekonomike?

Mjetet financiare ndryshojnë nga mjetet e tjera ekonomike pasi:

- pjesa më e madhe krijojnë një marrëdhënie debitor/kreditor ose marrëdhënie pronësie, në të cilën një njësi fiton një të drejtë ndaj burimeve ekonomike të njësisë tjetër;
- nuk prodhojnë mallra dhe shërbime;
- sigurojnë përfitime në formën e të ardhurave nga interesi;
- sigurojnë një pjesë në të ardhurat neto të njësisë tjetër institucionale, mbajnë fitime kapitale ose ruajnë vlerë.

Tërësia e ndryshimeve të reformave sociale dhe ekonomike, për pensionistët do të thotë se politikat qeverisëse duhet të mbështesin dhe të sigurojnë besimin e tyre në lidhje me qëndrueshmërinë e sistemit. Sipas analizës makroekonomike rritja e masës së pensionit sipas inflacionit, me ritme më të ulëta se rritja e pagës kontributive, sjell rritjen me ritme më të shpejta të të ardhurave krahasuar me shpenzimet.

Impaktet e tranzicionit


Tronditja ekonomike pati një efekt të fuqishëm. Rënia e Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP) për më shumë se 30 % nga viti 1991 deri në 1994 çoi në një rënie të shpejtë të vlerës reale të pensionit. Gjatë të njëjtës periudhë rënia e pensionit ishte më e vogël se rënia e pagës.

Për arsye humanitare dhe si rezultat i presionit politik, rritja e papunësisë ishte pasojë e politikave të largimit të moshës së madhe nga puna për t'i lënë vend punëtorëve të rinj në moshë. Në mënyrë të pa evitueshme, u ushtrua një presion në rënie mbi nivelin e pensioneve dhe në ngritje, lidhur me pagesën e kontributeve. Kontributet e Sigurimeve Shoqërore u rritën me rreth 25% në vitin 1990 dhe në rreth 35% në fund të kësaj dekade.

Emergjencia për daljen e sektorit financiar privat

Dalja e sektorit financiar privat, ishte një zhvillim i mëvonshëm. Tashmë ishte krijuar bursa si edhe kompanitë e sigurimit të jetës. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ishin zhvilluar fondet e përbashkëta dhe kompani sigurimesh, disa prej të cilave

filluan të ofronin atë produkt të quajtur pension në tregje të cilat nuk ishin të rregulluara mirë. Proçesi reformues në fushën e pensioneve në aspektin teknik të tij është domosdoshmëri, por duhet vlerësuar strategjia dhe forma me të cilën do të implementohet. Kjo shpjegon popullaritetin e fondeve private të pensioneve si edhe vlerësimin e sistemit të përcaktuar të kontributeve, që do të përshkruhet gjatë këtij studimi. Sipas analizës për funksionimin financiar të sistemit të pensioneve në përgjithësi dhe në veçanti për skemat e pensioneve (fshat – qytet) rezulton se, sistemi është i disbalancuar sipas paraqitjes grafike:



Aktualisht të gjithë të moshuarit përfitojnë pension pleqërie, por duke qënë se sot një përqindje e ulët e popullsisë kontribuojnë në sistemin e sigurimeve shoqërore, numri i pensionistëve të ardhshëm do të fillojë të bjerë gradualisht. Për të patur formalizim të sektorit informal, në mënyrë që koeficienti i varësisë të mos jetë i lartë në të ardhmen duhet patjetër që të rritet baza e kontribuesve.

Përkufizim



Pensioni është shuma e të ardhurave që në bazë të një marrëveshje u ofrohet kontribuesve, për të përfituar të ardhura të rregullta kur ata për shkak të arsyeve objektive (moshe apo gjendje shëndetësore) tërhiqen nga jeta ekonomike aktive.

Për të garantuar përshtatshmërinë e këtyre pensioneve, qeveritë dhe partnerët social si pjesë të tregut financiar dhe alternativat për reformimin e këtij, kanë zhvilluar krahas sistemit shtetëror edhe sistemin privat që përfshihet në Fondet private të pensioneve.

Zhvillimi i fondeve private të pensioneve, fillimisht suplementare vullnetare, e në vazhdimësi, të detyrueshme, aktualisht po vjen në një moment mjaft të rëndësishëm të problemeve që po përballët sot sistemi i pensioneve në Shqipëri.

Fondet e Pensionit.

Fondet e Pensionit të klasifikuara në këtë nënsektor janë njësi të pavarura institucionale, të cilat mbajnë dhe investojnë mjetet e kontribuesve, me qëllim përfitimin e të ardhurave pas daljes në pension. Fondet e pensionit mbulojnë grupe specifike individësh. Llogaritë e anëtarëve në fondet e pensionit veçohen dhe përfitimet në lidhje me to varen nga shuma e kontributeve. Pjesëmarrja në to, si nga punëdhënësi ashtu edhe nga punëmarrësi, është shpesh vullnetare, por mund të jetë edhe e detyruar. Gjithashtu, mund të ketë fonde pensioni të pavarura nga sistemi i sigurimeve shoqërore. Ky nënsektor nuk e përfshin fondin e sigurimit shoqëror i cili është një program i detyrueshëm që imponohet dhe kontrollohet nga qeveria, me qëllim financimin e përfitimeve sociale për të gjithë komunitetin.

Identifikimi i fondeve të pensionit si njësi institucionale varet nga fakti nëse ato janë të financuara apo jo - të financuara. Planet e pensionit të financuara kanë një grup të veçantë mjetesh dhe rezervash të cilat përdoren për prokurimin e përfitimeve. Planet e pensionit të fondësuar, janë të pavarura nëse ato administrohen nga një njësi e veçantë institucionale që klasifikohet në këtë nënsektor. Planet e pensionit të financuara janë të varura nëse ato nuk administrohen nga një njësi e veçantë, por llogaritë e tyre mbahen bashkë me llogaritë e prokuruesit të pensionit. Ato klasifikohen në sektorin institucional të punëdhënësit duke krijuar një pretendim të ekonomive familjare në sektorin që ofron planin. Fondi shikohet si pronë e përfituesve dhe jo e punëdhënësit. Planet e pensionit jo të financuara nuk kanë mjete të identifikueshme, përfitimet paguhën prej të hyrave të kontribuesve dhe duke tërhequr nga burimet e përgjithshme të prokuruesit të pensionit. Planet e pensionit jo të financuara ose që nuk janë të veçuara nga llogari të tjera të punëdhënësit, nuk kanë mjete të identifikueshme të cilat mund të konsiderohen mjete të sektorit të ekonomive familjare mbi fondin e pensionit.

Fondet e Pensioneve dhe ato të Investimit fillimisht e investojnë kapitalin e mbledhur në instrumentet që i ofron sot tregu shqiptar.

A. Tregjet e rregulluara:

1. Depozita me afat;
2. Bono thesari;
3. Prona të patundshme;
4. Investim në valutë të huaj;
5. Kredi (bankat);
6. Kuota në Shoqëri Kursim Krediti.

B. Tregjet informale:


1. Aksione të bizneseve private;
2. Kreditim të bizneseve apo individëve (fajde);
3. Investim në aktivitete të paligjshme.

Në mënyrë që në fushën e fondeve private të pensioneve, të arrihet zhvillimi financiar, funksionon Autoritetit i Mbikqyrjes. Parë në këtë këndvështrim theksojmë se: fond


pensioni është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të tij, i përbërë nga kontributet dhe investimi i tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifat, i krijuar mbi bazë kontrate, ku secili anëtar ka në pronësi pjesën e tij, e cila përbëhet nga kuotat e zotëruara në fond.

Në vendin tonë aktualisht janë liçensuar nga AMF (Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare) dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre 3 (tre), Fonde private vullnetare të pensioneve të cilat funksionojnë me kapital tërësisht shqiptar: “RAIFFEISEN PENSIONS SH.A“ “CAPITAL“, “SIGMA IPP“ dhe përfshihen në kolonën e tretë të sistemit të pensioneve dhe është vullnetare.

Paraqitja grafike sipas numrit të kontribuesve



Paraqitja grafike sipas kontributit në lek



Institutet e ngritura, për nga kompozimi i tyre, janë fonde të hapura e komplekse, ku themeluesit, që kanë siguruar edhe punonjësit e tyre, janë kompani të mëdha që veprojnë në sektorët e profesioneve të vështira të ekonomisë, si metalurgji, çimento, ndërtim etj, dhe institucione financiare bankare e të shoqërive të sigurimit, që paraqesin siguri e garanci për vijueshmëri të fondeve.

Instituti privat i pensioneve krijohet vetëm nga persona juridik që kanë kombësi shqiptare. Punëdhënësi që ka më shumë se 500 të punësuar, ka të drejtë të krijojë një institut pensionesh. Kur instituti i pensioneve krijohet nga më shumë se një person, në këtë rast mjafton që njëri prej tyre të ketë më shumë se 100 të punësuar dhe së bashku të bëhen 500 të punësuar.

Çdo individ mund të bëhet anëtar në një fond pensioni, vetëm pasi ka lidhur një kontratë me shoqërinë administruese.

Punëdhënësi mund të derdhë kontributet për pensione në favor të punëmarrësve të tij :

- nëpërmjet llogarisë bankare, si një shumë me periodicitet të përcaktuar, të shoqëruar me listën e punëmarrësve, duke specifikuar pjesën e kontributit që paguan punëdhënësi për secilin prej tyre si dhe pjesën e kontributit që paguan çdo punëmarrës.
- Çdo individ derdh kontributet për pensione suplementare në llogaritë bankare të Institutit të Pensioneve, në bazë të një periodiciteti të përcaktuar në kontratë.

Instituti i pensioneve mund të blejë letra me vlerë për jo më tepër, ose të shesë për jo më pak se çmimi që letra me vlerë është tregtuar në tregun publik në ditën e shitjes ose të blerjes së saj. Vlera e letrave me vlerë e një emetuesi e tregtuar në bursën e fondeve nuk duhet të kalojë 10 përqind të pasurisë së Institutit të Pensioneve. Ky kufizim

nuk ka vlerë në rastin e interesave të konsoliduara. Vlera e pasurive të paluajtshme ose të luajtshme nuk duhet të kalojë 5 përqind të pasurisë së institutit të pensioneve. Instituti i pensioneve nuk duhet të zotërojë më tepër se 20 përqind të vlerës totale të letrave me vlerë të emetuar nga secili prej emetuesve dhe të tregtuara në bursë. Instituti i Pensioneve do të jetë i detyruar të verë menjëherë në dijeni inspektoriatin për tejkalimin e kufijve.

Një institut pensionesh i profesioneve të vështira është i detyruar të arrijë një nivel minimal fitimi, të barabartë me normën e interesit të konsoliduar të sistemit bankar.

Instituti i pensioneve shpërndan fitimin e tij në një mënyrë të tillë që të paktën 5 përqind e tij të shkojë për fondin rezervë, jo më shumë se 10 përqind për dividendin e shpenzime të tjera në përputhje me vendimin e asamblesë së përgjithshme, me kusht që të mos ketë një dispozitë tjetër që të bëjë rregullimin më vonë, 10 përqind e formuesve të kapitalit, pjesa që mbetet u shpërndahet të siguruarve. Orientimi drejt fondit të detyrueshëm të pensioneve rrit normën e kursimeve të vendit, pra duke rritur investimet rriten outputet.

Anëtar i fondit të pensionit ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës së aseteve në llogarinë e vet ose pagesa periodike në formë pensioni. Ai mund ta përfitojë këtë kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, 5 vjet para se të mbushë moshën e pensionit ose kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme.

Literatura:

Albanian financial supervisory authority web site www.amf.gov.al

The Financial Crisis: Reform and Exit Strategies, OECD (2009), available at

<http://www.oecd.org/dataoecd/55/47/43091457.pdf>.

Joseph E. Stiglitz, "Economia della Finanza Publico"

Giorgio Stefani, "Economia della Finanza Publico"

Pinera, Jose. 2001, "Liberating Workers: The World Pension Revolution" Cato Institute

Shoqëritë e kursim-kreditit, sfida në kreditimin e ekonomive të vogla dhe përballja me konkurrencën e bankave tregtare

____Doktorante Arlinda Hoti____

Universiteti European i Tiranës

____Zana Komini____

Drejtoreshë Ekzekutive e Unionit Shqiptar Kursim-Kredi

ABSTRAKT. *Koncepti i mikrokreditit apo i quajtur ndryshe “kredia në shuma të vogla” nuk është më i ri tashmë në botën e mikrofinancës. Në mënyrë masive, mikrokredia po përdoret si një term i cili e identifikon atë me popullatat e varfëra apo vulnerable, të cilat janë të përjashtuara në marrjen e shërbimeve financiare nga ana e institucioneve bankare. Gjithashtu, mikrokredia aktualisht konsiderohet edhe si një mjet i fuqishëm për lehtësimin e varfërisë, frenimin e dukurive negative si papunësia dhe emigracioni dhe për emancipimin e gruas si një nga shtresat më vulnerable të shoqërisë. Mikrokredia është një mekanizëm financiar i cili prek në mënyrë masive miliona njerëz në mbarë botën. Në vitin 2006, rezultonte se 3133 institucione mikrokrediti u shërbenin mbi 113 milionë klientëve në mbarë botën ndërsa deri në vitin 2015, instrumenti i mikrokreditit tenton të prekë shifrën e 175 milionë klientëve. Në Shqipëri, Shoqëritë Kursim Kredi operojnë kryesisht në zonat rurale të rrethëve që kanë densitetin më të lartë të popullsisë dhe aktivitetit bujqësor dhe ekonomik të vendit, si p.sh zonat në Shqipërinë e Mesme dhe Ulëtirën Perendimore. Këto Shoqëri Kursim Kredi janë anëtarë të Unionit SHKK i cili ushtron aktivitetin e tij financiar në 13 rrethet e vendit. Shoqëritë Kursim Kredi janë të administruara nga bordet drejtuese që zgjidhen nga vetë anëtarët në Asambletë të Përgjithshme Vjetore. Qëllimi i këtij punimi është të analizojmë ecurinë e shoqërive të kursim kreditit dhe nëse kriza financiare ka pasur ndikim në funksionimin e tyre.*

Fjalët kyçe:

mikrokredi, krizë financiare, kursim kredi

Mikrofinanca, një fenomen jo më i panjohur

Koncepti “mikrofinancë” nuk është më koncept i ri në botën e financës, ai gjithnjë e më shumë po përdoret si një term, i cili e identifikon atë me popullatat e varfra apo vulnerable, pa akses ose me akses të kufizuar në shërbimet e institucioneve bankare.

Termi “mikrofinancë” përmbledh shumë elementë, ku një nga më të përhapurit është mikrokredia që shpesh shoqërohet me paketa speciale kursimi dhe sigurimi, të drejtuara dhe të adoptuara për nevojat e njerëzve të varfër dhe me të ardhura të ulta.

Mikrofinanca në dhjetëvjecarin e fundit është konsideruar si një nga mënyrat më efektive të stimulimit të zhvillimit socio-kulturor në vendet në zhvillim, si një mjet i fuqishëm për lehtësimin e varfërisë, frenimin e papunësisë, emigracionit si dhe për emancipimin e gruas, si një nga shtresat më pak të mbrojtura të shoqërisë. Eksperienca botërore tregon, se huaja e dhënë grave është shfrytëzuar në mënyrë më efektive se sa huaja e dhënë burrave⁷³.

Ideja e mikrofinancës ka bazat e veta në përkufizimin se mungesa e marrjes së kredisë dhe shërbimeve të tjera financiare është pengesa kryesore e zhvillimit për personat e varfër ose me të ardhura të ulëta, të cilët nuk kanë burime të ardhurash të vazhdueshme. Klientët tipik të mikrofinancës janë të varfërit dhe njerëzit me të ardhura të ulëta, që nuk kanë akses në institucionet e tjera formale financiare. Ndonëse nuk ka shumë të dhëna rreth universit të klientëve potencialë, numri i ekonomive familjare pa akses efektiv për shërbime financiare është jashtëzakonisht i madh. Mikrofinanca është një sipërmarrje që ka provuar aftësinë për të nxjerrë njerëzit nga varfëria⁷⁴. Me formulat e saj origjinale, ajo bën që burimet financiare të jenë të arritshme për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit. Këto burime shpesh përdoren për të financuar projekte të vogla në fusha të tilla, si bujqësi, blegtori apo shërbime si artizanale, ushqimore të vogla etj...


Klientët e mikrofinancës zakonisht janë të vetëpunësuar në sipërmarrje të vogla familjare si dyqane të vogla pakice, shitje në rrugë, prodhim artizanal, furnizim të ushqimeve, etj... Në zonat rurale janë fermerët dhe sipërmarrjet e vogla me të ardhura të kufizuara, si prodhimi i ushqimeve, tregëtimi, etj...

Mikrokredia, ndryshe nga institucionet e tjera huadhënëse nuk kërkon që klientët të kenë kolateral, të jenë në marrëdhënie pune apo të kenë histori kredie për të patur mundësi të marrin hua. Kjo përbën një avantazh të mikrokredisë dhe në të njëjtën kohë edhe një lehtësi e cila u lejon njerëzve të marrin kredi, gjë që nuk do ishte e mundur të merrej në institucionet financiare tradicionale. Të dhënat mbi statusin e

73 Hulme D., Mosley P., Finance against poverty, vol.1 I 2, Routledge, Londyn 1996

74 Mikrofinanca në funksion të politikave zhvilluese, Bala B, Budina L, Kreci E, Vataj J, Maj 2007

klientëve të mikrofinancës janë të limituara, por megjithatë gjykohet se shumë klientë të mikrofinancës janë shumë afër nivelit të varfërisë, mbi dhe nën këtë nivel.



Ekonomitë familjare që përbëjnë 10 përqindëshin më të varfër të popullsisë, nuk janë klientë tradicionalë të mikrokredisë sepse mungon qëndrueshmëria e cash flow-t të tyre. Mikrofinanca është e papërshtatshme për këtë kategori të popullsisë që ka nevojë për grante ose burime nga institucione të tjera publike për të përmirësuar situatën e tyre ekonomike. Ndihamat, janë mënyra më efçente për të transferuar burime tek shumë të varfërit, sesa kreditë që shumë prej tyre nuk janë në gjëndje që t'i paguajnë.

Në plotësim të teknikave të mëparshme, teoria e mikrokredisë është munduar të përcaktojë mjete që do të shmangnin disa nga rrisqet tradicionale të kredisë, duke u fokusuar në edukimin më të mirë të disiplinës së shlyerjeve dhe ngarkimin e normave të interesit që mbulojnë kostot e shpërndarjes së kredive. Të dyja këto mbështesin zhvillimin e institucioneve të mikrofinancës, të aftë për të vazhduar të shtrijnë shërbimet e tyre në të ardhmen.

Mikrofinanca ka ardhur duke u rritur me shpejtësi. Sipas të dhënave të CGAP (Grupi Konsultativ për Asistimin e të Varfërve) portofoli i mikrokredisë në botë llogaritet në vlerën e rreth 25 miliardë dollarëve, por gjykohet që industria ka nevojë për 250 miliardë dollarë për të plotësuar nevojat e të gjithë njerëzve të varfër që kanë nevojë për të.

Në vitin 2006, rezultonte se Institucionet e Mikrokredisë u shërbenin mbi 113 milionë klientëve në mbarë botën, ndërsa deri në vitin 2015 ky shërbim pritet të prekë shifrën e 175 milionë klientëve. Ndoshta arsyeja, që ka kaq shumë entuziazëm për mikrofinancën dhe sidomos për shërbimin financiar të mikrokredisë tregon se ajo është një mekanizëm i bazuar në treg që ka arritur disa suksese aty ku mekanizma të tjerë nuk ia kanë dalë.

Në fakt institucionet e Mikrofinancës, krahasuar me institucionet e tjera financiare në përgjithësi, kanë performuar më mirë përballë krizave të ndryshme. Ato kanë ditur që duke u shërbyer njerëzve me të ardhura të ulëta, të sigurojnë një cilësi të admirueshme të portofolit, të tërheqin burime financimi dhe të sigurojnë qëndrueshmëri financiare.

Përsa i përket krizës së fundit, sipas një studimi të MFC, duket se sektori mikrofinanciar në Europën dhe Azinë Qëndrore ka ndaluar rritjen në 2009. Në Institucionet Financiare jo bankare numri i huamarrësve aktivë u rrit vetëm me 3%, pas disa vitesh rritje me deri 30% në vit, ndërsa vlera e portofolit bruto të kredisë ra me 9%.

Edhe në rastin e Bankave Mikrofinanciare, rritja u ngadalësua për të dytin vit rradhazi. Numri i kredimarrësve aktivë u zvogëlua me 3% krahasuar me 2008, megjithëse ato arritën të rrisnin portofolin në total të kredisë me 3%.

Viti 2009 karakterizohet gjithashtu edhe nga një përkeqësim absolut i vlerës bruto të portofolit të kredisë në risk. Për herë të parë në historinë e 15 viteve të sektorit të mikrofinancës në Europë dhe Azinë Qëndrore shumica e Insitucioneve Financiare jo bankare vuajti nga keqësimi i rëndësishëm i cilësisë së portofolit.

Vlera e portofolit në risk mbi 30 ditë, u dyfishua për Institucionet Financiare jo bankare për të arritur në 6.2%, nga 2.8% në fund të 2008. Institucionet me nivel të lartë PAR-i, shumë shpesh vëzhgonin ulje në numrin e klientëve dhe vlerën e portofolit të huasë.

Për 2010, shumica e Institucioneve Mikrofinanciare besojnë se do të jenë në gjëndje që të ulin kreditë e këqija, të rrisin numrin e klientëve që iu shërbejnë dhe të rrisin volumin e portofolit të tyre. Ky parashikim mbështetet në kërkesat për kredi, kapacitetet e personelit dhe situatën ekonomike në shtetet përkatëse. Megjithatë, shumica e tyre parashikojnë që kushtet e huamarrjes do të jenë më strikte. Humbjet e mëtejshme nga kursi i këmbimit janë të pritshme në 42% të Institucioneve Mikrofinanciare.⁷⁵

Mikrofinanca në Shqipëri

Institucionet mikrofinanciare u krijuan në vendet e Evropës Qëndrore – Lindore që në fillim të viteve 1990. Duke qënë fillimisht një fenomen krejtësisht i panjohur, ato filluan të rriteshin në kushtet e ndryshimeve ligjore, rritjes së papunësisë dhe rritjes së varfërisë. Ndërkohë, në Shqipëri mikrofinanca i pati fillimet e veta në vitin 1992, në kuadrin e programeve të zhvillimit të financuara nga Banka Botërore. Vit pas viti, këto projekte kaluan përmes një sërë transformimesh institucionale dhe ligjore duke u shndërruar në institucione të vërteta mikrofinanciare që ofrojnë shërbime për popullatat e përjashtuara nga sistemi financiar bankar.

Aktualisht, në vend operojnë me sukses disa institucione mikrofinanciare si Unioni SHKK, Fondi Besa, Opportunity Albania, FAF, Unioni Jehona etj..., aktiviteti i të cilëve bën të mundur që mijëra shqiptarë të kenë akses në shërbimet financiare

75 *Microfinance Sector In Eca In 2009, Preliminary Results.*

në mënyrë që të fillojnë dhe të zhvillojnë aktivitetet e tyre sipërmarrëse. Në fund të vitit 2009, sektori i mikrofinancës në Shqipëri rezultonte me një tepricë kredie mbi 179 milionë USD të shpërndarë në më shumë se 55.000 klientë aktivë. Përveç mikrokredisë, dy institucione të mikrofinancës në vend, Unioni SHKK dhe Unioni „Jehona”, operojnë prej vitesh edhe me depozita kursimi⁷⁶.

Treguesit Kryesorë të SHIM	2008	2009
Total Asete (mln USD)	163.35	179.41
Teprica e kredisë (mln USD)	144.05	147.45
Portofoli i Depozitave (mln USD)	14.64	15.57
Numri i huamarrësve aktivë	50,681	55,727
Portofoli në Risk >30 ditë (mesatare e përllogaritur)	4%	4.78 %

Sektori i mikrofinancës është tashmë pjesë përbërëse e sektorit financiar në Shqipëri dhe vit pas viti ka treguar rritje, konsolidim e përmirësim të vazhdueshëm. Institucionet e mikrofinancës japin ndihmesën e tyre në drejtim të rritjes ekonomike në vend dhe reduktimit të varfërisë në zonat rurale dhe urbane, duke promovuar sektorin e mikro-ndërmarrjeve dhe të bizneseve të vogla.

Megjithëse në kushtet e efekteve të krizës ekonomike globale, gjatë 2008 sektori i mikrofinancës në Shqipëri u karakterizua nga një rritje e dukshme në treguesit kryesorë të saj, si ato të shtrirjes ashtu dhe të aktivitetit financiar (mikrokredi dhe depozita). Gjatë 2008, asetet në sektorin e mikrofinancës u rritën me 23.8 milionë USD, teprica e kredisë me 14 milionë USD, portofoli i depozitave me mbi 2 milionë USD dhe huamarrësit aktivë me 8.265 klientë⁷⁷.

Edhe objektivat për vitin 2010, synojnë rritje të mëtejshme të institucioneve të mikrofinancës në të gjithë treguesit e tyre. Sipas Bankës së Shqipërisë, si autoritet mbikëqyrës i mikrofinancës në vend, krahasuar me disa vende të tjera në rajon, mikrofinanca në Shqipëri ka shfaqur norma më të larta rritjeje me cilësi të mirë. Megjithatë, ka hapësira të mjaftueshme për t'i zhvilluar ato më tej. Mbajtja e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik, përmirësimi i nivelit për një ligj, rregulla më të mira për të drejtat pronësore dhe konkurrencë e lirë janë të gjithë faktorë shumë të rëndësishëm, të cilët do të përmirësojnë financimin e biznesit në Shqipëri, duke u mbështetur në faktin që Ekonomia shqiptare mbështetet në mikrobiznes. Sot, institucionet mikrofinanciare operojnë si institucione të pavarura me një numër klientësh gjithnjë e në rritje. Bankat gjithashtu, po tregojnë një farë interesi në mikrofinancim, por në një nivel të ulët, kjo mund të shpjegohet nga ngushtimi i konkurrencës në treg dhe nga nevoja për të eksploruar mundësi të reja investimi. Bankat janë veçanërisht aktive në mikrofinancimin në zonat urbane⁷⁸.

⁷⁶ Raport SHIM, 2009

⁷⁷ Raport SHIM 2008

⁷⁸ Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, në Konferencën Mesdhetare Euro mbi Mikrokreditin, 5 -6 Dhjetor 2005, Romë

Shpërndarja e informacionit me mënyrën më të shpejtë, më të mirë, më efikente dhe më të kuptueshme është përgjegjësi e të gjithë aktorëve të tregut, si për institucionin ndaj klientit ashtu edhe për klientin ndaj institucionit. Këto institucione duhet të ndërtojnë një strategji të qartë komunikimi me publikun për produktet që ofrojnë, kushtet financiare me të cilat i ofrojnë këto produkte dhe veçanërisht e rëndësishme për objektivat që ato kanë. Transparenca duhet të përfshijë avantazhet konkurruese të tyre ndaj bankave universale në kushtet e financimit dhe në asistencën që ato janë të afta të ofrojnë në lidhje me mirëadministrimin e portofolit të kredisë.⁷⁹

Unioni Shqiptar Kursim Kredi

Unioni SHKK është një nga aktorët më të rëndësishëm në sektorin e mikrofinancës dhe ofruesi ekskluziv i shërbimeve financiare në zonën rurale të vendit. Ai është një institucion mikrofinanciar i bazuar fuqishëm në filozofinë e kooperativës financiare. Unioni përfaqëson bashkimin vullnetar të Shoqërive Kursim Kredi në zonën rurale, të krijuara dhe të organizuara me qëllim ofrimin e shërbimeve financiare për anëtarët e tyre.

Shoqëritë e Kursim Kreditit, anëtare të Unionit SHKK, ushtrojnë aktivitet financiar në rreth 1000 fshatra në 16 rrethe të vendit në SHKK-të e rrjetit⁸⁰. Ato administrohen nga Bordet Drejtuese që zgjidhen në Asamblëtë e Përgjithshme Vjetore.

Ky aktivitet është një përgjigje përballë refuzimit të sistemit tradicional për personat në zonat rurale që kërkojnë një numër gjithnjë e më të madh shërbimesh financiare. Këto shërbime financiare mbështesin një sektor të gjerë duke kontribuar në rritjen e nivelit të punësimit, rritjen ekonomike dhe rritjen e të ardhurave.

Sektori rural, problemet dhe sfidat

Sektori rural jo prodhues i trashëguar nga e kaluara dhe i dominuar nga fermat e mëdha shtetërore ose kooperativat bujqësore, në fillim të viteve 1990 u transformua në një sektor rural karakterizuar nga mijëra ferma të vogla me baza familjare. Ferma familjare në zonën rurale është e fragmentizuar dhe sipërfaqja mesatare e saj është rreth 1.1 ha, kjo përbën një pengesë kryesore për përmirësimin e produktivitetit dhe zhvillimin efikent të sektorit bujqësor në vend. Fermat shumë të vogla dhe të fragmentizuara gjenden më shumë në zonat malore dhe ato veriore të vendit.

Fragmentizimi i tokës bujqësore sjell një sërë vështirësish për prodhimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe ka frenuar përdorimin më të madh të makinerive bujqësore. Nga ana tjetër, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë nga zonat rurale në zonat më të mëdha urbane ka rezultuar në një pjesë të konsiderueshme

79 *Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, në konferencën "Financa të Përgjegjshme", datë 23.03.2010*

80 *Unioni Shqiptar Kursim – Kredi, Raporti vjetor 2009*

të tokës bujqësore që ka mbetur e papunuar. Këto karakteristika dhe faktorë të tjerë prodhues dhe komercialë kanë krijuar një mjedis të përshtatshëm për importimin në shkallë të gjerë të produkteve të papërpunuara bujqësore nga jashtë, kryesisht nga vendet fqinje.

Sektori bujqësor është një nga sektorët më të rëndësishëm në ekonominë e vendit, duke kontribuar me rreth 21% në GDP. Familjet në zonën rurale vazhdojnë të dominojnë me më shumë se 50% të popullsisë, sektori bujqësor është alternativa kryesore dhe shpeshherë e vetme për punësimin e njerëzve që jetojnë në këtë zonë. Gjatë viteve 2001-2006 është llogaritur se rritja vjetore e prodhimit bujqësor mesatarisht ka qënë 3-3.5%⁸¹. Ky është një nivel poshtë normës së rritjes kombëtare dhe asaj potenciale. Kjo shpjegohet edhe si rezultat i problemeve specifike me të cilat përballlet ky sektor, ndër të cilat mund të përmendim:

- migrimi nga zonat rurale;
- pronësia e tokës dhe sipërfaqja shumë e kufizuar e fermës;
- marketingu i produkteve, niveli i ulët i zhvillimit të agro-përpunimit;
- niveli i ulët i teknologjive të përdorura;
- organizimi i dobët i fermerëve, etj...

Toka bujqësore përfaqëson vetëm 24% të sipërfaqes totale të vendit. Aktualisht, tregu i tokës në vend është i pazhvilluar. Nga statistikën e vitit 2006, rezulton se vetëm 2% e fermerëve kanë shitur tokë dhe vetëm 3.5% e tyre e kanë dhënë me qera. Disa nga faktorët që frenojnë zhvillimin e tregut të tokës janë: fragmentimi i tokës në shkallë të gjerë; tendenca e moshave të reja për të mos punuar në bujqësi; lidhjet e forta të fermerëve me tokën; tendenca për të mos shitur tokën e trashëguar; zhgënjimi i fermerëve me sistemin e mëparshëm të kooperativave bujqësore; pasiguria mbi pronësinë e tokës; në disa raste mbivendosja e pronësive; ndarja dhe ndërtime të paligjshme në tokat bujqësore etj...⁸²

Fermerët përballen me shumë probleme përsa i përket mekanizimit të bujqësisë. Një numër i madh traktorësh dhe makineri bujqësore janë importuar në vend vitet e fundit, por përsëri fermerët nuk zotërojnë akses të mjaftueshëm për këto mjete moderne. Kostot e këtyre makinerive janë të shtrenjta dhe si rrjedhojë niveli i përdorimit të mekanizimit bujqësor rritet ngadalë, kështu si alternativa e vetme për një numër të madh fermerësh shpeshherë mbeten përdorimi i mjeteve tradicionale si kafshët apo puna manuale.

Nevojat për financim në zonën rurale

Mungesa e funksionimit të sistemit financiar në zonat rurale ka patur një ndikim të konsiderueshëm në këto zona. Pavarësisht zhvillimit të sistemit bankar gjatë viteve

81 *Strategjia për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Nëntor 2007*

82 *Strategjia për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Nëntor 2007*

të fundit, banorët e zonave rurale praktikisht janë të përjashtuar nga tregu financiar, për një numër pa fund arsyes historike apo ligjore si mungesa e kolateralit tradicional, mungesa e funksionimit të plotë të sistemit ligjor, mosfunksionimi i tregut të tokës bujqësore, mungesa e eksperiencës në marrëveshjet me bankat, etj...

Edhe pse legjislacioni për vendosjen e tregut të tokës është përmirësuar ndjeshëm ka akoma pak transaksione me tokën bujqësore. Gjithashtu, ka shumë vështirësi lidhur me tregun e gjësë së gjallë dhe produkteve bujqësore. Shumica e familjeve rurale kanë akses të limituar në shërbimet bazë përfshirë edukimin dhe shërbimet primare shëndetësore. Aktualisht, asetit më i rëndësishëm për banorët e zonave rurale është toka, që e kombinuar me fuqinë punëtore, përbën burimin më të madh të të ardhurave. Shumica e sipërmartjeve në fshat janë shumë të vogla, të manaxhuara vetëm nga pronari dhe me pak staf, 1-5 persona. Shumica e transaksioneve financiare në fshat bëhen në cash. Midis investimeve më të rëndësishme në këtë sektor mund të përmendim investimet serioze në sistemin e vaditjes dhe drenazhimit, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në prodhim dhe në produktivitetin e tyre. Megjithatë investimet e bëra, një nga pengesat kryesore për realizimin e investimeve të reja në sektorin bujqësor është ekzistenca e fermave jashtëzakonisht të vogla e të copëtuara⁸³.

Praktikisht, popullata e zonës rurale nuk ka akses ose ka akses të kufizuar në shërbimet financiare të ofruara nga sistemi bankar. Aktualisht, në zonat rurale nuk ka degë bankare që të ofrojnë shërbime financiare dhe banorët në fshat duhet të udhëtojnë për në qytetin më të afërt për të shkuar dhe kryer transaksione në një bankë.

Produktet bankare në zonën rurale janë shumë pak të përdorura. Nga një studim i kryer nga EFSE në Shtator të vitit të kaluar, rreth 73.5% e të anketuarve në zonën rurale nuk i përdorin fare shërbimet bankare. Për më tepër, produkte financiare të tilla si leasing apo siguracioni nuk njihen fare nga popullata e kësaj zone. Përsa i përket kreditimit nga ana e institucioneve bankare, për fermerët ky konsiderohet si një proces i vështirë që përmban procedura të gjata dhe të komplikuar. Interesi i kredive që ofrojnë bankat është shumë i lartë dhe mungesa e kolateralit nga ana e fermerëve përbën një pengesë të madhe për të përfituar një kredi tek bankat komerciale. Gjithashtu, edhe kështet e shlyerjes të ofruara nga kreditimi në sistemin bankar, përbëjnë një problem për fermerët huamarrës që shpeshherë janë të detyruar të shlyejnë kredinë me këste mujore pa marrë parasysh ciklin e prodhimit që fillon shumë muaj mbas mbjelljes së produkteve bujqësore. Përrjashtim në këtë rast, përbëjnë kreditë e dhëna nga Unioni SHKK, i cili merr në konsideratë ciklin e të ardhurave dhe sezonalitetin e aktiviteteve bujqësore në kështet e shlyerjes së kredive⁸⁴.

Siç citohet nga studimi i EFSE-s: profili kreditues në zonën rurale është i karakterizuar nga mikrokredia dhe kredia në shuma të vogla. Kjo mund të shpjegohet për vetë faktin se popullata e varfër apo me të ardhura të ulëta është e përqëndruar kryesisht në zonën rurale dhe se kjo popullatë nuk ka asete të mjaftueshme për të

83 "Strategjia për zhvillimin rural", Botuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

84 "Boshllëku i financimit rural" – Studimi i EFSE, Shtator 2009

përfutur kredi në shuma relativisht më të mëdha.

Akoma më tej, rezultatet e këtij studimi tregojnë se kërkesa potenciale e zonës rurale për kredi do të vazhdojë të jetë e madhe dhe në vitet në vazhdim. Një kërkesë e tillë është e destinuar të plotësohet në një shkallë të konsiderueshme nga institucionet e mikrofinancës që operojnë në zonën rurale, kryesisht nga Shoqëritë e Kursim Kreditit anëtare të Unionit SHKK. Shoqëritë Kursim Kredi janë institucionet që dominojnë tregun e shërbimeve financiare në zonën rurale, gjë e cila konfirmohet edhe nga studimi i EFSE në Shtator 2009.

Bankat kooperative dhe mikrofinanca përballë krizave

Kriza e fundit financiare që preku thellë institucionet financiare dhe kryesisht investuesit financiarë në pronat e patundshme e sigurime, dëshmoi se bankat kooperative zotërojnë një imunitet më të mirë kundrejt krizave të tilla. Edhe pse disa nga bankat e mëdha kooperative kanë ndjerë efektet negative të shkaktuara nga kriza, prapë se prapë rezultoi se ato janë goditur shumë më pak nga efektet e krizës globale sesa bankat private dhe të investimeve. Tiparet kryesore që i veçojnë dhe i bëjnë më të mbrojtura në kohë krizash bankat kooperative nga bankat private ose të investimeve janë:

- kapitalizimi dhe qëndrueshmëria e mirë e tyre;
- aplikimi i një modeli të ndryshëm banking-u që i vendos anëtarët dhe klientët në zemër të tij;
- ushtrimi i një mekanizmi kontrolli nga poshtë lart;
- skema të brendshme të garantimit të depozitave;
- përfshirja e gjerë e anëtarëve në vendimmarrje nga poshtë lart.

Kriza globale tregoi gjithashtu se bankat kooperative u shfaqën si fituese të dukshme të situatës, me rritje të lehtë të aseteve, si një model biznesi i suksesshëm që prodhon burime të qëndrueshme dhe partneritet me klientët.

Një nga dëshmitë më të forta të popullaritetit dhe suksesit të modelit të bankave kooperative është edhe forcimi i pozicionit të tyre në treg në dekadat e fundit. Kjo tregohet qartë edhe në trendin e raportit anëtarë-popullatë në bankat kooperative në Europë, ku ky raport është rritur nga 14 përqind në 17 përqind për periudhën 1996-2008.

Unioni SHKK, model i qëndrueshëm përballë krizave

Siç është përmendur edhe më lart, Unioni SHKK i ka rrënjët e veta në modelin e kooperativave financiare që është një model i njohur dhe i zbatuar në Evropë nga i cili kanë origjinën e tyre Banka të mëdha si Raiffeisen, Credit Mutuel, Rabobank, Credit Cooperatif, etj... Si një aktor i rëndësishëm i mikrofinancës në vend dhe si një zbatues i modelit të kooperativës financiare, Unioni SHKK gjatë kësaj periudhe tregoi se di të përballojë me sukses efekte negative të shkaktuara nga kriza të tilla si në aspektin

psikologjik ashtu edhe atë financiar. Kjo është bërë e mundur edhe nëpërmjet afërsisë që ekziston me klientët dhe profilin e tij.

Shoqëritë e Kursim Kreditit gjenden dhe funksionojnë në zemër të fshatit. Ekzistenca e skemave mbrojtëse, mekanizmave të kontrollit të ndërthurura, marrja e vendimeve sipas parimit “një anëtar një votë” dhe përgjegjësia sociale janë avantazhe që e bëjnë Unionin tepër të adaptueshëm dhe të mbrojtur kundrejt pasojave të tilla negative.

Qeverisja e bazuar në parimin “një njeri një votë” është një përparësi që edukon marrjen e vendimeve me pjesëmarrjen e të gjithë faktorëve të rëndësishëm duke gjykuar mbi leverdinë e një projekti si në afatshkurtër edhe në afatgjatë. Si një institucion që i ka rrënjët në filozofinë e kooperativës financiare, i qëndron besnik parimeve bazë të kësaj filozofie si përgjegjësia, solidariteti dhe afërsia.

Të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e institucionit në raport me anëtarin, komunitetin dhe nevojat për zhvillim të zonës rurale, Unioni do të vazhdojë të zgjerojë shkallën dhe format e ndërhyrjes, duke rritur performancat dhe qëndrueshmërinë financiare. Një nga sfidat me të cilat do të përballet institucioni në vitet në vazhdim është studimi dhe kuptimi më i mirë i nevojave të klientëve në mënyrë që të adaptohen si duhen politikat dhe produktet financiare.

Gjithashtu, në vazhdim të përmbushjes së misionit social, Unioni do të punojë për të lehtësuar aksesin e njerëzve të varfër dhe me të ardhura të ulta për shërbime financiare duke forcuar aftësitë institucionale, adoptuar shërbimet financiare sipas nevojave specifike dhe trajnuar stafin mbi një bazë të vazhdueshme. Për të rritur produktivitetin dhe forcuar performancat e tij financiare, Unioni do të fokusohet edhe në zhvillimin e teknologjive të reja si një kërkesë që shtrihet tregu financiar dhe anëtarët /klientët e Grupit.

Në përballjen me sukses të këtyre sfidave dhe për të rritur pozicionin e vet në treg si lider i shërbimeve financiare në zonën rurale, Unioni do t'i qëndrojë besnik modelit të vet të bankingut dhe të qeverisjes të bazuar në anëtarësinë e tij.

Muhamed Yunus, themelues i Grammeen Bank dhe fituesi i Çmimit Nobel në mikrofinancë thotë: “Varfëria nuk është krijuar nga të varfërit. Është krijuar nga struktura të shoqërisë dhe nga politikat e ndjekura prej shoqërisë. Ndryshoni këto struktura dhe ju do ta shihni sesi të varfërit do ndryshojnë jetën e tyre”. Eksperienca e Grammen Bank tregon se sapo u jepet një suport financiar, sado i vogël, të varfërit janë plotësisht të aftë të ndryshojnë jetën e tyre.

Mikrofinanca nuk është edhe aq e veshtirë, është një mision sa social dhe ekonomik që na inspiron për të ecur përpara.

Literatura:

- “Strategjia për zhvillimin rural”, botuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Nëntor 2007.
- “Strategjia e sektorit të bujqësisë dhe Ushqimit”, botuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, Nëntor 2007
- “Boshllëku i financimit rural” Studimi i EFSE, Shtator 2009.
- Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, në Konferencën Mesdhetare Euro mbi Mikrokreditin, 5 -6 Dhjetor 2005, Romë
- Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani, në konferencën “Financa të Përgjegjshme”, datë 23.03.2010
- Raporte të SHIM 2008 dhe 2009
- MICROFINANCE SECTOR IN ECA IN 2009, Preliminary Results

Risku i kredidhënies në Shqipëri

MA. Majlinda Gjata

Departamenti i Menaxhimit të Riskut të Kredisë, Banka Raiffeisen

MA. Evis Gjebrea

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT. *Kriza financiare, e cila filloi në vitin 2008 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shumë shpejt u përhap në të gjithë botën dhe u transformua në një krizë ekonomike duke prekur ekonomitë reale. Kjo krizë dëshmoi sesa e globalizuar është ekonomia botërore dhe se efektet negative që një vend përjeton përhapen në mënyrë zinxhir edhe në vendet e tjera. Ekonomitë e vendeve në zhvillim fillimisht nuk u prekën, duke qënë më pak të integruara në tregjet financiare botërore dhe më pak të ekspozuara ndaj produkteve financiare të sofistikuara, të cilat ishin në qendër të krizës. Por, thellimi i krizës në pjesën e dytë të vitit dhe rritja e ndikimit në ekonomitë reale solli pasoja edhe në vendet në zhvillim. Në Shqipëri kriza nuk e preku sektorin financiar në ato përmasa si në vendet e tjera dhe madje mund të thuhet në nivele të papërfillshme. Kjo si rezultat i mungesës së ekspozimit të sektorit bankar Shqiptar ndaj produkteve financiare të sofistikuara, ndaj institucioneve financiare që ishin në qendër të krizës dhe për shkak të nivelit të ulët të huamarrjes në tregjet botërore financiare. Megjithatë, në tremujorin e fundit të vitit 2008, për shkak të efektit psikologjik të shkaktuar nga kriza, shumë depozitues tërhoqën fondet e tyre, duke shkaktuar probleme me likuiditetin e bankave. Kjo solli nevojën e bankave për likuiditet, si dhe rënien e ritmeve të kreditimit në sektorin bankar. Megjithatë situata e likuiditetit të bankave u stabilizua shumë shpejt nëpërmjet ndërgjegjësimit nga Banka e Shqipërisë për mostërheqjen e depozitave. Ekonomia shqiptare, duke qënë një ekonomi që ka si burim të rëndësishëm dërgesat e emigrantëve nga jashtë, ndjeu pasojat e rënies së këtyre dërgesave. Kjo ndikon më pas në rënien e kërkesës konsumatore ndaj produkteve të bizneseve, duke i shkaktuar këtyre të fundit vështirësi financiare për shlyerjen e detyrimeve. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë rrezikun e kredisë bankare, duke prezantuar efektin që ka pasur kriza botërore globale mbi aftësinë paguese të kredimarrësve shqiptarë. Në këtë studim do të paraqitet jo vetëm efekti i krizës, por do të prezantohen masat e propozuara (ndërmarra) për uljen e rrezikut.*

Hyrje:

I. Kriza Financiare Botërore dhe Efektet e saj në Ekonomitë Reale të Vendeve të Botës

Jemi dëshmitarë që bota sot është e globalizuar dhe nuk ka sesi të habitemi përse kriza financiare që filloi në SHBA “infektoi” sistemin bankar dhe ekonominë e vendeve të botës me një ritëm shumë të shpejtë. Sipas Stephen Roach, përfaqësues i Morgan Stanley në Azi kur ekonomia dhe konsumatori amerikan kanë probleme kjo nënkupton pasoja për gjithë ekonominë botërore⁸⁵.

Data 14 Shtator 2008 do të shënonte zyrtarisht datën e tërmetit të sistemit bankar në Amerikë kur Banka Lehman Brothers shpalli falimentimin dhe kërkoi mbrojtjen nga ligji amerikan, që ka të bëjë me shpalljen e falimentimit dhe vënien nën administrimin shtetëror. Pas këtij veprimi kompania vlerësuese e cilësisë së bankave Moody’s njoftoi se vlerësimi i Bankës ulej nga niveli « A2 » në nivelin shumë të ulët « B3 »⁸⁶.

Origjina e kësaj krize që ndryshe quhet si « *subprime mortgage meltdown* », daton në vitin 2006 kur vlera e kredive hipotekare pësoi rënie si rezultat i politikës që u përdor për dhënien e kredive çdo personi pa marrë parasysh aftësinë e tyre garantuese të kthimit të kredisë. U bë tashmë i njohur fenomeni që kredi mund të merrte madje edhe një babysitter, pa pasur garanci dhe të ardhura të mjaftueshme për kthimin e kredisë.

Për ata lexues që nuk janë ekonomistë të mirëfilltë, dhënia e kredisë nga një bankë bëhet mbi bazën e analizës së riskut të kredisë, që do të thotë të analizimit të aftësisë kthyesë të shumës së gjithë kredisë plus pagesës së interesave që aplikohen mbi këtë shumë. Ajo që ndodhi në SHBA nuk mori parasysh rreziqet në kthimin e kredive të cilat ishin evidente. Pas kësaj banke do të shihnim edhe banka të tjera si Merrill Lynch, Bearn Stearns etj që do të falimentonin zinxhir jo vetëm në Amerikë, por edhe në botë.

Vetëm gjatë 2 tremujorëve të fundit të 2007-ës Banka « Goldman Sachs » në SHBA humbi 1.5 miliardë USD, Merrill Lynch 8.4 miliardë USD, Citigroup 6 miliardë USD, UBS Zvicër 11 miliardë franga zvicerane, Deutsche Bank 2.2 miliardë Euro etj, ndërkohë sipas vlerësimit të « Royal Bank of Scotland », humbjet e bankave në këtë periudhë janë rreth 500 miliardë dollarë⁸⁷.

Për të normalizuar këtë situatë hapi i pare që ndërmorën qeveritë e shumë vendeve në botë ishte injektimi i likuiditetit nga ana e Bankave Qendrore të shumë vendeve në

85 Civici, Adrian, “Globalizimi”, UET Press, 2009, f. 109

86 Civici, Adrian, “Globalizimi”, UET Press, 2009 f. 108

87 Civici, Adrian, “Globalizimi”, UET Press, 2009 f. 108

tregjet ndër-bankare. Konkretisht, në 7 gusht 2007 në ndërhyrjen e parë që u bë për këtë qëllim, Banka Qendrore Evropiane hodhi në tregun evropian 95 miliardë Euro, ndërsa Fed Amerikan që është ekuivalenti i Bankës Qendrore po në të njëjtën ditë injektoi në tregun financiar amerikan 24 miliardë USA⁸⁸.


Shumë shpejt kjo krizë do të transformohej nga një krizë financiare në një krizë ekonomike botërore duke prekur ekonomitë reale të vendeve të ndryshme. Sipas një vështrimi mbi ekonominë botërore i kryer nga FMN është parashikuar që prodhimi botëror në vitin 2009 do të ulet me 1.3%, ndërsa në vitin 2010 do të rritet me 1.9%⁸⁹. Ritmet e rritjes së ekonomisë botërore u ulën nga 5% që ka qenë për 5 vitet e fundit për të arritur në 3.4%. Inflacioni mesatar në nivel global arriti në 3.5% në vitin 2008 nga 2.1% që ishte në vitin 2007⁹⁰.

Tabela dhe grafikët e mëposhtëm tregojnë se çfarë ndodhi me ekonomitë e vendeve më të zhvilluara në botë.

	Rritja e PBB-së		Norma Vjetore e Papunësisë		Norma Vjetore e Inflacionit	
Vendet	2007	2008	2007	2008	2007	2008
SHBA	2	1.1	4.6	5.8	2.9	3.8
Eurozonë	2.7	0.9	7.5	7.5	2.1	3.3
Gjermani	2.5	1.3	8.4	7.3	2.3	2.8
Greqi	4	2.9	8.3	8.3	3	4.2
Itali	2.9	-0.6	6.1	6.7	2	3.5
Japoni	1.9	-0.6	3.9	4	0	1.4

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2008, fq. 15

Treguesit kryesorë për vitin 2007




88 Civici, Adrian, "Globalizimi", UET Press, 2009 f. 108

89 FMN, *World Economic Outlook*, prill 2009, f. 16,

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2009/01/pdf/text.pdf>

90 Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, fq. 15

Treguesit kryesorë për vitin 2008



Ashtu siç e tregojnë indikatorët makroekonomikë, ekonomitë në botë janë tronditur nga kriza financiare. Artikulli në vijim sqaron efektet që kriza pati në ekonomitë reale të vendeve, që duket si një proces zinxhir duke prekur jo vetëm financat e qeverive, por edhe ato të individit.

Si rezultat i falimentimit të shumë bankave në Amerikë dhe Evropë u shkurtuan vende pune, duke rritur nivelin e papunësisë së këtyre vendeve. Rritja e papunësisë për një individ do të thotë më pak të ardhura dhe ulje e konsumit personal apo familjar. Ulja e konsumit bën që çmimet e mallrave të bien, duke sjellë më pak të ardhura për bizneset apo qeveritë e vendeve. Për ato vende, ekonomitë e të cilave varen nga eksportet, ulja e çmimeve në rang botëror keqëson bilancin tregtar, e cila është llogaria që pasqyron eksportet dhe importet e një vendi. Situata mund të jetë më me avantazh për vendet, ekonomitë e të cilave varen nga importet, duke përfutur mallrat apo shërbimet me çmime më të lira.

Si ekonomia amerikane ashtu edhe ajo e Eurozonës kanë njohur ritme të ulta të rritjes së PBB-së: në SHBA nga 2% që ishte në vitin 2007 u ul në 1.1 % në vitin 2008 apo në Eurozonë nga 2.7 % që ishte në vitin 2007 në 0.9% në vitin 2008, çka tregon për një ngadalësim të kërkesës së brendshme.

Megjithëse çmimet u ulën për shkak të uljes së kërkesës së brendshme, përsëri çmimi i energjisë si dhe ai i ushqimeve të përpunuara u rrit. Kjo ka ndikuar në rritjen e inflacionit në të gjitha vendet, sipas tabelës së mësipërme. Ajo që është shqetësuese në veçanti për Eurozonën është se inflacioni arriti në 3.3%, duke tejkaluar kufirin e lejuar nga Banka Qendrore Evropiane që është 2%.

Efekti primar që kriza financiare pati ishte humbja e besimit nga individët ndaj sistemit financiar. Kjo u reflektua në tërheqjen e depozitave nga llogaritë bankare apo në mos investimin e parave nëpër banka. Si rrjedhim, shumë qeveri të botës përfshi edhe Shqipërinë bënë deklarata publike, apo edhe nxitën popullatën që të mos nxitonin të tërhiqnin paratë, duke i garantuar se ishte pikërisht shteti që tashmë po ndërhynte duke injektuar likuiditete për t'i shpëtuar bankat nga kriza.

Si rezultat i mos pasjes së likuiditetit të nevojshëm, kredia në ekonomi ulet për shkak se bëhet më e shtrenjtë dhe nuk është e disponueshme në mënyrë të lirë. Kjo frenon bizneset për rritjen e aktivitetit të tyre ekonomik, duke pasur efekt në uljen e ritmeve të zhvillimit ekonomik, ose e thënë ndryshe në uljen e rritjes ekonomike.

Kjo situatë shkakton vështirësi për qeverinë, e cila për të stimuluar rritjen ekonomike i duhet të marrë para borxh. Për shkak të krizës financiare botërore, kredia në tregjet ndërkombëtare u shtrenjtua dhe shumë qeveri u gjendën përballë zgjedhjes së financimit të borxhit të tyre nëpërmjet instrumenteve financiarë në tregun e brendshëm, siç janë bonot e thesarit. Rritja e kërkesës për këto instrumente shkaktoi rritjen e normave të interesit, duke çuar në rritjen e shpenzimeve nga ana e Qeverisë për kryerjen e shërbimit të borxhit, e cila është në rolin e huamarrësit. Rritja e shpenzimeve nga ana e qeverisë do të thotë përkeqësim i defiçitit buxhetor.

Një tjetër efekt negativ i krizës ka të bëjë me tkurrjen e investimeve të huaja. Investitorët kudo në botë, duke pasur problemet e tyre të likuiditetit, nuk janë të gatshëm të investojnë në vende të tjera. Kjo është dhe një ndër arsytet përse qeveritë rriten ritmet e tyre të marrjes së borxhit, për të financuar rritjen ekonomike të sqaruar më lart.

Në të njëjtën kohë pakësimi i investimeve do të thotë më pak valutë e huaj në vend. Duke qenë se valuta pakësohet ajo bëhet më e shtrenjtë, duke vendosur presione ndaj monedhës vendase, e cila zhvlerësohet.

II. Risku i Kredisë në Shqipëri

Risku i kredisë është rreziku që shfaqet nga pamundësia e shlyerjes së kredisë nga ana e kredimarrësve. Çdo bankë kur jep një kredi analizon riskun e kthimit të saj dhe sigurohet për kthyeshmërinë mbi bazën e kolateralit të kërkuar, situatës financiare të kredimarrësit apo edhe kërkesën për palë të tretë që të garantojë kredimarrësin, në rast të konstatimit të vështirësive të kthimit të kredisë.

Ashtu siç do të analizohet edhe në këtë artikull, ndonëse Shqipëria nuk u prek nga kriza financiare në ato përmasa që u prekën vendet e tjera, përsëri mund të thuhet se si bizneset, ashtu edhe individët, hasën vështirësi në përballimin e aktivitetit të tyre ekonomik dhe të përballimit të jetesës.

Sipas raportit të Bankës së Shqipërisë mbi Stabilitetin Financiar për vitin 2008, ndjeshmëria e sistemit financiar dhe sektorit bankar është rritur ndaj zhvillimeve të brendshme makroekonomike. Vështirësitë e sektorit real kanë thelluar vështirësitë financiare për sipërmarrjet e biznesit dhe për familjet. Kjo, për arsye se sipërmarrjet e biznesit përballen me burime më të rralla dhe më të shtrenjta financimi.

Vrojtimet e ndryshme për gjendjen e sektorit të biznesit në përgjithësi konfirmojnë rritjen e vështirësive financiare në situatën aktuale dhe mungesën e optimizmit për zhvillimet afatshkurtra⁹¹.

91 *Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2008 për Stabilitetin Financiar, fq 12*

Konkretisht, veprimtaritë kryesore të bizneseve shqiptare janë ndikuar negativisht prej rënies së investimeve dhe shitjeve. Krijimi i vështirësive për bizneset do të thotë më pak vende pune, pra rritje të papunësisë, duke shkaktuar rënie të të ardhurave të individëve dhe familjeve dhe si rrjedhim, uljen e kërkesës. Gjithashtu, edhe burimet e jashtme të financimit për bizneset janë ulur për shkak të rënies së kreditimit nga ana e bankave.

Vështirësitë e sektorit real të ekonomisë, si rezultat i ngadalësimit të rritjes ekonomike, tkurrjes së kreditimit nga ana e bankave për shkak të vështirësive të likuiditetit në muajt e fundit të vitit 2008 kanë sjellë rritjen e vëllimit të kredive me probleme. Kjo ka ndikuar në cilësinë e portofolit të kredisë në drejtim të rritjes së kredive me probleme, duke nxitur shtrëngimin e procedurave në kredidhënie.

Sektori bankar është i ndjeshëm ndaj sjelljes së kursit të këmbimit, veçanërisht për ndikimin që kjo përcjell në cilësinë e portofolit të kredisë. Kriza botërore shfaq presione ndaj kursit të këmbimit në Shqipëri. Në Shqipëri kredia në valutë mbizotëron në totalin e kredisë, për shkak të normave të ulëta të interesit dhe për shkak të një lloj qëndrueshmërie që kursi i këmbimit të lekut ka treguar në vitet e fundit.

Por, nënvlerësimi i lekut në vitin 2009, si rezultat i krizës së fundit botërore solli probleme tek individët, të cilët duhet të ishin të gatshëm të sakrifikonin më shumë lekë për të shlyer këstet e kredive në valutë. Kjo situatë përbënte rrezikun e krijimit të vonesave për shlyerjen e kredive, duke rritur shanset e kthimit të kredive në kredi me probleme dhe krijuar vështirësi për bankat.

Aftësia për të shlyer borxhin është drejtpërdrejtë e lidhur me gjendjen financiare të firmave dhe në këtë drejtim me rëndësi është vlerësimi i ecurisë së stabilitetit financiar të firmave. Gjithashtu, i rëndësishëm është edhe treguesi i kërkesës së pritshme për tremujorin e parë të vitit 2009, i cili jep informacion mbi potencialin e rritjes së veprimtarisë së këtyre sektorëve dhe aftësinë e tyre për të kapërcyer një situatë relativisht më të vështirë⁹².

Sipas vlerësimit të Bankës së Shqipërisë në raportin vjetor të stabilitetit financiar, gjendja financiare e firmave në sektorët e industrisë dhe shërbimeve ka një rënie të konsiderueshme, sidomos gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, duke nënkuptuar se rreziku i kredisë në lidhje me këta sektorë mund të jetë rritur. Po ashtu, vrojtimi në sektorin e ndërtimit tregon se gjendja financiare e firmave të ndërtimit është përkeqësuar gjatë gjashtëmujorit të dytë, ndërsa ajo mbetet mbi mesataren e tre viteve të fundit.

Po sipas këtij raporti, edhe situata financiare e individëve, e shprehur nga treguesi i situatës financiare aktuale dhe të pritshme, gjithashtu dëshmon për një rënie të kursimeve dhe një rrezik më të madh të përkeqësimit të cilësisë së kredisë për individët. Të gjithë treguesit shfaqin një përkeqësim të përgjithshëm të situatës financiare të sipërmarrjeve të biznesit dhe të familjeve. Këto përkeqësime sjellin efekte që reflektohen në rënien e kërkesës për mallra, rënie të investimeve për shkak të kufizimeve për financim.

92 *Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2008 për Stabilitetin Financiar*

Sikurse është përmendur në këtë artikull përkeqësimi i sipërmarrjeve të biznesit çon në rritjen e numrit të individëve të papunë dhe kufizon në këtë mënyrë të ardhurat e familjeve. Sipas raportit vjetor të vitit 2008 të Bankës së Shqipërisë për stabilitetin financiar, treguesi i besimit të konsumatorit për tremujorin e fundit të vitit 2008 shfaq rënie nën mesataren e tij historike.

Gjatë vitit 2008 punëzënia është rritur, duke shënuar 12.7% në fund të tremujorit të katërt të vitit. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008 ritmi i rritjes vjetore të pagave, si në sektorin shtetëror, ashtu edhe në atë privat është ngadalësuar. Në terma nominale niveli i pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror u rrit mesatarisht me 7.5%, ndërsa paga mesatare e regjistruar në biznese gjatë nëntë muajve të parë të vitit vlerësohet të jetë rritur në terma nominale vjetore me rreth 15.1%. Në terma reale rritja vjetore e pagës mesatare të ndërmarrjeve ekonomike për këtë periudhë vlerësohet në rreth 11 %.

Gjatë tremujorëve të parë të vitit paga mesatare vjetore nominale për sektorin e prodhimit është rritur mesatarisht me 19.8% në degën e ndërtimit dhe me 11.8% në degën e industrisë. Në sektorin e shërbimeve rritja vjetore e pagës mesatare ka rezultuar e lartë për tregtinë me pakicë dhe atë me shumicë, me përkatësisht 25.5% dhe 12.9%.

Analiza e ecures së të ardhurave duhet mbështetur edhe me të dhënat mbi punësimin për të kuptuar më mirë dinamikën e ecures së të ardhurave përgjatë kohës. Rezultatet e vërtetimit për individët tregojnë se niveli i papunësisë për tremujorin e fundit të vitit 2008 është rritur ndjeshëm. Këtë gjë e konfirmon edhe rezultati i vërtetimit për të njëjtën periudhë të sektorëve të industrisë dhe të shërbimeve, të cilët kanë ulur punëzëninë. Përfundim bën sektori i ndërtimit, i cili shfaq një rritje të punëzënisë në tremujorin e katërt të vitit 2008.

Nga analiza e mësipërme rezulton se me forcimin e mundshëm të efekteve të krizës ndërkombëtare në ekonominë e vendit, aftësia e sektorit të ekonomive familjare për të gjeneruar të ardhura nëpërmjet punëzënisë mund të bjerë. Me rënie në nivelin e të ardhurave, rreziku që i kanoset sistemit financiar nëpërmjet cilësisë së kredithënisë për këtë sektor do të rritet.

Rënia ekonomike, ulja e investimeve, përkeqësimi i aktivitetit të bizneseve dhe situatës financiare të individëve, shtojnë presionin mbi Qeverinë Shqiptare për të gjallëruar ekonominë dhe injektuar likuiditet. Gjatë vitit 2009 Qeveria Shqiptare u përball me marrjen e borxhit të jashtëm me një kosto të lartë për shkak të tkurrjes së financimit në rang botëror. Ndonëse Shqipëria u klasifikua në 2007 nga Standard & Poor për të hyre në tregjet financiare ndërkombëtare, kjo gjë ende nuk ka ndodhur për shkak të krizës. Qeveria Shqiptare, e detyruar të mbulojë defiqitin buxhetor, si dhe financojë projektet e investimit, mori borxh nga banka private, i cili ishte tepër i shtrenjtë.

Drejt një mbikqyrje efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri

____ MSc Rinald Guri _____

Drejtoria e Kërkimit dhe Statistikës, AMF

____ MA Anxhela Dervishi _____

Drejtoria e Raportimit dhe Analizës Financiare, AMF

ABSTRAKT. *Mësimi kryesor i krizës së sotme botërore është rëndësia dhe rregullimi i efektshëm i institucioneve të rëndësishme financiare, i cili është jetik për qëndrueshmërinë financiare botërore. Kriza financiare e ka përqendruar gjithë vëmendjen te rëndësia e trajtimit të riskut të sistemit dhe te roli i rëndësishëm që mund të luajnë tregjet dhe institucionet rregullatore të tregjeve në trajtimin e kësaj çështjeje. Alternativa e parë e parashtruar në këtë temë, e cila vlerëson se një nga elementët më të rëndësishëm të një mbikqyrje efektive është adaptimi i përqasjes së re bashkëkohore, ajo e mbikqyrjes me bazë risku, është përkthyer si një strategji efektive afatgjatë e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF). Kriza e fundit financiare ka treguar rëndësinë e një infrastrukture të rëndësishme të mbikqyrjes në drejtim të administrimit të riskut. Siguruesit duhet të marrin përsipër një masë të caktuar risku në kursin e biznesit të tyre, duke realizuar njëkohësisht edhe fitimin e tyre. Praktikrat dhe strukturat e administrimit të riskut duhet t'u përshtaten mirë rreziqeve dhe sfidave që paraqet ambienti i biznesit.*

Fjalë kyçe:

Sigurim, risk, mbikëqyrje efektive

Modeli aktual dhe tendenca globale e kalimit në një mbikqyrje me bazë riskun

Modeli aktual, i njohur ndryshe dhe si Solvency I, i njeh fillimet në direktivat e vitit 1973 dhe 1979. Këto direktiva i kërkojnë siguruesve të disponojnë një nivel të mjaftueshëm kapitali me qëllim përballimin e pasigurive të

biznesit të sigurimeve. Rëndësia e rregullimit ligjor të aftësisë paguese u rrit me daljen e gjeneratës së tretë të direktivave të BE në vitin 1994, të cilat vendosën kontroll të tarifave dhe produkteve në vendet anëtare. Qëllimi i këtyre rregullave ishte kapja në kohë e problemeve të mundshme të siguruesve, me qëllim mbrojtjen më efikase të polic-mbajtësve. Vendet anëtare mund të hartonin rregulla më strikte, pasi në direktiva përcaktohet vetëm një minimum i përbashkët. Viti 2002 shënon adoptimin e direktivës së Solvency I, direktivë që amendoi pjesërisht sistemin e aftësisë paguese në fuqi. Kjo direktivë ishte detyruese në vitin 2004 dhe e la të pandryshueshëm mënyrën e përlllogaritjes së aftësisë paguese, me përjashtim të ndryshimit të disa komponentëve me qëllim një reflektim më të mirë të situatës. Konkretisht, u përcaktua një nivel më i lartë i fondit të garancisë, u kërkua rritja e minimumit të nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, u përforca mbikëqyrja (shoqëria e sigurimit duhet të jetë solvente në çdo moment dhe jo vetëm kur depoziton pasqyrat financiare) dhe fazat e ndërhyrjes në momentin e evidentimit të problemeve.

Sipas modelit Solvency I, shoqëria e sigurimit duhet të zotërojë minimalisht aftësi paguese në vlerën më të lartë, midis nivelit minimal të kërkuar sipas përlllogaritjeve dhe nivelit të fondit të garancisë. Në qoftë se do të analizoheshin anët e forta dhe të dobëta të modelit Solvency I, atëherë ndër pikat më të forta të këtij modeli janë thjeshtësia dhe plotësia. Për më tepër rezultatet e tij janë të krahasueshme midis kompanive të ndryshme. Megjithatë, ky model karakterizohet nga një sërë dobësish, ku kryesisht, ky model lë jashtë profilin e riskut specifik të shoqërive të sigurimit. Për këtë arsye, Solvency I shihet si një zgjidhje e ndërmjetme drejt një modeli rregullator, i cili do të reflektonte në mënyrë më të saktë risqet me të cilat një sigurues përballet.

Regjimi i aftësisë paguese në vendet e Bashkimit Evropian është duke iu nënshtruar një reforme të thellë. Një projekt i quajtur Solvency II do të prezantojë një regjim të ri të aftësisë paguese, i cili ka si synim vendosjen e një tërësie rregullash për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe standardeve për menaxhimin e riskut, në vendet e Bashkimit Evropian, të cilat do të zëvendësojnë kërkesat aktuale të Solvency I.

Qëllimi i Solvency II është, që t'i vijë në ndihmë mbikëqyrësve të mbrojnë në mënyrë më efektive interesat e polic-mbajtësve, duke ulur probabilitetin e falimentimeve të subjekteve të mbikëqyrura, si dhe duke ulur probabilitetin e humbjeve të konsumatorëve dhe të çrregullimeve të tregut. Ky projekt gjithashtu synon të lehtësojë biznesin për shoqëritë e sigurimit në vendet e BE, pasi rregullat aktuale që ndryshojnë sipas juridiksioneve, do të zëvendësohen me kërkesa më të harmonizuara. Kuadri ligjor që po hartohet, përbëhet nga tre "kolona" dhe është ekuivalente e rregullimit të bankave nën Basel II. Ky sistem adreson risqet nga këndvështrimi sasior, i proceseve mbikëqyrëse, transparencës dhe publikimit. Për finalizimin e këtij projekti është parashikuar fillimi i vitit 2013.

Çfarë është mbikëqyrja me bazë risku

Qëllimi i mbikëqyrjes me bazë risku, është të përqendrojë përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë dhe fuqisë financiare, tek menaxhimi i kompanisë dhe këshilli mbikëqyrës.

Është përgjegjësi e kompanisë, që të ketë politika dhe praktika të mira për menaxhimin e riskut që lidhet me biznesin e saj. Mbikëqyrja nga ana e Autoritetit Rregullator bëhet nëpërmjet analizave selektive dhe procedurave të testimit, për të matur se sa efikase është kompania në menaxhimin dhe zbutjen e risqeve.

Koncepti bazë i mbikëqyrjes me bazë risku, është identifikimi i risqeve dhe fokusimi tek risqet më të mëdha në veprimtarinë e një kompanie sigurimi dhe më pas puna me menaxhimin e shoqërisë, me qëllim minimizimin e këtyre risqeve drejt niveleve të pranueshme.

Objektivi i përjasjes me bazë risku, është parandalimi i vështirësive financiare, përpara se ato të ndodhin, në alternativë me tentativën për t'i rregulluar këto probleme, pasi ato kanë ndodhur. Shoqëria e sigurimit, duhet të ketë një sistem të menaxhimit të riskut, për sinjalizimin dhe kontrollin, me qëllim që risqet të jenë brenda niveleve të përcaktuara në politikat e shoqërisë. Në këtë mënyrë, sistemi mbikëqyrës me bazë risku, jo vetëm që identifikon dhe mat risqet, që lidhen me aktivitetin e një shoqërie sigurimi, por merr në konsideratë dhe deri në çfarë mase këto risqe minimizohen dhe menaxhohen nga proceset apo modelet e brendshme të shoqërisë.

Një sistem mbikëqyrje me bazë risku, ka në thelb matjen e risqeve në mënyrën më objektive të mundshme, duke përdorur edhe tregues financiarë apo duke aplikuar norma për matjen e efikasitetit të Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë. Qëllimi është hartimi i një profili risku, i cili përfaqëson vlerësimin nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës për shoqërinë në lidhje me fushat e risqeve specifike të shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve. Përveç se është një sistem që identifikon dhe mat risqet, pjesë e këtij sistemi janë dhe fazat e ndërhyrjes nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës, gjatë niveleve të ndryshme të riskut, ndërhyrje e cila shpeshtohet dhe forcohet me rritjen e nivelit të riskut në një shoqëri sigurimi.

Një rol tepër të rëndësishëm në përjasjen me bazë risku luan dhe qeverisja e mirë e kompanisë, duke përfshirë dhe praktikatat për menaxhimin e riskut. Roli dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe Menaxhimit të Lartë të shoqërisë, janë thelbësore për garantimin e praktikave të shëndosha financiare dhe të ecurisë së biznesit.

Kriza financiare e kohëve të fundit nxori në pah se institucionet e menaxhuara mirë i rezistojnë turbulencave financiare për një kohë më të gjatë, sesa institucionet e keq menaxhuara. Sado e fortë dhe efikase të jetë mbikëqyrja, ajo nuk mund t'i shndërrojë institucionet me menaxhim të dobët, në institucione financiarisht të shëndetshme. Kjo është një nga arsyet kryesore, që mbikëqyrja me bazë risku vendos theksin tek cilësia e menaxhimit dhe praktikave të shëndetshme financiare. Tendenca mbarë globale e forcimit të standardeve të qeverisjes së kompanive rritet faktin se menaxhimi i fortë dhe cilësor përbën garancinë më të mirë për institucione financiare më të shëndetshme.

Kompanitë e mirë menaxhuara karakterizohen nga lidhshmëri i fortë, i cili e përcjell qartë vizionin e kompanisë tek stafi. Në këto kompani procedurat dhe politikat janë të mirë dokumentuara dhe zbatohen me rigorozitet nga punonjësit. Ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave është e qartë si dhe funksionojnë më së miri mekanizmat

e kontrollit të brendshëm. Politika e kontabilitetit është konservative. Institucionet e keq menaxhuara angazhohen shpesh në praktika agresive kontabiliteti dhe metoda të tjera për të fshehur parametrat e dobët, të cilat do të shkaktonin reagim nga ana e rregullatorit.

Avantazhet dhe sfidat në implementimin e një sistemi efektiv mbikëqyrës me bazë riskun në Shqipëri

Parandalimi dhe shmangia e problemeve – Një nga disavantazhet e mbikëqyrjes tradicionale e bazuar në rregulla është se problemet në shumicën e rasteve evidentohen kur mund të jetë tepër vonë për t'i eliminuar dhe për rrjedhojë mbikëqyrja mundohet të minimizojë pasojat. Mbikëqyrja me bazë risku mundohet t'i evidentojë problemet dhe të reduktojë riskun, përpara se këto të kthehen në probleme serioze, pra synon parandalimin e problemeve dhe jo shërimin e pasojave.

Menaxhim risku më i mirë dhe aftësi më të mira të mbajtjes së riskut – Qëllimi i mbikëqyrjes me bazë risku është arritja e një niveli më të mirë e menaxhimit të riskut nga ana e subjekteve të mbikëqyrura, bazuar në praktika të shëndosha. Kur kjo gjë arrihet atëherë përfitimet i kalojnë dhe industrisë, si rezultat i kompanive më efikente dhe aftësive më të mira të mbajtjes së riskut. Efektet pozitive ekonomike në këtë rast janë të dukshme dhe në nivel makro, në sajë të një tregu më eficient.

Përdorimi me efikasitet i burimeve – Duke qenë se burimet e mbikëqyrësve janë gjithmonë të kufizuara, energjia dhe fokusi më i madh i kushtohet problemeve dhe çështjeve me risk më të lartë dhe që mund të shkaktojnë më shumë dëm ndaj sistemit financiar. Alokimi efikas i stafit tek shoqëritë me prioritet të lartë është thelbësor në arritjen e objektivave mbikëqyrëse. Një sistem i paralajmërimit të hershëm në kohë mund të ndihmojë këtë proces, duke identifikuar siguresit që duhet të analizohen më herët dhe deri në detaje. Mbikëqyrja me bazë risku konsideron rolin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë, politikave dhe rregullave të brendshme si elementë të cilët, nëse ndiqen dhe zbatohen me rigorozitet nga menaxhimi, reduktojnë ndjeshëm shfaqjen e problemeve.

Përqasje e strukturuar dhe e qëndrueshme në vlerësimin e riskut – Pavarësisht faktit se mbikëqyrja me bazë risku përdor gjykimin në një shkallë të lartë, një përqasje e tillë mund të strukturohet në mënyrë që të sigurojë një përqasje të strukturuar dhe të qëndrueshme në vlerësimin e riskut nga ana e mbikëqyrësit. Metodologjitë e bazuara në risk, sigurojnë qëndrueshmëri në vlerësimin e riskut dhe vendimmarrje, nëpërmjet përdorimit të variablave të pranueshme për matjen e riskut. Një pjesë e tyre mund të maten më me saktësi dhe t'i vendosen pesha specifike sipas rëndësisë, gjë që e bën metodologjinë e përdorur më pak të hapur ndaj gjykimit. Një gjë e tillë minimizon subjektivizmin që karakterizon interpretimet e ndryshme nga individë të ndryshëm brenda një organizate, në lidhje me një vlerësim apo një situatë të caktuar.

Sfiduese për stafin mbikëqyrës – Përqasja me bazë risku kërkon mbajtjen e një komunikimi të vazhdueshëm me industrinë dhe kryesisht me menaxhimin e lartë të

shoqërisë së sigurimit, në lidhje me veprimtarinë dhe planet e ardhshme të shoqërisë. Inspektimi në vend merr një rol më thelbësor në një përjasje me bazë risku, pasi informacioni që inspektori i mbikqyrjes kërkon të marrë është pak a shumë i njëjtë me informacionin që menaxhimi i lartë i shoqërisë së sigurimit përdor për hartimin e strategjive të vetë shoqërisë. Në shumë raste matet kredibiliteti dhe risku i mundësive të marra në konsideratë nga menaxhimi i shoqërisë në realizimin e strategjive, gjë që kërkon një profesionalizëm të lartë dhe është më sfiduese sesa roli që stafi mbikëqyrës luan në një ambient tradicional mbikqyrje me bazë rregullat.

Transparente për industrinë – Qëndrueshmëria, struktura dhe objektiviteti që karakterizojnë një sistem të tillë, rrisin transparencën si për Qeverinë ashtu edhe për industrinë. Duke qenë se kemi të bëjmë me një sistem formal, ku veprimet janë të dokumentuara dhe të shpjeguara, kjo gjë e bën të lehtë përkrahjen politike dhe kuptimin e veprimeve të mbikëqyrësit në instanca të larta të vendimmarrjes politike. Për industrinë ky sistem ka të njëjtin sërë përfitimesh në sajë të transparencës që ofron. Duke qenë se, siguruesit do të kenë akses se si maten dhe vlerësohen risqet nga ana e rregullatorit, përfshi këtu edhe veprimet që implikojnë ato, do të jenë në gjendje të gjejnë alternativa me risk më të ulët në arritjen e objektivave të tyre.

Mbikëqyrja tradicionale bazuar në rregulla, ka rezultuar jo efikase në vendosjen e kufizimeve që tentojnë të parandalojnë vështirësitë financiare për subjektet e mbikëqyrura. Kjo për vetë faktin se tregu financiar zhvillohet me një dinamikë të lartë, në kundërshtim me rregullat të cilat janë statike. Rregullat nuk mund të parashikojnë çdo lloj skenari apo situatë, pavarësisht faktit që ato mund të përditësohen në varësi të skenarëve të rinj që mund të ndodhin. Duke u bazuar në rregulla ekziston gjithnjë rreziku, që vëmendja i kushtohet një situatë, e cila nuk ka peshë dhe rëndësi, ndërkohë që risqet e vërteta mund të anashkalohen dhe të bëhen evidentë vetëm atëherë kur rregullat thyhen dhe është tepër vonë për të ndërhyrë. Ky është dhe një nga disavantazhet kryesore të mbikqyrjes tradicionale të bazuar në rregulla, gjë që synon ta ndryshojë mbikëqyrja me bazë risku.

Pavarësisht avantazheve të ndryshme që sjell përjasja me bazë risku, ajo shoqërohet me një sërë sfidash për t'u kapërcyer. Kryesisht sfidat kryesore që AMF mund të përballet janë si më poshtë:

Aftësitë profesionale të stafit mbikëqyrës – në një përjasje me bazë risku, stafi mbikëqyrës duhet të karakterizohet nga një shkallë e lartë profesionalizmi dhe kuptimi të koncepteve financiare, risqeve dhe veprimtarisë së sigurimit dhe për më tepër të jetë në gjendje të diskutojë këto aspekte me anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe të menaxhimit të lartë të subjekteve të mbikëqyrura. Kjo është një detyrë tepër komplekse dhe shumë më e vështirë sesa interpretimi i ligjit dhe gjetjet e kundravajtjeve ligjore, në një ambient mbikqyrje bazuar në rregulla.

Metodologji komplekse – bën të domosdoshme hartimin e manualeve të brendshme dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit për mbajtjen dhe ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve.

Adaptimi i stafit mbikëqyrës – Adaptimi i stafit me metodologjinë e re mbetet

një nga sfidat kryesore gjatë kalimit në një përjasje me bazë risku. Vlerësimi dhe matja e risqeve të ndryshëm që karakterizojnë një industri dhe subjektet brenda saj, kërkojnë një fokus tjetër, nga ai që aktualisht zbatohet bazuar në rregulla. Përcaktimi nëse subjektet janë në përputhje me dispozitat ligjore është një detyrë relativisht e thjeshtë, ku ka dy alternativa, është ose jo në përputhje me ligjin. Ndërkohë, gjykimi për nivelin e riskut që karakterizon një veprimtari apo politikë, si dhe masën se si këto risqe menaxhohen nga subjektet, kërkon aftësi më të mëdha nga stafi mbikëqyrës, në mënyrë që të kryejë vlerësime të mirë informuara. Ky gjykim është po ai që supozohet të kryhet nga këshilli mbikëqyrës dhe menaxhimi i shoqërisë. Vështirësitë rriten kur gjykimi i bërë nga stafi mbikëqyrës mund të kundërshtohet nga institucionet financiare, në rastet kur është e vështirë të provohet “vërtetësia”.

Mbikëqyrja me bazë risku zhvendos fokusin nga nivelet e ulëta në hierarkinë e shoqërisë ku kryhen transaksionet, në instancat më të larta ku merren vendimet dhe hartohen politikat. Cilësia e menaxhimit të shoqërisë së sigurimit, besueshmëria e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të riskut, strategjitë dhe planet e biznesit janë të gjitha fusha që duhen vlerësuar, pasi ndikojnë në ecurinë e mëtejshme dhe stabilitetin financiar të një shoqërie sigurimi. Kalimi nga një metodologji e thjeshtë për tu kuptuar e zbatuar, si ajo e bazuar në rregulla, në një metodologji komplekse, e cila kërkon njohje të thellë të risqeve dhe menaxhimit të tyre, kuptimit të biznesit dhe praktikave financiare është një detyrë e vështirë për çdo rregullator.

Gatishmëria e industrisë – shoqëritë e sigurimit në Shqipëri ende nuk kanë struktura të mirëfillta për menaxhimin e riskut. Për më tepër një pjesë e mirë e industrisë ende nuk e ka marrë në konsideratë nevojën për të pasur sisteme të sofistikuar të menaxhimit të riskut, si pjesë e pandarë e veprimtarisë së tyre, gjë që kushtëzon ndjeshëm gjithë procesin. Në një ambient ideal, ku industria mban dhe zbaton modelet e saj të brendshme të menaxhimit të riskut, kalimi në një përjasje me bazë risku do të vinte në një mënyrë të natyrshme. Situata aktuale e bën një gjë të tillë një sfidë akoma më të madhe për Autoritetin. Hyrja e investitorëve strategjikë vitet e fundit, në tregun shqiptar të sigurimeve, mund të lehtësojë disi këtë sfidë, nisur nga fakti që përfaqësojnë institucione të konsoliduara dhe të mbikëqyrura në tregje të zhvilluara, ku mbikëqyrja me bazë risku gjen zbatim, duke siguruar nivelin e nevojshëm të ekspertizës për subjektet ku ata kanë interesa pjesëmarrës dhe dominues.

Kushtet e nevojshme për implementimin e mbikqyrjes me bazë riskun në Shqipëri

Kushtet e nevojshme për implementimin e mbikqyrjes me bazë risku, sipas parimit nr 1 të IAIS (ICP 1) janë:

- Politika institucionale dhe bazë ligjore e përshtatshme për mbikqyrjen e sektorit financiar;
- Infrastrukturë e tregut financiar;
- Sistem gjyqësor dhe ligjor, ku vendimet të jenë të zbatueshme;

- Standarde kontabiliteti, auditimi dhe aktuariale;
- Profesione si aktuari, audituesi dhe ekspertët kontabël;
- Statistika bazë ekonomike, financiare dhe sociale;
- Tregje financiare efçente
- Disponibiliteti i alternativave afatmesme dhe afatgjata të investimit.

Mbikëqyrja me bazë risku kërkon që edhe baza ligjore të jetë konceptuar me bazë risku, përfshi këtu dhe kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit. Baza ligjore duhet të shprehë dhe mishërojë qartë objektivat e mbikqyrjes, të cilat janë promovimi i një tregu sigurimesh efçent, të sigurt dhe të qëndrueshëm, për përfitimin dhe mbrojtjen e interesave të polic-mbajtësve.

Sistemi gjyqësor dhe ligjor në Shqipëri është ende në fazë tranzicioni, të paktën për sa i takon zbatimit të vendimeve të AMF, të cilat kalojnë në proces gjyqësor. Vështirësitë e hasura gjatë ecurive të proceseve gjyqësore që kanë lidhje me sanksionet e vendosura shoqërive të sigurimit lidhen me faktin se nga ana e organeve gjyqësore nuk ka një njohje specifike të problemeve teknike që paraqiten në këtë fushë, gjë që në parim bëhet akoma më e vështirë gjatë kalimit nga një sistem me rregulla në një sistem ku përfshihet më shumë gjykim.

Standardet e kontabilitetit në Shqipëri janë në një fazë tranzicioni dhe kthese të rëndësishme, në kuadrin e zbatimit të SNRF-ve duke filluar që nga viti 2008, të cilat janë të detyrueshme për tregun e sigurimeve. Përveç sfidave që shoqërojnë këtë proces në tërësi në shkallë vendi, për tregun e sigurimeve situata paraqitet akoma më e vështirë, pasi SNRF 4 që lidhet direkt me kontratat e sigurimit, është ende i papërfunduar dhe bën pjesë tek standardet më të diskutuara nga industria në mbarë botën, për sa i përket kontradiktave dhe vështirësive në aplikim. Ky tranzicion në fushën e standardeve të kontabilitetit rrit më tej vështirësitë e kalimit në një përjasje me bazë risku, pasi prek direkt metodat e vlerësimit të aseteve të shoqërive të sigurimit nga ana e Autoritetit, në mungesë të rregullave specifike që rregullojnë vlerësimin e aseteve për qëllime rregullative.

Profesioni i aktuarit në Shqipëri është ende në faza zhvillimi. Akoma nuk ekziston një regjistër i aktuarëve të certifikuar dhe të njohur nga Autoriteti, pavarësisht certifikimit të klasës së parë prej tetë aktuarësh në vitin 2007. Mbështetja në profesionin e lirë dhe të pavarur të aktuarit, si ekspertizë e pavarur luan një rol kyç në një përjasje me bazë risku. Tranzicioni i këtij profesioni në Shqipëri, e bën akoma më të vështirë kalimin në një përjasje me bazë risku.

Shqipëria ka ende rrugë për të bërë në drejtim të konsolidimit të statistikave bazë ekonomike, financiare dhe sociale, një kusht i nevojshëm për të kaluar në një sistem mbikëqyrës me bazë risku. Shqipëria është një vend në zhvillim dhe për rrjedhojë dhe tregjet financiare ende nuk mund të konsiderohen të konsoliduara dhe efçente. Mungesa e tregut të kapitalit dhe larmia e pakët e instrumenteve financiarë brenda vendit, bën akoma më të vështirë gjetjen e alternativave afatmesme dhe afatgjata të investimit.

Kalimi në një përjasje të plotë të mbikqyrjes me bazë risku në tregun e sigurimeve

në Shqipëri është një sfidë e madhe. Në një sistem të tillë, Autoriteti duhet të zotërojë pavarësi institucionale dhe financiare, mbrojtje ligjore, staf me kapacitet të lartë profesional, të nevojshme për të ushtruar funksionet e tij.

Matja dhe vlerësimi i kujdesshëm i elementeve përbërës të pasqyrës së bilancit është më i rëndësishëm sesa zbatimi i raporteve financiare që bazohen në të. Vlerësimi i bilancit luan një rol kyç në efikasitetin dhe cilësinë e indikatorëve financiarë apo testeve të ndryshëm. Aplikimi i peshave apo faktorëve të ndjeshëm ndaj riskut, si për aktivet dhe detyrimet, mund të jetë një përmirësim i mirë i modelit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Një hap i rëndësishëm në përmirësimin e kapaciteteve mbikëqyrëse në afatgjatë, do të ishte përmirësimi i informacionit të marrë, si dhe kërkesa për auditim në përputhje me nevojat e ardhshme të mbikqyrjes. Një gjë e tillë do të përbënte një pikënisje tepër të rëndësishme dhe do të vendoste bazat e nevojshme për një aplikim progresiv të standardeve përherë e më të ndjeshme ndaj riskut, në linjë me zhvillimin e tregut. Rritja e shpejtë e tregut të Jo-Jetës, paralelisht e shoqëruar me rritjen ekonomike, duhet të shoqërohet me rritjen e kontributit të profesionit të aktuarit në drejtim të tarifimit të produkteve, rezervave teknike dhe monitorimit financiar të siguruesve.

Metodologjia e “Mbikqyrjes me fokus riskun”, si një strategji afatgjatë që do të zbatohet në Shqipëri

Ndërtimi i matricës së riskut është një metodologji e qëndrueshme dhe relativisht e thjeshtë për vlerësimin e riskut të një siguruesi. AMF po punon në ngritjen e kësaj metodologjie, duke e parë si një proces me disa faza. Kështu, së pari do të punohet në drejtim të vlerësimit të riskut të biznesit, e më pas kur stafi të jetë familjarizuar me këtë pjesë të punës, duhet të bëhet zgjerimi i procesit të vlerësimit të riskut me vlerësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut nga ana e shoqërive të sigurimit, duke arritur në këtë mënyrë tek risku neto, për secilin nga aktivitetet e mundshme. Hapi final është vlerësimi i kapitalit dhe cilësisë së fitimeve, dhe efekti i këtyre vlerësimeve në riskun e përgjithshëm neto, duke çuar në vlerësimin e riskut të përbërë, i cili përfaqëson profilin e riskut të një shoqërie.

Megjithatë, asnjë metodologji nuk mund të zëvendësojë të kuptuarit e parimeve bazë dhe përdorimin e gjykimit të shëndoshë dhe mendimin praktik. Stafi mbikëqyrës duhet të ketë njohuri të mira mbi industrinë, aktivitetet e biznesit të saj, produktet që tregtohen dhe duhet të jetë i aftë të gjykojë i mirë informuar gjatë vlerësimit të riskut. Vetëm në këtë mënyrë modeli duhet të na ofrojë një mundësi të shkëlqyer për vlerësimin e riskut.

Në mënyrë më të detajuar metodologjia e Mbikqyrjes me fokus riskun fillimisht ndalet tek identifikimi i aktiviteteve kryesore në të cilat është e përfshirë kompania dhe i risqeve kryesore që shoqërojnë këto aktivitete.

Gjatë **identifikimit të aktiviteve**, mbikëqyrësi duhet të vërejë mënyrën me të cilën kompania është strukturuar, menaxhohet dhe organizon aktivitetet. Duke qenë

se fokusi i mbikqyrjes me bazë risku është të vlerësojë se sa mirë është menaxhuar risku, mbikëqyrësi duhet të shqyrtojë riskun në të njëjtën mënyrë që e shqyrtojnë menaxherët e kompanisë.

Gjithashtu është e domosdoshme **ndarja e aktiviteteve me nivele të ndryshme risku**. Aktivitetet/produktet me risk të lartë duhet të veçohen për vlerësim risku, për tu siguruar që risku që përmbajnë nuk është fshehur, duke i kombinuar ato me produkte/aktivitete me risk më të ulët.

Është detyra e mbikëqyrësit të aplikojë një gjykim të shëndoshë në momentin kur vendos se cilat risqe i aplikohen një aktiviteti dhe në çfarë shkalle i aplikohen. Risqet do të kategorizohen si: i ulët, i mesëm ose i lartë.

Për të arritur në vlerësimin e riskut neto në secilën prej aktiviteteve të kompanisë, duhet të bëhet **vlerësimi i cilësisë së funksioneve të saj mbikëqyrëse** (kontrollit dhe menaxhimit të riskut nga shoqëria):

- Bordi: i cili mbikëqyr menaxhimin dhe operacionet që kryhen në kompani
- Menaxhimi i Lartë: i cili drejton dhe mbikëqyr menaxhimin e operacioneve të kompanisë
- Auditi i Brendshëm: mbikëqyr efikasitetin dhe zbatimin e politikave procedurale, organizative, dhe atyre të kontrollit;
- Zbatueshmëria: mbikëqyr menaxhimin e pajtueshmërisë së kompanisë me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet në juridiksionin në të cilën ajo operon;
- Menaxhimi i riskut: mbikëqyr menaxhimin e risqeve në aktivitetet e kompanisë, duke u siguruar që ekzistojnë procese efektive;
- Menaxhimi operacional: planifikon, drejton dhe kontrollon operacionet e përditshme të aktiviteteve të kompanisë. Siguron që politikat, praktikat, niveli dhe eksperiencia e stafit është e mjaftueshme dhe efikase për menaxhimin e përditshëm të riskut.

Në rastet kur shoqërive të sigurimit u mungojnë struktura formale që u korrespondojnë fushave të sipër përmendura, dikush në nivelin e duhur të autoritetit brenda shoqërisë duhet të ketë përgjegjësinë për funksionet e përshkruara.

Mbasi funksionet e sipër përmendura janë kategorizuar në lidhje me performancën në secilën prej aktiviteteve të biznesit, atëherë mund t'u bëhet një kategorizim i përgjithshëm. Nëse një nga funksionet e mësipërme është kategorizuar si i fortë për secilën nga aktivitetet, atëherë kategorizimi i tij total do të jetë i fortë. Por nëse funksioni kategorizohet në mënyrë të ndryshme për aktivitete të ndryshme të institucionit, duhet bërë një gjykim për kategorizimin total.

Risku Neto i një aktiviteti është risku që mbetet, mbasi risku sipas aktiviteteve i është nënshtruar teknikave të kontrollit dhe menaxhimit të riskut nga shoqëria. Meqenëse një mbikqyrje me bazë risku është progresive, mbikëqyrësi duhet të japë vlerësimin e tij/saj më të mirë për drejtimin e riskut neto për çdo aktivitet. Ai mund të jetë duke u reduktuar, stabil ose duke u rritur.

Të vlerësuarit e riskut neto për një aktivitet është një ushtrim i gjykimit të mirë dhe të informuar. Sa më i lartë të jetë risku i biznesit në një aktivitet, pritët që po aq i lartë

të jetë edhe cilësia e mbikqyrjes nga shoqëria.

Mbasi risku neto vlerësohet për çdo aktivitet, vlerësohet **risku i përgjithshëm neto** në të gjitha aktivitetet. Për të bërë këtë mbikëqyrësi do të marrë në konsideratë riskun neto të çdo aktiviteti dhe domethënien e çdo aktiviteti për institucionin. Për shembull, nëse aktiviteti me risk të lartë përbën vetëm 5% të biznesit të kompanisë, nuk ka gjasa që të ketë një efekt në vlerësimin total neto të riskut. Në të kundërt, nëse ai aktivitet përfaqësonte 50% të biznesit, ka gjasa që risku i përgjithshëm neto të vlerësohet si i lartë, pavarësisht niveleve të ulëta të riskut neto për aktivitetet e tjera. Ashtu si dhe me riskun neto, drejtimi i riskut të përgjithshëm neto duhet vlerësuar si në zbritje, stabil, e në rritje.

Risku i përbërë është vlerësimi i riskut të përgjithshëm neto mbasi merret në konsideratë ndikimi i kapitalit dhe fitimeve në të. Për riskun e përbërë ne shtojmë një nivel risku për të siguruar më shumë detaje në vlerësim. Risku i përbërë vlerësohet si i ulët, i mesëm, mbi mesataren ose i lartë.

Kapitali është një tregues i fuqisë aktuale të kompanisë ndërsa fitimet janë një tregues të një qëndrueshmërie financiare në vazhdimësi. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksojmë se kapitali dhe fitimet janë të varura nga njëri-tjetri. Fitimet suportojnë kapitalin, duke gjeneruar fitimet e mbartura dhe një kapital i mjaftueshëm ndihmon fitimet e kompanisë.

Kapitali është një burim i mbështetjes financiare për të mbrojtur institucionin nga humbjet e paparashikuara. Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit merr në konsideratë si sasinë po ashtu edhe cilësinë e kapitalit, gjithashtu edhe menaxhimin e kapitalit, pra sa mirë i parashikon menaxhimi dhe bordi nevojat e kompanisë për kapital. Kapitali vlerësohet si i fortë, i pranueshëm ose i dobët dhe situata vlerësohet si në përmirësim, e qëndrueshme ose në përkeqësim.

Fitimet absorbojnë humbjet normale të parashikuara në një periudhë të dhënë dhe mundësojnë mbështetje financiare, duke kontribuar në gjenerimin e brendshëm të kapitalit të institucionit dhe në aftësinë për të gjeneruar kapital të jashtëm. Vlerësimi i fitimeve konsideron nivelin (sasinë), burimet, mbështetjen dhe luhatjet e fitimeve. Ashtu si kapitali, fitimet vlerësohen si të forta, të pranueshme ose të dobëta dhe situata vlerësohet më tej si në përmirësim, e qëndrueshme, ose në përkeqësim.


Mbasi vlerësohet niveli i riskut të përbërë, duhet të shqyrtohet nëse ai do të ulët, do të qëndrojë stabil ose do të rritet nga niveli aktual i vlerësimit.

Vlerësimi final që do t'i bëhet riskut të përbërë është periudha kohore gjatë të cilës vlerësimet aktuale të drejtimin dhe të nivelit të riskut do të jenë të vlefshme. Kur tregu është i qëndrueshëm dhe institucioni nuk po konkurren fort në treg, vlerësimi i riskut të përbërë mund të qëndrojë i vlefshëm për një numër periudhash fiskale. Por luhatja në institucion ose në treg mund të kërkojë që vlerësimi të rishikohet në një periudhë më të shkurtër.

Vlerësimi i riskut është një detyrë e vazhdueshme. Është detyrë e AMF për të grumbulluar informacion që lidhet me riskun e siguruesit që po mbikëqyr. Ndërkohë që informacioni grumbullohet, me kalimin e kohës do të kemi një moment në të cilin

do të kemi informacion të ri të mjaftueshëm për të justifikuar përditësimin e profilit të riskut të kompanisë.

Cikli i mbikqyrjes me fokus riskun jepet në mënyrë grafike si më poshtë:



Burimi: AMF, Manuali i Integruar i Inspektimit
Projekti “Drejt një mbikqyrje efektive”.

Konkluzione

Mbikëqyrja tradicionale bazuar në rregulla, ka rezultuar jo efikase në vendosjen e kufizimeve që tentojnë të parandalojnë vështirësitë financiare për subjektet e mbikëqyrura. Kjo për vetë faktin se tregu financiar zhvillohet me një dinamikë të lartë, në kundërshtim me rregullat të cilat janë statike. Rregullat nuk mund të parashikojnë çdo lloj skenari apo situatë, pavarësisht faktit që ato mund të përditësohen në varësi të skenarëve të rinj që mund të ndodhin. Duke u bazuar në rregulla, ekziston gjithnjë rreziku që vëmendja i kushtohet një situatë e cila nuk ka peshë dhe rëndësi, ndërkohë që risqet e vërteta mund të anashkalohen dhe të bëhen evidentë vetëm atëherë kur rregullat thyhen dhe është tepër vonë për të ndërhyrë. Ky është dhe një nga disavantazhet kryesore të mbikëqyrjes tradicionale të bazuar në rregulla, gjë që synon ta ndryshojë mbikëqyrja me bazë risku.

Kriza financiare botërore tregoi se rregullimi i efektshëm i institucioneve të rëndësishme financiare, është jetik për qëndrueshmërinë financiare botërore. Për më tepër, kriza tregoi se institucionet rregullatorë duhet t'i kushtojnë vëmendje trajtimit të riskut të sistemit. Gjatë vitit 2009 ka vazhduar puna për realizimin e Projektit “Drejt një Mbikëqyrje Efektive”, i cili ka filluar në vitin 2008 me asistencën e Bankës Botërore (BB) dhe financim të FIRST Initiative. Puna e stafit mbikëqyrës është përqendruar në drejtim të hartimit të manualit të integruar të mbikëqyrjes, i cili do ta ndihmojë atë në zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes, atë me bazë riskun. Për hartimin e këtij manuali, përveç ekspertizës nga ekspertë të BB, janë shfrytëzuar dhe modele të vendeve të cilat aktualisht zbatojnë këtë metodologji të re mbikëqyrjeje.

Projekti pritet të finalizohet në Maj 2010 edhe do të shoqërohet dhe me kërkesat për ndryshime ligjore në mbështetje të metodologjisë së re. Në përfundim të projektit do të hartohet një plan strategjik veprimi, i cili do të identifikojë mënyrat e zbatimit të metodologjisë, të shtrira dhe në kohë.

Kalimi në një përqaasje të plotë të mbikëqyrjes me bazë risku në tregun e sigurimeve në Shqipëri është një sfidë e madhe. Në një sistem të tillë, Autoriteti duhet të zotërojë pavarësi institucionale dhe financiare, mbrojtje ligjore, staf me kapacitet të lartë profesional, të nevojshëm për të ushtruar funksionet e tij.

Literatura:

Prudential Supervision of Insurance Undertakings, *Conference of the insurance supervisory services of the member states of the European Union*, 2002.

Solvency of Insurance Undertakings, *Conference of Insurance Supervisory Services of the Member States of the European Union*, 1997.

AFSA (2006). *Annual Report*.

AFSA (2007). *Annual Report*.

AFSA (2008). *Annual Report*.

AFSA (2009). *Annual Report*.

Financimi i qeverisjes vendore – sfidat bashkitë, komunat dhe sistemin bankar

Ornela Shapo (Këmbora)

Lider për zhvillimin ekonomik vendor, Projekti i USAID

MA. Ardiana Sokoli

Menaxhere e Përgjithshme e Biznesit, San Paolo Bank

Dr. Anilda Bozdo

Shefe e Departamentit të Financë-Bankë, UET

ABSTRAKT. *Deçentralizimi vendor, që prej vitit 1998 është bazuar në tre shtylla të rëndësishme (i) deçentralizimi i funksioneve / funksione të reja nga viti në vit për njësitë vendore; (ii) shtimin e instrumentave financiarë në dorën dhe diskrecionin e pushtetit vendor dhe (iii) rritje e kapaciteteve institucionale. Miratimi i ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor konsakroi strategjinë e deçentralizimit vendor në Shqipëri në të treja këto shtylla duke qartësuar instrumentat fiskal dhe financiar si burimet jetike të realizimit të funksioneve të veta të njërive vendore.*

Së fundmi miratimi në shkurt të vitit 2008 të ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore ishte një hap i rëndësishëm në forcimin e financave dhe “autonomisë financiare vendore” nga njëra anë por edhe shprehje e pjekurisë së këtyre njërive për të marrë vendime të rëndësishme në interes të komunitetit që përfaqësojnë. Nga ana tjetër tregu bankar në Shqipëri ishte mëse i përgatitur për të eksploruar një treg të tillë, pasi prej vitesh ishin tentuar skema të tilla financimi në partneritet të plotë institucion financiar – bashki apo edhe në një marrëdhënie edhe më të komplikuar si ajo e financimit të skemave PPP (partneritetit publik privat).

Tashmë me anë të asistencës së USAID po eksplorohej ky treg dhe është realizuar kredia e parë tregtare me një njësi vendore ndërkohë që janë duke u përfunduar disa kredi të tjera. Ndërkohë që procedura e huamarrjes mbetet ende një sfidë për të gjithë aktorët

e interesit duke pasur parasysh këtu rrishtun që nuk njihet për të dyja palët; procedurat disi burokratike; gjendjen aktuale të tregut financiar bankat në vend por jo vetëm si dhe kushtëzimet e vazhdueshme që vijnë prej autoritetet miratues të këtyre kredive siç është Ministria e Financave. Po a janë vërtet njësitë vendore për përgatitura dhe të afta për të hyrë në këtë treg; çfarë përfaqësojnë këto kredi tregtare për projektet e tyre të investimit dhe kapacitetet reale të tyre për të hyrë në këto marrëdhënie me bankat. Cilat janë nga ana tjetër sfidat që duhet të marrin parasysh institucionet financiare dhe ato bankare në këto marrëdhënie dhe çfarë rezultatesh priten.

Fjalë kyçe:

decentralizim vendos, huatë, instrumentat fiskal, risku, sistemi bankar, skemat PPP.

Hyrje

Tema e ditës në pothuajse të gjitha tryezat ekonomiko-financiare në Shqipëri dhe në Evropë është stoku i borxhit publik në rritje, rënia ekonomike, reformat që duhen ndërmarrë për përbalimin e krizës financiare globale si dhe sfidat e reja që duhet të përballojë në vendin tonë qeverisja vendore në lidhje me kapacitetet financiare që ajo ka dhe veprimet që po ndërmerr qeverisja qendrore në lidhje me decentralizimin vendor.

Në morinë e çështjeve që diskutohen, instrumenti i ri i financimit të pushtetit vendor me anë të huasë nga sistemi financiar/bankar ndoshta e ka të vështirë të tërheqë vëmendjen e aktorëve në treg, si edhe e autoriteteve rregullatorë për të gjetur sa më shumë hapësirë për implementim. Ligji për huamarrjen vendore i miratuar në shkurt 2008 dhe ai për obligacionet bashkiake në tetor 2009 janë shumë pak të njohur në tregun bankar, ndërkohë që njësitë vendore e shohin implementimin e tyre si çelës për realizimin e investimeve strategjike.

Përgjithësisht vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në kuadrin e menaxhimit të borxhit publik i trajtojnë kufizimet ligjore dhe institucionale për huamarrjen vendore si pjesë e kufizimeve të stokut total të borxhit publik. Këto vende e shohin qeverisjen qendrore si përgjegjësen kryesore për menaxhimin e borxhit total publik kurse qeverisjen vendore e analizojnë në kuadrin e performancës së saj, e cila varet shumë nga politikat qendrore financiare dhe fiskale nëse ka, që aq fort lakohen sot në dy nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore në Shqipëri.


Përputhshmëria me normat ligjore dhe klasifikimi i favorshëm i bankës janë të nevojshme, por jo kushte të mjaftueshme që një bashki të marr borxh. Suksesi i menaxhimit të përgjithshëm financiar kërkon një qëndrim proaktiv, ku politikë-bërësit vendor përshtatin politikën e investimit me kapacitetin aktual të borxhit të njësisë vendore, duke vlerësuar kostot afatshkurtër, afatmesme dhe të mirat dhe përfitimet e çdo projekti investimi.

A. Deçentralizimi financiar vendor në Shqipëri

Shqipërisë gjatë procesit të reformimit ekonomik dhe decentralizimit gradual të saj i është dashur të bëjë një sërë reformash institucionale dhe ekonomike, një prej tyre është edhe ajo e decentralizimit vendor. Kjo e fundit bazohet në tre shtylla kryesore: (i) reformimi institucional dhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore; (ii) transferimi i kompetencave dhe funksioneve të NjQV-ve dhe legjislacionit përkatës si dhe (iii) fuqizimi i kapaciteteve financiare të njësive vendore. Të tria këto shtylla janë ndërtuar gradualisht për të siguruar një decentralizim të suksesshëm, por ajo që ka më shumë rëndësi dhe pa të cilën dështon mbajtja në këmbë e dy shtyllave të tjera është fuqizimi financiar i pushtetit vendor.

Që prej vitit 2000, si vit i rëndësishëm në reformën e decentralizimit vendor dhe për më tepër atij financiar, njësive vendore u janë transferuar instrumente financiar dhe fiskalë që kanë rritur në mënyrë esenciale autonominë financiare të tyre. Duke filluar që me ligjin organik të organizmit dhe funksionimit të pushtetit vendor, i cili përcaktoi qartë jo vetëm reformën strukturore dhe pavarësinë institucionale të NjQV-ve por edhe burimet financiare të tyre.

Grafiku 1. Struktura e të ardhurave vendore (në %)



Kështu sot konkludohet se fondet e veta të njësive vendore (të cilat vijnë prej të ardhurave nga taksat; tarifat dhe menaxhimi i aseteve vendore) zënë mbi 50% të totalit të buxhetit të tyre të pakushtëzuar; ndërkohë që transfertat e pakushtëzuar e qeverisë shpërndahet nëpërmjet një formule përgjithësisht të konsoliduar, e cila ka ardhur në rritje nga njëri vit në tjetrin me përjashtim të këtij të fundit (vitit 2010 ku u ul me rreth 14% kundrejt asaj të alokuar në vitin 2009). Grafiku i mësipërm shpreh qartë ndryshimin cilësor të kapaciteteve financiare gjithnjë në rritje të njësive vendore, e cila

nga një raport 20% me 80% midis të ardhurave të veta dhe grantit të qeverisë gjatë vitit 2010 pritët të kapë raportin 54% me 46%.

Sigurisht që kjo autonomi në rritje e kapaciteteve financiare të njësive vendore vjen së pari prej rritjes së numrit të instrumenteve financiar dhe fiskalë nga njëri vit në tjetrin (me disa hapa mbrapa gjatë viteve të fundit: siç janë ulja e barrës fiskale për tatimin mbi biznesin e vogël; ndërhyrja në kompetencat e PV dhe kushtëzimi i nivelit të tarifave vendore në maksimumi 10% të gjitha së bashku sa niveli referues i tatimit mbi biznesin e vogël; ulja e fondeve të grantit të qeverisë etj), por edhe nga përmirësimi i vazhdueshëm i mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore. Fakt për këtë është ecuria e tatimit mbi biznesin e vogël i cili në fund të vitit 2005 u përgjysmua si taksë dhe në fund të vitit 2009 mbledh pothuajse të njëjtin nivel sikurse në vitin 2005 (rikuperim total i uljes së barrës fiskale në katër vjet, duke supozuar se rritja ekonomike ka influencuar në të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë me rreth gjysmën e rritjes / gati 44% aq saç vlerësohet të jetë edhe rritja e PBB-së gjatë kësaj periudhe, për rrjedhojë e gjithë rritja tjetër vlerësohet të ketë ardhur prej përmirësimit administrativ të kësaj takse).

Me gjithë këto hapa në fushën e deçentralizimit fiskal herë përpara e herë mbrapa ajo çfarë ka rëndësi të theksohet është se liria bruto fiskale e njësive vendore që prej vitit 2002 e deri më sot përbën 88% e buxhetit të pushtetit vendor, ndërkohë që liria neto fiskale është rreth 60% e buxhetit të tyre, kur kjo e fundit (liria neto fiskale) në vitin 2001 ishte vetëm 7% e buxhetit total të PV në Shqipëri⁹³.

Duke iu referuar edhe të dhënave statistikore të qeverisjes vendore dhe asaj qendrore që prej vitit 2000 (i cili konsiderohet si vit i rëndësishëm në reformat e deçentralizimit vendor) shihet qartazi rritja e kapaciteteve financiare të njësive vendore gjatë gjithë kësaj dekade (edhe pse jo fort e qëndrueshme gjatë 3 viteve të fundit).

Tabela 1. Buxheti i PV dhe ai i Shtetit

Në mln Lekë	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009 fakt	2010 (plan)
Totali i të ardhurave të Buxhetit të Shtetit	130,642	145,639	154,595	167,224	184,355	204,163	229,444	251,555	291,238	334,823	360,955
Totali i të ardhurave të Pushtetit Vendor	36,387	37,699	38,287	44,105	47,432	52,635	26,226	26,355	27,526	30,572	38,223
Të ardhurat e veta të NjQV	1,316	2,038	2,676	7,923	9,613	12,019	11,112	9,366	11,307	12,149	20,948
Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar e PQ	3,643	4,870	9,500	6,300	6,277	7,300	15,114	16,988	16,219	18,423	17,275
Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar e PQ	31,428	30,791	26,111	29,882	31,542	33,317					
Totali i të ardhurave të pakushtëzuara të PV	4,959	6,908	12,176	14,223	15,890	19,319	26,226	26,355	27,526	30,572	38,223
Prodhimi i Brendshëm Bruto	523,043	583,369	622,711	694,098	750,785	814,797	891,000	982,737	1,090,305	1,173,760	1,278,693
Pesha e PV në totalin e Buxhetit të Shtetit											
Totali i të ardhurave të PV në BSh	27.9%	25.9%	24.8%	26.4%	25.7%	25.8%	11.4%	10.5%	9.5%	9.1%	10.6%
Totali i të ardhurave të pakushtëzuara të PV në BSh	3.8%	4.7%	7.9%	8.5%	8.6%	9.5%	11.4%	10.5%	9.5%	9.1%	10.6%
Pesha e PV në PBB											
Totali i të ardhurave të PV në PBB	7.0%	6.5%	6.1%	6.4%	6.3%	6.5%	2.9%	2.7%	2.5%	2.6%	3.0%
Totali i të ardhurave të pakushtëzuara të PV në PBB	0.9%	1.2%	2.0%	2.0%	2.1%	2.4%	2.9%	2.7%	2.5%	2.6%	3.0%

Kështu nëse në vitin 2000 të ardhurat totale mbi të cilat njësitet vendore kishin diskrecion të plotë përdorimi zinin më pak se 4% të totalit të buxhetit të shtetit ose

93 Shiko “Deçentralizimi në zhvillim a kërcënim”, ISB – Artan Hoxha, Gazeta Shqip Nëntor 2009

më pak se 1% të PBB-së në vitin 2009 vlerësohet se arritën në rreth 11% të buxhetit të shtetit dhe mbi 3% të PBB-së, që do të thotë një katërfishim i kapaciteteve financiare të njësive vendore brenda një dekade.

Një burim tjetër shumë i rëndësishëm i financave vendore përveç instrumenteve fiskal dhe transfertave të qeverisjes vendore (qofshin këto grante të shpërndara me formulë apo konkurruese) janë edhe menaxhimi i aseteve vendore dhe instrumenti i huamarrjes nga bankat dhe institucionet e tjera financiare. Të dy këto burime të ardhurash, së fundi njësitet vendore kanë tërhequr vëmendjen e qeverisjes vendore (proçesi i transferimit të pronave të paluajtshme nga PQ tek njësitet vendore) po përshpejtohet si bazë për krijimin e skemave të para të partneritetit publik-privat si dhe edhe janë realizuar tashmë me ndihmën e asistencës së huaj aplikimet e para për hua tregtare në sistemin bankar shqiptar.

Deçentralizimi vendor e sidomos ai financiar e fiskal sollën performancë në qeverisjen vendore e reflektuar kjo në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit. Dhjetëvjeçari i parë i deçentralizimit vendor deri në vitin 2000 karakterizohet nga një PV që ofron shërbime në nivele minimale për komunitetin dhe buxhet që shkon pothuajse për paga dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe institucioneve publike vendore. Kështu nëse në vitin 2000 investimet zinin mbi 20% të buxhetit të PV, në fund të këtij dhjetëvjeçari arrin në rreth 40%; ndërkohë që edhe struktura e shpenzimeve korente ka zvogëluar peshën e pagave dhe rritur ato për mirëmbajtje (ku 24% shkojnë për paga dhe sigurime dhe 38% për mirëmbajtje).

Kuptohet që shifrat e ofruara më sipër japin pikturën e madhe të të gjithë PV në vend, ndërkohë që situata paraqitet shumë e ndryshme nga njëra njësi vendore tek tjetra (komuna krahasuar me bashkitë; dhe midis këtyre të fundit bashki të vogla; të mesme apo të mëdha pa marrë në analizë Tiranën dhe Durrësin me një situatë tërësisht të ndryshme nga gjithë njësitet e tjera vendore në Shqipëri).

Kështu kryesisht në bashki të vogla pesha e investimeve është rreth 30% e totalit të buxhetit të tyre të pakushtëzuar, në bashki të kategorisë së mesme ato shkojnë në rreth 40% kurse në njësi të mëdha vendore (të cilat për hir të së vërtetës janë të pakta) portofoli i investimeve shkon edhe deri në 55% të totalit të buxhetit të tyre.

Gjithsesi edhe pse ndryshimi strukturor i buxheteve vendore ka sjellë rritje të rëndësishme të peshës së investimeve që njësitet vendore kryejnë, po të kthehemi mbrapa tek pesha që vetë PV zë në totalin e buxhetit të shtetit dhe PBB-së e cila është shumë e vogël nga më të voglat në Evropë dhe rajon do të shohim se investimet e PV në total dhe për më tepër ato të njësive vendore për secilin rast më vete janë shumë modeste. Për rrjedhojë edhe natyra e investimeve të njësive vendore është e tillë që plotëson nevojat emergjente të komunitetit – kryesisht ndërtimi i rrugicave të brendshme në lagje; rindërtimi i hapësirave të gjelbëruara dhe atyre rikrijuese; rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve etj. Ndërkohë që projektet e “mëdha” mbeten ende në hije, pasi buxheti vjetor i njësive vendore nuk i përballon dot implementimin e tyre. Bërja e detyrueshme, tashmë nga ana e Ministrisë së Financave, e hartimit e programeve buxhetore afatmesme ka dhënë një hapësirë të vogël për menaxherët vendorë që të

guxojnë të zbatojnë projekte më të mëdha, të cilat parashikojnë implementimin e tyre me fonde buxhetore më shumë sesa një buxhet vjetor. Duke qenë se projektet e infrastrukturës vendore edhe pse të mëdha në këto raste mund të realizohen në më pak sesa një vit, përfaqësuesit vendor po i shfrytëzojnë mekanizmin e programit buxhetor afatmesëm, duke filluar punimet për implementimin e këtyre projekteve në gjysmën e dytë të vitit dhe përfundimin e tyre në gjysmën e parë të vitit pasardhës buxhetor, duke shfrytëzuar kështu fondet e investimeve të dy buxheteve vjetore. Gjithsesi kjo formulë edhe pse ka bërë të mundur implementimin e projekteve më të mëdha, ka sjellë probleme në marrëdhëniet midis njësive vendore; investitorëve dhe thesarit të Ministrisë së Financave.

Sikurse e përmendëm më sipër, dy mundësitë e reja për thithjen e burimeve të investimeve janë menaxhimi i aseteve publike për aktivitet ekonomik ose krijimin e skemave të partneritetit publik privat dhe huamarrja nga sektori bankar, janë një instrument shumë i mirë që në kushtet aktuale të buxheteve vendore janë pothuajse zgjidhja e vetme për realizimin e projekteve të rëndësishme të investimit. Nëse menaxhimi i aseteve mbetet ende një fushë e re e pa eksploruar siç duhet nga njësitet vendore, jo vetëm për arsyen e mungesës së aseteve të mjaftueshme që mund të përdoren për aktivitet ekonomik, por edhe kuadri ligjor mjaft i paqartë për sa i përket krijimit të skemave të partneritetit PP, si edhe problemet sociale që ato sjellin si rrjedhojë e zënies me forcë nga shtresa sociale në nevojë, instrumenti i huamarrjes vendore është një levë e fuqishme financiare në duart e menaxherëve vendorë për realizimin e këtyre investimeve prioritare për komunitetin që ato përfaqësojnë.

B. Financat vendore dhe huamarrja nga sistemi bankar si mundësi e re financimi

Inkurajimi i njësive vendore për të hyrë në tregun e kredisë tregtare (ose më saktë financimit me anë të huasë) është një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Deçentralizimin Vendor (hartuar në 1999 – 2000 dhe rishikim i fundit 2006).

Njësitet e qeverisjes vendore në Shqipëri që prej më shumë se dy vjetësh kanë në dorë një instrument të ri financiar, atë të kredimarrjes nga sektori bankar dhe institucionet e tjera financiare i rregulluar me anë të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore në Shqipëri”, si edhe mundësinë e emetimit të obligacioneve nëpërmjet miratimit së fundi (më 15.10.2009) të ligjit numër 10158 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”. Edhe pse ligji për huamarrjen vendore, shpesh herë i quajtur edhe i “guximshëm” për kapacitetet aktuale të buxheteve vendore dhe menaxherëve të tyre, fryma që sjell ai (ligji) konsiderohet si konservatore dhe vlerësohet se nuk do të sjellë situata ngërçi në administrimin e financave vendore, ndërkohë që kufijtë ligjorë të borxhit vendor ndoshta nuk do të kënaqin aq shumë nevojat e PV për të realizuar projekte të mëdha investimi.

Një procedurë speciale e parashikuar është edhe ajo e interceptimit të financimit.

Për të bërë të mundur aplikimin e këtij instrumenti të ri financimi (huanë nga sistemi financiar/bankar) për njësitë vendore, po nën mbështetjen e USAID-it, i cili asistoi në hartimin e ligjit për huamarrjen vendore dhe akteve nënligjore të tij (udhëzimi për zbatimin e ligjit; manuali për huamarrjen vendore; trajnimi i stafeve të disa bashkive, si dhe sensibilizimi i aktorëve të interesit etj) ka mundur një program DCA⁹⁴. Ku me anë të të cilit USAID ka lidhur marrëveshje me dy banka shqiptare (BKT dhe Raiffeisen) duke ofruar garanci pjesore për kreditë që do t'u lëvrohen njësive vendore shqiptare të dhëna nga këto banka. Garancia përfaqëson pagesën e 50% të principalit të kredisë së marrë nga njësia që do të ndeshet me situatën e pamundësisë së pagimit / shlyerjes së kredisë.

Po si e sheh komuniteti i qytetarëve dhe ai i biznesit instrumentin e huamarrjes vendore. Për të verifikuar perceptimin e tyre dhe nëse ata do të mbështesnin njësinë vendore në përdorimin e këtij instrumenti të ri financiar në dy vite radhazi 2008-2009 Projekti i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri ka realizuar sondazhin për “Shërbimet e Qeverisjes Vendore, Përgjegjshmëria dhe Zhvillimi i Ekonomisë Vendore” ku midis të tjerave qytetarët dhe bizneset janë pyetur në lidhje me:

- (i) Nëse ata janë dakord që Bashkia të marrë hua për të përmirësuar shërbimet publike?
- (ii) Nëse janë dakord, a do të vazhdonin të ishin dakord që huaja e marrë të përballohej me rritjen e tarifave vendore?

Fig. 31 A do të ishit dakord që bashkia të merrte hua financiare për të përmirësuar shërbimet?
Vetëm ata që janë përgjigjur “Shumë dakord” ose “Dakord”





Fig 32. Nëse po, do të vazhdonin të ishit dakord edhe nëse marrja e huasë do të çonte në tarifa më të larta për qytetarët dhe bizneset?
Vetëm ata që janë përgjigjur “Po”



Është interesante të njihemi me rezultatet e këtij sondazhi, i cili është realizuar në 20 bashki në gjithë vendin, ku siç shihet nga grafikët e mëposhtëm⁹⁵ të gjitha njësitet përveç Pogradecit që ka një përqindje rreth 50% të të intervistuarve të gjitha njësitet e tjera janë pro marrjes borxh për përmirësimin e shërbimeve (me një mesatare mbi 65% të të gjitha bashkive të intervistuar).

Ndërkohë që në vitin 2008 qytetarët nuk ishin shumë pro rritjes së tarifave vendore për përballimin e shlyerjes së huasë në vitin 2009 qytetarët (nga 25% në 42% pro)e mbështesin më shumë rritjen e tarifave

94 Development Credit Authority (DCA) Autoriteti për Zhvillimin/Nxitjen e Kredisë

95 Sipas sondazhit USAID/LGPA “Shërbimet e qeverisjes vendore, përgjegjshmëria dhe zhvillimi i ekonomisë vendore” realizuar nga IDRA 2009

për përballimin e huasë vendore. Kjo është një dëshmi që instrumenti i huamarrjes tashmë është më i njohur, jo vetëm midis përfaqësuesve të pushtetit vendor, por edhe qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Si dhe ata janë koshient për faktin se disa investime publike vendore mund të përballohen për vetë koston e madhe që kanë me anë të huasë, edhe pse ajo do të sjellë më shumë barrë fiskale për ta.

Kapacitetet huamarrëse të disa njësive vendore në Shqipëri

Baza e përlllogaritjes së kapaciteteve ligjore për borxhin vendor janë të ardhurat e pakushtëzuara të njësive vendore. Dy komponentët kryesorë të të ardhurave të pakushtëzuara (i) të ardhurat e veta nga taksat, tarifat dhe aktivitetet e tjera të njësisë vendore dhe (ii) transfertat e pakushtëzuara të qeverisë kanë peshë të ndryshme në njësi të ndryshme vendore. Progresi i bërë në drejtim të shtimit të burimeve të financimit të pushtetit vendor reflektohet në peshën që zënë sot të ardhurat e veta (taksat dhe tarifat) kundrejt grantit të qeverisë (që nëse në vitin 2009 ishin të barabarta; këtë vit ato priten të jenë më të larta sesa granti) nga vetëm 25% që zinin në vitin 2000 në 54% sipas planit 2010. Nga njëra anë kjo rrit diskrecionin për të parashikuar dhe për rrjedhojë thithur fonde nëpërmjet huamarrjes nga sektori bankar, por nga ana tjetër edhe punën më serioze dhe riskun për të realizuar planet afatgjata të mbledhjes së tyre (plane që në vërtetë bazohen te skemat e shlyerjes së kredive bankare). Gjithashtu vetë struktura e buxheteve të pakushtëzuara të njësive vendore është e ndryshme nga një njësi vendore në tjetrën, e për rrjedhojë edhe kapaciteti real i thithjes së fondeve nga huaja vendore dhe sigurisht risku i shlyerjes së kredisë, i cili varet nga natyra e të ardhurave të pakushtëzuara. Taksat dhe tarifat vendore janë kompetencë e plotë e pushtetit vendor, por për aq saç' e lejon ligji për sistemin e taksave vendore, i cili ndryshohet si rregull me propozim të Qeverisë dhe miratohet nga Parlamenti. Rastet e ndryshimeve të fundit ligjore në këtë ligj tregojnë rënien e konsiderueshme të nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat, si dhe uljen e diskrecionit të pushtetit vendor për t'i aplikuar ato⁹⁶.

Edhe pse konsiderohet konservator për arsyet e shpjeguara më sipër ky instrument i ri financiar në krahasim me strukturën e buxhetit të njësive vendore mund të konsiderohet një levë e fuqishme financiare. Duke iu referuar të dhënave për disa njësi vendore në Shqipëri (marrë si vit bazë / llogaritjesh financiare viti 2009) vlerësohet se instrumenti i huasë vendore bën të mundur që këto njësi të rrisin portofolin e tyre vjetor të investimeve me 2.6 herë (rasti i Elbasanit) dhe 6 herë (Korçë), e deri në 17 herë për Gramshin.

Gjithsesi për ta përgjithësuar fuqinë e shumëfishimit të instrumentit të huamarrjes, nisur nga fakti që njësia vendore mund të marrë hua në një moment të caktuar sa 1.3 herë nivelin e të ardhurat e veta të pakushtëzuara në vitin e kaluar buxhetor, si dhe bazuar në faktin që mesatarisht struktura buxhetore e njësive vendore në Shqipëri

96 Ndryshimet në ligjin për sistemin e taksave vendore në Prill 2009, si dhe ulja e kufirit për bizneset subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar në Dhjetor 2009.

Tabela 2. Huaja maksimale e mundshme për disa njësi vendore në Shqipëri në vitin 2010

Kufijtë e Huamarrjes bazuar në Kriterin e Stokut	Viti Bazë 2009		
	në Mln. Lekë	në Mln. Euro	në Mln. USD
Vlorë	1,501.6	11.1	15.0
Fier	952.1	7.1	9.5
Elbasan	892.6	6.6	8.9
Korçë	841.6	6.2	8.4
Shkodër	758.1	5.6	7.6
Pogradec	389.2	2.9	3.9
Lezhë	235.8	1.7	2.4
Fushë Krujë	186.0	1.4	1.9
Kukës	157.2	1.2	1.6
Gramsh	139.1	1.0	1.4
Librazhd	94.3	0.7	0.9
Petrelë / Komuna	77.9	0.6	0.8
Himarë	73.2	0.5	0.7

është e tillë që raporti i shpenzimeve korente dhe atyre për investime është 60 me 40% në totalin e buxhetit të tyre, mund të themi që me anë të huasë njësitë vendore mund të realizojnë projekte investimi të tilla sa 3.2 herë fondet vjetore të investimit që ato disponojnë në buxhetin e tyre normal. Kuptohet që kjo shifër sikurse e shpjeguam është një mesatare e potencialeve që ofron ky instrument në një buxhet vjetor vendor dhe ashtu sikurse jepet në tabelën më sipër ky instrument jep shumëfish të ndryshëm për njësi vendore të ndryshme, kjo varet kryesisht prej strukturës buxhetore të njërive vendore (sa peshë zënë investimet në buxhetin e tyre), si edhe prej madhësisë së njësisë vendore. Kuptohet që njësitë e vogla vendore me buxhete shumë modeste sado e vogël që të jetë huaja ajo jep një efekt disafishues mbi fondet e investimeve të njësisë, të cilat janë pothuajse zero, ndërkohë që në njësitë e mëdha edhe pse në vlerë huaja është e konsiderueshme shumëfishimi i fondeve vjetore të investimeve nuk është kaq i madh sa në njësi të vogla dhe të mesme vendore (për shembull rasti i Elbasanit – në vitin 2010 mund të marrë hua 890 milionë lekë, ndërkohë që efekti shumëfishues i fondeve të investimeve nga huaja është vetëm 2.6 herë, pasi fondi i investimeve në buxhetin e bashkisë për vitin 2010, pa marrë parasysh kredinë, është më pak se 300 milionë lekë).

Eksperienca e deritanishme ka treguar se kapacitetet reale huamarrëse të njërive vendore (përgjithësisht tek NjQV të vogla) janë shumë më të vogla sesa limiti ligjor i stokut që ato mund të arrijnë në një moment të caktuar (pra sesa ç'mund të marrin ligjërisht në një moment të caktuar). Nëse do ti referohemi kriterëve kufizues të shpjeguar më sipër njësitë vendore përveç kufirit të stokut (që përcakton shumën maksimale të huasë që një njësi mund të marrë në një moment të caktuar) duhet të plotësojë edhe dy kritere të tjerë që kufizojnë shërbimin vjetor të borxhit (pra sa i lejohet maksimalisht në një vit një njësi vendore të shlyejë huanë përkatëse = principal + interes). Sikurse e përmendëm këto kritere llogariten dhe midis tyre përzgjidhet ai

që lejon shumën monetare më të vogël për njësinë përkatëse. Rastet e realizuara kanë treguar se edhe pse njësia vendore ka pasur një kufi stoku prej 94 milionë lekë në vitin 2010; shërbimi maksimal vjetor është aq i vogël sa i akumuluar në vite i duhet një periudhë shumë e gjatë për ta shlyer huanë e marrë; ndërkohë që kostoja e kthimit të saj (si rrjedhojë e kohës së gjatë të shlyerjes).

Tabela 3. Kufijtë e shërbimit të borxhit për Bashkinë Librazhd

Vite	Periudha	Kufizimi i shërbimit të borxhit	Kredi 45 Milionë Lekë (me këste të harmonizuara me kufizimet)
1	2010	3,498	2,995
2	2011	2,424	2,400
3	2012	2,859	2,800
4	2013	3,404	2,995
5	2014	4,439	4,395
6	2015	5,586	5,493
7	2016	6,855	6,791
8	2017	7,753	7,591
9	2018	8,735	8,391
10	2019	9,807	9,591
11	2020	10,977	10,791
12	2021	14,100	13,991
13	2022	10,977	9,991
14	2023	14,100	13,991
15	2024	17,537	7,116
Totali		123,051	109,319

Sikurse shihet kësaj njësie vendore i lejohet që në pesë vitet e ardhshme (2010-2014) të kthejë mbrapsht për një hua të marrë maksimumi 16 milionë lekë, për dhjetë vjet (2010-2019) një shumë prej 55.4 milionë lekë dhe pas pesëmbjdhjetë vjetësh një shumë që shkon deri në 123 milionë lekë.

Shihet gjithashtu se është shumë e vështirë që për një hua prej 94 milionë lekë sa çështë edhe maksimumi i kapacitetit huamarrës ligjor për të, të shlyhet një hua e tillë. Në tabelën pasardhëse kemi përlllogaritur këste vjetore për shlyerjen e huave të ndryshme duke konsideruar një

normë vjetore interesi prej 10% (dhe aplikuar metoda e shlyerjes me këste të barabarta PMT të huasë).

Tabela 4. Kufizimet e shërbimit të huasë dhe këstet vjetore për shumën të ndryshme kredish

Vite	Periudha	Kufizimi i shërbimit të borxhit	kufizime akumulative në vite	Kredi 94 milionë Lekë	Kredi 80 milionë Lekë
1	2010	3,498		12,122	10,316
2	2011	2,424		12,122	10,316
3	2012	2,859		12,122	10,316
4	2013	3,404		12,122	10,316
5	2014	4,439	16,624	12,122	10,316
6	2015	5,586		12,122	10,316
7	2016	6,855		12,122	10,316
8	2017	7,753		12,122	10,316
9	2018	8,735		12,122	10,316
10	2019	9,807	55,359	12,122	10,316
11	2020	10,977		12,122	10,316
12	2021	14,100		12,122	10,316
13	2022	10,977		12,122	10,316
14	2023	14,100		12,122	10,316
15	2024	17,537	123,051	12,122	10,316
Totali		123,051		181,823	154,743

Nëse do të bënim një përllogaritje të kufijve maksimal të stokut të borxhit për të gjitha njësitë vendore në Shqipëri (të gjitha bashkitë dhe komunat) vlerësohet se të gjitha së bashku ato mund të marrin sot një shumë e cila shkon rreth 39 miliardë lekë (ose më pak se 300 milionë Euro). Shifër kjo që përfaqëson vetëm 11% të buxhetit të shtetit ose 3% të PBB-së. Gjithashtu në vijim të logjikës së përdorur më sipër nëse do të kishim mundësi të realizonim ushtrimin e bërë për bashkinë Librazhd shifra

e mësipërme (39 miliardë lekë) duhet të jetë shumë më e ulët. Nga të dhënat që disponojmë të gjitha bashkitë së bashku përfaqësojnë rreth 57% të pushtetit vendor ndërsa komunat 43% të buxhetit të PV. Nëse do të konsiderojmë se të gjitha bashkitë së bashku mund të marrin hua 60% të kapacitetit maksimal ligjor të tyre dhe komunat 20% të kapacitetit atëherë për vitin 2010 nëse të gjitha njësitë vendore do të aplikonin për të marrë hua nga tregu financiar / bankar shuma totale që ato mund të thithin nëpërmjet këtij instrumenti është rreth 17 miliardë lekë (120 milionë Euro), që do të thotë më pak se 5% e totalit të buxhetit të shtetit ose vetëm 1.3% e PBB-së.

C. Kreditimi bankar dhe huamarrja vendore

Që prej shkurtit 2008 e deri më tani⁹⁷ vetëm një hua vendore ka kaluar të gjitha fazat e aplikimit dhe miratimit të saj ndërkohë që një portofol tjetër prej 4-5 të tillash pret miratimin përfundimtar nga Ministria e Financave – procedura dhe çështje që varen nga rrethanat e menaxhimit të borxhit publik nga ana e Ministrisë së Financave.

Bashkia Fushë-Krujë pioniere në këtë drejtim si njësi vendore që guxoi të hyjë në tregun bankar të kredisë tregtare për financimin e projekteve të rëndësishme të investimit lidhi një marrëveshje kredie në qershor të vitit 2009 për shumën 100 milionë lekë (1 milionë Dollarë amerikanë). Projekti i investimit i cili pritet të financohet nëpërmjet kësaj huaje është një segment i unazës veriore të qytetit. Projekt i cili vlerësohet se do ti japë zgjidhje disa problematikave që sjell infrastruktura aktuale e qytetit dhe nevojat e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe industrial të tij.

Në të vërtetë kostoja e projektit të unazës është më e lartë se 100 milionë lekë – vlera e kredisë bankare, e cila shkon në rreth 400 milionë lekë, pasi bashkia do të financojë projektin pjesërisht nga fondet e veta të buxhetit 2010, pjesërisht nga kredia dhe një segment i unazës së bashku me një rrotandë (rreth rrotullim që mundëson kalimin nga segmenti i unazës në rrugën kombëtare) do të realizohen nga buxheti i shtetit (nëpërmjet granteve konkurruese të menaxhuara në këtë rast nga Bashkia dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve). Kufizimi total për stokun e borxhit që kishte kjo bashki në vitin 2009 kur edhe u aplikua për kredi ishte 160 milionë lekë. Duhet theksuar se kjo njësi vendore ka një performancë shumë të mirë të mbledhjes së të ardhurave dhe një strukturë buxhetore të tillë që i lejon asaj jo vetëm të marrë një hua afatgjatë për shumën që ka nevojë por edhe të lërë hapësirë brenda buxheteve vjetore në vitet në vazhdim për investime të tjera (jo vetëm shlyerjen e kredisë për këtë projekt).

Gjithsesi edhe po të aplikonte për shumën totale të kufirit të borxhit kjo njësi vendore nuk do të mund të plotësonte nevojën e realizimit të këtij investimi; fakt i cili përforcon idenë tonë se ligji aktual ka kufizime shumë të forta për nevojat e njësive vendore.

97 Që prej nëntorit 2008, më saktë duke iu referuar edhe akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore

Që prej vitit 2000 si vit i rëndësishëm i decentralizimit vendor (ku janë transferuar një sërë funksionesh nga qeveria PV) ofrimi i shërbimeve publike dhe nevoja për përmirësimin e tyre është bërë mëse evident, si rrjedhojë e mungesës së investimeve të munguara nga ana e PV në vite (mungesë e kapaciteteve financiare nga ana e tyre). Në kushtet e buxheteve të kufizuara dhe shpesh herë edhe fare modeste njësitë vendore janë mjaftuar me përmirësimin e kushteve të infrastrukturës vendore dhe përmirësimin e objekteve në menaxhim dhe për rrjedhojë edhe shërbimeve për komunitetin. Në gjithë këtë periudhë vihet re amortizimi i infrastrukturës së trashëguar dhe nevoja për zgjerimin dhe ngritjen e infrastrukturës së re e cila lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e numrit të popullsisë sidomos në zonat e urbane; ndërtimeve të reja të individëve dhe biznesit si dhe nevojës për shtimin e ofrimit të shërbimeve në funksion të PV siç janë arsimi parashkollor dhe shërbimi mjekësor parësor. Kjo automatikisht do të thotë fonde investimesh të cilat njësitë vendore nuk i disponojnë brenda buxheteve të tyre vjetore. Instrumenti i huamarrjes synon të plotësojë pikërisht këtë nevojë të njërive vendore, ndaj është e natyrshme që kërkesat e njërive vendore për financim me anë të huasë të jenë kryesisht (pothuajse të gjitha deri më tani) të projekteve të infrastrukturës. Edhe një grup bashkish dhe komunash të cilat kanë përfunduar një pjesë të mirë të procedurave të huamarrjes nga sistemi bankar kanë si objekt investimi projekte infrastrukture. Më poshtë është një listë projektesh dhe fondesh financiare për investim me anë të huasë nga sistemi bankar në disa njësi vendore deri më tani:

Sikurse vihet re nga raporti i mësipërm duket që pothuajse të gjitha njësitë vendore janë në pritje të një miratimi përtej kompetencave ligjore të Ministrit të Financave. Bazuar në ligjin për “Huamarrjen e Qeverisjes Vendore” në nenin 5 të tij parashikohet se: Vendimi për huanë afatgjatë hyn në fuqi pas konfirmimit të Ministrit të Financave. Ministri i Financave kufizohet vetëm në konfirmimin e përputhshmërisë së procedurave për autorizimin e huasë dhe verifikimin e respektimit të kufizimeve të borxhit vendor të parashikuara në këtë ligj. Nëse Ministri i Financave nuk përgjigjet brenda 20 ditëve nga data e marrjes së njoftimit vlerësohet se ai e ka konfirmuar huanë në fjalë.

I shqetësuar nga gjendja aktuale e stokut të borxhit publik⁹⁸, Ministri i Financave bazuar në ligjin numër 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” neni 58 i tij ku përcaktohet se: “borxhi publik përbëhet nga borxhi i qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor” dhe se totali i borxhit publik nuk duhet të kalojë shumën prej 60% të PBB-së, më 27 Janar 2010 ka nxjerrë një urdhër i cili parashikon që: “Të gjitha njësitë vendore që sipas ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 plotësojnë të gjitha kriteret për huamarrje, gjatë vitit 2010 u lejohet të marrin hua (disbursim vjetor) deri në 5% të shumës së shpenzimeve të buxhetit të tyre vjetor të një viti më parë”.

Së pari ky urdhër i fundit kufizon edhe më shumë mundësitë edhe atyre pak njërive vendore që janë të afta të plotësojnë të gjitha kufizimet ligjore të analizuara më sipër për të marrë hua. Duhet theksuar se masa prej 5% e totalit të shpenzimeve

98 Sipas statistikave të FMN dhe BB, të shkurtit 2010 për vitin 2009 ishte 59.99% e PBB-së, ndërkohë që sipas MF dhe BSh për vitin 2009 është 58.9% e PBB-së.

të një viti buxhetor është një shumë jashtëzakonisht e vogël për to (për shembull për bashkinë Elbasan ajo është rreth 60 milionë lekë, ndërkohë që projekti që kërkohet të financohet me anë të huasë është 800 milionë lekë).

Së dyti ky urdhër nuk është shumë i qartë pasi ai shprehet për disbursimin e lejuar nga një hua e miratuar për vitin 2010, ndërkohë që nuk cilëson se çfarë do të ndodhë me disbursimet e mëtejshme në vitet e tjera 2011.....

Së treti ky urdhër nuk zgjidh problemin e tejkalimit të stokut të lejuar të borxhit publik pasi ashtu sikurse u analizua më sipër të gjitha njësitë vendore të marra së bashku sikur të gjitha të aplikonin për hua në vitin 2010 nuk mund të marrin më shumë sesa 1% e PBB-së së Shqipërisë.

Dhe së fundmi ky kufizim ligjërish është diskriminues pasi është detyrues vetëm për njësitë vendore dhe asnjë kufizim për pushtetin qendror. Kemi parasysh që po në Janar të këtij viti kur MF nxorri këtë kufizim doli në treg për të emetuar obligacione qeveritare në Euro në shumën prej 300 milionë Euro (që përfaqëson 3.2% të GDP-së).

Literatura:

- Ligji numër 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- Udhëzimi i Ministrit të Financave, numër 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- Ligji numër 10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”
- Urdhri i Ministrit të Financave numër protokoli 857, datë 27.01.2010 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- “Overview of Albanian local government for borrowing purposes”, Maj 2008
- “Manual për huamarrjen e qeverisjes vendore”, Tiranë Prill 2009,
- “Tendenca e të ardhurave vendore në Shqipëri”, Shtator 2009
- “Deçentralizimi: Në zhvillim a në kërcënim”, Gazeta Shqip, Tiranë 5.12.2009
- “Shërbimet e qeverisjes vendore, përgjegjëshmëria dhe zhvillimi ekonomik vendor”, sondazh i USAID/LGPA realizuar nga IDRA 2008-2009

Kreditimi i njësive të qeverisjes vendore dhe roli i fondeve të zhvillimit

Benet Beci

Drejtor Ekzekutiv, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Enea Hoti

Specialist, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Blendi Bushati

ABSTRAKT. *Deçentralizimi dhe autonomia lokale kërkon ekzistencën e njësive të qeverisjes vendore me organe të zgjedhura dhe struktura demokratike, të cilat kanë autonomi dhe kompetenca të zgjeruara si dhe instrumenta të duhura ligjore, administrative dhe financiare për të përmbushur misionin e tyre. Në këtë aspekt deçentralizimi financiar është komponenti thelbësor në bërjen realitet të parimit të deçentralizimit dhe autonomisë vendore. Në këtë punim do të fokusohemi pikërisht në çështjen e kreditimit të njësive të qeverisjes vendore si një nga instrumentet financiare në dorë të pushtetit vendor për të përmbushur nevojat për investime kapitale si dhe roli që luajnë fondet e zhvillimit në këtë fushë duke prezantuar disa nga praktikatat ndërkombëtare dhe krahasimisht rolin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në mbështetjen e nevojave të investimeve kapitale të pushtetit vendor si dhe sfidat për të ardhmen në këtë drejtim.*

Fjalët kyçe:

bursa, tregu i kapitaleve, tregu i letrave me vlerë, sistemi financiar, sektori jobankar, biznesi, kapital privat.

1. Hyrje:

Deçentralizimi në Shqipëri si proces ka filluar me ndryshimin e sistemit politik pas vitit 1992 megjithatë duhet theksuar se në vitet e para të demokracisë më emergjente ishin reformat në sistemin ekonomik, politik dhe të drejtësisë në nivel kombëtar. Kjo solli edhe një zhvendosje të prioriteteve në drejtim të realizimit të reformës së decentralizimit.

Reforma e decentralizimit në Shqipëri mori hov dhe u parapri nga plotësimi gradual i infrastrukturës ligjore në fushat respektive sipas kërkesave të Kushtetutës së Shqipërisë së vitit 1998, Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore dhe Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit. Duke filluar nga viti 2000, realizimi i procesit të decentralizimit u pa i lidhur ngushtë me hartimin e legjislacionit përkatës për të mundësuar transferimin e përgjegjësi nga pushteti qendror drejt qeverisjes vendore.

Decentralizimi dhe autonomia lokale kërkon ekzistencën e njësisë të qeverisjes vendore me organe të zgjedhura dhe struktura demokratike, të cilat kanë autonomi dhe kompetenca të zgjeruara si dhe instrumente të duhura ligjore, administrative dhe *financiare* për të përmbushur misionin e tyre. Në këtë aspekt decentralizimi financiar është komponenti thelbësor në bërjen realitet të parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore.

2. *Financimi i pushtetit vendor dhe financimi i investimeve kapitale në Shqipëri*

Decentralizimi financiar në Shqipëri ka ecur në raport me zhvillimin ekonomik, vazhdimësinë e procesit të reformave ekonomike dhe politike, organizimin e institucioneve financiare si dhe ekuilibrimin e diferencave ekonomike të rajoneve dhe grupeve të caktuara të popullsisë. Nëpërmjet decentralizimit fiskal gjatë këtyre viteve është synuar kryesisht sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për pushtetin vendor për të ushtruar funksionet e përcaktuara me ligj, nëpërmjet dhënies së autoritetit të nevojshëm në vendosjen dhe në përdorimin e taksave vendore dhe përmirësimit të skemave financiare të ndarjes së transfertave të pakushtëzuara e të projekteve të investimeve kapitale që buxheti i shtetit alokon për pushtetin vendor.

Njësitë e qeverisjes vendore financojnë funksionet e tyre nga të ardhurat që sigurohen nga tre burime kryesore :

1. nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore;
2. nga fondet e transferuara nga pushteti qendror;
3. fondet që u vijnë drejtpërdrejtë atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare.

Në realitet burimet kryesore të të ardhurave të njësisë të qeverisjes vendore mbi të cilat NJQV-të kanë diskrecion të plotë, përbëhen nga taksat vendore dhe fonde të transferuara nga buxheti i shtetit.

A) *Taksat e tarifatat vendore.* Një paketë fiskale me ligje të miratuara në vitin 2002,

shënoi një fazë të rëndësishme të reformës së decentralizimit fiskal që sanksionoi një autonomi të rritur të bashkive dhe të komunave për të përcaktuar të ardhurat e veta vendore dhe nivelet e tyre. Siç vërehet, nga tabela Nr.1 më poshtë, të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga taksat, tarifat dhe të ardhurat jotatimore, kanë ardhur në rritje të kënaqshme, nga 0.59% e PBB-së në vitin 2000 kanë arritur në 1.34% e PBB në vitin 2006. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore luajnë një rol të rëndësishëm në totalin e të ardhurave të buxhetit të qeverisjes vendore duke përbërë rreth 43 % të të ardhurave totale në vitin 2007.

Tabela 1: Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në % të PBB-së.

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Të ardhurat e pushtetit vendor (Total)	0.59%	0.71%	0.87%	1.17%	1.31%	1.56%	1.34%
Taksa lokale	0.25%	0.35%	0.43%	0.72%	0.74%	1.01%	0.95%
Tatimi mbi Biznesin e vogël	0.31%	0.34%	0.41%	0.42%	0.54%	0.46%	0.29%
Të ardhura jotatimore	0.03%	0.02%	0.03%	0.03%	0.03%	0.09%	0.10%

Burimi: Strategjia e Rishikuar e Deçentralizimit-www.km.gov.al

Fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit (që në 2007-n përbënin rreth 48 % të buxhetit të NJQV-ve.) përbëhen nga:

B) Transferta e pakushtëzuar, që jepet sipas kriterëve të përcaktuara me ligj, bazuar në funksionet dhe kompetencat e veta ose të përbashkëta të komunave dhe bashkive, si dhe për arritjen e barazisë së burimeve mes njërive të ndryshme të qeverisjes vendore në raport me mundësitë e tyre për të krijuar të ardhurat e nevojshme.

B 2) Transferta të Kushtëzuara, kryesisht në formën e fondeve për investime kapitale por edhe për kryerjen e funksioneve të deleguara. Fondet për investime kapitale jepen nëpërmjet skemës së granteve konkurruese, që nga 2010 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Këto fonde financojnë, bazuar në një skemë konkurruese projekte të investimeve kapitale të propozuara e të menaxhuara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore në rrugë lokale, ujësjellës e kanalizime, shkolla, qendra shëndetsore etj.

Shpenzimet. Ku shkojnë paratë?

Shpenzimet kryesore për funksionet e NJQV-ve në Shqipëri mund të grupohen në të mëposhtmet:

Sektori Social: Në të përfshihen funksione të dhënies së ndihmës ekonomike (krejtësisht i mbuluar nga Qeveria Qendore; shpërndahet nga NJQV-të bazuar në udhëzime lëshuar nga Ministria e Punës). Arsimi fillor dhe i mesëm janë funksione të përbashkëta ku shumica e shpenzimeve kryhet nga Ministria e Arsimit dhe shpenzimeve investimesh kapitale, në përgjithësi nëpërmjet granteve konkurruese dhe shpenzime të operimit e mirëmbajtjes që mbulojnë nga të ardhurat e veta të NJQV-ve. Të tjera shpenzime në fushën sociale më të vogla përfshijnë shërbime sociale për të moshuarit e grupet në nevojë, shpenzimet për artin, kulturën e sportin etj.

Infrastruktura lokale: Si investimet kapitale ashtu edhe shpenzimet në mirëmbajtjen e aseteve të infrastrukturës lokale në pronësi vendore duhet të mbulohen nga buxheti i Njësive të Qeverisjes Vendore nëpërmjet të ardhurave të tyre apo transfertave nga buxheti, sidomos nga grantet konkurruese për investimet kapitale. Përfshin rrugë, ujësjellës e kanalizime, trotuare, ndriçim, sheshe, parkingje, riparim fasadash etj.

Rrugët lokale përfshijnë një pjesë të rrjetit rrugor rural dhe të gjithë rrjetin rrugor urban të vendit. Në total janë rreth 9,800 km rrugë rurale dhe rreth 2,200 km rrugë urbane. Shumica e investimeve kapitale shpenzohen në këtë sektor nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Sipas një studimi në vitin 2007⁹⁹ të rrjetit rrugor rural rreth 80 % e rrjetit është në gjendje të keqe ose shumë të keqe, c'ka në kushtet e vendit tonë do të thotë praktikisht e pakalueshme. Me decentralizimin e funksionit të ujësjellsave aktualisht me VKM-të përkatëse, është kompletuar edhe procesi i transferimit të aseteve të tyre. Nga rreth 57 shoqëri të UK të vendit, vetëm 8 kanë mbetur pa u transferuar. Shumica e këtyre ndërmarrjeve, pavarësisht transferimit janë krejtësisht të varura nga buxheti qëndror për mbijetese. Në zonat rurale, mendohet se rreth 50 % e popullsisë është akoma e pafurnizuar me ujë nga sistemet e ujësjellësit apo sistemet janë tejet të amortizuara. Në këto kushte është lehtësisht e imagjinueshme nevoja shumë e madhe për investime kapitale.

Ndërtim infrastrukturë të re. Përveç rikonstrukcionit të infrastrukturës ekzistuese, NJQV-të kanë nevojë edhe për ndërtim të infrastrukturës së re që u shërben zonave të reja të banimit, lagjeve informale, zonave të reja të biznesit, zonave turistike etj. Vetëkuptohet që kjo infrastrukturë është shumë e kushtueshme por gjithashtu e domosdoshme për funksionet e zhvillimit ekonomik të territorit lokal.

Ndërsa mund të argumentohet se për shkak të funksioneve të kufizuara, niveli i shpenzimeve për funksionet që lidhen me qeverisjen vendore është relativisht i përshtatshëm, apo i krahasueshëm me vende të ngjashme¹⁰⁰ është e qartë se për shkak të trashëgimisë së varfër dhe nivelit të zhvillimit ka një nevojë të jashtëzakonshme për investime kapitale në nivel vendor.

Megjithëse ka përpjekje shumë të mëdha që ky hendek të mbyllet nëpërmjet financimeve me anë të skemave të investimeve kapitale nga buxheti i shtetit apo nëpërmjet programeve të mëdha të financuara nga donatorë të ndryshëm, është e qartë se ka nevojë për më tepër para.

Në kushtet kur mundësia e rritjes së të ardhurave nga taksat lokale apo rritje drastike të transfertave nga qeveria qendore (duke parë edhe tavanet e PBA-së) duket e pamundur, dhe kur burimet nga donatorët janë të kufizuara, ka vetëm një mundësi, atë të marrjes kredi në tregje për financimin e investimeve kapitale.

99 Butler, Robert (2007) Management and Financing of Local Roads in Albania.

100 Albania Local Finance Policy Note, World Bank Document September 2008.

3. Kreditimi i Njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Huamarrja është një instrument financiar në duart e njësive të qeverisjes vendore për të siguruar burime financiare. Kjo mundësi i është dhënë pushtetit vendor me ligjin Nr.9869 datë 4/2/2008 “Mbi huamarrjen vendore”. Në kushtet e një autonomie më të gjerë fiskale dhe transferimi të një numri në rritje kompetencash tek pushteti vendor, në mënyrë për të garantuar një ushtrim efektiv të mandatit nga zyrtarët vendorë si dhe për të garantuar më shumë shërbime publike të kryera nga pushteti vendor me më shumë cilësi, dhënia e kredive për pushtetin vendor do të forcojë në mënyrë sinjifikative kapacitetet e tyre financiare dhe ekonomike.

Pushtetit vendor i lejohet të marrë hua vetëm për investime kapitale ose për të rifinancuar huatë/borxhet ekzistuese si dhe për të emetuar instrumente financiare si obligacione ose bono. Ligji përcakton rregulla dhe kriteret specifike cilësore dhe sasiore për marrjen e kredive dhe huave. Këshilli Bashkiak ka autoritetin për të miratuar huatë/kreditë ndërsa Kryetari i Bashkisë/Komunës ka kompetencën për të negociuar termet dhe kushtet e marrëveshjes së huasë me bankat respektive. Në rastet e transaksioneve të huave ose për raste të specifikuar në ligj njësitet e pushtetit vendor kanë të drejtë të hapin llogari rrjedhëse në bankat e përzgjedhura sipas kushteve të tregut.

Për çfarë mund të merret kredia ?

- Huaja afatgjatë – vetëm për financime të shpenzimeve kapitale; rifinancim të kredisë;
- Huaja afatshkurtër vetëm për mungesë likuiditetesh;
- Garancia për të tretë vetëm për shpenzime kapitale;

Garancitë ligjore për pagimin e kredive ?

- Huaja është detyrim i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm për organet aktuale dhe të ardhshme të NJQV-së,
- Shërbimi i borxhit, është pagesë e detyrueshme dhe shpenzim parësor për buxhetin vendor;
- Garanci mund të lihen një pjesë e të ardhurave, nëpërmjet mekanizmit të ***interceptimit të finacimit***; prona vendore jo-publike si dhe detyrim për zbatim të niveleve të caktuara të taksave dhe tarifave, kushte për administrimin e ndërmarrjeve dhe pronave; procedura specifike pagimi etj (neni 16 i ligjit për huamarrjen vendore) ;
- Shteti/qeveria nuk është garant i borxhit vendor ose vetëm nëse ka një marrëveshje specifike.

Megjithëse ligji për huamarrjen vendore është miratuar që në 2008 dhe mekanizmat ligjore për huamarrjen vendore në Shqipëri janë shumë restriktive, po kështu edhe limitimet e marrjes së borxhit si dhe garancitë ligjore për ripagimin e borxheve, situata është e tillë që sot kemi vetëm 2 raste të procedurave të kredive midis një bashkie dhe një banke komerciale të nivelit të dytë.

Nga këto të dhëna si më sipër nxjerrim konkluzionin se ka një problem në funksionimin e instrumentit të kredisë vendore. Njëra anë mund të jetë mosbesimi i

tregut bankar komercial për të dhënë hua për qeverisjen vendore, kujtojmë që tregu bankar ka ulur gjithashtu ndjeshëm edhe kreditimin e individëve apo subjekteve ekonomike private. Po kështu nevojat për borxh të qeverisë janë më të mëdha duke zënë hapësirat për borxh vendor dhe duke thithur likuiditetet nga bankat e nivelit të dytë. Nga ana tjetër mund të jetë hezitimi i NJQV-ve të cilat të pamësuar me instrumentin e ri, nuk aplikojnë për kredi. Normat e larta të interesit për kreditë komerciale mund të jenë një faktor frenues për marrjen e kredive nga pushteti vendor.

Deçentralizimi financiar është një proces që ka patur luhajtje ndër vite duke mos garantuar një skemë të vazhdueshme dhe të parashikueshme për fluksin e burimeve të të ardhurave. Por është gjithashtu e sigurtë që një pjesë e madhe e NJQV-ve nuk kanë kapacitet kredimarrës, duke pasur të ardhura të ulta, performancë të dobët fiskale dhe financiare si dhe mungesë kapacitetesh në menaxhimin financiar, gjë që sjell për pasojë eliminimin si aktorë potenciale në tregun e kredive komerciale.

Kjo sfidë, megjithë vështirësitë që paraqet, është e mundur për t'u fituar po të kemi në vëmendje eksperiencat e suksesshme ndërkombëtare në këtë fushë, e cila tregon që ekzistojnë instrumente të tillë financimi të cilët janë të qëndrueshëm, të vazhdueshëm dhe të vetë financueshëm. Të tillë mund të përmendim, si një nga instrumentet më të përdorura ndërkombëtarisht, Bankat ose Fondet e Zhvillimit Lokal, që janë skema financimi/kreditimi të rinovueshëm për NJQV-të. Më poshtë prezantohen disa nga këto eksperiencia ndërkombëtare.

4. Eksperiencia ndërkombëtare në financimin e investimeve kapitale në nivelin vendor dhe roli i fondeve të zhvillimit.

Financimi i investimeve kapitale i NJQV-ve është problem që nuk prek vetëm Shqipërinë por pothuajse të gjitha vendet që kanë një shkallë të caktuar deçentralizimi, dmth. ku qeveria qendrore ka ndarë funksionet dhe kompetencat me pushtetin vendor. Duke lënë mënjanë çështjet e deçentralizimit fiskal dhe sistemit të transfertave ndërqeveritare, që nuk janë objekt i këtij punimi, prezantojmë më poshtë disa nga instrumentet e financimit të investimeve kapitale të NJQV në botë.

Instrumenti më i përhapur janë skemat që kanë për bazë financimin ose më saktë kreditimin e NJQV-ve, në formën e bankave ose fondeve për zhvillim lokal/rajonat. Këto instrumente variojnë nga instrumente tipike të nxitura nga shteti ose nga donatorët ndërkombëtarë, të cilat janë skema që ekzistojnë kryesisht në vendet në zhvillim dhe skema që menaxhohen nga banka komunale të mirëfillta tregtare, të cilat operojnë kryesisht në vendet e zhvilluara. Mund të themi që në vendet në zhvillim ekzistojnë sot rreth 60 skema të tilla dhe numri i tyre vazhdon të rritet¹⁰¹. Patjetër që më afër realitetit shqiptar janë skemat e përdoruara nga vendet me zhvillim të ngjashëm me Shqipërinë.

101 Pellegrini.A., Cennteniali Group, "IPWA Financial Tools Task Force", prezantim powerpoint aksesuar nga faqja e internetit www.google.com, në datën 10.4.2010.

Fondi Kroat për Zhvillimin Rajonal

Ky instrument është një instrument kreditimi i krijuar me ligj të miratuar nga Parlamenti Kroat në vitin 2001, për të mbështetur zhvillimin e balancuar të NJQV-ve në Kroaci. Ky fond vepron si një strukturë e pavarur me Bord Drejtues dhe një staf mbështetës.

Që nga 2003 janë financuar mbi 100 milion dollarë për projekte në fushën e:

- infrastrukturës komunale (rrugë; ujësjellsa, trotuare etj.)
- infrastrukturës ekonomike (zonat e lira ekonomike; inkubatoret e biznesit; agjenci zhvillimi etj.)
- zhvillim rural (rrjeti ujësjellës-kanalizime; turizmi rural) projekte relevante për zhvillimin rajonal;

Disa nga rezultatet e projekteve të financuara janë: rreth 1.615.844 ml tuba ujësjellësi; 1.187.317 metër rrugë, 3.464.952 m² sipërfaqe e pajisur me infrastrukturën komunale (ujë,gaz,energjia).

Tipet e mbështetjes financiare për NJQV-të janë 3 lloje:

- kredi
- grant i pakthyesëm
- subvencion i kthyesëm me % interesi sipas HBOR (Banka Kombëtare Kroate)

Kreditë mund të financojnë deri në 80 % të projektit (për zonat e varfra) dhe deri në 50% për pjesën tjetër të NJQV-ve. Kushtet e përcaktuara me ligj të kredive komunale janë:

- afati i ripagimit të kredisë deri në 15 vjet, me një periudhë faljeje ripagimi (grace period) prej 3 vjetësh;
- interesi vjetor 6%;
- NJQV-të që aplikojnë për kredi duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligjin kroat për huamarrjen vendore.

Fondi i Zhvillimit Bashkiak në Gjeorgji

Fondi i Zhvillimit Bashkiak (Municipal Development Fund) në Gjeorgji është një fond i krijuar me ligj në kuadrin e një marrveshje të qeverisë gjeorgjiane me Bankën Botërore për të financuar investimet kapitale të pushtetit vendor. Fondi pra është një: i) Institucion për financimin e investimeve në pushtetin vendor dhe ii) Institucion që zbaton programin e financimit të NJQV me donator Qeverinë dhe WB.

Financimi i investimeve në pushtetin vendor bëhet sipas formulës së mëposhtme :

- 20% bashkëfinancim i NJQV-ve;
- 40% grant nga Banka Botërore;
- 40 % kredi nga Fondi Zhvillimit Bashkiak;
- Kredia ka 15% interes vjetor; afati i shlyerjes 10 vjet; periudha e faljes së ripagimit (grace period) 1 vit;
- Projektet financohen në minimum 240,000 USD - në maksimum 600.000 USD.

5. Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe roli i saj në investimet kapitale të pushtetit vendor, mundësitë dhe sfidat.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është krijuar si agjensi autonome implementuese e “Projektit të Lehtësimit të Varfërisë në Zonat Rurale” në fillim të vitit 1993, mbi bazën e një marrëveshje midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore. Misioni i FSHZH-së është “nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e lokal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit”.

Më datë 11 maj 2009, Kuvendi i Shqipërisë miratoi **Ligjin Nr. 10130 dt.11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”** që i përcakton këtij institucioni një status të veçantë ligjor.

Objekti i veprimtarisë së FSHZH-së është, hartimi, menaxhimi, financimi, zbatimi, mbikqyrja e projekteve të lidhura me fushën e veprimtarisë.

Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në ligj, FSHZH-ja udhëhiqet nga këta objektiva kryesorë:

- a) përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore;
- b) përmirësimi i shërbimeve publike vendore;
- c) forcimi institucional i njësisë të qeverisjes vendore;
- ç) nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Veprimtaria e FSHZH-së rregullohet nga Këshilli Drejtues i përbërë nga anëtarë të Qeverisë në nivel Ministri apo zv.Ministri si dhe përfaqësues të të gjitha niveleve të Njësive të Qeverisjes Vendore. Këshilli Drejtues siguron harmonizimin e politikave kombëtare sektoriale apo ndër-sektoriale me ndërhyrjet e FSHZH-së në nivel rajonal e lokal.

Për sa më sipër në harkun kohor të 17 viteve FSHZH-ja ka arritur të afirmohet si agjencia ose partneri kryesor për NJQV-të në Shqipëri në drejtim kryesisht të investimeve kapitale, me një aktivitet të rëndësishëm në drejtim të planifikimit të zhvillimit lokal dhe forcimit të kapaciteteve të NJQV-ve.

Deri më sot FSHZH¹⁰² ka administruar mbi 320 milion USD në mbi 1,700 projekte të infrastrukturës lokale në të gjithë vendin. FSHZH ka patur partneritet me rreth 15 donatorë ndërkombëtarë e bilaterale duke zbatuar mbi 15 programe në fushën e zhvillimit lokal. Gjatë këtyre viteve është krijuar një ekspertizë e qëndrueshme teknike, ekonomike e financiare në fushën e menaxhimit të projekteve me financim të huaj si dhe një ekspertizë të gjërë në fushën e zhvillimit lokal në vend. Aktivitetet aktuale të FSHZH-së përfshijnë disa ndërhyrje në shkallë thuajse sektoriale në sektorin e rrugëve rurale dhe ujësjellsave rurale si dhe në vazhdimësi me filozofinë e deritanishme të ndërhyrjes së projekteve komunitare.

Pavarësisht sa u tha më sipër, kjo skemë e financimit të investimeve kapitale nga FSHZH në territorin e të gjithë NJQV-ve të vendit paraqet disa sfida sidomos për të ardhmen e vet. Në radhë të parë, megjithë volumin e projekteve të financuara, “nevoja”

102 Për më tepër informacion rreth FSHZH-se www.albaniandf.org.

për financimin e investimeve vjen gjithmonë në rritje nga ana e pushtetit vendor.

Kjo shpjegohet me faktin që procesi i decentralizimit ka sjellë shtimin e funksioneve të reja dhe kompetencave për pushtetin vendor nga njëra anë dhe rritjen në mënyrë asimetrike, në krahasim me funksionet dhe kompetencat e decentralizuara, të burimeve financiare megjithë sukseset e shënuara në vitet e fundit në drejtim të decentralizimit fiskal.

Nga ana tjetër edhe përsa i përket burimeve të financimit, mund të thuhet se skema e përdorur deri tani për investimet kapitale dmth: financim grant plus 10% kontribut bashkëfinancimi nga NJQV-ja nuk është një skemë “e qëndrueshme”, që do të thotë që skema është e mbyllur në momentin e realizimit të investimit kapital.

Deri më sot funksionimi i kësaj skeme ka qenë i vazhdueshëm falë kredive me terma të buta të furnizuara nga donatorët ndërkombëtarë dhe të marra nga Qeveria Shqiptare dhe zbatim nga FSHZH-ja, duke garantuar deri më sot ose më saktë deri në 2014 (me projektet në zbatim) të financimit të nën-projekteve të NJQV-ve.

Por mekanizmi kryesor financues i FSHZH-së si më sipër, që janë kreditë e marra nga qeveria shqiptare prej donatorëve ndërkombëtarë, nuk mund dhe nuk do të vazhdojë në pafundësi për disa shkaqe që nuk varen prej Shqipërisë. Disa nga këto shkaqe janë:

- kalimi i Shqipërisë nga vend i nivelit të varfër në vend në zhvillim, që sjell edhe ndryshimin e marrëdhënieve financiare me donatorët ndërkombëtarë për rrjedhojë edhe financimet nuk janë më financime me terma të butë dhe/ose grante;
- ndryshimi i pozicionimit financiar ndërkombëtar i Shqipërisë që ndikohet edhe nga kriza globale financiare, duke sjellë vështirësi në sigurimin e kredive me terma të butë;
- rritja e nivelit të borxhit publik të Shqipërisë (borxhit qeveritar) duke ulur mundësinë për financime shtesë ndërkombëtare për pushtetin vendor nëpërmjet kredive të zbatuara nga FSHZH-ja;
- zhvendosja e vëmendjes së donatorëve në rajone të tjera të varfra ose për vende në emergjencë financiare.

Të gjithë faktorët e mësipërm por edhe të tjerë që nuk janë përmendur, nxjerrin nevojën e rishikimit të skemës ekzistuese të financimit nga ana e FSHZH-së dhe kthimit të saj në “një skemë të qëndrueshme” dhe mundësisht të “vetë-financueshme” duke kontribuar në këtë mënyrë në uljen e barrës financiare për qeverinë nga njëra anë, por edhe garantimin e vazhdimësisë së financimit të investimeve kapitale të njëjësive të qeverisjes vendore nga ana tjetër.

Për t’iu përgjigjur këtij realiteti të ri me nevoja shumë të mëdha për financimin e investimeve kapitale dhe vështirësive në sigurimin e burimeve financiare duke u mbështetur edhe në hapësirat e ofruara nga kuadri i ri ligjor, duket se roli i ri natyral për FSHZH-në mund të jetë shndërrimi në një institucion kreditues për NJQV-të.

Në një studim të kryer në vitin 2007¹⁰³ rezulton se rreth 10 % e NJQV-ve mund të jenë të afta financiarisht për marrjen dhe shlyerjen e një kredie të qenësishme.

Ka disa opsione se si FSHZH mund ta fillojë aktivitetin e tij kredidhënës:

- FSHZH mund të kthehet menjëherë në institucion kredidhënës dhe të vazhdojë aktivitetin vetëm me NJQV-të që mund të marrin e shlyejnë kredi;
- FSHZH mund të provojë forma të ndërmjetme bashkëpunimi me NJQV-të, pra kredi për disa NJQV dhe grant për NJQV-të më të varfra me pamundësi reale për të mbledhur taksa lokale.
- FSHZH mund të fillojë me një skemë pjesërisht grant, pjesërisht kredi e pjesërisht bashkëfinancim lokal sipas një formule të tillë 40% kredi, 40% grant dhe 20% bashkëfinancim.

Gjithsesi pas njëfarëkohe të ndërmjetme është e qartë se në këtë skemë FSHZH do të duhej ta orientonte aktivitetin e vet drejt kredisë për të qënë një institucion i vetqëndrueshëm.

Për të ruajtur nga karakteri i vet publik, FSHZH në ndryshim nga një bankë komerciale, mund të vazhdonte krahas kredisë të kishte një rol si asistent teknik i Njësitë të Qeverisjes Vendore, së paku në dy fusha:

- Përmirësimi i performancës financiare, mbledhjes së të ardhurave nga NJQV-të që performojnë financiarisht poshtë mundësive të tyre, programet e rishëndoshjes financiare.
- Asistimi për përzgjedhjen, fizibilitetin dhe menaxhimin e projekteve të infrastrukturës së financuar nga kredia.

Së fundmi, vlen të theksojmë se teza e hedhur këtu rreth pozicionimit të FSHZH-së në tregun e huadhënies komunale kërkon një diskutim më të gjerë nga këndvështrimi i financave publike të vendit, raportit me tregun privat financiar dhe së fundmi, e mbase më e rëndësishmja, në raport me pozicionimin më të mirë të mundshëm të FSHZH-së si një instrument i fuqishëm për zhvillimin lokal e rajonal.

6. Konkluzione

1. Në vitet e fundit hapa shumë të rëndësishëm janë bërë në kuadër të decentralizimit fiskal, ku krahas deçentralizimit të funksioneve, janë decentralizuar edhe e drejta për vendosjen e përdorimit të të ardhurave lokale për këtë qëllim. Shpenzimet kryesore nga Njësitë e Qeverisjes Vendore bëhen në fushën e infrastrukturës lokale, sidomos në investime kapitale. Nevojat për financime të investimeve kapitale të qeverisjes vendore edhe në të ardhmen e parashikueshme do të jenë mjaft të larta për shkak të trashëgimisë shumë të varfër e nevojave për zhvillimin e infrastrukturës së re.
2. Në kushtet kur mundësia e rritjes së të ardhurave nga taksat lokale apo rritjes

103 Pete L. Doty "ADF, a new vision towards self-sustainability", a report prepared for the ADF mid-term strategy.

drastike të transfertave nga qeveria qendrore (duke parë edhe tavanet e PBA-së) duket e pamundur dhe kur burimet nga donatorët janë të kufizuara, ka vetëm një mundësi, atë të marrjes kredi për financimin e investimeve kapitale.

3. Qeveria Qendrore do të jetë e “*detyruar*” të lehtësohet nga kreditimi i financimit të investimeve për pushtetin vendor, nisur nga problemet e hasura për borxhin e vet publik dhe mund të kërkohet një lëvizje strategjike drejt zhvendosjes së barrës ripaguese të kredive ndërkombëtare, ku përfitues të drejtëpërdrejtë janë NJQV-të, drejt pushtetit vendor.
4. Tregu bankar i kredive komerciale mbetet i pa aksesueshëm aktualisht për qeverisjen vendore, në pjesën dërrmuese të tij, si dhe kjo tendencë mund të vazhdojë për një kohë të gjatë nisur edhe nga eksperiencat e vendeve të tjera në zhvillim.
5. Skemat e financimit/kreditimit, të bankave dhe fondeve të zhvillimit, për investimet kapitale të pushtetit vendor, bazuar në suksesin e tyre në vendet e tjera, mund të jenë opsioni më i mundshëm për qeverisjen vendore në Shqipëri për financimin nëpërmjet **kredive “komunale”** të investimeve të tyre kapitale.
6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit është instrumenti kryesor, krahas fondeve të veta të NJQV-ve, për financimin e projekteve të infrastrukturës në nivel vendor. Pavarësisht nga vëllimi mjaft i madh i realizuar dhe i parashkuar për 4-5 vitet e ardhshme, skema e financimit të përdorur prej FSHZH-së nuk është e qëndrueshme dhe afatgjatë për të garantuar financimin e qëndrueshëm në kohë dhe partneritetin për NJQV-të në financimin e investimeve kapitale dhe në një periudhë afatmesme duhet synuar në ndryshimin e skemës së financimit.
7. FSHZH-ja nisur nga eksperiencia dhe kapacitetet e saj mund të jetë një zgjidhje dhe zgjedhje oportune dhe efiçente për garantimin afatgjatë të financimit të investimeve kapitale për pushtetin vendor, bazuar në modelet e suksesshme ndërkombëtare të financimit të fondeve të zhvillimit për kreditimin e investimeve kapitale lokale. Si një institucion publik, FSHZH mund të kishte një rol të rëndësishëm për të luajtur si asistent teknik për NJQV-të për mbështetjen në përmirësimin e performancës së tyre financiare dhe përmirësimin e menaxhimit të projekteve të infrastrukturës por jo vetëm.

Aktiviteti financiar i njësive dhe sfidat e sistemit financiar në shqipëri

Dr. Fatbardha Molla (Beqiri)

Lektore, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Shqipëri

Prof. PhD. Flutura Kalemi

Lektore, Universiteti Bujqësor i Tiranës

ABSTRAKT. *Dikur mjaftonte të kishe pak intuitë dhe suksesi i biznesit ishte i garantuar. Me një investim fillestar minimal mund të arrije norma të larta fitimi, sidomos po të vendosje të merreshe me tregti. Ishte një kohë kur guximi dhe lidhjet personale ishin më të rëndësishme se aftësitë administruese. Nuk kishte nevojë për studime tregu apo administratorë të aftë. Sot të nisësh një aktivitet, të investosh diku apo të rrisësh aktivitetin ekzistues nuk është më aq e thjeshtë. Duhet të kemi njohuri mbi aktivitetin financiar të njësive ekonomike, i cili zhvillohet në fushën funksionale në të cilën merr edhe emrin është i lidhur me të gjitha fushat e tjera funksionale të drejtimit organizativ, konsiston në administrimin e faktorit kapital. Duhet të dimë nevojën financiare të njësive që përfaqëson shumën e përgjithshme të mjeteve financiare, që në një moment të caktuar duhet të mbeten pranë njësive ekonomike për zhvillimin e veprimtarisë së saj ekonomike. Ajo paraqet masën absolute të nevojës financiare në një moment të caktuar. Është me rëndësi të përcaktohet se cila pjesë e saj është afatgjatë dhe se cila është afatshkurtër dhe probleme të tjera të rëndësishme. Për të orientuar sadopak drejtuesit e njësive ekonomike në njohjen sa më mire të problemeve financiare.*

Hyrje:

1. Aktiviteti financiar dhe nevojat financiare

Aktiviteti financiar i njësive ekonomike, i cili zhvillohet në fushën funksionale në të cilën merr edhe emrin, është i lidhur me të gjitha fushat e tjera funksionale të

drejtimit organizativ, konsiston në administrimin e faktorit kapital. Tradicionalisht në këtë fushë futen funksionet që i sigurojnë njësisë ekonomike rezerva të mjaftueshme mjetesht financiare, të nevojshme për kryerjen aktivitetit të vet .

Konceptet moderne fusin në këtë fushë edhe funksionet që kanë për detyrë t'i sigurojnë njësisë ekonomike vënien në punë me efijencë të këtyre mjeteve financiare në aktivitetin e saj, e thënë ndryshe administrimin e përdorimeve .

Ato konsistojnë në:

- furnizimin e njësisë ekonomike me burimet e nevojshme në lidhje me objektivat e saj, në kushtet më ekonomike;
- administrimin e drejtpërdrejt të investimeve që janë tipike për fushën financiare;
- ka pastaj detyra kontrolli që lejojnë verifikimin në mënyre që përdorimi i mjeteve financiare të jetë efijent për aq sa lejon struktura sasiore dhe cilësore.

Me qëllim që ta përmbushë sa më mirë detyrën, drejtimi financiar përdor disa instrumente:

- ato që kërkohen të mbajnë vazhdimisht nën kontroll nevojat për fonde;
- ato që bëjnë mbledhjen sistematike, koordinimin dhe interpretimin e informacioneve të nevojshme për programimin e njësisë ekonomike;
- ato që merren me analizimin e situatës së kaluar dhe të tashme të njësisë ekonomike për të përcaktuar pse janë krijuar nevojat financiare, si janë mbuluar ato në të kaluarën dhe rrjedhimisht vlerën e politikave të ndjekura në të kaluarën;
- ato që bëjnë parashikimin e nevojave të ardhshme financiare, me qëllim që të programojë modalitetet e sigurimit të fondeve, mjeteve financiare .

2. Nevoja financiare

E parë në optikën financiare, veprimtaria e njësisë ekonomike zhvillohet dhe konkretizohet me një vazhdimësi komplekse fluksesh monetare që vijnë si pasojë e dinamikës së veprimtarisë së investimeve, marrjes së financimeve, kthimet dhe rivendosjes së tyre.

Për të zhvilluar veprimtarinë e saj njësia ekonomike ka nevoje për mjete financiare për të përballuar nevojat. Për mbulimin e nevojave financiare njësisë ekonomike i duhet të kërkojë përveç mjeteve të krijuara nga veprimtaria e saj, edhe nga mjetet që ofrohen nga sistemi financiar dhe i kreditit.

Nevoja financiare lind sepse investimet dhe shpenzimet që shkaktjnë dalje të mjeteve monetare, nga pikëpamja e kohës kryhen para se të realizohen të ardhurat nga të cilat përfitohen mjetet monetare. Nevoja financiare përfaqëson shumën e përgjithshme të mjeteve financiare, që në një moment të caktuar duhet të mbeten pranë njësisë ekonomike për zhvillimin e veprimtarisë së saj ekonomike. Ajo paraqet masën absolute të nevojës financiare në një moment të caktuar. Është me rëndësi të përcaktohet se cila pjesë e saj është afatgjatë dhe se cila është afatshkurtër.

- Pjesa që konsiderohet afatgjatë përfaqësohet nga investimet në objektet teknike afatgjatë, materiale e jomateriale e financiare, si dhe nga niveli minimal ekonomik nevojave në materiale, produkte etj.

Mënyrat e mbulimit të nevojës financiare

Mbulimi i nevojës gjën shprehjen e vet në burimet e ndryshme që klasifikohen në:

- Burime të veta e të huajtura
- Të brendshme dhe të jashtme
- Afatgjatë dhe afatshkurtër

Në lidhje me këto dallime bilanci paraqet këto grupime:

- Pasuria neto, ajo përmbledh mjetet e veta të brendshme dhe të jashtme
- Pasivi afatgjatë
- Pasivi afatshkurtër

Përbërësit pasuror pasivë klasifikohen sipas:

- a. Karakteristikave teknike
- b. Karakteristikave ekonomike
- c. Karakteristikave financiare

Për sa u përket karakteristikave teknike, zërat e pasivit të gjendjes pasurore, duhet të grupohen në mënyrë të tillë që evidentohen se ekzistojnë:

- a. Burime financimi që lihen në ndërmarrje për një kohë të papërcaktuar dhe pa asnjë kusht shlyerje.
- b. Burime financimi që vënë kapital në dispozicion të ndërmarrjes për periudha kohore pak a shumë të gjata, por me kushtin e shlyerjes të tyre.
- c. Për sa u përket karakteristikave ekonomike, zërat kontabël duhet të klasifikohen në mënyrë të atillë që të evidentohet menjëherë mënyra se si grupet e ndryshme marrin pjesë në procesin e prodhimit .

Kjo për qëllim për të vërtetuar nëse këto zëra janë bashkuar në një kompleks që është i aftë të kontribuojë me një kosto sa më të ulët, duke mbajtur parasysh faktin se përdorimi i kapitalit të vet nuk shkakton kosto, ndërsa përdorimi i kapitalit të siguruar nga burime të huajtura shkakton kosto në formën e interesave pasive ose forma të tjera detyrimi.

- d. Për sa u përket karakteristikave financiare, zërat kontabël duhet të grupohen në bazë të kohës që do të përdoren nga njësia:

- Për një kohë të papërcaktuar, pa asnjë kusht shlyerje (kapital të vet),
- Për një periudhë të gjatë kohe, por me kushtin e shlyerjes së tyre (detyrime afatmesme dhe afatgjatë),

Për një periudhë të shkurtër, por me kushtin e shlyerjes së tyre (detyrime afatshkurtër)

3. Proçesi i buxhetimit të kapitalit

Për të vlerësuar së për sa para ka nevojë një biznes për një periudhë të caktuar, menaxherët e financës gjenerojnë një buxhet kapitali. Hapi i parë është të parashikohen shitjet. Pastaj ato projektojnë asetet e nevojshme për të mbështetur atë nivel shitjesh. Më pas, ata vendosin nëse këto asete ekzistojnë tani apo nëse ata kanë nevojë t'i blejnë. A mund të mbështeten asetet nëpërmjet fondeve të brendshme apo do të ketë nevojë për burime të jashtme? Nëse do të ketë nevojë për para , vendosim si t'i sigurojmë fondet.

Kapitali afatshkurtër është pothuajse gjithmonë në formën e llojit të një huaje. Huatë bankare janë të zakonshme, por shumë biznese bazohen në hua *faktorësh*. Faktorët blejnë llogari marrëse me ulje çmimi. Ulja varet nëse marrëset janë blerë me burime apo pa burime. “Me burime” do të thotë se faktori ka të drejtën t’i kthejë llogaritë kompanisë, nëse nuk është në gjendje t’i mbledhë ato. “Pa burime” do të thotë që faktori supozon detyrimin total për të mbledhur debinë. Pa burim vjen një rënie shumë më e madhe në vlerën e marrësve, meqë faktori po merr më shumë rrezeqe. Bizneset nuk duhet të jenë keq në mungesë të parave “cash”, saqë të jenë të detyruar të shesin stoke pa interesa fikse për të mbuluar nevojat afatshkurtra për para “cash”.

Rasti i tepër parave “cash”

Shumë biznese të suksesshme, për arsye të ndryshme, nuk kërkojnë linja kredie por mbajnë para “cash” nga stinët e mira të shitjes për t’i mbartur ato në kohë të vështira. Por, duke mbajtur shumë para “cash” mund të jetë edhe një problem. Si dollarët e fshehur nën dyshek, paratë vetëm nuk mund të fitojnë asgjë. Një përqindje e shpejtë apo një test acidi – (asetet aktuale – inventarin) / detyrimet aktuale, – sugjerojnë që biznesi ka para “cash” të tepërta. Biznesi duhet të paktën të ngrejë llogari fshirëse – llogari bankare, balancat e të cilave transferohen automatikisht në llogari interes-mbajtëse apo investime, si fonde tregu në para. Nëse ka teprim të mjaftueshëm në “cash”, biznesi duhet të ketë edhe disa mjete investimi afatshkurtra. Çdo industri ka disa përqindje debie standarde, zakonisht një kombinim debie të gjatë dhe të shkurtër. Ju duhet të shikoni krahasimet e kompanisë suaj. Duke supozuar debi, veçanërisht kur keni rrjedhje në “cash” për ta mbuluar atë, mund t’ju ndihmojë të rriteni me butësisht.

Faktorizimi

Ja se si vepron faktorizimi. Një faktor (kompani faktorizuese) blen llogari të klientëve nga kompania, duke nxjerre në ulje zakonisht 3% në 5% të shumës së llogarive. Kjo ulje është së pari për të kompensuar faktorin për marrjen e riskut në mbledhjen e llogarive. Faktori mund të blejë llogari *me burime*, që do të thotë se ka të drejtën të shesë llogaritë sërish tek kompania, nëse ajo nuk mbledh nga klientët brenda një kohe të caktuar. Nëse blen llogari *pa burime*, faktori është përgjegjës për mbledhjen.

Bizneset kanë më shumë fleksibilitet në opsionet e financimit për kapital afatgjatë. Debia afatgjatë, si një hipotekë apo formë tjetër e huasë indirekte, është shumë e zakonshme për biznese të vogla. Nëse biznesi është një ent që mund të lëshojë stoke, ky është një opsion. Disa biznese mund të zgjedhin të lëshojnë obligacione. Në çdo

rast, sukcesi në ngritjen e fondeve nëpërmjet stoqeve apo obligacioneve mund të varet në deklarime të mira financiare, kështu që përsëri mund të ketë një joshje për t'u bërë krijues me kontabilitetin për të përmirësuar numrat.

Terma kyçe

Faktorizimi – Shitja e llogarive marrëse në një kompani faktorizuese apo një faktor në një uljeje për supozimin e riskut të mbledhjes nga llogaritë. E njohur gjithashtu si financim i llogarive marrëse.

4. Sistemi financiar në Shqipëri dhe roli i tij në financimin e njësive

Cilido që kërkon të marrë kredi në euro apo dollarë nga bankat e huaja që operojnë në Shqipëri, për investime, për të blerë një apartament apo automjet të ri duhet të përgatitet për një përqindje të kripur interesi bankar.

Rritja e normës së interesit bankar ka ndodhur që kur kriza financiare ka pushtuar tregjet botërore.

Argumenti i tyre kryesor është prania tepër e kufizuar e Shqipërisë në tregjet globale. Por nuk mendojnë kështu ekspertët vendas. Ata paralajmërojnë një ngadalësim të rritjes ekonomike nga 6 përqind në 2008 në 4,5 - 5 përqind në 2009, një ulje të dërgesave të emigrantëve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në vendet e BE, pasi atyre u duhet tani të përballen me krizën financiare që po *përfjetojnë këto vende*.

Në kushtet kur efektet e krizës botërore bëhen gjithnjë e më të dukshme, institucioni kryesor bankar në Shqipëri ka marrë disa masa për përballimin e këtij mjedisi në ndryshim. Banka e Shqipërisë ka ndryshuar dhe përmirësuar kuadrin e raportimit të bankave, në drejtim të kohës dhe cilësisë së të dhënave, në veçanti lidhur me ekspozimin e tyre ndaj tregjeve financiare (dhe bankave mëmë), detyrimet e tyre (depozitat dhe ekspozimin ndaj linjave të kredisë) ndaj bankave mëmë, si dhe lidhur me zhvillimet në portofolin e tyre të kredisë. Megjithatë efektet e krizës globale kanë ndikuar në disa sektorë të ekonomisë, veçanërisht të atyre sektorëve që prodhojnë për eksport si dhe në rënien e dërgesave të emigrantëve, efekte që pritet të ndikojnë në një ulje të rritjes ekonomike për vitin 2009, në krahasim me rritjen e shënuar në vitin 2008.

Në vendet e zhvilluara, politikat makroekonomike ndeshën në vështirësi për të gjetur një ekuilibër midis ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe forcimit të presionit të inflacionit.

Pasojat e krizës financiare dhe të rritjes së çmimeve të produkteve energjetike dhe ushqimore, u materializuan në formën e humbjeve të konsiderueshme në bilanc për institucione të rëndësishme financiare, në rritje të kostos së prodhimit dhe të nivelit të përgjithshëm të çmimeve, ulje të konsumit, ngadalësim të rritjes ekonomike dhe rritje të papunësisë.

Veprimet e harmonizuara të autoriteteve monetare, nëpërmjet ndërhyrjeve për t'i dhënë tregjeve likuiditetin e nevojshëm dhe për të mbështetur drejtpërdrejt institucione

financiare të rëndësishme, kanë shmangur një kolaps të tregjeve financiare. Sistemi financiar në Shqipëri ka vijuar rritjen e tij të qëndrueshme. Aktivitetet e sektorit financiar kanë njohur rritje të qëndrueshme, por pjesa e sektorit financiar jobankar vijon të ketë një peshë të ulët në tregun financiar. Rezultati i mirë financiar, si në sektorin bankar ashtu edhe në atë financiar jobankar, vijon të mbështetet prej zgjerimit të shpejtë të veprimtarive me kthim të lartë nga investimi.

Burimi kryesor i financimit të veprimtarisë mbeten depozitat e publikut, ndërkohë që edhe pse me rritje, financimi i veprimtarisë nëpërmjet linjave të kreditimit të marra nga grupet bankare zotëruese është ende në nivele të pranueshme. Treguesi i kapitalizimit të sektorit financiar dhe veçanërisht të atij bankar është rritur, duke përfutur kryesisht prej kapitalizimit të fitimit. Analizat e skenarëve të rrezikut, konfirmojnë se sektori bankar është në gjendje të mirë për të përballuar rreziqet e ndryshme, që mund të rrjedhin si rezultat i lëvizjeve të padëshirueshme në kursin e këmbimit dhe në normat e interesit. Megjithatë, nevojitet një ndjekje e kujdesshme e ecurisë së cilësisë së aktiveve dhe ka ardhur koha për t'i kushtuar një vëmendje më të madhe ecurisë së treguesve të likuiditetit. Në rastin e sektorit bankar, cilësia e portofolit të kredisë paraqitet tërësisht e kontrollueshme.

Rritja e shpejtë e kredisë dhe vështirësitë që mund të ndeshin sektorë të veçantë të ekonomisë që janë kredituar në mënyrë të ndjeshme, janë faktorë që do të vijnë të ushtrojnë presion mbi cilësinë e kredisë në të ardhmen. Për këtë qëllim, bankat të ndjekin një politikë të identifikimit sa më të shpejtë të kredisë me probleme dhe të krijojnë menjëherë fondet përkatëse rezervë.

Në lidhje me likuiditetin, është e nevojshme që strukturat drejtuese të bankave, të ndjekin praktika që lejojnë vetë institucionin të plotësojë nevojat e pritshme për likuiditet në mënyrë sa më të pavarur, por duke pasur edhe alternativa të cilat përmirësojnë aftësinë e tyre për të gjeneruar likuiditet, në rast nevojë. Ato duhet të rishikojnë cilësinë e portofolit të letrave me vlerë, veçanërisht të atij në valutë, për të realizuar karakteristikat optimale të sigurisë dhe të tregtueshmërisë. Në të njëjtën kohë, duhet rivlerësuar përshtatshmëria e niveleve të treguesve të caktuar, për sa i takon diferencave në afatet e maturimit dhe në llojin e valutës së aktiveve dhe të burimeve të financimit.

Zgjerimi i krizës në tregjet ndërkombëtare financiare drejt Evropës, ka bërë që të shtohet rreziku i ndikimit të sistemit financiar në vend. Megjithatë, disa faktorë kuqezojnë nivelin relativisht të ulët të ekspozimit të sistemit tonë financiar ndaj institucioneve të huaja financiare, nivelin e ulët të integritetit në përgjithësi dhe mirë-kapitalizimin e veprimtarisë së grupeve bankare evropiane dhe të filialeve të tyre që veprojnë në vendin tonë, do të shërbejnë si elemente mbrojtëse për sistemin tonë financiar ndaj këtij rreziku. Në kuadrin e zhvillimeve ekonomike globale, pasiguria për zhvillimet e ardhshme në çmimet e mallrave të konsumit dhe në rritjen ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian, të Zonës së Euros dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të diktojë ecurinë e normave të interesit në tregjet e parasë dhe të kredisë, si edhe ecurinë e kursit të këmbimit. Ekziston gjithashtu, rreziku që përcjellja e vështirësive që ndesh ekonomia e vendeve

evropiane dhe më gjerë, të pasqyrohet në vendin tonë, nëpërmjet uljes së fluksit të hyrjeve nga emigrantët, përkeqësimit të deficitit tregtar dhe uljes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Megjithatë, shkalla e materializimit të këtij rreziku dhe madhësia e tij, nuk pritet të jenë të rëndësishme.

Me gjithë zhvillimet e fundit në tregjet financiare ndërkombëtare, në sistemin bankar shqiptar nuk evidentohet ndonjë rrezik, i cili ka mundësi të lartë materializimi me pasoja të menjëhershme në veprimtarinë e tij. Sidoqoftë, nevojitet rritja e vigjilencës dhe e kujdesit nga ana e institucioneve financiare, për të ruajtur ekspozime sa më të ulëta në tregjet financiare ndërkombëtare, si edhe për të siguruar një veprimtari të mirë-kapitalizuar dhe likuide.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë iu ka kërkuar strukturave drejtuese të bankave, të përcaktojnë dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme konkrete, për të ruajtur dhe për të përmirësuar aftësinë për të gjeneruar në vazhdimësi rezultat financiar pozitiv, duke ruajtur cilësinë e aktiveve dhe treguesit e likuiditetit. Banka e Shqipërisë do t'i orientojë dhe do t'i mbështesë këto veprime, nëpërmjet krijimit të stimuljeve të nevojshëm rregullativë. Intensifikimi i dialogut me industrinë financiare dhe bashkërendimi i veprimeve mes autoriteteve publike, janë elemente të cilat do t'i shërbejnë ruajtjes së besimit të publikut në sistemin financiar dhe zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarisë.

Sistemi bankar në Shqipëri

Sistemi bankar në vend, ka treguar një performancë pozitive në të gjithë treguesit e tij, edhe gjatë tre mujorit të parë të këtij viti, krahasuar me fundin e vitit 2008, ndonëse përballë efekteve të krizës financiare ndërkombëtare. Tremujori i parë i vitit 2009 shënoi rritje të aktiveve të sistemit bankar me rreth 0.04 përqind në terma relativë, kundrejt fundit të vitit 2008. Ndërkohë që ky tremujor dallon rritjen e shkallës së ndërmjetësimit të sektorit bankar në ekonomi. Dinamika në strukturën e aktiveve të sistemit bankar u përcaktua kryesisht nga zhvillime të tilla si: tendenca në rritje e peshës së kredidhënies, reduktim të kredisë me probleme si dhe rritje të depozitave në monedhën lekë, euro dhe USD. Ndryshe nga tremujori paraardhës, analiza e dinamikës së strukturës së portofolit të kredive këtë tremujor, dallon për ritmin më të lartë të rritjes së kredisë akorduar bizneseve kundrejt kredisë dhënë individëve. Banka e Shqipërisë ka intensifikuar mbikqyrjen e bankave në vend, me qëllim që të monitorohet nga afër procesi i administrimit të rrezikut dhe mënyrës se si bankat reagojnë ndaj zhvillimeve të reja.

Sfidat e sistemit bankar përballë zhvillimeve ekonomike ndërkombëtare

Banka e Shqipërisë vlerëson se përballë zhvillimeve ekonomike ndërkombëtare, është rritur ndjeshmëria e sistemit financiar ndaj zhvillimeve të brendshme makroekonomike, ku rreziqet kryesore lidhen me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik

të vendit. Zhvillimet e tremujorit të fundit të vitit 2008, si edhe të muajve të parë të vitit 2009, tregojnë që rritja ekonomike për vitin 2009, ndonëse pritet të jetë pozitive, do të jetë e ulët. Arsyet e këtij ngadalësimi të rritjes ekonomike, lidhen me rënien e kërkesës së brendshme, për shkak të rënies së të ardhurave të agjentëve të brendshëm ekonomikë që ndërveprojnë me tregjet ndërkombëtare dhe me uljen e ndjeshme të financimit nga ana e sektorit bankar në vend. Për këtë arsye, mundësitë për zgjerim të veprimtarisë së sistemit financiar do të jenë më të kufizuara dhe rezultati i tij financiar do të jetë më i ulët. Nga ana tjetër situata më e vështirë e likuiditetit në tregun e brendshëm financiar si edhe në tregun e huaj, po shoqërohet me rritjen e kostos së financimit të deficitit buxhetor, duke sjellë rritjen e ngarkesës fiskale në një periudhë afatmesme. Banka e Shqipërisë vlerëson se, ruajtja e objektivit të përcaktuar në fillim të vitit për deficitin buxhetor, do t'i shërbente më mirë realizimit të financimit të tij me një kosto më të ulët dhe çlirimit të fondeve për përdorim në tregun e brendshëm dhe për sektorin privat.

Përfundime :

Roli i komunitetit privat në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë është i padiskutueshëm dhe në këtë kuadër, ky do të përbënte klientelën e shëndoshë të bankave dhe do të kontribuonin në suksesin e dy palëve.

Siç dihet, funksioni themelor i sistemit bankar është kanalizimi i kursimeve apo mjeteve të lira të njësive suficitare, drejt njësive ekonomike deficiitare.

Kredia përbën kështu mekanizmin më të rëndësishëm në financimin e aktivitetit ekonomik të sipërmarrjeve, ndërsa bankat shërbejnë si instrument i realizimit të këtij qëllimi të fondeve. Sigurimi i financimit nëpërmjet kredisë bankare është një nga problemet më të mprehta, me të cilat ndeshet aktualisht biznesi në vendin tonë.

Megjithatë, mund të thuhet që bankat kane bërë përmirësime në drejtim të krijimit të lehtësive të duhura ndaj biznesit shqiptar, si për fillimin e një veprimtarie të re biznesi, ashtu dhe për zgjerimin e atyre ekzistuese.

Banka e Shqipërisë ka si detyrë ligjore edhe politikën e kreditimit. Aktiviteti kreditues i bankave është një ndër kanalet e transmisionit të politikës monetare dhe për këtë arsye, Banka e Shqipërisë është e interesuar ta nxisë atë.

Duke ju referuar sa më sipër dhe rezultateve të pyetësorit, njësitë ekonomike janë të interesuara për të punuar me dy tipat e financimit, por duke pasur parasysh se ndër rrugët kryesore të financimit të njësisë ekonomike vazhdon të mbeten bankat ose sistemi bankar dhe duke ditur se ekzistojnë lidhje mes rritjes së ekonomisë dhe konsolidimit të sistemit financiar¹⁰⁴ dhe arriten në një konkluzion se zhvillimi i sistemit financiar është parashikues i mirë për rritje të ardhshme të ekonomisë.

Pra, si konkluzion, sa më i zhvilluar të jetë sistemi bankar, aq më e madhe do të

104 nga nje seri studimesh te King and Levine 1993

jetë mundësia e njësive ekonomike për t'u financuar me kredi të leverdishme. Me gjithë përparimet në sistemin tonë bankar, me rritjen e numrit të tyre dhe uljes së vazhdueshme të përqendrimit bankar mbetet që të rritet ndërmjetësimi bankar.

Dhe si konkluzione drejt asaj të arritjes së optimumit të miksimit të burimeve të financimit mbeten:

- Pasiguria e madhe për të ardhmen
- Situata e brendshme politike dhe ekonomike
- Kushtet jo të favorshme të financimit, shuma të pamjaftueshme, norma të larta interesi, etj
- Dhe duhet të punohet shumë që ndërmjetësimi nëpërmjet bankave të bëhet kulturë në biznes

Literatura:

1. Accounting for Menagers Bill Webster
2. Allott, A. (2000), Management Accounting Change, Management Accounting, UK,
3. Ferrara, W. (1995), Cost/Management accounting: The 21st Century Paradigm,
4. Management Accounting, USA, Dhjetor, fq. 30, 36.
5. www.aicpa.org
6. www.gasb.org
7. www.rmahq.org
8. Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, Vëllimi 8 numër 4, dhjetor 2005
9. Kontabiliteti i drejtimit, F. Kalemi, 2006
10. Konferenca e pestë ndërkombëtare "Biznesi dhe Punësimi", Prishtinë 21 shtator 2006
11. Konferenca e gjashtë ndërkombëtare "Biznesi dhe Punësimi", Prishtinë 19 tetor 2007
12. Konferenca e shtatë ndërkombëtare "Biznesi dhe Punësimi", Prishtinë tetor 2008
13. Halit Xhafa – Beshir Ciceri, Drejtimi financiar
14. Vjollca Karapici, Analiza financiare
15. Magdalena Bregasi, Politika financiare e ndërmarrjes
16. Ardian Fullani, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, E mërkurë , 08 tetor 2008 Tirana Observer.

Pse nuk ishin efektive uljet e kontributeve për sigurimet shoqërore për periudhën 2005-2009

Ilir BEQJA

Deputet

MBA Enea ZAFIRI

Universiteti Europian i Tiranës

ABSTRAKT. *Kriza ekonomike botërore ndikoi jo vetëm ekonomitë në mbarë botën por dhe sistemet përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore (S.SH.SH). Për të përballuar krizën, vende të ndryshme morën masa të cilat synonin jo vetëm amortizimin e efekteve por dhe rimëkëmbjen e sistemit. Këto masa synuan të ndikonin pozitivisht edhe në sistemin e S.SH.SH. Masat dhe efikasiteti i tyre ishin të ndryshme për vende të ndryshme.*

Si një ekonomi e hapur, edhe ekonomia shqiptare u godit nga kjo krizë. Pasojat u ndjenë edhe në sistemin e S.SH.SH. Qeveria shqiptare ndërhyri në sistemin ekonomik për të amortizuar efektet e krizës por kjo ndërhyrje u kushtëzua nga karakteristikat e sistemit si dhe nga fushata elektorale e cila shoqëroi në një masë të madhe krizën. Pasojat e ndërhyrjes pritet të japin efekte afatshkurtra dhe afatgjata si në sistemin ekonomik, ashtu dhe në sistemin e S.SH.SH.

Objektivi i këtij studimi është dhënia e rekomandimeve për ndërhyrje të qeverisë në sistemin shqiptar të S.SH.SH me qëllim zbutjen ose eliminimin e efekteve negative të krizës ekonomike botërore. Për të arritur këtë, do të krahasohen përvoja e vendeve të tjera me përvojën shqiptare.

Studimi do të ndahet në tre pjesë. Pjesa e parë do të paraqesë një pamje të pasojave të krizës në sistemet e S.SH.SH të vendeve të ndryshme dhe masat që kanë marrë qeveritë e

këtyre vendeve për të përballuar efektet e krizës.

Pjesa e dytë do të paraqesë një pamje të sistemit shqiptar të S.SH.SH para dhe pas goditjes nga kriza. Në këtë pjesë do të analizohen pasojat e krizës, ndërhyrjet që ka kryer qeveria shqiptare, si dhe pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të këtyre ndërhyrjeve në S.SH.SH.

Pjesa e tretë do të paraqesë një analizë krahasuese me synim nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve.

Hyrje

Në Shqipëri, gjatë një periudhe 4 vjeçare (2005-2009) u kryen dy ulje në nivelin e përqindjes së pagesës së kontributeve për sigurimet shoqërore. Objektivat e uljeve në kontributet për sigurimet shoqërore ishin: rritje të ardhurash, rritje punësimi dhe ulje evazioni në pagesën e kontributeve. Njëkohësisht me këto ulje u ndërmorën edhe katër rritje të shumës së pensioneve mujore. Ulja e kontributeve, (ulja e të ardhurave) dhe rritja e pensioneve (rritja e shpenzimeve) detyrimisht do të krijojnë vështirësi në vetë-financimin e skemës së pensioneve. Sipas ISSH dhe Ministrisë së Financave kjo vështirësi parashikohej të kalohej me rritjen e madhe të të ardhurave që parashikohej të vinte nga rritja e numrit të kontribuesve (si pasojë e vetëdeklarimit dhe formalizimit) si dhe rritja e pagës mesatare të deklaruar me më shumë sesa dyfishi (Koldashi 2006, DH.T.I.T 2009).

Të dhënat nga ISSH (2010) tregojnë që, gjatë 4 viteve (2005-2009), numri i kontribuesve urbanë u rrit vetëm më 23.7%, një rritje normale nëse krahasohet me rritjen e PBB prej 26.58% për të njëjtën periudhë (FMN 2008, 2010), raporti i të ardhurave të skemës së detyrueshme ndaj PBB ngeli pothuajse i njëjtë, nga 5.67% në vitin 2005 në 5.69% në vitin 2009, dhe papunësia pothuajse e njëjtë (sipas INSTAT nga 14.1% në vitin 2005 dhe 13.75% në vitin 2009). Nga ana tjetër, shpenzimet e skemës së detyrueshme të pensioneve u rritën nga 5.69% e PBB në vitin 2005 në 6.26% e PBB në vitin 2009, defikiti i skemës së detyrueshme të pensioneve shkoi nga 142 milion në vitin 2005 në 6,499 milion në 2009 dhe financimet nga buxheti u rritën nga 1.66% e PBB në vitin 2005 në 2.42% të PBB në vitin 2009.

Punëdhënësit, punëmarrësit dhe evazioni

Të dy uljet e kontributeve të sigurimeve shoqërore në Shqipëri nuk arritën të realizonin objektivat e qeverisë si për evazionin ashtu dhe për të ardhurat dhe punësimin pasi kishte arsye të tjera që ndikuan dhe nuk e lejuan uljen të ishte efektive. Arsyeja e parë ishte mungesa e stimuljeve për punëdhënësit të cilëve, nga njëra anë ju ulën pagesat për kontributet, nga ana tjetër ju rritën kostot e punës nëpërmjet taksës së sheshtë si dhe pagave dhe punonjësve të referencës. Arsyeja e dytë ishte mungesa e stimuljeve për të punësuarit. Në skemën e pensioneve mungojnë stimujt për një të punësuar që të vetë-deklarohet ose që të deklarojë pagën reale.

Punëdhënësit dhe taksa e punës

Vendet e Evropës Qendrore e Lindore dhe vendet e Azisë Qendrore (ECA), grup ku bën pjesë edhe Shqipëria, kanë nivele të larta kontributesh për pensione. Megjithatë, këto kontribute të larta nuk përbëjnë problem për konkurrueshmërinë e pagave për këto vende për sa kohë pagat janë të ulëta. (Holzmann *et al.* 2005). Në realitet, kostot e punës nuk janë domosdoshmërisht më të lartat në vendet me kontributet më të larta. Një vend mund të ketë vërtetë kontribute të larta për sigurimet shoqërore, por, nëse kjo shoqërohet me nivele më të ulëta taksash mbi punën efekti total rezulton të jetë një taksë pune më e ulët në vendet me kontribute më të larta (Euzeby 1995). Nga ky arsyetim rrjedh se, nëse ulja e kontributeve shoqërohet me faktorë të tjerë që ndryshojnë koston e punës si taksa e sheshtë, efekti total mund të jetë i ndryshëm nga ai i parashikuari.

Efekti i taksës së sheshtë

Kosto totale e punës për një punëdhënës është shpenzimi total që ai kryen për një punonjës. Ky shpenzim përfshin pagën neto (pagesën që merr në dorë punëtori), pagesën për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat. Nga këto elemente, në 4 vitet e fundit kanë ndryshuar kontributet për sigurimet shoqërore dhe mënyra e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat. Tabela në vazhdim jep në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e kryera. Nga tabela shihet qartë që kemi një ulje të kontributeve për punëdhënësit (nga 29% në 2005 në 15% në 2009), gjë që supozon një rënie në koston e punës.

	2005	2006	2007	2009
Kontribute punëdhënësi	30.7%	21.7%	21.7%	16.7%
<i>Sigurime shoqërore</i>	29%	20%	20%	15%
<i>Sigurime shëndetësore</i>	1.7%	1.7%	1.7%	1.7%
Kontribute punëmarrësi	11.2%	11.2%	11.2%	11.2%
<i>Sigurime shoqërore</i>	9.5%	9.5%	9.5%	9.5%
<i>Sigurime shëndetësore</i>	1.7%	1.7%	1.7%	1.7%
Tatim mbi të ardhurat	<i>Progresiv</i>	<i>Progresiv</i>	10.0%	10.0%

Njëkohësisht me uljen e kontributeve, kemi një ndryshim në mënyrën e llogaritjes së tatimit mbi të ardhura, nga progresiv në të sheshtë. Përpara hyrjes në fuqi të taksës së sheshtë, tatimi mbi të ardhurat llogaritej në mënyrë progresive, duke tatuar shumë pak pagat e ulëta dhe duke e rritur ndjeshëm masën e tatimit për pagat e larta. Në të kundërt, taksa e sheshtë taton njësoj, më 10%, si pagat e ulëta ashtu dhe ato të lartat. Ky ndryshim në llogaritje, ka efekte të ndryshme mbi koston e punës në vartësi të nivelit të pagës.

Një shembull konkret na ndihmon të shikojmë efektin e kombinuar mbi një pagë mesatare. Për të përcaktuar pagën mesatare është marrë informacioni më i fundit nga

INSTAT mbi pagat, ai i vitit 2007. Sipas INSTAT, paga mesatare për këtë vit ka qënë 27,350 lekë/muaj. Duke marrë në konsideratë edhe faktin që pagat nuk deklarohen të plota (Koldashi 2006) llogaritjet janë kryer për një pagë mesatare prej 30,000 lekë/muaj.

Tabela në vazhdim paraqet një analizë krahasuese mbi efektin e ndryshimit në kontribute dhe efektin e ndryshimit në taksën e sheshtë mbi këtë pagë. Si bazë krahasimi është marrë viti 2005. Ky vit krahasohet me vitin 2007, vit kur janë bërë efektive edhe taksa e sheshtë edhe ulja e kontributeve me 9%, dhe me vitin 2009, vit kur u krye ulja e fundit në kontribute me 5%. Në tabelë fillimisht është llogaritur paga neto ose ndryshe paga që merr në dorë punëtori në vitin 2005¹⁰⁵. Më pas, duke supozuar se punëtori është racional dhe i intereson vetëm se sa para dërgon në shtëpi, është supozuar që ky punëtor do të kërkojë nga punëdhënësi të paktën po të njëjtin nivel page neto. Si rezultat, është mbajtur e njëjta pagë neto dhe janë kryer llogaritjet sipas ndryshimeve në nivelin e kontributeve dhe në taksa¹⁰⁶.

VITI	2005	2007	2009	05/07 (në %)	05/09 (në %)
Paga bruto	30,000	32,792	32,792	9.3%	9.3%
Kontribute punëdhënësi	9,210	7,116	5,476	-22.7%	-40.5%
Kontribute punëmarrësi	3,360	3,673	3,673	9.3%	9.3%
Tatim të ardhura personale	800	3,279	3,279	309.9%	309.9%
Page neto	25,840	25,840	25,840	0.0%	0.0%
Kosto pune	39,210	39,908	38,268	1.8%	-2.4%

Nga shembulli duket qartë se efekti në koston e punës është i dyfishtë. Nga njëra anë kemi ulje të koston si pasojë e uljes në nivelin e kontributeve me 9% në vitin 2006 dhe me 5% në vitin 2009 ndërsa nga ana tjetër kemi rritje të kostove si pasojë e ndryshimit në taksën e sheshtë. Efekti i uljes në kontributet që paguhet nga punëdhënësi është 22.7% pas uljes së parë dhe 40.5% pas uljes së dytë. Ky efekt asnjëansohet totalisht nga rritja në tatimin mbi të ardhura nga 2.66% e pagës bruto në vitin 2005 në 10% të pagës bruto në vitet 2007 dhe 2009. Si pasojë, në total, pas uljes së parë me 9%, kosto e punës për punëdhënësin në vitin 2007 janë rritur në krahasim me vitin 2005. Ulja e dytë prej 5% sjell vetëm një ulje modeste me 2.4% në krahasim me vitin 2005. Këto të dhëna tregojnë që, në koston e punës për pagën mesatare, ulja e kontributeve nuk ka pasur asnjë efekt.

Konkluzioni i parë i kësaj analize është që ulja e kontributeve e shoqëruar me taksën e sheshtë nuk jep asnjë stimul financiar për firmat që të deklarojnë më shumë punonjës. Si pasojë, ulja e kontributeve nuk jep asnjë efekt në uljen e evazionit. Të dhënat nga ISSH (2010) e konfirmojnë këtë konkluzion. Sipas ISSH, në vitin 2005, kontributorë urbanë ishin 325 mijë persona ndërsa në vitin 2007 vetëm 355 mijë

105 Llogaritjet janë bazuar në UDHEZIM Nr. 5 Dt. 18.1.2005

106 Llogaritjet janë bazuar në LIGJ Nr. 9766, Dt. 9.7.2007, LIGJ Nr. 9600, Dt. 27.7.2006 dhe LIGJ Nr. 10070, Dt. 5.2.2009

persona. Pra kemi një rritje vetëm më 9% për një periudhë dy vjeçare. Ndërkohë PBB për të njëjtën periudhë është rritur më 11.3% (FMN 2007, 2008, 2009). E njëjta situatë rezulton edhe pas uljes së dytë të vitit 2009 e cila ka sjellë një rritje vetëm më 5.9%, nga 381 mijë në vitin 2008 në 403 mijë në vitin 2009. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, rritja në PBB reale është 10.8% (FMN 2010). Siç shihet, në të dy rastet rritja në numrin e kontribuuesve nuk arrin as në nivelin e rritje së PBB, gjë që tregon se të dyja uljet ishin të paefektshme.

Një konkluzion i dytë që mund të nxirret nga kjo analize është që ulja e kontributeve e shoqëruar më taksën e sheshtë nuk jep stimuj financiarë për të punësuar më shumë punonjës. Pas një ulje totale me 14% në nivelin e pagesës për kontribute, në vitin 2009 kemi një reduktim të kostos së punës vetëm me 2.4% krahasuar më vitin 2005. Sipas një llogarie të thjeshtë, që kjo ulje të krijojë fonde të mjaftueshme për të punësuar një punonjës shtesë duhet që firma të ketë të paktën 42 punëtorë të punësuar. Nga të dhënat e INSTAT rezulton se në vitin 2008 vetëm 7% e bizneseve të regjistruara në Shqipëri kishin mbi 50 punonjës. Pra ulja e kontributeve mund të stimulonte punësimin vetëm tek ky 7% i ndërmarrjeve të mëdha të cilat, është e vështirë që të mendohet se prisnin këtë ulje për të marrë një punonjës më tepër në pune. Të dhënat nga INSTAT mbështesin këtë konkluzion. Gjatë gjashtë muajve të dytë të vitit 2009, periudhë gjatë të cilës ulja supozohej të jepte efektet e saj, papunësia, në vend që të ulej është rritur nga 141,335 ose 12.7% në tremujorin e dytë në 143,340 ose 13.75% në tremujorin e katërt të vitit 2009.

Pagat dhe punonjësit e referencës

Në pamundësi për të legalizuar bizneset joformale dhe për ti bërë pjesë të skemës së sigurimeve, qeveria vendos të shtrydhë më tej bizneset që ka tashmë në regjistrin e tatimeve. Everest- Phillips Max (2008) e përcakton një sjellje të tillë si “Gjueti në kopshtin zoologjik”. Midis ndjekjes dhe formalizmit të bizneseve joformale (gjueti në xhungël) dhe shtrydhjes në maksimum të bizneseve formale (gjueti në kopshtin zoologjik) qeveria Shqiptare vendos të mbyllë problemet financiare duke zgjedhur formën e dytë, që është më e lehta por që ka efektivitet afatshkurtër.

Në kushtet e një reforme të imponuar nga FMN dhe Banka Botërore të cilat kërkonin në mënyrë të përsëritur stabilitetin financiar të skemës së pensione (FMN 2007: 36, FMN 2008: 35) qeveria vendos të ndërhyjë në treg duke vendosur më VKM Nr.285, datë 4.5.2007 sistemin e pagave të referencës. Sipas kësaj VKM, bizneset do të paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin e fitimit mbi pagat nisur nga pagat e përcaktuara si paga reference nga vetë qeveria. Këto paga reference sollën një rritje në nivelin e kontributeve pasi baza e llogaritjes ishte më e lartë sesa ajo reale. Kjo rritje konfirmohet edhe nga të dhënat e ISSH (2010) sipas të cilave, viti 2007 është më i mbari në nivel rritje të ardhurash (14%).

Një objektiv i dytë me anë të të cilit FMN (2007: 54) vendoste nën presion qeverinë ishte arritja e një numri prej 440,000 kontribues urbanë (shifër e cila më

pas korrektohet në 410,000 pasi u quajt e paarritshme nga qeveria FMN 2008: 13). Për të arritur këtë objektiv, me një VKM të dytë, VKM Nr. 1251, datë 10.9.2008 përcaktohet dhe numri i referencës i personave që duhet të punësojë një biznes. Si rezultat, biznesi do të paguante kostot e sigurimeve për një numër punonjësish të përcaktuar nga qeveria pavarësisht nëse i kishte ose jo të punësuar këta punonjës. Të dy këto veprime shtojnë më tej kostot e punës për punëdhënësit duke asnjëanësuar totalisht efektet e uljes së nivelit të kontributeve. Në përfundim, kosto e punës, në vend që të ulej më 9%, u rrit si pasojë e taksës së sheshtë dhe pagave dhe punonjësve të referencës.

Punëmarrësit dhe evazioni

Megjithëse Shqipëria ka një popullsi të re, rreth 1/3 më pak persona mbi 65 vjeç sesa mesatarja e ECA, (Banka Botërore 2006) përsëri raporti midis kontribuesve dhe përfituesve është problematik. Në vitin 2005 ky raport, për zonën urbane ishte 88% pra 88 përfitues për çdo 100 kontribues. Ky raport është përmirësuar disi në vitin 2009 duke shkuar në 71% por përmirësimi ka ardhur jo si pasojë e luftës kundër evazionit por nga rritja e moshës së pensionit (ISSH 2010). Megjithatë edhe ky raport mbetet shumë i lartë. Shkaku kryesor është niveli i lartë i evazionit. Në Shqipëri, niveli i ulët i pjesëmarrjes në skemë reflektohet më pas në nivelin e ulët të pensioneve dhe nivelin e lartë të kontributeve (Barlett *et al* 2007).

Ulja e kontributeve, për sa kohë nuk është shmangur evazioni do të shkaktojë patjetër probleme likuiditeti në skemën e pensioneve. Edhe skema më e mirë e grumbullimit dhe kontrollit [të kontributeve nga pensionet do të dështojë nëse nuk ka mbështetjen e pjesëmarrësve në të, së bashku të punësuar dhe punëdhënës (Rofman *et al* 2009).

Stimujt për evazion

Miopia në konsum dhe nevojat për konsum të tanishëm janë motivuesit kryesorë për punonjësit që të shmangin pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore (B.B. 1999). Miopia vjen sepse disa individë, në momentin që marrin vendime, i japin peshë shumë të vogël në funksionin e dobisë së tyre konsumit të ardhshëm. Si pasojë e miopisë, të rinjtë i japin shumë pak rëndësi konsumit të ardhshëm dhe kursejnë shumë pak (Thompson, 1998: 28). Nga ana tjetër, nevojat për konsum të tashëm mund të nxisin punonjësit që të shmangin pagesën për pensione. Varfëria, ngushtica financiare e përkohshme ose, për të rinjtë, nevojat e familjes së re janë shumë më shtërnguese sesa nevojat për konsum në të ardhmen (McGillivari 1997).

Të dy këto motive janë prezentë në tregun shqiptar të sigurimeve shoqërore. Nevojat për konsum të tanishëm stimulohen nga niveli i ulët i pagave. Pagat mesatare për vitin 2007 sipas INSTAT ishte 27,350 lekë ose vetëm diçka më shumë sesa 220 Euro. Me këtë nivel pagash, punonjësit do të kërkojnë mënyra për të shmangur pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore për çdo përqindje kontributesh me

qëllim të vetëm rritjen e konsumit aktual. Si rezultat, ulja e kontributeve vështirë se sjell ulje të evazionit.

Nga ana tjetër, miopia stimulohet nga mungesa e një lidhje të qartë midis kontributeve dhe përfitimeve. Në Shqipëri, kjo mungesë vjen së pari si pasojë e ndërhyrjeve të vazhdueshme në skemën e pensioneve. Ky problem shkaktohet nga rritjet në mënyrë diskrete të pensioneve gjatë periudhës 2005-2009. Këto rritje shpesh gjatë gjithë kohës e më shumë lidhjen midis kontributeve dhe përfitimeve. (Shëarz 2007). Kjo është një shtysë e fortë për të deklaruar një pagë minimale dhe për të fshehur pagën reale.

Se dyti, miopia stimulohet nga vetë ndërtimi i skemës. Skema është ndërtuar në mënyrë të tillë që stimulon evazionin. Grumbullimi i kontributeve kryhet duke marrë si bazë një pagë minimale 5 herë më të vogël sesa paga maksimale. Në vitin 2009 paga minimale ishte 16,120 lekë në muaj ndërsa paga maksimale 80,600 lekë në muaj¹⁰⁷. Ndërkaq, pensioni maksimal me ligj është fiks dy herë më i madh sesa pensioni minimal (20,552 kundrejt 10,276 - ISSH 2010). Kjo skemë e nxit evazionin për disa arsye. Së pari, meqë pensioni maksimal do të jetë vetëm sa dyfishi i pensionit minimal atëherë nuk ka arsye përse të deklarohet paga reale. Punonjësit stimulohen të deklarojnë maksimumi dyfishin e pagës minimale. Së dyti, individët që deklarojnë të ardhura më të larta sesa dyfishi pagës minimale do ta arrijnë shumë shpejt pensionin maksimal. Si rezultat, nëse punonjësit janë të detyruar të deklarojnë paga të larta për një periudhë të caktuar, skema i nxit që, për kompensim, të mos deklarojnë fare për një periudhë tjetër pasi nga kjo pagesë nuk marrin asnjë përfitim (Banka Botërore 2006). Së treti, në Shqipëri, pensioni minimal është 38% e pagës mesatare ndërsa pensioni mesatar vetëm 41% (Shwartz 2007). Si rezultat, për çdo nivel page të deklaruar diferenca në përfitim është shumë e vogël dhe për pasojë punonjësit nxiten të paguajnë pagën minimale.

Efektet afatshkurtra të ndërhyrjes në skemë

Në Shqipëri për periudhën 2005-2009 përveç uljes së kontributeve ka pasur dhe rritje të vazhdueshme të nivelit të pensioneve. Brenda një periudhe 4 vjeçare, kemi një rritje totale të pensioneve më 31% në qytet dhe 85% në fshat ndërkohë që kemi 2 ulje të nivelit të kontributeve me 9% në vitin 2006 dhe 5% në vitin 2009. Këto ndërhyrje në skemën e pensioneve kanë sjellë rritje të madhe të shpenzimeve dhe reduktim të ndjeshëm në të ardhura. Analiza në vazhdim paraqet efektet në të ardhurat dhe shpenzimet e skemës gjatë kësaj periudhe.

Të ardhura dhe shpenzime

Tabela në vazhdim paraqet në mënyrë të përmbledhur ecurinë e treguesve kryesore të të ardhurave të skemës së kontributeve të detyrueshme.

107 VENDIM Nr. 700, datë 18.6.2009

	2005	2006	2007	2008	2009
Të ardhurat (milion lekë)	46,191	51,274	58,661	62,305	65,111
Rritja vjetore	12%	11%	14%	6%	5%
Në % ndaj GDP	5.67%	5.81%	6.07%	5.73%	5.69%
Shpenzimet (milion lekë)	46,333	50,970	58,132	62,909	71,610
Rritja vjetore	10%	10%	14%	8%	14%
Në % ndaj GDP	5.69%	5.78%	6.01%	5.78%	6.26%
Suficiti (deficiti) skemës	(142)	304	529	(604)	(6,499)
Financim nga buxheti (milion lekë)	13,521	15,392	20,667	20,282	27,675
Si % ndaj GDP	1.66%	1.74%	2.14%	1.86%	2.42%

Burimi: ISSH 2010

Nga tabela shihet qartë që, viti më i mirë në nivel grumbullimi të ardhurash si në përqindje rritje ashtu dhe në përqindje ndaj GDP është viti 2007, vit gjatë të cilit u vendosën pagat e referencës. Ndërkohë vitet në vazhdim janë më nivele rritje modeste, vetëm 6% dhe 5%.

Në të kundërt nga të ardhurat, shpenzimet kanë një trend rritës, duke lëvizur nga 5.69% e PBB në vitin 2005 6.26% e PBB në vitin 2009. Edhe këtu shihet efekti i pagave të referencës. Viti 2007, vit në të cilin hyjnë në efekt pagat e referencës rezulton viti më i mirë nga pikëpamja e likuiditetit për skemën. Pavarësisht se shpenzimet kanë rritjen më të madhe 14% përsëri skema qëndron likuide madje prodhon suficit prej 529 milion lekë. Ndërkohë, viti 2009, gjatë të cilit kemi rritje në pensione, ulje në kontribute por nuk kemi ndërhyrje të tjera në skemë është viti më i vështirë. Deficiti i skemës brenda 1 viti rritet më 10.7 herë.

Pasojë të ndërhyrjeve janë ndjerë edhe në financimet nga buxheti. Tabela tregon qartë që niveli i ndërhyrjes ka ardhur në rritje duke u dyfishuar në vlerë absolute nga 13,521 milion lekë në 27,675 milion lekë. Sipas FMN (2010) shkurtimi i kontributeve të vitit 2009 nuk solli shmangie të dukshme në evazion por, nga ana tjetër, rriti deficitin e pensioneve në një nivel të lartë duke marrë në konsideratë popullsinë shumë të re të Shqipërisë.

Efekti në nivelin e pensioneve

Një efekt tjetër që këto ulje nuk marrin në konsideratë është efekti i tyre në nivelin e ardhshëm të pensioneve. Sipas ligjit pensioni i pleqërisë përbëhet nga dy pjesë: pensioni bazë dhe shtesa për çdo vit pune. Pensionin bazë e përcakton çdo vit qeveria. Shtesa bazohet në pagën e çdo viti. Për ta sjellë pagën e një periudhe të mëparshme në një nivel aktual në momentin e daljes në pension, ajo rritet me koeficientë të caktuar. Për çdo vit, koeficienti është raporti midis kontributit mesatar vjetor me kontributin mesatar vjetor të një viti më parë. Ulja e përqindjes së kontributeve në vitin 2006 ka sjellë që për vitin 2006 dhe 2007 të kemi koeficientët më të ulët që prej vitit 1997.

Koeficientët e ulët do të bëjnë që shtesa për pension të jetë më e vogël. Ulja e re përqindjes së kontributeve, efektive prej 1 maj 2009, do të bëjë që kontributi mesatar vjetor i vitit 2009 të jetë më i vogël sesa po të mos ulej masa e kontributeve. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me koeficientin e vitit 2010. Kështu për të gjithë personat që do të dalin në pension pas vitit 2011 shtesa mbi pension do të jetë më e vogël sesa në kushtet kur nuk do të kishim pasur ulje të përqindjes së kontributeve.

Efektet afatgjata

Rritja e deficitit në buxhet ka disa probleme afatgjata. Së pari, deficitet e larta në skemën e pensioneve kanë shpeshherë pasojë makroekonomike negative të cilat thellohen në raste krizash. Rasti më domethënës është ai i Brazilit në vitin 1998 ku një deficit buxhetor më i madh se 6% e PBB shkaktoi një krizë mbas krizës financiare në Rusi dhe në Azinë Lindore. 4% e këtij deficiti ishte si pasojë e kostos së pensioneve (Holzmann et al 2005). Së dyti, deficitet e larta dhe në rritje të skemës së pensioneve mbajnë në vetvete rrezikun e dëmtimit të stabilitetit makroekonomik, duke shtypur investimet e tjera publike dhe/ose investimet që ndihmojnë rritjen ekonomike (Holzmann et al 2009). Së treti, kriteret e Maastricht-it, të detyrueshme për të hyrë në BE, janë strikte përsa i përket nivelit të lejuar të borxhit: deficit i buxhetor poshtë 3% e PBB dhe niveli i borxhit jo më shumë se 60% e PBB. Një deficit në rritje i skemës së pensioneve detyrimisht do të detyrojë qeverinë të heqë dorë nga shumë investime të tjera për të qëndruar brenda kufizimeve të Maastricht-it.

Konkluzione

Ulja e kontributeve nuk është strategjia më e mirë për të luftuar evazionin. Përvoja ndërkombëtare tregon se nuk ka prova të qarta që të tregojnë se një ulje në nivelin e kontributeve rrit vetë-deklarimin (Demarco et al 1999). Për më tepër, ulja në nivelin e kontributeve vështirë se gjeneron të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur të ardhura të mjaftueshme për të financuar shpenzimet e mëdha për pensione (Schwarz 2007). Analiza e mësipërme i konfirmon këto konkluzione.

Rekomandimi ynë është që të ndërpriten sa më shpejt ndërhyrjet në skemë vetëm me qëllime elektorale. Të gjithë përpjekjet të fokusohen fillimisht në reformën e pensioneve dhe veçanërisht në luftën kundër evazionit. Më vonë, nëse lufta kundër evazionit rezulton e suksesshme mund të rishikohet mundësia për të ndërhyrë në skemë por me kusht që të mos krijohen deficitet të cilat rrezikojnë jo vetëm likuiditetin e skemës por dhe vetë prodhimin e të mirave publike.

Literatura:

1. Banka Botërore (2006) *'Shqipëria Rishikim i Sistemit të Sigurimeve Shoqërore'*
Raporti Nr. 37594-AL Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor, Njësia e Evropës

- Juglindore, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
2. Bartlett, W Xhumari, M (2007) 'Social Security Policy and Pension Reforms in The Western Balkans' European Journal of Social Security, 2007, 9(4): 297-322
 3. Demarco, G. Rofman, R. (1999), 'Collecting and transferring contributions', Social Protection Discussion Paper Series, No. 9907 World Bank
 4. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (2009) 'Bode: Sigurimet shoqërore, 5% taksa për punëdhënësin' Pro Biznes' Viti III, Nr. 5 (80):
 5. Euzeby, A. (1995) 'Reduce or rationalize social security contributions to increase employment?' International Labor Review Vol. 134, 1995, No.2: 227-241, FMN 2007
 6. IMF Country Report No. 07/244
 7. IMF Country Report No. 08/128
 8. IMF Country Report No. 09/73
 9. FMN 2010 Albania—2010 Article IV Consultation, Preliminary Conclusions of the Mission <http://www.imf.org/external/np/ms/2010/031010.htm>
 10. Holzmann, R. Hinz, R. (2005) 'Old-Age Income Support in the 21st Century: An International Perspective on Pension Systems and Reform' Ëashington, D.C.: The International Bank for Reconstruction and Development / THE ËORLD BANK
 11. Holzmann, R. et al (2009) 'Pension Reform in Southeastern Europe Linking to Labor and Financial Market Reform' Ëashington, DC: The International Bank for Reconstruction and Development / The Ëorld Bank
 12. INSTAT TË PAPUNË TË RREGJISTRUAR SIPAS STATUSIT 1997-2007 <http://www.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Treguesit%20Sociale/Papunesia/PAP%202008/t1.xls>
 13. INSTAT "FORCAT E PUNËS" (Trem.4/07- Trem.4/09) http://www.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Fp/3Mujori_IV_2009/t1.xls
 14. INSTAT "PAGA MESATARE MUJORE PËR NJË TË PUNËSUAR" (SEKTORI PRIVAT DHE SHITET ROR) Periudha 1997-2007 <http://www.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Treguesit%20Sociale/Pagat/PAG%202008/t1.xls>
 15. INSTAT "Ndërmarrjet aktive sipas vitit të krijimit dhe madhësisë", 2008 http://www.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Treguesit%20Ekonomik/Regjistri%20i%20Ndermarjeve/RND_2008/tab3.xls
 16. ISSH (2010) 'Të dhëna për skemën e detyrueshme të pensioneve për periudhën 2004-2009' Raport i papublikuar.
 17. Koldashi, E. (2006) 'Reduktimi i masës së pagesës së kontributeve faktor bazë për rritjen e numrit të kontribuuesve' Konferenca Kombëtare Reduktimi i Ekonomisë Informale . Sfidë e Qeverisë Shqiptare Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Drejtoria e Nxitjes së Biznesit, Tirane 16 Tetor 2006
 18. LIG J Nr. 9600, Dt 27.7.2006 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË

REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

19. LIGJ Nr.9766, Dt. 9.7.2007 PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR,
20. LIGJ Nr. 10070, Dt. 5.2.2009 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR.
21. Max Everest-Phillips (2008) *Business tax as state-building in developing countries: applying governance principles in private sector development*’ International Journal of Regulation and Governance 8(2): 123–154
22. McGillivray, W. (1997) *Administrative issues in the implementation of social security reform*, Social Security Documentation: European Series, No. 25 Geneva, International Social Security Association.
23. Ministria e Financave (2010) *TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR* www.minfin.gov.al/downloads/Fiscal_Table_2000_2009.xls.
24. Schwarz, A. (2007) *Pension Systems and Labor Costs in*.
25. *Southeastern Europe*’ World Bank Human Development Department, Europe and Central Asia Region.
26. Thompson, L. (1998) *Older and wiser: The economics of public pensions*’ Washington, DC, Urban Institute Press.
27. UDHËZIM Nr. 4, dt 18.1.2005 PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE.
28. UDHEZIM Nr. 5 Dt. 18.1.2005 PER “TATIMIN MBI TË ARDHURAT”.
29. VENDIM Nr.285, datë 4.5.2007 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE, SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARISË EKONOMIKE, PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN JOPUBLIK, QË KRYEJNË PUNË, TË PAKUALIFIKUARA E TË KUALIFIKUARA, SI DHE PËR PERSONELIN DREJTUES E TEKNIKO-EKONOMIK TË TYRE.
30. VENDIM Nr.1251, datë 10.9.2008 “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT REFERUES TË TË PUNËSUARVE, PËR EFEKT TË PAGIMIT TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË DISA VEPRIMTARI KRYESORE, PËR TATIMPAGESIT E REGJISTRUAR NË BIZNESIN E VOGËL.
31. VENDIM Nr. 700, datë 18.6.2009 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE

NR. 7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”.

32. World Bank (1994) *Averting the old age crisis: Policies to protect the old and promote growth* New York, Oxford University Press.

Analiza e mjeteve financiare në shpenzimet e marketingut në sektorin bankar shqiptar

Jonida Këllezi, MA

Universiteti European i Tiranës

Valbona Zeneli, PhD candidate

Universiteti European i Tiranës

Oltjana Zoto, MA

Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT. Dekada e fundit ka përballur institucionet financiare me ndryshimet më të mëdha që kanë ndodhur ndonjëherë në historinë e këtij sektori. Globalizimi ka rritur burimet e konkurrencës, si edhe aksesin drejt informacionit, dhe rrjedhimisht ka zhdukur “konsumatorin besnik” të viteve të shkuara. Në mjedise të tilla, marketingu shihet nga këto institucione esenciale për suksesin e tyre në vitet në vijim! Aplikimi i marketingut në sektorin bankar është kryer fillimisht nga vendet perëndimore në vitet 1950. Në vitet në vijim, zhvillimet në këtë sistem ishin gjithmonë e më shumë të orientuara drejt tregut, gjë që influençoi bankat në krijimin e tregjeve të reja. Në vitet e fundit, lidhja midis marketingut dhe sektorit bankar ka qenë mjaft e fortë si pasojë e ndryshimeve në strukturat demografike, intensitetit të konkurrencës në sektorin financiar, dhe synimet e bankave për të rritur përfitimet vetjake. Në fakt, marketingu bankar nuk përfshin vetëm shitjen e produkteve dhe shërbimeve bankare, mirëpo ai konsiderohet gjithashtu edhe si një funksion që krijon personalitetin dhe imazhin e bankës në mendjen e konsumatorëve. Falë globalizimit, kriza financiare ka qenë çështja më e përfolur gjatë viteve të fundit, pasi ajo ka ndikuar në shumë ekonomi të zhvilluara

dhe në zhvillim. Vende të zhvilluara si SHBA, kanë pësuar falimentime kompanish, kanë shkurtuar vende pune, rritje çmimesh, etj. Ndërsa në vendet në zhvillim, si Shqipëria, efektet janë ndjerë në investime të huaja, në çmime, në të ardhura, etj. Synimi i këtij artikulli është të studiojë ndikimet që ka pasur kriza ekonomike mbi shpenzimet e marketingut bankar në Shqipëri. Faktet kanë treguar se, në periudha krize ekonomike, kompanitë kanë tendencë të shkurtojnë pikërisht shpenzimet nga buxheti i marketingut. Kjo situatë është vështruar edhe në krizën aktuale ekonomike, ku kompanitë, përfshirë edhe sektorin bankar në Shqipëri, kanë minimizuar buxhetet me të cilët zhvillonin kërkime dhe zhvillime produktesh, promovime, etj.

Fjalë kyçe:

institucionet financiare, marketingu, kriza ekonomike.

Hyrje

Historia e sektorit bankar shqiptar mund të ndahet në tre faza të rëndësishme. Faza e parë lidhet me periudhën komuniste, deri në fillim të viteve '90, ku bankat e vendit ishin të drejtuara nga shteti (Banka e Shqipërisë, Instituti i Sigurimeve, Banka Nacionale Tregtare, Banka Agrare); faza e dytë njihet si periudha e tranzicionit, deri në vitin 1997, ku ekonomia kalon nga e përqëndruar në duar të shtetit në privat. Kjo periudhë dallohet për skemat e firmave piramidale, ose e thënë ndryshe, krijimi dhe rrënimi i institucioneve ilegale të depozitimit të parave. Dhe periudha e fundit e kësaj historie i ka rrënjët nga viti 1997 dhe deri në ditët e sotme (Helfat dhe Lieberman, 2002). Përgjatë kësaj periudhe dallohen investimet e huaja në sektorin bankar të vendit, të cilat kanë ndihmuar Shqipërinë që të kthehet në veprimtarinë normale dhe sektori Bankar të rimarrë vitalitetin e tij.

Për më tepër, dekada e fundit i ka përballur institucionet financiare me ndryshimet më të mëdha që kanë ndodhur ndonjëherë në historinë e këtij sektori. Globalizimi ka rritur burimet e konkurrencës, si edhe aksesin drejt informacionit, dhe rrjedhimisht ka zhdukur “konsumatorin besnik” të viteve të shkuara. Në mjedise të tilla, marketingu shihet nga këto institucione si esencial për suksesin e tyre në vitet në vijim!

Nga ana tjetër, vitet e fundit ekonomitë e zhvilluara janë prekur në mënyrë të konsiderueshme nga kriza financiare, dhe falë globalizimit ritmet e saj janë përhapur mjaft shpejt edhe në ekonomitë në zhvillim.

Duke marrë parasysh efektet e kësaj krize, synimi i këtij artikulli është të studiojë ndikimet që ka pasur ajo mbi shpenzimet e marketingut bankar në Shqipëri.

1. Sektori bankar në shqipëri

Whitelock (2002) ka cituar se ekonomitë e centralizuara karakterizoheshin nga një përqëndrim i bizneseve në duar të shtetit. Në mënyrë të rëndësishme, Kawai dhe

Takayasu (2000) theksojnë se një ndër mjetet më të rëndësishme për të përmbushur objektivat e zhvillimit makroekonomik dhe për të arritur stabilitet, janë reformat në sektorin bankar dhe atë financiar.

Përgjatë dekadës së fundit, sistemi bankar në rajonin ballkanik ka kaluar në tre stade të rëndësishme – privatizimi, konsolidimi, si edhe hyrja e bankave të huaja në treg (Whitelock, 2002).

Është fakt që, bankat e huaja kanë luajtur një rol dominues në vendet e Europës Juglindore. Këto banka kanë penetruar tregjet në forma të ndryshme si, duke vendosur degë të tyre, duke marrë pjesë në privatizimin e bankave shtetërore, partnerizime, etj. Në fund të vitit 2004, Shqipëria zinte vendin e parë për tërheqjen e bankave të huaja në treg, krahasuar me vendet e tjera të Europës juglindore.

2. Investimet e huaja në sektorin bankar

Wolf (1999) ka cituar se procesi i tranzicionit ka qenë mjaft traumatik për shumë vende të Europës Jug Lindore. Ndërkohë, kjo periudhë i ka dhënë mundësi mjaft bizneseve të huaja për të zgjeruar aktivitetin e tyre në këto vende, dhe në të njëjtën kohë ka krijuar mjaft barriera hyrëse për të tjerë (Meyer dhe Jensen, 2004). Sipas Koch (2001), prezenca e bankave të huaja në sistemin bankar të një vendi, është burim për zhvillim të këtyre vendeve.

Tabela 1: Proporcioni i bankave të huaja në vendet e Europës Jug lindore. Në përqindje (%)

Shtetet	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Bullgaria	7.3	7.1	25.0	50.0	64.7	71.4	74.3	76.5	71.4	68.6
Rumania	25.0	25.8	39.4	44.4	55.9	63.6	72.7	77.4	70.0	71.9
Kroacia	1.9	6.9	11.5	16.7	24.5	48.8	55.8	50.0	46.3	40.5
Shqipëria	50.0	37.5	33.3	80.0	84.6	92.3	92.3	92.3	86.7	87.5
Maqedonia	50.0	22.7	9.1	25.0	21.7	31.8	38.1	35.0	38.1	38.1
Serbia & Mali I Zi					4.0	3.7	14.8	24.0	34.0	25.6

Marrë nga: Shoqata Shqiptare e Bankave

Siç edhe mund të shihet nga tabela e mësipërme, në fund të 2004, Shqipëria zë vendin e parë për investimet e bankave të huaja në treg me 87.5%, e ndjekur nga Rumania me 71.9% dhe Bullgaria me 68.6%. Kroacia dhe Maqedonia kishin një proporcion bankash të huaja në vend prej 40.5% dhe 38.1% respektivisht. Ndërsa tregun e Serbisë dhe Malit të Zi e dominonin bankat vendase. Shqipëria ka numrin më të madh të bankave të huaja, pasi ekspertët e kësaj fushe i kanë mirëpritur bankat e huaja në mënyrë që ata të luanin një rol të rëndësishëm në modernizimin e sistemit bankar vendas.

Përgjatë viteve të fundit, sektori bankar në Shqipëri është konsideruar si pjesa më

e zhvilluar e sistemit financiar të vendit dhe menaxhon 95.5% të totalit të aseteve financiare. Sistemi bankar Shqiptar konsiston në 16 banka (nga këto, 3 banka shqiptare dhe 13 të huaja / partnerizime). Në përgjithësi ky treg ofron produkte dhe shërbime universale / të njëjta, ndaj shpesh thuhet se këto banka janë komerciale. Mirëpo ky sistem karakterizohet nga një gradë e theksuar përqëndrimi / koncentrimi, ku katër bankat: Raiffeisen Bank, Intesa San Paolo, Banka Kombëtare Tregtare dhe Tirana Bank, kanë rreth 73% të aseteve.

Banka Qëndrore thekson se tregu bankar ka pësuar një zhvillim të rëndësishëm përgjatë katër viteve të fundit. Sidomos pas vitit 2004, disa banka kanë pësuar zhvillime të brëndshme, si pasojë e bashkimit me banka të mëdha të grupeve ndërkombëtare. Vlen të theksohet fakti se bashkimi ose partneriteti me bankat e huaja, i ka dhënë mundësi këtyre bankave të kenë likuiditet për çdo tip finanzimi.

3. Roli i marketingut në sistemin bankar

Pikëpamja e marketingut siç e përmendëm më lart, ka marrë rëndësi në vendet perëndimore pas viteve 50 dhe pas viteve 90 në Shqipëri. Perspektivat e reja të sistemit bankar të orientuara drejt tregut kanë influencuar bankat që të krijojnë një treg të ri. Bankat kanë filluar të performojnë marketingun dhe teknikat planifikuese në mënyrë që të ofrojnë shërbimet e tyre në mënyrë më eficiente. Marketingu i mirë nuk kryhet aksidentalisht, por është një rezultat i planifikimit dhe zhvillimit të kujdesshëm. Praktikrat e marketingut vazhdimisht rregullohen dhe adaptohen me ndryshimet e industrisë, në mënyrë që të rrisin shanset e suksesit të kompanisë. Mirëpo, ekselencia në marketing është shumë e vështirë dhe e rrallë për tu arritur. (Mihail, 2008)

Ajo që është e rëndësishme është që marketingu në sektorin bankar duhet konsiderur në kuadrin e marketingut të shërbimeve. Marketingu i bankave nuk përfshin vetëm shitjen e shërbimit bankar por është dhe një funksion i cili ngulit personalitetin dhe imazhin e bankave në mendjen e konsumatorëve.

Sipas studimeve, qëllimi i rëndësishëm së marketingut për sektorin bankar dhe bankat mund të shpjegohet në baze të:

1. Ndryshimet në strukturën demografike, diferencimet e popullsisë në numër dhe në kompozim, afektojnë cilësinë dhe karakteristikat e konsumatorëve të cilët përfitojnë nga shërbimet bankare.
2. Konkurrencë e fortë në sektorin e shërbimeve financiare
3. Dëshira e bankave për rritje të fitimeve, bankat duhet të rrisin fitimet e tyre për të krijuar tregje të reja, për të mbrojtur dhe zhvilluar përqindjet e tregut që kanë dhe të mbijetojnë ndaj konkurrencës dhe krizave të ndryshme, si kjo e fundit.

Evoluimi dhe karakteristikat e marketingut bankar në vite:

1. Marketing i orientuar nga promovimi
2. Marketing i bazuar në krijimin e marrëdhënieve të ngushta me konsumatorët

3. Marketing reformist
4. Marketing i specializuar në fusha të veçanta
5. Marketing i orientuar nga kërkimi, planifikimi dhe kontrolli

Studimet e ndryshme kanë treguar se përfitueshmëria ose suksesi i një banke është i lidhur ngushtë me aftësitë e stafit të saj të marketingut, operacionet e kryera saktë dhe një menaxhim i mirë i riskut. Mirëpo, në një ekonomi normale arritja e këtyre çështjeve është mjaft e vështirë. Çështja bëhet akoma edhe më e vështirë në periudha recesioni!

Shumë studiues të këtij sistemi kanë arritur në konkluzionin se bankat duhet të jenë të afta të adaptohen në mënyrë të shpejtë me ndryshimet që ndodh në mjedisin e tyre të biznesit dhe më së shumti me ndryshimet në sjelljet konsumatore.

3.1. Marketing mix-i në sektorin bankar

Bankat janë në një periudhë në të cilën fitojnë para në ofrimin e shërbimeve, përtej shitjes së parave. Shërbimet bankare, si edhe shërbimet e tjera janë të paprekshme dhe janë: dhënia e kredive, depozitimi, dhe procedurat e transferimit. Srtuktura e këtyre shërbimeve përcakton dhe suksesin afat-gjatë të këtyre instituteve (Herrero dhe Peria, 2004).

Çmimi është një komponent i rëndësishëm i marketing mix-it, për këtë arsye bankat duhet të vlerësojnë me kujdes çmimet e shërbimeve të ofruara, dhe politikat e çmimeve. Tradicionalisht bankat përdorin tre metoda: “në bazë të kostove” (“cost plus”), “në bazë të transaksioneve” (“transaction volume base”) dhe “në bazë të drejtuesit të industrisë” (“challenging the leader”).

Distribucioni / Shpërndarja është e rëndësishme dhe zyrat e bankave përdorin metodat tradicionale në shërbimet bankare.

Promocioni si një element i rëndësishëm i marketing mix-it, konsiston në shitjen personale, reklama, marrëdhëniet publike dhe shitjen e mjeteve promociionale (Kotler dhe Caslione, 2009)

4. Produktet dhe shërbimet bankare në Shqipëri


Ekspertët e fushës kanë theksuar se bankat janë të përqëndruara më së shumti në hapjen e depozitave nga persona fizike dhe juridik. Ajo c’ka është vënë më së shumti re përgjatë viteve 2007, 2008 është se, bankat në Shqipëri kanë shtuar nivelin e tyre të punës, fushatat komunikuese, numrin e produkteve dhe shërbimeve, kreditimin e ekonomisë, si edhe numrin e filialeve në të gjithë territorin shqiptar. Sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë (2009), rritja e konkurrencës evidentohet më së shumti nga numri i shërbimeve dhe produkteve që ofrohen nga bankat, si edhe nga kostot e prodhimit të produkteve të ndryshme.

Siç edhe është theksuar më sipër, në vitet e fundit në Shqipëri është shtuar numri i bankave të huaja, të cilat i kanë fokusuar më së shumti aktivitetet e tyre në dhënien e kredive. Fakti që Shqipëria është një vend në zhvillim të shpejtë dhe rrjedhimisht


tërheq mjaft investitorë të huaj, justifikon arsyet përse bankat po promovonin më së shumti dhënien e kredive si avantazhet e tyre konkurruese (grafiku 1). Mirëpo, sipas analistëve, interesat në Shqipëri janë më shumë të larta në krahasim me vendet e tjera të Europës, dhe me kalimin e kohës investitorët do të përballen me pamundësinë për ti kthyer këto para, sipas skemave të likuidimeve që kishte vendosur sistemi bankar.

Për më tepër, kreditë për blerjen e pronave të patundshme dominuan tregun përgjatë pesë viteve të fundit, me interesa që i kalonin 5% në vit. Pas promovimeve agresive të kredive për shtëpi, bankat më të mëdha filluan të prezantonin në treg edhe produkte të tjera: si kredi për konsum, për blerje makinash, pajisje elektroshtëpiake, etj. Sipas të dhënave nga Banka Qendrore, tregu i kredive konsumatore zë rreth 10 – 13% të tregut të kredive.

Grafik 4, Ndarja e huasë sipas bankave, 2007 (%).



Grafik 3, Ndarja e huasë sipas bankave, 9 majori 2008 (%).



Marrë nga: Shoqata Shqiptare e Bankave

Përsa i përket këtij sektori, duhet të marrim fillimisht në konsideratë faktin se euro është përzgjedhur si monedha kryesore për të kryer këto lloj financimesh. Ndërsa kreditë në monedhën vendase (lekë – ALL) zënë rreth 29% të totalit të këtij portofoli. Gjithsesi, nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë për vitin 2008, vihet re një rënie mjaft e lehtë si nga personat fizike dhe ato juridike për marrjen e huave nga bankat (grafiku 2). Më specifikisht, bankat raportojnë këto lloje kredish të marra nga shqiptarët: 34.7% kredi për persona fizikë; 23% për kredi konsumatore dhe 22% kredi për shtëpi.

Marrë nga: Shoqata Shqiptare e Bankave

Tregu i kredive është tregu më fitimprurës i bankave, mirëpo gama e tyre nuk limitohet në kaq. Ndër produktet e tjera që kanë rëndësi të përmenden janë edhe:

- Kartat e kreditit dhe debitit
- Shërbimet me POS
- Të gjitha format e financimit, për persona fizike dhe juridike, *Leasing dhe Retail*
- Pagesa dhe transfertat me anë të SWIFT

5. Fushatat e komunikimit

Në vitet e fundit, fytyra e komunikimit të marketingut ka filluar të ndryshojë në diçka më shumë komplekse dhe më pak të prekshme sesa ishte në të shkuarën, kjo si

pasojë e faktit se tregjet po zhvillohen me ritme të mëdha dhe tashmë teknologjia po ofron kanale të shumta komunikimi dhe mënyra të reja për të dërguar mesazhe tek publiku duke stimuluar përgjigjet e tyre. Institucionet bankare përdorin fushatat (të cilat janë më së shumti edukative) dhe mediat për të forcuar imazhin dhe të ofruar informacione. Mediat e reklamave që bankat preferojnë janë: gazetatat, revistat, radio, postimi direkt, reklamat outdoor dhe reklamata televizive.

Duke e vlerësuar dinamizmin dhe efikasitetin e fushatave të komunikimit, në Shqipëri identifikohen dy sektorë të tregut që përdorin maksimalisht dhe në mënyrë strategjike mjaft elementë të tij: *sektori bankar dhe ai i telekomunikacionit*.

Duke iu referuar të dhënave nga Shoqata e Bankave, më poshtë do të kryejmë një analizë krahasuese të shpenzimeve të këtij sektori në vitet e fundit, kundrejt sektorëve të tjerë të rëndësishëm në tregun Shqiptar.

Në vitin 2008, sektori bankar zinte rreth:

- 67% të tregut të reklamimeve në TV
- 17% outdoor
- 10% në median e printuar
- 3% në radio
- 1% në Internet

Sektori i telekomunikacionit zinte rreth:

- 55% të reklamimeve në TV
- 25% outdoor
- 15% në median e printuar
- 4% në radio
- 1% në web.

6. *Kriza botërore ekonomike*

Deri në gusht të 2007, atëherë kur “shpërtheu” kriza financiare, dukej si një periudhë e mirë ekonomike në mbarë Botën. Rritja ekonomike ishte e fortë, inflacion i ulët, tregtia ndërkombëtare ishte zgjeruar, dhe vendet në zhvillim po shënonin një progres të konsiderueshëm. Kjo situatë u përforcua akoma më shumë edhe nga tre trende të pakontrollueshëm në vite. Fillimisht, vlerat e pasurive të patundshme po rriteshin në një shpejtësi të madhe në shumë vende, përfshirë edhe vendet e zhvilluara si SHBA. Së dyti, një numër i madh vendesh njëkohësisht po përjetonin defiqite buxhetore të mëdha, përfshirë në këtë listë edhe SHBA. Ç’ekuilibri global u manifestua nëpërmjet një rritjeje të konsiderueshme të defiqitit buxhetor të SHBA-së, e cila u pasqyrua nga teprica të konsiderueshme në Azi, veçanërisht në Kinë, dhe në vendet eksportuese të naftës në Lindjen e Mesme dhe Rusi. Dhe së treti, levat e ekonomisë kishin ndërtuar nivele të jashtëzakonshme në shumë sektorë anembanë globit, sidomos midis konsumatorëve në SHBA dhe Britani, dhe në subjekte financiare në shumë vende.

Duhet theksuar fakti se, ç’ekuilibri global nuk u shkaktua vetëm nga faktorët e mësipërm, por ato ishin ndër faktorët më të rëndësishëm.

EBRD (2009) ka deklaruar se përsa i përket rajonit Ballkanik, kriza globale ekonomike ka prekur më së pakti Shqipërinë. Në fakt, në vitin 2008 ekonomia u rrit me rreth 7%; kurse një vit më pas, në 2009, vetëm me 6%. Ndërkohë, po sipas EBRD (2009) defiçiti buxhetor i 2008 u rrit me 5.7%, nga 3.5% në 2007, dhe kjo për arsye të një numri të konsiderueshëm projektesh në infrastrukturë. Në mënyrë të rëndësishme, administrimi i të ardhurave dhe menaxhimi i borxhit publik u fuqizuan më shumë, gjë që çoi në një rritje të taksave mbi të ardhurat në 2008, pavarësisht uljes së taksave për korporata dhe atyre personale në 10%.

Impakti më i madh i krizës, sipas EBRD (2009), është ndjerë në ekonominë reale si pasojë e uljes së remitançave (një ulje me rreth 18% në gjysmën e parë të 2009, krahasuar kjo me një vit më parë) dhe me uljen e eksporteve (rreth 17% më pak në vit, në fillim të 2009), ndërkohë që importet u ulën me rreth 2%. Si rrjedhojë, defiçiti aktual vazhdon të qëndrojë i lartë tek rreth 15% e GDP. Ndërkohë, si përgjigje e rënies së vlerës së monedhës së huaj, Banka Qëndrore ndoqi politikën e uljes së normës nga 6.25 në 5.75% në janar të 2009.

7. Marketingu bankar shqiptar gjatë krizës

Kotler (2009) ka sugjeruar se në një mjedis dinamik biznesi si ky i ditëve të sotme, bizneset duhet të kenë më shumë fleksibilitet dhe ti përshtaten mjaft shpejt ndryshimeve të tregut.

Duke iu referuar edhe një herë sistemit bankar shqiptar, nga shifrat vihet re se fillimi i vitit 2009, shënon një rënie të aktivitetit të marketingut bankar, dhe kjo shpjegohet me pasojat e krizës botërore, dhe veçanërisht me rënien në numër të depozitave të hapura nga “personat fizikë”.

Duke u përballur me këtë situatë, strategjia e marketingut që përdorën bankat më të suksesshme ishte ajo e rritjes së interesave të depozitave. Disa banka e tejkaluan edhe limitin maksimal, 8% ALL ose 6% Euro. Një element tjetër kyç i strategjisë së marketingut këtyre bankave ishte ai i fokusimit në tregje të vogla dhe potenciale. Rrjedhimisht, në këto periudha bankat u fokusuan më së shumti në krijimin e produkteve dhe shërbimeve për emigrantët dhe për klientelën e tyre besnike. Mirëpo, të trembur nga kriza ekonomike globale, sipas Bankës së Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë në Shqipëri nuk kanë respektuar ligjin e transparencës ndaj klientëve të tyre.

Dhe deri në fillim të vitit 2009, Banka Qëndrore ka publikuar se totali i depozitave përbëhet nga: 50% e dërgesave (të ardhurat) e emigrantëve, 17% nga biznesi, dhe 33% shpërndahen në mënyra të ndryshme nga popullata lokale. Mirëpo, për periudhën janar - mars 2009, nga dërgesat (të ardhurat) e emigrantëve hynë vetëm 196 milion euro, që përfaqësojnë rreth 8% më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë (në 2008) (Banka e Shqipërisë, 2009). Po sipas Bankës së Shqipërisë, në mënyrë që bankat e nivelit të dytë të përmirësojnë aktivitetin e tyre përgjatë pjesës tjetër të 2009, është të rrikthejnë sigurinë tek klientët e tyre për depozitat.

Përsa i përket komunikimit të marketingut nga bankat, duhet theksuar fakti se

në varësi të objektivave të komunikimit, fushatat planifikohen në bazë të buxhetit që kompanitë kanë në dispozicion për to. Raiffeisen Bank është banka e cila zë vendin e parë për fushatat komunikimi në vend, me një buxhet prej 2.5 milion euro. Ajo pasohet nga Intesa San Paolo (1.6 milion euro), Tirana Bank (1.5 milion euro), dhe më pas bankat që kanë në dispozicion më pak buxhet për fushata promocionale si, Alpha Bank, BKT, NBG, etj.

Mirëpo, ndërkohë që për vitin 2008 raportohet një vlerë prej 4,994,085 euro shpenzime për fushata komunikimi bankare; një vit më pas, raportohet një vlerë prej 2,403,681.74 euro shpenzime. Kjo na lë të kuptojmë se përse kjo industri i ka ulur ndjeshëm shpenzimet për të komunikuar me audiencat e tyre të synuara.

Konkluzione

Studimi i mësipërm na çoi në konkluzionin se, Shqipëria duke qenë një vend me një sektor financiar jo shumë të zhvilluar dhe me pak ekspozim ndaj mallrave ndërkombëtare, nuk është prekur shumë nga kriza aktuale ekonomike. Megjithatë, një rënie në mallrat e eksportit është vëzhguar dhe recesioni global do të ndikojë në remitancat. Si rrjedhojë, ekonomistët kanë konkluduar se ekonomia shqiptare përgjatë 2009 do të kishte një zhvillim më të ulët, mirëpo jo negativ.

Megjithë zhvillimet positive të vendit, periudhat e krizës ekonomike i frikësojnë bizneset dhe i detyrojnë ata që të ulin shpenzimet e tyre. Eksperiencia e deritanishme ka treguar se fusha e parë e reduktimit të kostove, është ajo e marketingut. Ende në ditët e sotme, njerëzit e biznesit dhe publiku në tërësi vazhdojnë të kenë një koncept të gabuar për marketingun. Ajo ç'ka e bën një kompani të ketë sukses janë pikërisht idetë e saj të marketingut dhe ofertat. Departamenti i marketingut, blerjes, kërkimit dhe zhvillimit, financat dhe të tjera, ekzistojnë për të suportuar punën e kompanisë në tregun e konsumatorit. Pra, marketingu nuk është një aktivitet për të patur shitje në kohë të shkurtër; por një investim në kohë të gjatë për kompaninë! Ndaj, shpesh sugjerohet që kompanitë të adaptojnë buxhetet e tyre në situata krize, pasi reduktimi ose eliminimi i buxheteve të marketingut nënkupton që kompania nuk ka ku të gjenerojë më shitje.

Në mënyrë të rëndësishme, ne arritëm në konkluzionin se sektori bankar shqiptar nuk e ka eliminuar marketingun nga strategjia e tij e biznesit përgjatë krizave. Në të kundërt, veprimtaritë kanë vazhduar me sukses, mirëpo jo me të njëjtin intensitet si më parë. Pra, kostot e marketingut po menaxhohen në vitet e fundit në mënyrë efektive dhe eficiente, gjë që dallohet në një përgjysmim të shpenzimeve të këtij sektori!

Rekomandime

- Disa rekomandime për marketerët në periudha krizash, janë si më poshtë:
- Një zgjidhje është gjenerimi i ideve për produkte të reja dhe të përshtatshme për tregun në periudha krize.

- Largimi nga përdorimi i metodave tradicionale të reklamimit, të cilat janë mjaft të kushtueshme, dhe përdorimi i marketingut direkt ose atij online, pasi ato zotërojnë, kosto të ulët, komunikimet interaktive dhe të sofistikuara me audiencat e ndryshme, etj.

ZHVILLIMI SIPAS ASPEKTIT TË MARKTINGUT TË SHËRBIMEVE

- *Marketingu i brendshëm*: këto marrëdhënie janë shumë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me gjetjen dhe mbajtjen e personelit të suksesshëm dhe profesional.
- *Network marketing*: banka dhe konsumatori të cilët tregtojnë shërbime për njëri-tjetrin në organizatë.
- *Relationship marketing*: marrëdhënia e ngushtë me konsumatorin është një element shumë i rëndësishëm, por edhe cikli i jetës së kësaj marrëdhënieje është shumë i rëndësishëm.

Literatura:

- Bank of Albania “2008 Yearly Report”.
- Cetina, I. dhe Mihail, N. (2008) *Price Strategies in Banking Marketing*.
- Gordon & Glickson LLC (2004) *The Globalization of Services: Increasing Success and Mitigating Risk* [online Gordon & Glickson, Attorneys at Laë. Available from: [http://www.mcguirewoods.com/newsresources/publications/technology_business/2004.1`2.31.pdf](http://www.mcguirewoods.com/newsresources/publications/technology_business/2004.1`2.31.pdf)
- Herrero, A. G. dhe Peria, M. S. M. (2004) *What Determines the Mix of Foreign Bank Claims and Does it Matter?* [online Bank of Spain and World Bank.
- Helfat, C. E. dhe Lieberman, M. B. (2002) The Birth of Capabilities: Market Entry and the Importance of Pre – history. *Industrial and Corporate Change*, Vol. 11, No. 4, pp. 725 – 760. Full – text [online EBSCO database.
- Kawai, M. dhe Takayasu, K. (2000) *The Economic Crisis and Banking Sector Restructuring in Thailand*. A study of Financial Markets.
- Koch, A. J. (2001) Selecting Overseas Markets and Entry Modes: Two Decision Processes or One? *Marketing Intelligence & Planning*, Vol. 19, No. 1, pp. 65 – 75. Full – text [online Emerald database.
- Kotler, P. dhe Caslione, J. A. (2009) *Chaotics. The Business of Managing and Marketing in the Age of Turbulence*. AMACOM.
- Kosak, M. dhe Cok, M. (2008) *Ownership structure and profitability of the banking sector: The evidence from the SEE region*, Vol. 26, No. 1, pp. 93 – 122.
- Meyer, K. E. dhe Jensen, C. (2004) *Foreign Direct Investment and Government Policy in Central and Eastern Europe* [online. Copenhagen Business School, Center for East European Studies. Available from: <http://ep.lib.cbs.dk/download/ISBN/x645154007.pdf> .
- Nwokah, N. G, Anyanwu, A. V. dhe Momodu, A. A. (2009) *Global Financial Melt Down and Implications for Marketing in Nigeria*. EuroJournals Publishin, Inc.
- Song, I. (2004) *Foreign Bank Supervision and Challenges to Emerging Market*

Supervisors [online. IMF Working Paper.

- Zefi, E. (2003) *Albania in Transition and the Regional Integration Process* [online. Economic Faculty of Korca. Available from: http://www.acit-al.org/publications/Research_papers/dec_2003_E_Zefi.pdf .
- Wolf, H. C. (1999) *Transition Strategies: Choices and Outcomes* [online. Princeton Studies in International Finance. Available from: http://www.princeton.edu/~ies/IES_Studies/S85.pdf .
- Whitelock, J. (2002) Theories of Internationalisation and their Impact on Market Entry. *International Marketing Review*, Vol.19, No. 4, pp. 342 – 347. Full –text [online. EMERALD database.
- Wildes, J. J. dhe Singer, B. E. (2009) *Non – Traditional Advertising During Economic Turbulence*. New York Law Journal, Vol. 241, No. 111.

Menaxhimi dhe mundësitë e mikrofinancës në vendet në zhvillim : rasti i Shqipërisë

____ Prof.Asoc.Dr. Magdalena Bregasi _____

European University of Tirana

____ Dr.Eda Luga _____

Agricultural University of Tirana

ABSTRAKT. *Ecuria e reformave institucionale, bankare dhe e mjedisit financiar tregojnë se drejtimi i mikrofinancës ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Shumë banka shqiptare aktualisht janë të interesuara për t'u fokusuar në mikrofinancë. Institucione financiare jo bankare janë duke fokusuar si mision kryesor mikrofinancën si Partneriteti Shqiptar i Mikrokreditit, Fondacioni BESA, etj. Fondacioni BESA është vlerësuar në vendin 43 ndaj 50 institucioneve mikrofinanciare më të mira të botës për vitin 2008 (Forbes). Ka më shumë se 140 shoqëri shqiptare të kursim - kreditit, por që vazhdojnë veprimtarinë e tyre në territore të kufizuara. Në fakt, pavarësisht nga rezultatet pozitive të arritur në vitet e fundit nga sistemi financiar dhe bankar në përgjithësi, janë të pranishme vështirësi në marrjen e kredive nga bankat veçanërisht në sektorin rural ku unionet e kreditit mund të financojnë vetëm 4%. Nga ana tjetër janë të pranishme shumë rreziqe ndër të cilët dallohet norma e lartë e interesit në nivel 31% ndërkohë që depozitat e kursimit ofrojnë nga 6 - 8%.*

Sa më sipër, punimi fokusohet në problemet dhe sfidat e menaxhimit të mikrofinancës në vendet në zhvillim duke u ndalur veçanërisht në rastin e Shqipërisë si dhe në mësimet nga eksperiencia globale. Ai analizon drejtimet vijuese:

***Së pari,** një vështrim të shkurtër të mikrofinancës në Shqipëri me fokus më të gjerë në zonat rurale;*

***Së dyti,** specifikat e drejtimit të mikrofinances rurale: objektivat, pengesat dhe perspektiva;
Së treti, krahasimi i institucioneve financiare rurale në Shqipëri si aktorë të rëndësishëm për rritjen dhe mbështetjen e kredisë rurale dhe sigurimin e ndihmës për biznesin e vogël;
Së fundi, mësimet nga përvoja globale për t'u marrë në konsideratë në rastin shqiptar.
Punimi bazohet në shqyrtimin e literaturës së huaj dhe vendase, në studimet e institucioneve ndërkombëtare si dhe në të dhënat statistikore të institucioneve të mikrofinancës në Shqipëri.*

Hyrje

Ecuria e reformave institucionale, bankare dhe e mjedisit financiar tregojnë se drejtimi i mikrofinancës ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Shumë banka shqiptare aktualisht janë të interesuara për t'u fokusuar në mikrofinancë. Institucione financiare jo bankare janë duke fokusuar si mision kryesor mikrofinancën si Partneriteti Shqiptar i Mikrokreditit, Fondacioni BESA, etj. Fondacioni BESA është vlerësuar në vendin 43 ndaj 50 institucioneve mikrofinanciare më të mira të botës për vitin 2008 (Forbes). Unioni SHKK klasifikohet po në vitin 2008 në 16 institucionet më të mira në botë nga MIX.

Ka më shumë se 100 shoqëri shqiptare të kursim - kreditit, por që vazhdojnë veprimtarinë e tyre në territore të kufizuara. Në fakt, pavarësisht nga rezultatet pozitive të arritur në vitet e fundit nga sistemi financiar dhe bankar në përgjithësi, janë të pranishme vështirësi në marrjen e kredive nga bankat veçanërisht në sektorin rural ku unionet e kreditit mund të financojnë vetëm 4%. Nga ana tjetër janë të pranishme shumë rreziqe ndër të cilët dallohet norma e lartë e interesit në nivel 31% ndërkohë që depozitat e kursimit ofrojnë nga 6 - 8%.

Sa më sipër, punimi fokusohet në problemet dhe sfidat e menaxhimit të mikrofinancës në vendet në zhvillim duke u ndalur veçanërisht në rastin e Shqipërisë si dhe në mësimet nga eksperiencia globale. Ai analizon interpretimin e mikrofinancës, evidenton disa mësimet nga përvoja globale dhe e BE-së, duke u ndalur më pas në specifikat e zhvillimit të mikrofinancës në vendin tonë me fokus më të gjerë në zonat rurale; krahasimin e institucioneve financiare rurale në Shqipëri si aktorë të rëndësishëm për rritjen dhe mbështetjen e kredisë rurale dhe sigurimin e ndihmës për biznesin e vogël dhe së fundi, në nevojën e një banke rurale për të mbështetur më mirë procesin. Punimi bazohet në shqyrtimin e literaturës së huaj dhe vendase, në studimet e institucioneve ndërkombëtare si dhe në të dhënat statistikore të institucioneve të mikrofinancës në Shqipëri.

Mikrofinanca: interpretimi dhe specifikat e Institucioneve të Mikrofinancës (IMF)

Rëndësia e mikrofinancës dhe institucioneve financiare të decentralizuara, njihet si kontribuese në zhvillimin e vendeve ku është aplikuar ky sistem. Ky koncept nuk është krejt i ri, edhe pse së fundi ka njohur një zhvillim më të madh. Kjo falë ndryshimeve të ndodhura në zhvillimin e këtyre vendeve. Kështu rëndësia në rritje e sektorit privat si motor i zhvillimit të vendit, shpërthimi i mikrondërmarrjeve, qoftë kjo edhe në sektorin informal, si dhe suksesi i konfirmuar i disa institucioneve financiare të mikrofinancës

në botë, e ka rritur rëndësinë e studimit të institucioneve të tilla, në vendet në zhvillim.

Për më tepër aktorët e zhvillimit kanë kuptuar që mikrofinanca përbën një armë të rëndësishme në luftën kundër varfërisë. Lehtësia në gjetjen e kredive në masa të vogla mund të ketë një efekt të rëndësishëm mbi kushtet e jetesës së më të varfërve. Mjaft studime tregojnë se përfituesit nga programet e mikrofinancës nuk kanë arritur vetëm të rrisin të ardhurat e tyre por kanë patur edhe një përmirësim të nivelit të menaxhimit të bizneseve të tyre apo edhe të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore dhe të edukimit. Kjo ka patur një impakt përsa i takon vlerësimit personal të tyre. Kjo mund ti bëjë ata të kenë më shumë besim në vetvete përsa i takon aktivitetit ekonomik social dhe politik të vendit të tyre.

Mikrofinanca fokusohet në zhvillimin e aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura dhe kursim derisa të zvogëlohen rrisqet dhe pasiguritë me të cilat përballen këto vende. Gjithashtu është vënë re se, në disa raste dhe duke ndjekur disa parime është e mundur të krijohen lehtësisht institucione të specializuara në mikrofinancë.

Eksperiencia tregon gjithashtu, që nuk ekzistojnë zgjidhje absolute unike dhe të përhershme për të përballuar të gjitha sfidat me të cilat ndeshet pjesa e varfër e popullsisë sot. Megjithatë është mjaft e rëndësishme të adaptohen forma që ofrojnë produkte financiare për më të varfërit, duke ndihmuar në pjesëmarrjen e përfituesve nga programet e mikrofinancës si dhe me qëllim, krijimin e institucioneve që do të shërbenin si bazë për integrimin e mëtejshëm të skemave të tilla në sistemin financiar të vendit.

Përpjekjet e para për të ofruar shërbime financiare për të varfërit i lidhën këto shërbime me aktivitete ekonomike specifike. Për shembull: mes viteve 1950 dhe 1970, qeveritë dhe donatorët u përqendruan në ofrimin e kredive bujqësore të subvencionuara për fermerët e vegjël, me shpresën e rritjes së produktivitetit dhe të ardhurave. Për më tej, gjatë viteve 1980 roli i mikrofinancës u konsolidua me tej duke ofruar hua për gratë e varfëra me qëllim sipërmarrjen e tyre në biznese të vogla, duke i bërë ato të afta të gjeneronin dhe akumulonin aktive dhe të rrisnin të ardhurat dhe mirëqënien e familjes.

Suksesi i disa programeve të kredisë për mikrondërmarrjet solli eksperimente të guximshme për sa i përket përcaktimit të produktit, metodologjisë së shpërndarjes dhe strukturave institucionale, të kryera në shumicën e rasteve nga praktika në vendet në zhvillim. Këto eksperimente rezultuan në lindjen e institucioneve mikrofinanciare (IMF) si institucione të specializuara financiare që i shërbejnë të varfërve. IMF quhen “mikro” për shkak të permisave të vogla të transaksioneve të tyre, me hua që fillojnë me 50 USD dhe depozita që fillojnë me 5 USD. Nga ana tjetër, quhen “financiare”, sepse ofrojnë shërbime të sigurta dhe të besueshme financiare për të varfërit.

IMF ekzistojnë në forma të ndryshme ligjore, që përfshijnë organizata joqeveritare (OJQ), unione krediti, ndërmjetës financiare jobankare dhe banka tregtare. Suksesi i tyre ka treguar që njerëzit e varfër mund të jenë kliente të çmuar të shërbimeve financiare të skicuara në mënyrë specifike dhe që shërbimi i kësaj zone tregu mund të jetë financiarisht i realizueshëm dhe fitimprurës.

Duke ofruar akses më të mirë për shërbimet financiare për të varfërit, IMF luajnë një rol të rëndësishëm zhvillimi duke i bërë familjet të afta të krijojnë, të kenë në pronësi dhe të akumulojnë pasuri dhe aktive. Ato ndikojnë në rritjen e kapaciteteve të sipërmarrjes dhe të krijimtarisë duke ndihmuar përmirësimin social dhe ekonomik.

Për shumicën e njerëzve, mikrofinanca nënkupton dhënien e kredive shumë të vogla (mikrokredi) familjeve shumë të varfëra, për t'i ndihmuar ato të përfshihen në aktivitete produktive apo për të zhvilluar bizneset e tyre të vogla. Me kalimin e kohës, mikrofinanca ka përfshirë një gamë më të gjerë shërbimesh (kredi, kursime, sigurime, etj), ndërkohë që është kuptuar që njerëzit e varfër dhe shumë të varfër të cilët nuk kanë akses në institucione tradicionale formale financiare, kërkojnë një shumëllojshmëri produktesh financiare.

II. Mësime nga përvoja globale dhe BE-së për t'u marrë në konsideratë në rastin shqiptar

Në botë llogaritet të ekzistojnë rreth 10.000 institucione mikrokrediti që u shërbejnë rreth 20 milionë personave. Në kompleks, mikrokrediti rritet në botë rreth 30% në vit dhe duket se ka interes nga institucionet zyrtare, sa u le vend edhe polemikave mbi rolin e mundshëm si “alibi” për të ulur ndërhyrjen publike për zhvillim. Sipas shifrave të UNCTAD, konferenca ONU mbi ekonominë dhe zhvillimin, vetëm 2% e 500 milionë mikroshoqërive ekzistuese në botë - që përbëjnë deri në 50 % të disa ekonomive nacionale – kanë mundësi krediti. Një shifër praktikisht koinciduese me destinatarët e programeve të mikrokreditit “bankave të të varfërve”. 98%-shi mbetet, përballet me një mohim kategorik nga sistemi bankar “formal”.

Mikrokredia nga ana e saj filloi të merrte rëndësi në vitet 1980, megjithëse eksperimentet më të hershme datojnë 30 vjet më parë në Bangladesh, Brazil dhe në disa vende të tjera. Ndryshimi më i rëndësishëm i mikrokreditit ishte se ai shmangu dështimet e një brezi të mëparshëm financimi të orientuar drejt zhvillimit, duke insistuar në ripagimin, duke ofruar norma interesi që mund të mbulonin kostot e dhënies së kredisë, dhe duke u fokusuar në grupe klientësh, burimet e financimit të të cilëve vinin nga sektori informal. Vëmendja u zhvendos nga disbursimi i shpejtë i kredive të subvencionuara, për mbështetjen e sektorëve të synuar, drejt ndërtimit të institucioneve lokale të qëndrueshme që u shërbejnë të varfërve. Në pjesën më të madhe, mikrokrediti ka qenë një iniciativë e sektorit privat (jo me qëllim fitimi) që shmangu ndikimet politike, dhe si pasojë, ka kapërcyer virtualisht të gjitha format e tjera të financimit me qëllim zhvillimi.

Tradicionalisht mikrofinanca është përqëndruar në ofrimin e produkteve të kreditimit shumë të standartizuar. Të varfërit, ashtu si kushdo tjetër, kanë nevojë për një shumëllojshmëri instrumentesh financiare, për të qenë në gjendje të ndërtojnë asete, stabilizojnë konsumin dhe të mbrojnë veten kundrejt riskut. Kështu, shohim një zgjerim të konceptit të mikrofinancës.

Mikrofinanca mund të përkufizohet si ofrimi i shërbimeve financiare për

sipërmarrësit mikro. Pjesa dërrmuese e popullsisë së ekonomive në zhvillim ende punon në sektorin informal të zonave urbane apo rurale. Këta mikrosipërmarrës shpesh varen ekskluzivisht në suksesin e aktiviteteve të tyre të vogla në të cilat investojnë mjeshtëritë, krijueshmërinë dhe energjinë e tyre mbresëlënëse. Fatkeqësisht, ndërmarrjet e tyre rrallë zgjerohen përtej nivelit të mbijetesës, kryesisht si pasojë e mungesës së kapitalit.

Mikrofinanca kombinon motivin e kërkimit të fitimit me prioritetet e zhvillimit social. Gjatë 20 viteve të shkuara, ndërmjetës të specializuar financiarë, janë orientuar me sukses ndaj këtij tregu dhe kanë zhvilluar produkte dhe metodologji që i përshtaten në mënyrë perfekte nevojave dhe karakteristikave të këtij tregu. Ata kanë treguar që mikrofinanca është një biznes fitimprurës dhe me rrezik të menaxhueshëm: mikrosipërmarrësit marrin kredi me normat e interesit të tregut dhe ripagojnë me një nivel që kalon shumicën e bankave tregtare (mesatarisht 97%). Eksperiencia ka treguar gjithashtu se, ndërkohë që mikrofinanca është një biznes në vetvete, ajo është gjithashtu edhe një mjet i fuqishëm zhvillimi; edhe kreditë me shuma mjaft modeste gjenerojnë fitime të mëdha nga biznesi dhe kontribuojnë si në krijimin e vendeve të punës, edhe në ngritjen e nivelit të jetesës së familjeve (ushqim i përshtatshëm, strehim dhe shëndet më i mirë, me shumë edukim).

Tendencat më të përhapura dhe më premtuese që shoqërojnë suksesin e mikrofinancës janë:

Institucionet mikrofinanciare po përfshihen në gjenerimin e fondeve nga burime tregtare si një mënyrë e forcimit të qëndrueshmërisë së tyre afatgjatë. Komercializimi në fakt ka treguar që është një nga kushtet esenciale të stabilitetit, rritjes dhe pavarësisë për të gjitha institucionet lider mikrofinanciare.

Industria mikrofinanciare gjithnjë e më tepër kërkon ekspertizë dhe njohuri të specializuara financiare. Një numër gjithnjë e më i madh profesionistësh të talentuar biznesi kanë arritur me sukses ekonomizime të shkallës, diversifikim produkti dhe rritje të përfitueshmërisë në këtë treg gjithnjë e më shumë konkurrues.

Mikrofinanca po rritet dhe po kthehet në një industri transparente dhe të rregulluar. Gjithnjë e më shumë vëmendje po i kushtohet institucioneve lider mikrofinanciare nga rregullatorë, auditorë të njohur biznesi dhe agjenci klasifikuese, për shkak të rëndësisë në rritje të këtyre institucioneve në tregjet kombëtare të kapitalit. Përfshirja e tyre siguron një strukturë solide ligjore, financiare dhe politike për të mbështetur rritjen e industrisë.

Ky evolucion nuk nënkupton që mikrofinanca po zhvendos fokusin e saj nga lehtësimi i varfërisë në të kundërt: komercializimi, ekspertiza dhe rregullimi janë mjetet për përmirësimin e nivelit dhe cilësisë së ndikimit të situatave socio-ekonomike të mikrosipërmarrësve dhe familjeve të tyre. Industria mikrofinanciare po zhvillohet shpejt, si në përmasa edhe në cilësi. Ndër argumentat kryesore evidentohen:

Rritja e nivelit të kërkesës e orientuar nga miliona mikrosipërmarrës të cilët ende presin të marrin shërbime të tilla bazë financiare siç janë kredite për kapital pune. Mikrobankierët vlerësojnë se nëse ata arrijnë të plotësojnë kërkesat e tyre, atëherë vetëm në 5 vitet e ardhshme ata do të kenë nevojë për 10 deri në 20 miliardë dollarë.

Dalja në treg e produkteve të reja dhe gjithnjë e më të sofistikuara (karta krediti dhe debiti, leasing, financimi i strehimit dhe edukimit, sigurimet dhe pagesat e transfertave, etj.).

Mikrofinanca po trajtohet gjithnjë e më shumë si një levë për të kontribuar në rritjen ekonomike. Në vende të ndryshme ka për qellim të mbështesë pjesën e popullsisë më të ndjeshme kundrejt disponimit të mjeteve financiare, problemeve të punësimit dhe nevojës së sipërmarrjes. Në kushtet e krizës ekonomike të viteve të fundit, fokusimi në mikrofinancë tërheq vëmendjen lidhur me kontributin e saj përballë pasojave sociale të krizës. Në kushtet kur numri i personave që humbasin punën rritet dhe nga ana tjetër shtresat që nuk arrijnë të sigurojnë besimin e bankave duke u konsideruar “të rrezikshme” imponojnë një trajtim më të kujdesshëm të mikrofinancës. Trajtimi i mikrofinancës është objekt i autorëve dhe punimeve shkencore. Nëse idetë e para të mikrofinancës i adresoheshin mbështetjes së sipërmarrjes për shtresat varfëra e kryesisht në zonat rurale, aktualisht mbështetja me mikrofinancë dhe mikrokredi është një tendencë në rritje në vendet e BE-së si instrument i luftës kundër papunësisë. BE në mbështetje dhe konform axhendës së Lisbonës ka nisur që në vitin 2007 “Inisiativën europiane për një zhvillim të mikrokredisë në favor të rritjes dhe punësimit » bazuar në ofertën e huave për shuma më të vogla se 25000 euro. Qëllimi i politikave të mikrokredisë në BE është të stimulojë kalimin e personave të papunë në sipërmarrës të vegjël të pavarur.

Akset kryesore të iniciativës europiane lidhur me mikrokreditin janë:

së pari, përmirësimi i mjedisit juridik dhe institucional të shteteve anëtare: jo në të gjitha vendet e BE kuadri i mbështetjes legale lejon zhvillim të favorshëm për mikrokreditin. Për më tepër specifika e mikrokredisë ka përmasa të ndryshme vëmendje në legjislacionet kombëtare dhe komunitare. Në këtë kontekst edhe në BE punohet për një përmirësim të legjislacionit dhe mbështetjes institucionale për zhvillimin e mikrokredisë. Lidhur me këtë aks, BE ka tashmë propozuar vendeve anëtare për të krijuar një mjedis që lejon zhvillimin e IMF dhe mbulimin e klientelës, e cila është potencialisht e lartë dhe për rrjedhim IMF duhet të krijojnë akses të lehtë për të siguruar burime financiare. Por nuk duhet harruar se IMF financohen nga subvencione dhe donacione. Prandaj, mbështetja e mikrokredisë dhe lehtësimi i përqindjes së interesit duhet shoqëruar gjithashtu me zvogëlimin e shpenzimeve të shfrytëzimit të veprimtarive me anë të regjimeve fiskale më favorizuese si dhe me përshtatjen e rregullimit dhe mbikqyrjeve kombëtare specifike për mikrofinancën.

Së dyti, krijimi i një klime më të favorshme për shpirtin e sipërmarrjes : kërkon mbështetjen e zhvillimeve ekonomike inovatore. Për këtë, BE po synon gjithnjë e më shumë përmirësimin e kuadrit institucional për punëtorët e pavarur dhe mikrondërmarrjet me anë të një sistemi informacioni më të plotë dhe koherent. Paralel ky aks kërkon minimizimin e pengesave juridike, fiskale dhe administrative, rritjen e shërbimeve për formimin profesional dhe mjedise sa më të favorshme për mikrondërmarrjet.

Së treti, inkurajimin e shpërndarjes së praktikave të mira specifiktë për formimin apo edukimin profesional. Në këtë kuadër BE ka propozuar krijimin e një njësie të re me objekt sigurimin e asistencës teknike për të mbështetur IMF jo bankare në shtetet anëtare të BE. Misioni i kësaj njësie të re është:

Të ndërtojë një kod të drejtimit të mirë të IMF duke forcuar besimin tek këto institucione dhe të propogandojë rregullat etike dhe praktikat më të mira;

Të krijojë një etiketim “mikrokredi” për të tërhequr më shumë vëmendjen e qytetarëve të BE. Ky etiketim do të ndihmojë edhe fondet e investimeve që kanë objekt mikrokreditin.

Të sigurojë informacione për iniciativat e reja dhe sigurimin e publiciteteve :

Të hartojë manuale teknike, guida dhe materiale informatike të nevojshme për të ndjekur shembullin e më të mirëve.

Të lehtësojë financimet e IMF duke mobilizuar burimet financiare.

Së katërti, mbështetja me kapital financiar suplementar për IMF jo bankare. BE propozon krijimin e një mikrofondi me qëllim ndihmën e IFM për t’u bërë autonome dhe për të kontribuar në rritjen e ofertës së mikrokreditit në BE.

III. Mikrofinanca rurale shqiptare: objektivat, evolucioni dhe problemet

Mikrofinanca është instrument fitimprurës në ekonomi. Ajo është konsideruar si një nga mjetet e nevojshme dhe kërkesë e domosdoshme për të vlerësuar shërbimet financiare në zonën rurale. Mbështetje për aktivitete të vogla rurale dhe të përmirësimit të kushteve të jetesës përmes institucionit mikrofinanciar si modeli i Raiffeissen ka qenë një frymëzim për vendet ish-komuniste që nga fillimi i procesit të tranzicionit (1990). Mikrofinanca rurale është konsideruar si një institucion i rëndësishëm për rritjen e mbështetjes rurale të kredisë dhe për të siguruar ndihmën për biznesin e vogël gjatë reformës ekonomike nga modeli i centralizuar në ekonominë e tregut.

Mikrofinanca rurale shqiptare ka krijuar fizionominë e saj nga bashkëpunimi i fortë me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të ndryshëm.

Politika dhe menaxhimi i mikrofinancës rurale ka pasur që nga fillimi një grup të interesit përfutues në zonën më të varfër shqiptare për të siguruar kredi rurale, për të inkurajuar dhe për të përmirësuar dhënien e kredisë për të varfërit me qëllim sipërmarrës. Mikrofinanca është influencuar edhe nga procesi i ristrukturimit bankar dhe sektorit financiar në përgjithësi.

Evidentohen evolucione të rëndësishme në dy dekadat e fundit të IMF si rasti i Fondacionit të Zhvillimit Shqiptar. FEFAD ka ofron kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shkallë.

Tabela N.1. Perceptimi i disponueshmërisë së burimeve të kreditit në fshat

Burimet në dispozicion për kredi	Jo në dispozicion	Në dispozicion dhe unë mund të marrë kredi nga ky burim	Në dispozicion, por normat e interesit (ose kërkesat e tjera) janë shumë të larta	Nuk e di
Banka Raiffeisen	139	34	2	125
Banka Tregetare Kombetare	146			154
Banka Procredit	103	4	70	123
PSHM	106		53	141
Building the Future (World Vision)	124		4	172
Furnizuesi ose blerësi	126			174
Huadhënës privatë	120	7	10	163
Anëtarët e familjes	101	51	3	145
Miq e të afërt	100	61	12	127
Fondacioni BESA	115	8	26	151
USHKK	13	236	17	34
Të tjera	94	5	1	200

Ndërkohë që biznesi i madh ka mundësinë e gjetjes së kredisë, biznesi i vogël ndjehet më shumë i kufizuar për shkak të garanties. Nga kjo pikëpamje institucionet mikrofinanciare kanë një rol vendimtar në zhvillimin e sipërmarrësve të vegjël. Nëse deri më sot në vendin tonë operojnë 16 banka, roli i tyre është pa efekt në zonat rurale. Sistemi bankar është i përqëndruar në zonat e mëdha urbane dhe orientohet në një pjesë të konsiderueshme në blerjen e bonove të thesarit këto instrumente ofrojnë norma më të larta interesi se depozitat.

Nga ana tjetër në Shqipëri, veprojnë IMF. Këto institucione përgjithësisht veprojnë me fonde të siguruar nga donatorë të ndryshëm, kryesisht të huaj.

Forcimi i shoqatave të mikrofinancës mbetet prioritar sipas raportit të Bankës Botërore (2007) me qëllim inkurajimin e instrumenteve të reja. Kërkesa për shërbimet e këtyre institucioneve mbetet e lartë dhe kushtëzohet nga rritja e shoqatave të mikrofinancës, ndërsa kredite e ofruara prej tyre varen nga:

kapitali dhe financimi shtesë; investimet dhe asistenca e mëtijshme teknike për të ulur koston dhe për të përmirësuar menaxhimin operativ të shoqërive të kursim-kreditit dhe së fundi, nga organizimi institucional ose nga fakti se këto institucione do të vendosin të bëhen subjekte tregtare, apo të qëndrojnë si organizata joqeveritare (OJQ). Në përgjithësi, të tregut mikrofinanciar në Shqipëri është i përbërë nga institucioni mikrofinanciar dhe ruajtjen dhe shoqatat e kreditit me një klientelë të ngrohtë: ofrojë produktet financiare bankare komerciale ku nuk funksionojnë. Por

shërbimi klientelë ka vetëm 20% të klientelës e përgjithshme të sistemit financiar në Shqipëri, vetëm 1% e popullsisë shqiptare në moshën 15-65 vjeçare mosha varg ka qasje në mikrokredi dhe kredive mikrofinanciare vazhdojnë të jenë shumë të vegjël si një përqind GDP për frymë krahasuar me ato në vendet e tjera të rajonit (Banka Botërore, 2007).

Në kuadër të projekteve të ndryshme, në Shqipëri prej vitesh operojnë disa institucione financiare jobankare që mund të konsiderohen si institucione të mikrokreditit. Institucionet kryesore të mikrokreditit në vendin tonë janë:

Institucionet financiare jobankare të mikrofinancës që operojnë kryesisht në sektorin urban:

- Fondacioni BESA
- Partneri Shqiptar në Mikrokredi (PSHM)
- Institucionet financiare jobankare të mikrofinancës që operojnë kryesisht në sektorin rural

Tabela N.2 Portofoli i huasë për IMF kryesore në Shqipëri

	Portofoli i huasë 2006 (milion \$ USA)	Numri i kredive	Hua mesatare (USD)
Fondacioni Besa	29	7000	4142
FFZM	14	5343	2620
PSHM	14	7000	2000

Burimi: World Bank report 42061-AI, 2007.

Kërkesat për IMF që veprojnë në tregje urbane dhe rurale përballen me konkurrencën nga bankat tregtare, për të rritur madhësinë e një huaje të vetme dhe për të diversifikuar të shërbimeve financiare. Por ky proces duhet të menaxhohet përballë rreziqeve të ndryshme si dhe nivelit të informalitetit, zbatimit të standarteve të kontabilitetit dhe sistemit të garancisë së kredisë. Megjithë situatën e dilemave lidhur me efektet e krizës globale, të dhënat e viteve 2008 - 2009 treguan se IMF ekzistuese në vendin tonë ruajtën likuiditetet e tyre dhe rritën portofolin e kredisë. Shembull konkret është USHKK që operon në rreth 900 fshatra, por shtrirja territoriale mbetet prioritet. Vetëm gjatë vitit 2008, aktitet në sektorin e mikrofinancës arrijnë shifrën 23.8 milionë USD, teprica e kredisë 14 milionë USD, portofoli i depozitave mbi 2 milionë USD dhe huamarrësit aktivë arrijnë numrin 8.265 klientë. Në rritjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të mikrofinancës në vend, kanë dhënë kontributin e tyre të rëndësishëm të pesë institucioneve anëtare të Shoqatës së Institucioneve Mikrofinanciare.

Përpara IMF shtrohet nevoja e rritjes së kujdesit për klientin duke i ofruar produkte sa më inovatore financiare, por nga ana tjetër ky proces duhet të koordinohet edhe më mirë me politikat bankare të vendit si dhe mbështetjet legale.

IV. Krijimi i një banke rurale për konsolidimin e institucioneve të mikrofinancës me fokus sektorin rural

Fokusi i seksionit vijues është argumentimi se përse krijimi i një banke rurale të mikrofinancës, konkretisht mbi bazën e Grupit Unioni SHKK duhet të tërheqë më shumë vëmendjen e aktorëve institucionalë në vendin tonë.

Çfarë do të sillte kryerja e një aktiviteti bankar?

- ✓ Futjen e produkteve të reja të kërkuara nga klientët
- ✓ Rritjen e kursimeve
- ✓ Lehtësi në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare për rifinancime
- ✓ Lehtësi në thithjen e njohurive të reja për kërkim dhe zhvillim
- ✓ Rritje të aksioneve përmes aksionerëve të jashtëm
- ✓ Forcim i ambjentit konkurrues

Themelimi i një Banke të Mikrofinancës Rurale duhet të ruajë 2 objektiva:

1. Mbrojtjen e arritjeve të deritanishme të Grupit Unioni SHKK
2. Përsheptim i zgjerimit në zonat rurale

A do ta mbështesë situata aktuale krijimin e Bankës së Mikrofinancës Rurale?

Situata aktuale karakterizohet nga:

Modeli ekzistues solid i biznesit

Shkk-të janë të qëndrueshme dhe kjo krijon premisë për të hartuar një plan strategjik për një periudhë të ardhshme 5 vjecare. Përfitueshmëria në terma të kthimit për aksion është rritur nga 9-13%

Potenciale në rritje të Grupit Unioni Shkk të cilat mund të shikohen:

- ✓ Rritje të Shkk-ve ekzistuese, pasi shumë prej tyre nuk kanë kapur potencialin maksimal të tyre, apo pasi shumë klientë kanë mbetur ende jashtë tyre
- ✓ Rritje përmes shkk-ve të reja- zgjerimi në zona të reja, fshatra dhe klientë të rinj
- ✓ Rritje përmes produkteve të reja –Grupi Unioni Shkk ka filluar të zhvillojë produkte të reja me partnerë të rinj
- ✓ Rritje përmes futjes së produkteve të reja bankare- hipoteka, hua për biznesin e vogël dhe të mesëm
- ✓ Evoluimi i konkurrencës. Aktualisht Grupi Unioni Shkk nuk ka konkurrentë, por ajo pritët të rritet, pasi sektori paraurban po tërheq interes për bankat tregtare.

Dy elementët e parë tregojnë, që Grupi Unioni SHKK përbën një biznes të mirë, i cili mund të sjellë përfitime të mira nga burime të mëdha dhe investitorë të rinj.

Sot Grupi është në një pozicion relativisht komfort sepse bankat nuk kanë hyrë në zonat rurale dhe nuk kanë një model biznesi të aplikuar në këto zona. Kjo për faktin se krijimi i Shkk-ve kërkon investime, aftësi dhe kohë. Megjithatë konkurrenca mund të ndjehet në kontekstin që: kostot e transaksioneve në zonat urbane janë rritur, klientët e shkk-ve po zgjerohen dhe po bëhen atraktiv për konkurrentët.

Çfarë do të sjellë krijimi i një Banke të Mikrofinancës Rurale?

- ✓ Një bankë mund të ofrojë produkte të reja, të cilët do të sillnin një rritje të përfitueshmërisë dhe zgjerimit të zonës së veprimt
- ✓ Një bankë mund të tërheqë investitorë të rinj kombëtar apo ndërkombëtar, publik ose privat. Avantazhet e tërheqjes së investitorëve të rinj janë: aksione shtesë, ide, njohuri dhe mbrojtje ndaj ndërhyrjeve të politikës.
- ✓ Banka nuk e zëvendëson sistemin ekzistues por e plotëson atë: Shkk-të do të mbeten bërthama e modelit të ri, ato do të jenë njësi bazë të Grupit + Bankë. Shkk-të do të bëjnë biznes si zakonisht, përveç shtimit të bizneseve të reja si agjensi të bankave. Ato janë kanale kryesore të shpërndarjes për bankat duke vepruar si një pikë shërbimi me kosto të vogël.

Misioni i Bankës së Mikrofinancës Rurale: *"Mbështetja financiare dhe teknike për shoqëritë e kursim kreditit, që janë institucione, të krijuara dhe menaxhuara nga vetë anëtarët, me qëllim përfundimtar nxitjen e aktiviteteve produktive në zonat rurale"*

Objektivat e bankës:

- a. Ruajtja dhe zhvillimi i një segmenti tregu
- b. Ofrimi i shërbime të nevojshme duke minimizuar kostot e transaksionit
- c. Reformimi institucional që siguron vazhdimësi
- d. Forcimi i vazhdueshmërisë financiare dhe regjistrimi në sektorin bankar formal

Transformimi i një sistemi aktual drejt një institucioni me statusin e një banke tregtare, të regjistruar sipas ligjit për bankat, mendojmë se është një zgjidhje e përshtatshme, duke ofruar të njëjtat garanci të kërkuara. Modeli institucional i propozuar, duhet të lejojë integrimin e pronarëve të përbërë nga investitorë institucional.

Konkluzione

Edhe pse mikrofinanciari është në zhvillim në Shqipëri ka më shumë hapësirë për të zgjeruar në këtë sektor si një instrument i rëndësishëm për të kontribuar në zhvillimet ekonomike.

Bankat shqiptare kanë kryer shumë në vitet e fundit dhe konsiderohen si një nga operatorët më të suksesshëm në ekonominë shqiptare. Nga ana tjetër, ato mbetet shumë për të bërë në ofertën e mikrokredisë. Edhe financimi rural vazhdon të jetë i rëndësishëm me kontributin e aktorëve të ndryshëm, si dhe Fondacioni BESA, PSHM, SHKK etj. Por nevojat e rritjes së sektorit rural duhet të mbështeten edhe më shumë me zgjerimin e mikrofinancave rurale duke përmirësuar efikasitetin e produkteve të tyre financiare dhe nxjerrjen e inovacioneve për procesin e menaxhimit. Përveç kësaj, në zhvillimin dhe mbështetjen e kredisë për prodhimin rural shumë argumenta evidentojnë nevojën për të krijuar një Bankë Rurale të Mikrofinancës.

Zhvillimet e mikrofinancës dhe mikrokredisë në vendin tonë duhet të paraprihen edhe më mirë në spektrin rregullator dhe institucional për të mbështetur sipërmarrjen specifikisht të shtresave në nevojë si në zonat urbane edhe në ato rurale. Nga ana tjetër, mësimet e ofruara nga eksperiencia globale dhe e iniciativave aktuale të BE-së duhet të merren më shumë në konsideratë.

Literatura:

1. ČECHURA, L. (2008): Investment, credit constraints and public policy in a neoclassical adjustment cost framework, Discussion paper No. 115, IAMO.
2. Custer G. M. (2008): Audit of USAID/Albania's Economic Restructuring and Agriculture Development Program (Report Number 8-182-08-001-P), Frankfurt, Germany.
3. Grashof L., (2002): Building a Microfinance Network in Albania – Challenges and Opportunities, Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) GmbH, Eschborn, Germany.
4. MAFF, (2007): Report 2007, Tirana.
5. McDonald B. and Ledgerwood J., (1999): *Case Studies in Microfinance: Albania – Albanian Development Fund*, World Bank, Washington, DC.
6. Republic of Albania, Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection (2007): Rural development crosscutting strategy 2007-2013, Tirana.
7. Schläpfer A. and Wohlfender M., (2007): Mobilizing Savings in Rural Albania - An example from the Albanian Savings and Credit Union, University of Bern, Switzerland.
8. World Bank, (2007): Albania Access to finance for Enterprise Sector, Report No. 42061-Al.
9. ČECHURA, L. (2008): Investment, credit constraints and public policy in a neoclassical adjustment cost framework, Discussion paper No. 115, IAMO.
10. Custer G. M. (2008): Audit of USAID/Albania's Economic Restructuring and Agriculture Development Program (Report Number 8-182-08-001-P), Frankfurt, Germany.
11. Grashof L., (2002): Building a Microfinance Network in Albania – Challenges and Opportunities, Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit

- (GTZ) GmbH, Eschborn, Germany.
12. MAFF, (2007): Report 2007, Tirana.
 13. McDonald B. and Ledgerwood J., (1999): *Case Studies in Microfinance: Albania – Albanian Development Fund*, World Bank, Washington, DC.
 14. Republic of Albania, Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection (2007): Rural development crosscutting strategy 2007-2013, Tirana.
 15. Schläpfer A. and Wohlfender M., (2007): Mobilizing Savings in Rural Albania - An example from the Albanian Savings and Credit Union, University of Bern, Switzerland.
 16. World Bank, (2007): Albania Access to finance for Enterprise Sector, Report No. 42061-Al.

Një këndvështrim etik mbi krizën financiare

Dr. Kreshnik Bello

Përgjegjësi i Departamentit të Marketingut, UET

MSc. Artur Temo

Universiteti European i Tiranës

MBA Edmond Bello

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT. *Një fokusim më i kujdesshëm në çështjen e krizës globale, pa dyshim që zbulon se kjo krizë financiare midis pasojave të tjera, ka shkaktuar dhe një dilemë globale në aspektin etik të biznesit. Problemet me tregjet financiare kanë parashtruar nevojën që kjo krizë etike (e shndërruar në krizë besimi), të kuptohet sa më saktësisht në mënyrë që të shërbejë për të parandaluar faktorët që krijojnë kushte të përshtatshme për kriza të ngjashme. Synimi i këtij artikulli është që të kontribuojë në mënyrë modeste në ndërgjegjësimin e opinionit akademik shqiptar, mbi lidhjet që ekzistojnë midis një etike biznesi të pamjaftueshme dhe krijimit të krizave të besimit.*

Nëse ne nuk jemi në gjendje të kuptojmë problemet etike lidhur me atë ç'ka ka ndodhur, atëherë ekonomia globale dhe tregjet financiare ka shumë të ngjarë të përsëritin të njëjtat gabime. Për të kuptuar problemet etike është e domosdoshme që komuniteti financiar i biznesit të krijojë një kuptim të thellë dhe të qëndrueshëm në kulturën organizacionale që krijoi kushtet për krijimin e një kategorie asetesh të titulluara si 'sub-prime loans'. Me drejtpërdrejt pyetja që shtrohet është: cilat ishin forcat që stimuluan krijimin dhe lulëzimin e kulturës së konsumit bazuar në huamarrje.

Kriza financiare preku ose ndikoi jo vetëm ekonominë e zhvilluara, por edhe ekonominë në zhvillim. Për këtë arsye, megjithëse ndikimi më i madh mund të ketë qenë lokal për shume vende, reagimi dhe kundërpërgjigja është e domosdoshme që të jenë ndërkombëtare. Kjo do të

sillte një reagim më efektiv ndaj krizës. Ishte pikërisht ndërhyrja individuale dhe kolektive e qeverive të vendeve të ndryshme ajo që sipas përqasjes Kensiane bëri të mundur që efekti i krizës të minimizohej dhe më pas të kontrollohej në një masë të konsiderueshme.

Eksperiencat e viteve të fundit kanë treguar se qëndrueshmëria e suksesit të bizneseve dhe të ekonomisë së tregut në tërësi nuk është plotësisht e garantuar. Globalizimi i ekonomisë dhe shfaqja e të ashtuquajturit 'Kapitalizëm Global' ka sjellë me vete gjithashtu edhe lindjen e risqeve të reja me të cilat biznesi do të mund të përballlet vetëm nëse aplikon norma të pëlqyeshme etike, të cilat do të kontribuonin në mirëqenien e shoqërisë në tërësi.

Fjalët kyçe:

Ekonomi globale; Krizë ekonomike; Etikë dhe përgjegjshmëri

Hyrje

Në hapësirën tonë të diskutimit ne kemi pasur interesin të fokusohemi në dimensionin etik të krizës financiare, si dhe në detyrimet e përgjegjësitë që menaxherët, kompanitë, qeveritë dhe organizmat ndërkombëtare kanë ndaj individëve dhe komuniteteve që influencohen prej aktiviteteve të tyre. Kjo gjë, nën këndvështrimin bashkëkohor të sjelljes së organizatave ka të bëjë me 'corporate social responsiveness' dhe bazohet në idenë se si organizatat duhet të trajtojnë në mënyrë proaktive shqetësimet dhe pritshmëritë e publikut. Në vazhdim të këtij diskutimi, ne do të kemi rastin të paraqesim disa orientime dhe rekomandime të cilat ndihmojnë për përcaktimin nëse vendimet që merren prej organizatave i plotësojnë ose jo standardet etike. Në përfundim të diskutimit, audienca do të ketë mundësinë të krijojë një kuptim më të qartë mbi rolin qendror që luan etika në praktikatat e biznesit, si edhe në jetën e individëve, komuniteteve dhe shoqërive, ku organizatat zhvillojnë aktivitetet e tyre.

Etika e biznesit dhe marrëdhënia e saj me krizën financiare

Etika e biznesit si një disiplinë, ka lindur prej nevojës për t'ju përgjigjur pyetjes se përse vendime të caktuara – të cilat merren prej organizatave – duhet të vlerësohen edhe në aspektin etik, gjë e cila do të përcaktonte nëse ato ofrojnë zgjidhje të drejta apo të gabuara. Do të ishte gabim të mendohej se arsyetimet etike lidhur me skandalet dhe veprimet shoqërisht-të-dëmshme të korporatave të konsideroheshin si idealiste ose naive. Pa ndihmën e arsytimit etike si do të mund të gjykojmë nëse aktivitete apo aspekte të caktuara të biznesit janë shoqërisht të dobishme apo të dëmshme (të pranueshme ose jo)? E gjejmë me vend të përmendim këtu se 'të pranueshme' ose 'të papranueshme', 'të drejta' ose 'të gabuara' lidhet me atë ç'ka mund të konsiderohet 'moralisht e drejtë ose moralisht e gabuar'. Këto janë çështje që do t'i qartësonin shumë njëri prej përkufizimeve mbi etikën, i cili sugjeron se: "Etika e biznesit ka të bëjë me studimin e situatave dhe aktiviteteve të biznesit, si dhe me përcaktimin se çfarë është

e drejtë ose e gabuar në këto aktivitete¹⁰⁸.

Në vazhdim mund të themi se njerëzit e kuptojnë se janë duke u përballur me një dilemë etike vetëm atëherë kur skrupujt e tyre moralë futen në veprim, duke i bërë ata të hezitojnë, të debatojnë ose të reflektojnë mbi një veprim të caktuar, nëse ai është i drejtë apo i gabuar. Problemi më kryesor që vihet re lidhur me etikën dhe që i ndërlikon edhe më tej dilemat morale, është vështirësia për të vendosur parime të përjetshme, të cilat do të ishin në gjendje të përcaktonin nëse një veprim mund të konsiderohet etik ose jo. Kjo ndodh sepse grupe të ndryshme njerëzish mund të kenë opinione të ndryshme lidhur me një veprim – opinione këto që bazohen në interesat vetjake, në qëndrimet personale dhe në besime apo vlera që individit ka kohë që i zhvillon brenda vetes. Megjithatë, pavarësisht nga kjo lloj vështirësie, organizatat gjithmonë e më tepër janë duke e kuptuar rolin që etika luan në suksesin dhe mirëqenien e tyre afatgjatë.

Kështu, p.sh organizata e Kontabilistëve Publik të Çertifikuar (CPA në Sh.B.A) beson se standardet e larta etike që ajo ka vendosur, përbëjnë arsyen kryesore përse kjo organizatë gëzon besim në mendjen e publikut. Shumica e firmave të kontabilitetit që CPA pati përfshirë në një studim mbi etikën¹⁰⁹, raportuan se kanë në funksionim programe që i mundësojnë stafit diskutimin me menaxherët të çdo lloj çështjeje, për të cilën ata nuk ndjehen profesionalisht dhe moralisht të qetë. Kjo gjë është realizuar nëpërmjet programeve udhëzuese, nëpërmjet politikave të dyerve të hapura dhe atyre të ndërtimit të marrëdhënieve të mira midis personelit dhe menaxhimit. Por nga ana tjetër këto firma nuk treguan gatishmëri për të diskutuar rreth rasteve kur personelet e tyre qenë përballur me çështjet etike gjatë marrëdhënieve të tyre me klientët. Le të kujtojmë këtu se integriteti dhe përgjegjshmëria ndaj klientëve duhet të jenë elementë çelës në aktivitetet e të gjithë firmave që operojnë në industrinë financiare.

Në diskutimet dhe debatet e shumta rreth krizës globale të viteve 2007-2008 duket sikur arsyet më të dukshme që e shkaktuan atë kanë qenë kreditë e këqija (pa kufizime), kontrolli i dobët i riskut, bonuset e majme të drejtuesve të kompanive, çmimet e fryra të banesave, pangopësia për fitime jonormale, etj. Një vëzhgues i kujdesshëm nuk do ta kishte të vështirë të dallonte që fenomeni nuk ka pasur thjesht natyrë ekonomike dhe politike. Në thelbin e vet ai përmban dimensione etike dhe përgjegjësie sociale, që do të thotë se ndërmjet shkaqeve të paraqitura më lart duhet përfshirë edhe rënia graduale deri në kolaps e normave dhe sjelljes etike brenda industrisë financiare. Nisur nga një këndvështrim i ngjashëm, Citizens Ethics Network me qendër në Londër shpreh habinë se përse gjatë debateve për krizën nuk po zhvillohet gjithashtu një analizë se çfarë ka qenë e padrejtë dhe e pandershme në gjithë këtë histori. Po t'ju referohemi parimeve të moralit, analizat rreth dukurisë 'krizë ekonomike globale' duket sikur e anashkalojnë një diskutim 'se çfarë – në ato që ne bëjmë – është e drejtë dhe e moralshme dhe çfarë nuk është'. Për më tepër, shumë organizata i konsiderojnë standardet etike si të përmbushura vetëm nëse bëhet aq sa e kërkon ligji dhe asnjë

108 *What is business ethics by Crane and Matten 2007, pp. 4-15 in 'Business Ethics' 2nd Ed., Oxford*

109 *A study on ethics in the accounting profession by Warth, Robert J. Oct. 2000, CPA Journal*

gjë më tepër. Megjithëse njerëzit vihet re se mbajnë qëndrime të qarta dhe të prera lidhur me çfarë është e drejtë dhe çfarë jo, Bunting (editor i gazetës Britanike “The Guardian”) shprehet se: – “Politika duket sikur e ka humbur aftësinë për të bërë këto lloj gjykimesh”. Ai vazhdon, duke thënë se “Politika është bërë shumë teknokratike dhe menaxheriale, duke u fokusuar më tepër në çështjet se cila palë do të jetë më në gjendje të krijojë një rritje më të madhe ekonomike”. Duke iu referuar opinionit publik, votuesit e demokracive perëndimore duket se i konsiderojnë si të parregullta bonuset e ekzagjeruara të drejtuesve të korporatave, si dhe huadhëniet dorëlëshuara të bankave, por me sa duket të votuarit e tyre (politikanët), duket sikur e kanë humbur aftësinë për të prodhuar zgjidhje që i përgjigjen këtij shqetësimi.

Jo rrallë vihet re që shoqëria, duke përdorur procedura politike dhe ligjore mund të llobojë për të nxjerrë ligje që specifikojnë se çfarë u lejohet të bëjnë ose çfarë nuk u lejohet të bëjnë njerëzit dhe organizatat. Normalisht grupet që sigurojnë mbështetjen më të madhe nëpërmjet lobimit arrijnë të krijojnë ligje që reflektojnë më mirë interesat dhe besimet e tyre. Shpesh herë këto ligje nuk specifikojnë se si një organizatë duhet të balancojë objektivat dhe vendimet, në mënyrë që nga ato të mos dalin palë të humbura. Në rastet më të mira, nëpërmjet lobimit janë krijuar ligje që i udhëzojnë bizneset se si duhet të trajtojnë klientët dhe grupet e tjera të quajtura ‘stakeholders’, por në raste të tjera lobimi është përdorur si mjet për të përmbushur interesat e korporatave.

Ashtu si njerëzit, edhe kompanitë ndodhen përpara situatave në të cilat ato duhet të vendosin se çfarë është e drejtë të bëjnë dhe çfarë jo. Në mënyrë të veçantë, nëse nuk ka ligje specifike që përcaktojnë se si duhet të sillen kompanitë, janë menaxherët ata që duhet të vendosin se cila është zgjidhja e drejtë dhe etike, duke marrë parasysh ndikimin që do të kenë vendimet dhe kurset e veprimit në grupet që preken prej tyre. Grupet e interesit (stakeholders) mund të përfitojnë ose dëmtohen nga veprimet e kompanive dhe për këtë arsye kompanitë dhe menaxherët e tyre kanë një rëndësi të veçantë për këto grupe. Në këto kushte mund të shtrohet pyetja: duhet që korporata të ndiejë ndonjë përgjegjësi morale lidhur me çfarë është e drejtë apo e gabuar në veprimet e saj? Pavarësisht se kjo pyetje për shume kohe ka krijuar debate te ashpra brenda komunitetit të biznesit, tani ekziston një mendim përgjithësisht i pranuar se organizatat e biznesit në fakt kanë edhe përgjegjësi të tjera që shtrihen përtej realizimit të fitimit.¹¹⁰

Sipas një studimi të kryer nga ‘The World Economic Forum’ (Janar 2010), 2/3 e njerëzve besojnë se kriza ekonomike aktuale është gjithashtu një krizë e etikës dhe e vlerave. Vetëm 50 % e respondentëve shprehin opinionin se vlerat dhe parimet morale ekzistojnë në shoqërinë e sotme. Ky studim u realizua nëpërmjet Facebook dhe përfshiu 130 000 njerëz në Francë, Gjermani, Indi, Indonezi, Izrael, Meksikë, Arabi Saudite, Turqi dhe Shtetet e Bashkuara. Rreth 2/3 e të intervistuarve mendojnë se njerëzit nuk përdorin të njëjtat vlera morale në punë dhe në biznes me ato vlera dhe parime që ata i përdorin në jetën e tyre private. Kur të intervistuarit u pyetën

110 *These arguments have been widely presented in the CSR literature, but are largely derived from the works of Davis (1973) and Mintzberg (1983)*

nëse biznesi duhet të ndjehet së pari i përgjegjshëm ndaj aksionerëve dhe pastaj ndaj punonjësve dhe klientëve – rreth 50% e tyre iu përgjigjën pyetjes me përgjigjen se: të tre grupet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë prej organizatave. Të intervistuarit e zgjeruan opinionin, duke thënë se vetëm 25% e organizatave ndërkombëtare të biznesit i aplikojnë qasjet që bazohen në vlerat moralo / etike. Kjo shifër shkon në 40% në rastin e organizatave të vogla dhe të mesme. Të pyetur se cilat do të ishin vlerat që duhet të dominojnë sistemin politik dhe ekonomik në rang global, rreth 40% e të intervistuarve u përgjigjën se ato janë ndershmëria, integriteti dhe transparencja; 24% zgjedhën respektimin e të drejtave të të tjerëve, dinjitetin dhe pasurinë e pikëpamjeve, 20% shfaqën opinionin se duhet të jetë zgjedhja e kurseve të veprimit që çojnë në mirëqenien e shoqërisë në tërësi dhe 17% e tyre e përqendruan vëmendjen në problemet që kane të bëjnë me ambientin.

Natyra e përgjegjësive sociale të korporatave

Përgjegjësia sociale e korporatave përfshin pritshmëritë ekonomike, ligjore, etike dhe filantropike që shoqëria vendos mbi korporatat në një periudhë të caktuar kohe.

Përgjegjësia Ekonomike – Korporatat përbëhen prej aksionerëve, të cilët kërkojnë një kthim të arsyeshëm mbi investimet që ata kanë bërë. Ato kanë punonjës të cilët kërkojnë siguri, kushte pune dhe një pagë të përshtatshme. Por korporatat kanë dhe klientët, të cilët kërkojnë produkte cilësore dhe me një çmim të arsyeshëm. Sipas Carroll (1991), realizimi i përgjegjësive ekonomike është diçka që kërkohet prej të gjitha korporatave.

Përgjegjësia Ligjore – Ky lloj detyrimi kërkon që korporatat dhe format e tjera të biznesit të zbatojnë ligjet dhe t'i kryejnë aktivitetet në 'përputhje me rregullat e lojës'. Kjo lloj përgjegjësie gjithashtu kërkohet prej të gjitha korporatave. John C. Bogle (2009) shpreh opinionin, se megjithëse shumica mund të besojnë se kriza u shkaktua prej kredive që merreshin shumë lehtë, në fakt ajo u shkaktua prej 'cavalier attitudes' të bankerëve lidhur me riskun – gjë që dëmtoi lidhjet midis huadhënësve dhe huamarrësve ... si dhe faktit që ligjvënësit dhe agjencitë ligj-zbatuese, dështuan të luanin siç duhet rolin që u ishte ngarkuar nga shoqëria.¹¹¹

Përgjegjësia Etike – Korporatave u kërkohet që të marrin gjithashtu përgjegjësi ndaj shoqërisë në tërësi, duke bërë atë çka është e drejtë dhe e ndershme edhe në rastet kur nuk ekzistojnë pengesa ligjore për të kundërtën. Kriza e viteve 2007-2008 u shkaktua edhe sepse menaxherët e korporatave të zotëruara prej publikut e vendosën interesin e tyre mbi interesin e anëtarëve të publikut, që ishin aksionerë në këto korporata. Është konstatuar se menaxherët e korporatave amerikane – duke abuzuar me rolin e agentit që u pati besuar publiku (aksionerët) – kanë arritur të bëhen vetë pronarë të 75% të aksioneve të organizatave që ata përfaqësojnë. Duke i plotësuar këto

111 *A crisis of ethic proportions: we must establish a 'fiduciary society' (April, 2009) by John C. Bogle, The Wall Street Journal*

analiza edhe me arsyetime të tjera rreth shkaqeve të krizës, duket se shkak u qendror është dështimi për të kuptuar ndryshimet në vetë natyrën e kapitalizmit – ndryshime që janë duke ndodhur përpara syve të gjithsecilit. Shoqëria, që mbështet ekonominë e tregut të lirë, po neglizhon të plotësojë obligimet ndaj vetë konsumatorëve, të cilët përbëjnë dhe qendrën e këtij sistemi dhe kjo po ndodh, duke lejuar krijimin e fitimeve të ekzagjeruara në dëm të këtij grupi të rëndësishëm ‘stakeholder’. Në këtë kontekst, përgjegjshmëria sociale e korporatave –sipas një përkufizimi të pranuar gjerësisht – ka të bëjë me aftësinë e korporatave për t’iu përgjigjur me proaktivitet presioneve që vijnë nga aktorët e ndryshëm të shoqërisë.

Përgjegjësia Filantropike – Nëpërmjet kësaj forme obligimi – shprehen mbështetësit e këtij modeli – korporatat duhet të tregojnë kujdesin e duhur për të përmirësuar kushtet dhe cilësinë e jetesës së punonjësve, komuniteteve lokale dhe shoqërisë në tërësi.

Klaus Schëab (themelues dhe drejtor ekzekutiv i Forumit Ekonomik Botëror) bazuar në observimet që u përmendën më lart, thekson nevojën për krijimin e një grupi vlerash që do të shërbejnë si themel për ndërtimin e institucioneve që trajtojnë çështjet e ekonomisë globale. Ai vazhdon, duke thënë se sistemi aktual ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të veta ndaj tre miliardë njerëzve (1/2) që janë pjesë e shoqërisë globale. Nga një këndvështrim i ngjashëm, John DeGioia (President i Georgetown University, Sh.B.A) shprehet se “kriza ekonomike-financiare, duhet të shihet si një mundësi për të ri-artikulluar vlerat që udhëheqin të gjitha institucionet globale dhe se komunitetet fetare duhet të luajnë një rol qendror në ruajtjen e vlerave morale të shoqërisë në tërësi”.

Kriza financiare u shkaktua në një shkallë të madhe për shkak të pangopësisë për fitime, që krijoi dhe idenë se siguracionet mund të përdoren për të shndërruar huadhëniet në asete të tregëtueshme, të cilat nuk bënin gjë tjetër veçse e transferonin riskun në kurriz të të tjerëve. Bankat filluan të përdorin siguracionet si mundësi për të rritur të ardhurat, duke qenë njëkohësisht të vetëdijshme se nëse do të përdorin thjesht huadhënien për të realizuar të ardhura – kjo nuk do të kishte mundësi realizimi brenda një kohe të shkurtër, mënyrë kjo që nuk do të sillte fitime të shpejta. Duke ditur se janë pikërisht blerësit e siguracioneve ata që i bëjnë të ardhurat e tyre nëpërmjet kredi-marrësve, bankat bënë përllogaritjet që rezultuan në transferimin e riskut nga vetja tek këta klientë. Ky veprim, në aspektin etik është i dënueshëm sepse nëpërmjet tij dhuhet parimi që vendimet duhet të kenë parasysh që të minimizojnë ndikimet negative mbi grupet e ndryshme të interesit.

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me grupe të çfarëdoshme interesi, por me të paktën dy segmente klientësh të cilët janë: 1) blerësit e siguracioneve dhe 2) huamarrësit për blerje banesash. Imagjinoni për një moment më tej që ka sjellë fjala e përhapur se industria e siguracioneve është novacioni financiar më i madh i shekullit të 20-të. A nuk dallojmë në këtë lloj promocioni një efekt të ngjashëm tek besimi publik, që u shkaktuan nga thashethemet në mbështetje të skenave piramidale në Shqipërinë e viteve 1995-1996?

Ajo çka ndodhi në krizën amerikane ishte se bankat i përdorën huadhëniet në mënyrë të tillë që i bëri klientët e tyre të kishin një besim të tepruar në to dhe nga ana tjetër të kishin një perceptim të ulët për riskun. Bankat kujtuan se e kishin gjetur më në fund mënyrën se si të kontrollonin më mirë riskun, duke nxjerrë në të njëjtën kohë të ardhura në mënyra më efektive. Ato besuan se arritën ta shpërndanin riskun në mënyrë më efektive midis lojtarëve të ndryshëm në lojën e madhe për fitime, por për të cilin realiteti provoi të kundërtën. Si rrjedhojë, bizneset e tjera dhe tregtia në tërësi nuk mundën të përjashtoheshin nga efektet negative që shkaktoi kjo iniciativë e bankave, sepse ato kanë marrëdhënie direkte me klientët që kanë konsumuar shërbimet e huamarrjes – gjë e cila e barti efektin negativ në të gjithë sistemin. Kjo provon edhe njëherë tjetër se vendimet e gabuara që e përjashtojnë elementin etik prej procesit të vendimmarrjes, shkaktojnë efekte negative edhe tek grupet e tjera ‘stakeholders’.

Duke iu referuar artikullit të John C. Bogle ‘A Crisis of Ethical Proportions’ mund të huazojmë opinionin e njërit prej aksionerëve avanguard që e përshkruan krizën financiare globale, si një ‘krizë që ka një dimension të konsiderueshëm etik në vetvete’. Bogle plotëson arsyetimin se lidhur me atë çka ndodhi, përgjegjësia në një masë të konsiderueshme vendoset tek gërryerja që në mënyrë konstante iu është bërë standardeve etike tradicionale. Siç mund të ri-konstatohet, biznesi nuk duhet të ketë si përgjegjësi të vetme realizimin e fitimit – që është vetëm një prej objektivave – por edhe realizimin e një objekti qendror, që është kontributi në mirëqenien e shoqërisë. Ashtu siç ka thënë edhe Adam Smith në veprën e vet ‘Dora e Padukshme’, ... është një mënyrë nëpërmjet të cilës interesi i individit kontribuon në plotësimin e interesave të shoqërisë në tërësi, sepse të gjithë ne varemi nga forcat e tregut dhe konkurrenca për të krijuar begatinë dhe mirëqenien individuale dhe shoqërore.

Në këtë krizë financiare interesi individual u teprua (u abuzua) deri sa doli jashtë kontrollit, duke bërë që sukcesi individual të mos matej duke përdorur parametrat morale dhe etike, por duke i zëvendësuar ato me parametrin “modern” të sasisë të parave të fituara. Në këtë mënyrë, forcat e pakontrolluara të tregut i nënshtuan standardet e moralit tradicional që theksojnë sjelljen profesionale – dhe që kanë dashur një kohë shumë të gjatë për t’u zhvilluar. Në mënyrë që biznesi ta përmbushë siç duhet rolin e vet si ‘qytetar i globit’, ai duhet të vendosë një marrëdhënie etike me vetë shoqërinë dhe kjo shtrun nevojën që çdo profesion të zhvillojë standarde, për t’i shërbyer shoqërisë në mënyrë të përgjegjshme, të matur dhe jo të orientuar vetëm drejt interesit. Këtu vlen të përmendet dhe parimi i hershëm që pati udhëhequr biznesin dhe që pati shërbyer si një standard përgjithësisht i pranuar : ‘besimi forcohet duke u bërë i besueshëm’.

Duke transmetuar të njëjtin apel, gazeta britanike ‘The Guardian’ citon Kryeministrin Gordon Brown të shprehet se: ‘në shoqërinë e sotme, njerëzit po tregojnë se dëshirojnë t’ju rikthehen vlerave të qëndrueshme morale, siç janë përgjegjshmëria dhe ndershmëria’. Shoqëria e konsumit, e cila fokusohet tek plotësimi dhe madje stimulimi i dëshirave, vazhdon të dëmtojë seriozisht lidhjet dhe marrëdhëniet që dikur i ndihmonin njerëzit të kujdeseshin për interesin e përbashkët të komunitetit.

Konkluzione

Ky artikull studimor synon të sensibilizojë audiencën shqiptare mbi rolin që luan etika në drejtimin në mënyrë të përgjegjshme të bizneseve, si dhe shpjegojë lidhjen që ekziston midis metodave jo-etike dhe pasojave, të cilat mund të jenë aq të thella sa të formojnë një krizë të përmasës globale. Dimensionit etik të krizës nuk i është kushtuar vëmendja e duhur prej vendimmarrësve të bizneseve, si dhe organizatave që garantojnë mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe publikut. Ky fakt e ka bërë grupin studimor të hedhë vështrimin e vet në këtë aspekt të krizës financiare, duke u përpjekur ta kthejë këtë në një mundësi për t'i sugjeruar audiencës shqiptare idenë që të nxjerrë mësimet e duhura nga kjo situatë, që tërhoqi vëmendjen globale. Aspekti etik jo vetëm që duhet konsideruar si dimension i krizës ekonomike globale, por ai duhet të studiohet dhe njihet në detaje prej të gjitha organizatave shqiptare, në mënyrë që ato të përfshijnë elementin etik në proceset e tyre të vendimmarrjes. Interes të veçantë duhet t'i kushtojnë përfshirjes së etikës në programet e tyre të studimit dhe universitetet shqiptare, të cilat duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në përhapjen e këtij mentaliteti të ri. Duke konkluduar, vlen të theksojmë se ky diskutim nuk përfshiu gjithçka të mundshme, duke lënë në këtë mënyrë një rrugë të hapur për studiues të tjerë që kanë interes të avancojnë kontributin në këtë lloj studimi.

Literatura:

1. Business Ethics by Crane A. & Matten D (2007) 2nd Ed. Oxford University Press, NY
2. Corporate Governance by Christine A. M.(2004), Oxford University Press, New York
3. Organizational Behaviour: key concepts, skills and best practices by Kinicki A. and Kreitner (2008) 3rd Ed. McGraw-Hill, New York, NY
4. The Global Financial Crisis Explained – Credit and Credibility by Richard Kharn, Sept. 2009, www.marketoracle.co.uk/Article13709.html (12/03/2010)
5. Leadership lessons from Global Financial Crisis by Col Raman, Journal of Bombay Management Association, Institute of Management Studies, Thane, Vol.09
6. A study on ethics in the accounting profession by Robert Warth, Oct. 2000, CPA Journal
7. The Financial Crisis and the Collapse of Ethical Behaviour by Gregory Curtis, Chairman of Greycourt & Co.Inc
8. Ethics angle missing in financial crisis debate by Tom Heneghan, March 2010, @ [www.ibtimes.com/articles/20100304/ethics-angle-missing-financial-crisis-debat ...](http://www.ibtimes.com/articles/20100304/ethics-angle-missing-financial-crisis-debat...)
9. Essential lessons to draë from economic crisis by Anthony B. Robinson, Sept.2008 @ www.seattlepi.com/local/379840_faith20.html
10. Over 75% People Believe the Current Economic Crisis is also a Crisis of Ethics and Values by The World Economic Forum, Jan. 2010

Trends on Financial Regulatory Framework. The role and objectives of AMF as the Regulatory Body of Non- Bank Financial Markets in Albania.

Elisabeta Gjoni - Anxhela Dervishi

ABSTRACT: This paper draws on the lessons learned from the recent financial crisis regarding the improvement of legal framework of the financial system as a whole as well as the main aspects that reforms are mandated to improve this system's legal framework with reference to specific sectors' characteristics. This paper focuses on challenges and legal framework of insurance sector worldwide as well as on AFSA's role as the regulator of the non banking financial markets in Albania. This paper also analyzes the projects launched from AFSA on improvement of legal framework and insurance supervision in Albania through the implementation of risk focused supervision methodology.

The Impact of 'Impairment Test' as per IFRS and Basel II approaches on the Magnitude and Quality of Portfolio at Risk and the Capital Adequacy Exposure – Convergences and Divergences

Ilir Hoti

ABSTRACT: Basel II framework requires banks to conduct stress tests on their potential future minimum capital requirements. The implementation of International Financial Reporting Standards from all commercial banks residents in Albania has become a mandatory concern since January 1st 2009.

This study starts up with the asymmetric information risk going through all systemic ingredients within banking industry in Albania. A diagnostic examination covers the discrepancies between Basel II, IFRS and the Regulations of Bank of Albania on loans

portfolio's impairment risk identification, measurement and management. In addition we have developed a model on stress testing measurement and impact of IFRS 39 implementation on loans portfolio quality at least on monthly basis. The stress testing framework for minimum capital requirements is based on *mild recession scenarios* and considers all the interrelated components of risk exposure comparatively between Basel II and IFRS approaches. It includes the ad hoc paradoxes coming out from credit risk developments and the consequent effects in minimum capital requirements.

The paper provides some similar viewpoints compatible on Albanian Banking System data and underlines the importance of such joint modeling.

Local Government financing and current challenges to municipalities, communes and the banking system.

Ornela Shapo (Këmbora) - Ardiana Sokoli - Anilda Bozdo _____

ABSTRACT: Municipal decentralization from 1998 is based on three important column (1) function decentralization / new functions year by year for municipal units; (2) increment of financial instruments on municipal authorities hand (3) increase of institutional capacities. Law approval for organization and functioning of municipal authorities put the strategy of municipal decentralization on Albania on those three columns. It is clarified fiscal and financial instrument as main sources for own municipal authorities functions.

At last, the approval on February 2008 the law for municipal authority loans is the important step in enforcing of finance and "municipal autonomy" on one hand and the express the maturity of those municipal units to make important decisions on behalf of community that they represent. On the other hand the banking market in Albania is prepared to explore such market because for many years is attempted such financing scheme on full partnership financial institution – municipal unit or and more complicating relations as scheme financing PPP (Private public partnership).

Now with USAID assistance is explored this market and is realized the first commercial loan for one municipal unit, and are in process some other loans. The loan procedure is still the problem for all interest actors to take into the consideration the unknown risk for both parties, the buroucratic procedures, the actual financial market situation, the national banks and the continuous restrictions from approved authority of those loans as is Finance Ministry.

But, are the municipal units prepared to enter in this market? What are those commercial loans in investment projection sense and are they ready to enter in relations with banks? What are on other hand the duties that are to take into consideration by financial and banking institutions in those relations and what will be the result?

The Saving & Credit associations, their challenges in crediting the small economies, facing the competition of commercial banks and the global crisis: how successful are they currently in the market.

Arlinda Hoti - Zana Komini _____

ABSTRACT: Microcredit or differently named as “loan in small amounts” is not a new concept in the world of finance. In an immense way, microcredit is used as a term that identifies it with the poor or vulnerable groups of population, which are excluded from banking institutions in obtaining financial services. Also, microcredit actually is considered as a powerful tool for alleviation of poverty, prevention of negative phenomenon like unemployment and immigration and for emancipation of women as one of the less advocated groups in the society. Microcredit is a financial instrument that tackles enormously millions of people all over the world. In 2006 resulted that 3133 microcredit institutions were serving to more than 113 millions of clients throughout the world, while until the year 2015, the microcredit instrument tends to reach 175 million clients.

In Albania, Savings & Credit Associations mainly operate in rural areas of those districts which have the highest density of population, economic and agricultural activity such as districts in Central Albania, Western lowlands, and Southeastern part of the country. These Savings & Credit Associations are members of ASC Union, which extends its microfinance activity in around 1000 villages, in 16 districts of the country. Savings & Credit Associations are administered by Steering Boards which are elected by their own members in the General Annual Assemblies.

The goal of this paper is to provide an overview on the performance of Savings & Credit Associations and whether the global crisis has had any impact in their activity.

Non – bank intuitions, their role as financial intermediaries in Albanian financial markets; how successful they were and are now dealing with their role in the financial market.

Brunilda Duraj – Artan Santo

ABSTRACT : The non banking financial institutions are institutions providing financial services, licensed by the Bank of Albania pursuant to the regulation “On the granting of the license to exercise financial activity from the non banking subject in the Republic of Albania”. These non banking institutions are entitled to perform all the actions and to provide all the products serving the client, except for the saving accounts.

Such institutions play a primary role out of the whole of the financial intermediaries which role has increased by serving a greater number of clients. Compared to the banks such institutions are young in Albania, dating since as of 2000. Among the non banking financial institutions in our country, most of them belong to the microcredit institutions, leasing and due to the wide range of activity, the Albanian Post and Credins Institutions.

The main aim of this article is to describe the main types of the non banking financial institutions, the role they played in the country’s economy and the basic products these institutions offer.

The analysis of the development of these institutions is based in the analysis of the regulation frame and its enforcement before and after the 2000. The study is divided in two periods: before the year 2000, when non banking financial institutions were missing and after the 2000, with their establishment focusing on their role and help to the country’s economy.

From an initial point of view it looks like the banking and the financial market is saturated considering their number and their expanding. As a matter of fact, when the basic functions of the citizens are performed in cash, a variety of services from the different institutions, it is inclined that we are still far from meeting the economical and financial interests of the interested groups of the population (shareholders).

The country needs new products that should be provided from both the banking financial institutions and the non banking as well, to the extend where population is and to meet the needs for monetary and financial means of the individuals and the shareholders. Still in our country, borrowing and individual loan are available, mainly in the fields of economy such as construction and infrastructure; that is to say that the acknowledgement and presenting these institutions is yet far from meeting the market’s interests.

The risk of crediting in Albania while facing the current global crisis.

Majlinda Gjata - Evis Gjebrea _____

ABSTRACT: The financial crisis, which began in 2008 in United States of America quickly spread throughout the world and transformed into an economic crisis affecting real economies. This crisis has proven how globalized the world economy is and the negative effects that a country experiences spreads in chain in other countries. The economies of developing countries initially were not affected by the crises being less integrated into global financial markets and less exposed to sophisticated financial products, which were the focus of the crisis. But the deepening crisis in the second half of the year and the increase of its impact on real economies brought consequences in developing countries.

In Albania the crisis did not affect the financial sector in those dimensions as in other countries and may even be said to negligible levels. This as a result of lack of exposure of the Albanian banking sector to more sophisticated financial products, to financial institutions that were the focus of the crisis and because of the low borrowing level in world financial markets. However, in the last quarter of 2008 due to the psychological effects caused by the crises many depositors withdrew their funds causing problems for the banks. This brought the need for more liquidity for the banks and a decrease of the lending level of the banking sector. However the liquidity situation stabilized very quickly through the awareness run by the Bank of Albania against deposit withdraw.

The Albanian economy having as an important source the remittances from abroad felt the consequences of their decrease. This then leads to the decrease of consumer demand towards business products causing financial difficulties of the latter for payment of obligations. The purpose of this study is to analyze the credit risk by presenting the effect that the global crisis had on meeting the payment obligations by the Albanian borrowers. This study presents not only the effect of the crisis, but introduces the proposed measures (taken) to reduce the risk.

Albanian Stock Exchange facing the global crisis: a challenge yet to be undertaken.

Elvin Meka - Gjergji Filipi _____

ABSTRACT: The financial crisis of Fall 2008, which broke out in USA and was quickly turned into a global financial and economic one, had an irrevocable and substantial impact on the way the financial markets and systems operate, not only in an international but also in a local scale. The astonishing dimensions of financial losses experienced, due to the dramatic free fall of financial titles' prices throughout stock markets unavoidably give rise to the following questions:

- were capital markets and the instruments traded there the main culprits, which caused such a tremendous crisis, or they just served as a simple mechanism, transmitting it to investors?
- What would be the future role for the organized securities and other financial instruments markets?

Actually, the Albanian financial reality, when faced with this crisis, cannot give an outright and measured answer, in standard terms of price fluctuations of financial titles, as long as it still lacks an active capital market (despite the formal opening of Tirana Stock Exchange in 1996) and continues to be spun-off from financial globalization.

The intertwining of the financial and economic crisis, on an international scale, and the identified factors which caused them reveal the answer to the everlasting rethoric whether to activate or not the stock market in Albania: The capital market must be present within Albanian financial system not only to contribute to the economic growth, increased competition, but also to alleviate the factors and premises, which initiated and energized this global crisis.

The application of the second pillar as an indispensable reform for the development of the pension market in Albania.

Naim Hasa - Ermela Kripa _____

ABSTRACT: Providing for citizens in time of old age is an issue for every society. Pension levels are significantly determined by demographic structure, individual attitudes and economic growth. On this basis, every country has built its system of Social Security. In conditions where birth rates are falling and people's average life expectancy is extended, the number of retired, is growing at much faster pace than the growth rates of the labor

force. In this context, the old system of social security - "Pay As You Go" (PAYG) pension is moving increasingly towards the inability to meet the needs of "third population". These new situations, pose today before the social security system, some alternatives. First, "A systems should be reformed Pay As You Go pension? If so, what system should be adopted - Modified PAYG - completely private pension system, or a rotational system with many schemes (column)? Among the measures to be thought to improve the pensions market can say with full conviction is the development of private pension schemes.

Towards an effective Supervision of the Insurance Market in Albania.

Rinald Guri - Anxhela Dervishi _____

ABSTRAKT: Following the lessons learned from the recent global financial crisis, the adoption of risk based supervision has increasingly become the main component towards effective insurance market supervision.

This paper develops the ongoing reforms in the EU countries related with the transition from the old capital regime Solvency I towards a new project called Solvency II, as a solution to a regulatory model which reflects risks that an insurer faces. Moreover, this paper analyses the concept, objectives, advantages, challenges and necessary conditions for the implementation of risk focused supervision in Albania.

In this paper is summarized the methodology of risk focused supervision that AFSA has been working on, in order to implement it in Albania in the future.

Concerns regarding the financial activities of entities and the financial system in Albania.

Fatbardha Molla (Beqiri) - Flutura Kalemi _____

ABSTRACT: I have been working on this short project in order to modestly contribute concerning the financial problems of the economic units. In the past was necessary to have a little intuition and the success of business is guaranteed. With a minimal starting investment it can reach high profit rates, especially if you decide to enter business. There has been a time when the courage and personal relations were more important than the administrative skills. There was no need for market studying

or skilled administrators. Nowadays, to start an activity, to invest somewhere or to increase the actual activity is not so simple anymore.

We should have knowledge on the financial activity of the economic unit, which is developed in the functional area where it also takes its name and which is related to all the other functional areas of organizing directing, and consists in the administration of the capital factor. We should know the financial need of the units that represent the general sum of the financial means that at a certain moments should remain by the economic unit for the development of its economic activity. It presents the absolute measure of the financial need at a certain moment. It is important to define which part of it is long-term one and which is short-term one, and other important problems.

To orient howsoever the directors of economic units in knowing better the financial problem

Global financial crises from etith point of view

Kreshnik Bello - Artur Temo - Edmond Bello

ABSTRACT: Careful examination of global financial crisis can reveal that alongside other negative effects, it triggered a global dilemma on the ethical aspect as well. Problems concerning the financial markets and their ethical implications suggest that this crisis and its causing factors should be thoroughly understood if we want to use its lessons to preventing future crisis of a similar kind. This work intends to contribute towards raising awareness of the Albanian academic community regarding the links that exist between lack of business ethics and crisis which lead towards loosing the public trust.

If we fail to understand the ethical problems surrounding this crisis, then global economy and financial markets are likely to face similar situations, thus repeating the very same mistakes which were neglected in this one. If the financial community is keen on understanding the ethical issues, first it has to gain a sound understanding of the organizational culture that prepared the ground for the creation of such assets as subprime loans. In this context, the question that comes naturally is: which were the forces that stimulated the creation and flourishing of the consumer's buying-through-loans culture.

This financial crisis had an impact not only on the developed economies, it touched and the less-than-developed ones too. Although many countries may have been faced with stronger local effects, the response should be coordinated on a global level. This proved to be a more effective approach to handle it. It was the coordinated collective intervention by several governments the one that made possible the effects to be minimized and controlled to a greater extent. (A Keynesian approach)

As the last experiences have shown, the stability of business and economic

success is far from being guaranteed forever, and so is the market economy itself. The globalization of economy and the issue of 'Global Capitalism' have brought along new risks and challenges. Business can successfully face them only if it employs sound ethical norms and greater corporate social responsibility of which the whole society can benefit.

The Development of the Capital Market in Albania and the necessity for a new Stock Exchange with private capital.

Artan Gjergji - Enkela Idrizi _____

ABSTRACT: Despite the development of the financial system at a relatively considerable level, banking sector remains still the most developed part of the whole system in Albania. On the other side, the country has an underdeveloped non-banking financial sector, with branches which do not have the same level of development. Of them, capital market is the most undeveloped part of the sector, even though during the last decade many important steps have been undertaken towards the improvement of the legal infrastructure and setting up of the key institutions, necessary for the development. Despite this fact, all these efforts could not managed to be realized with the development of the capital market in order to enable the business community to use Tirana Stock Exchange as a potential financing alternative. This study is an attempt to see the ways for the development of the capital market in Albania, taking of course into consideration the nonfunctioning of it so far. At the end we arrive at the conclusion that the appropriate time has come for the development of the capital market in Albania and the establishment of a new stock exchange with private capital, bringing arguments for all the factors which lead to this conclusion, as well as taking into consideration all the risks, challenges necessary to be undertaken for this important initiative.

The impact of the financial crises in the system of Social and Health Insurance in Albania.

Ilir Beqja - Enea Zafiri _____

ABSTRACT: During the period 2005-2009 the government of Albania has lower twice the payment for the social security contributions. The objectives were to fight the evasion, to grow the revenues of the pension scheme and to stimulate employment. None of these objectives was achieved. The reasons are found on the introduction of flat tax and on the wages and number of employees of reference that more than eroded the gain from a lower employment cost and, on the pensions' scheme it-self which stimulate evasion. The short-run effect of those interventions was a significant deterioration of the cash flow of the pension scheme and a distortion on the indicators that calculate the pensions' level. The long run effect will be felt mostly on macroeconomic variables.

Local Government crediting and the role of development funds

Benet Beci - Enea Hoti - Blendi Bushati _____

ABSTRACT: Decentralization and local autonomy demands self governing local government units with their elected authorities and democratic structures, which have large autonomy and competencies (authority) but also appropriate legal, administrative and financial tools to accomplish their mission and duties. In this aspect the financial decentralization is a key component to realize the principle of decentralization and local autonomy.

In this paper we will focus on the issue of the local borrowing as a financial instrument available for the local government units to finance their capital investments needs and in this contexts the role of the development funds, in the mean time presenting the international practice in this field and the role of the Albanian Development Fund in supporting investments needs of the local government units and the challenges in this direction.

Policies efficacy of Bank of Albania during Global Crises

Besart Kadia

ABSTRACT: This paper analyses the measures taken by the Bank of Albania at the wake of the global financial crisis. The analysis will be conducted at two phases where a clear distinction is made between the financial panic that engulfed most of the economic agents in Albania and the subsequent fall in new credit in the Albanian economy. This paper argues that the Bank of Albania has been very successful in dealing with the public bank panic through its media communications and the support for the rise of the bank deposit insurance. However the latest data on the economy raises many other long term issues on how the Albanian economy will continue to perform. This I suggest should be leading concern for the central bank.

Issues and challenges of managing microfinance in emerging countries: the case of Albania

Magdalena Bregasi - Eda Luga

ABSTRACT: The progress of institutional reforms, banking and financial environment shows that the direction of microfinance has undergone significant changes. Albanian banks are currently very interested to focus on microfinance. Non-bank financial institutions are focused on primary mission as a Albanian Partnership of Microcredit, BESA Foundation, etc. According to FORBES (2008), BESA Foundation is estimated at 43 positions comparing to 50 microfinance institutions in the world.

There are more than 100 Albanian society saving - credit, but to continue their activities in limited areas. In fact, despite the positive results achieved in recent years by financial and banking system in general, present difficulties in obtaining loans from banks, especially in the rural sector, where credit unions may finance only 4%. On the other hand, many risks are present among which stands out above the interest rate at 31% while savings deposits offer by 6-8 %.

As above, the paper focuses on management problems and challenges of microfinance in developing countries, especially focusing in Albania as well as lessons from global experience. It analyzes the interpretation of microfinance, identifies some lessons from experience globale and EU, after dwelling on the specifics of the development of microfinance in the country with a wider focus on rural areas, rural financial institutions compare in Albania as important actors for growth and support of rural credit and providing assistance to small business and finally, in need of a

rural bank to better support the process. The paper is based on literature review of foreign and domestic, in studies of international institutions as well as statistical data on microfinance institutions in Albania.

Analisy of financial assets and impact of financial crises on marketing expensures in albanian banking system

Jonida Këllezi - Valbona Zeneli - Oltjana Zoto _____

ABSTRACT: The last decade has faced the financial institutions with radical changes. More on this, globalization has increased the competition level, as well as the information flow, which has consequently erased the “loyal customer” of the past. In similar situations, these institutions consider marketing as critical to their success!

Marketing application in the banking sector has been firstly used in Western Countries, in the 1950. In the following years, the developments in this sector were more and more oriented from the market, which pushed the banks constantly in pursuing for new potential markets.

During the last years, the banking sector has been focused even more toward marketing due to several reasons, such as: the changes in the demographic structure, the increased competition in the financial sector, the goals of banks for own profits, etc. In fact, the marketing of banks does not include only the sales of products and service, but it is also considered as a function that creates personality and image of the banks in consumer's perceptions.

However, due to globalization, in a short period of time, the recent financial crisis has created an impact on developed and developing countries. Developed countries, such as US, have experienced failures of big companies, have had reduction in the level of employees, have experienced price increases, etc. On the other hand, developing countries, like Albania, have faced the effect of the crises on FDI, goods prices, incomes, etc.

Therefore, the aim of this paper is to analyze the impacts of this economic crisis on the marketing expenses in the Albanian banking sector. Experience so far has proven that in economic crises periods, companies have the tendency to reduce mainly the marketing budget. This situation has been observed even in this current crisis, where companies, including the Albanian banking sector, have minimized considerably their budgets in research and development, promotion, etc.

Analysis of the financial assets which impacts the development of the Private Pensions Fund.

Albana Demi - Armando Mosho

ABSTRACT: Private Pension funds are institutions that represent a structure and build long-term savings schemes based on collective accumulation of free capital. As such, they compete in the creation of capital through interest rate to offer investors and encourage investments in financial instruments like bonds or securities representing a major source of investment to secure more lucrative projects, aiming at preserving and creating an efficient portfolio.

Currently there is a banking market, which functions as the primary and secondary market for domestic debt titles (bonds). In this market, and Private Pension Funds, for capital to collect, provide much higher rate of profit. On the other hand, to meet the profit rate, capital collected re-invest in activities with efficient investment portfolio. Pension Funds and Investment originally collected invest capital in the financial instruments provided by the Albanian market today: deposits, treasury bills, real estate, Investing in Foreign Currency, Loans, Savings and Credit Society in fee; Shares private businesses; credit to businesses or individuals.

Developments policies of Private Pension Funds enable to each individual choose to invest in the Fund and make regular payments. In addition, employers may also pay contributions on behalf of their employees. Alternatives offered by the Pension Fund enables each individual to invest in order to secure its future. State personal account when the pension benefit is determined on the basis of the amount of contributions paid, the duration of the period of investment and fund investment performance. The involvement of individuals in private insurance scheme is contingent upon completion of pension reforms in the economic field. In our country currently are licensed by the FSA (Financial Supervisory Authority) and operate their 3 (three), a voluntary private pension funds that operate wholly-owned Albanian: Pensions RAIFFEISEN JSC "Capital", "SIGMA IPP" and included in the third column and the pension system is voluntary.

Abstract

Kreshnik Bello. Ilia Kristo, Edmond Bello dhe Artur Temo _____

Recent financial crisis, with its height in September 2008, was just the beginning of a economic crisis, which is considered by many economists as one of most severe crisis many countries have been facing. The globalization has enabled the growth of life standart in a lot of developing countries, but it could not deflect the domino effect of transferability of the economic crisis, from most developed countries to developing and poor ones, which have been hoping in the miracle of capitalism.

Albania is one of the European countries, that has been facing the crisis without much economic consequences, even having a positive economic growth (last year). Financial sector is not much developed, compared to that of western countries, and mainly this and some other reasons may have been motives why financial system in Albania was not hit with the same intensity with which other European economies were. Albanian financial system, global crisis and some other matters are the objective of this paper.

POLIS

ECONOMICUS

KRYEREDAKTOR: ADRIAN CIVICI

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT EKONOMIK
NR. 4, VJESHTË 2009

JUS & JUSTICIA

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT JURIDIK / NR. 3, VJESHTË 2009 / KRYEREDAKTOR: KSENOFON KRISAFI



Universiteti
European i
Tiranës



Mos shfieto, lexo!